

NË GJYKATËN THEMELORE TË PRISHTINËS

Lënda numër: P 766/12

17 shtator 2013

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons, kryetar, Gjyqtarja Shpresa Hasaj-Hyseni dhe Gjyqtarja e EULEX-it Mariola Pasnik, si anëtarë të trupit gjykues, dhe Nexhmije Mezini, si proces-mbajtëse, në lëndën penale kundër:

- I. **AK**, emri i babait X, emri i nënës X, lindur më X, në X, X, shqiptar i Kosovës, banues në X, X, ka kryer shkollën e mesme, X; i akuzuar me Aktakuzën e Prokurorit Special të EULEX-it PPS nr. 07/10, me datë dhe të ushtruar në shkrimtoren e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 25 korrik 2011 (këtej e tutje “Aktakuza”) me veprat penale:

Akuza 1:

Krim lufte kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 142, 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (këtej e tutje “KPRSFJ”), vepër e parashikuar edhe në nenet 120, 121 të Kodit Penal të Kosovës (këtej e tutje “KPK”), lidhur me nenet 22, 24, 26 të KPRSFJ-së dhe 23, 25, 26 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të Protokollit Shtesë II të katër Konventave të Gjenevës (këtej e tutje “PSHII”); i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK1, NK2, NS, BL, BS, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, **cenuan integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë**

dhe të burgosurish ushtarakë serbë, të paraburgosur në një qendër paraburgimi të improvizuar të UÇK-së në fshatin Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, të ftohtit e tepruar, mungesën e kushteve higjieno-sanitare, ushqyerjen e papërshtatshme, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4, 5(1) PSHII; i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK2, NS, RM, NK1** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb**, i paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, dhe mbetjet trupore të të cilit u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës, ku ndodheshin pesë trupa; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke i dhënë **NS**, kryerësi i drejtpërdrejtë i vrasjes, një kosë, megjithëse ai e dinte, sepse u informua qartë për qëllimin e **NS's** se ky i fundit do ta vriste të burgosurin me atë kosë; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 3:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK2, NS, NK1, BL** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e**

Nejbojša Djuričićit dhe Veljko Markovićit, dy policë serbë të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, të cilët u ekzekutuan nga dëshmitari bashkëpunues X me disa të shtëna arme zjarri të shkrepura nga një pistoletë; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke i vënë të dy të burgosurit të marshojnë në vendin e ekzekutimit dhe duke i mbajtur viktimat në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, megjithëse ai e dinte (sepse u informua qartë për urdhrat e **FL's**), ose të paktën mund ta parashihte lehtë nga urdhrat e marrë (duke i vënë të dy të burgosurit serbë të marshojnë deri në një vend të largët në pyll) çka do t'u ndodhte atyre; në një vend të quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, më ose rreth datave 04/05 prill 1999;

- II. **NK1**, pseudonimi X, emri i babait X, emri i nënës X, lindur më X, në fshatin X, Komuna e X, shqiptar i Kosovës, banues në fshatin X, Komuna e X, ka ndjekur studimet në fakultetin juridik, inspektor në X; i akuzuar në Aktakuzë me veprat penale:

Akuza 1:

Krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar dhe komandant i UÇK-së, dhe si person që mbante pozitë përgjegjësie mbi qendrën e paraburgimit të Kleçkës, në bashkëkryerje me **FL, NK2, NS, AKN, BL, BS, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, **cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, të ftohtit e tepruar, mungesën e kushteve higjeno-sanitare,

ushqyerjen e papërshtatshme, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2:

Krim lufte kundër popullatës civile, në shkelje të neneve 22, 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK2, NS** dhe **RM, vrau AA**, civil shqiptar i Kosovës i cili më parë ishte paraburgosur dhe liruar nga qendra e paraburgimit në Kleçkë, duke e qëlluar atë me një armë zjarri AK-47; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, më ose rreth datës 03/04 prill 1999;

Akuza 3:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **NK2, NS** dhe dy ushtarë të paignifikuar të UÇK-së, **mori pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë** të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës dhe u identifikuan përmes ADN-së si **BC, ZF** dhe **ZT**, të cilët u ekzekutuan me disa plumba të armës së zjarrit AK-47 nga një grup i përbërë nga **NK1, NK2, NS** dhe dy ushtarë të paignifikuar të UÇK-së; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 4:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK2 cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb**, i paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritur; më pas viktimia u vra dhe mbetjet trupore të tij u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës ku ndodheshin pesë trupa; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 5:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK2, NS, RM, AK** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb**, të përmendur nën Akuzën 4 më lart; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke e vënë të burgosurin të shkonte me marsh deri në pikën e ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë, **NS**, megjithëse ai e dinte, sepse u informua qartë për qëllimin e **NS's** për të vrarë të burgosurin nga biseda e mëparshme ndërmjet këtij të fundit dhe **FL**, se i burgosuri do të ekzekutohej, në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 6:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të

Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK2, NS, AK, BL** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e ND dhe VM, dy policë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, të cilët u ekzekutuan nga dëshmitari bashkëpunues X me disa të shtëna arme zjarri të shkrepura nga një pistoletë; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke i mbajtur viktimat në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, megjithëse ai e dinte, sepse u informua qartë për qëllimin e **FL** për të vrrarë të burgosurit, çka do t'u ndodhte atyre; në një vend të quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, më ose rreth datave 04/05 prill 1999;

- III. **NK2**, shenja e thirrjes gjatë luftës X, emri i babait X, emri i nënës X, i lindur më X, në fshatin x, Komuna e x, shqiptar i Kosovës, banues në X, x, ka ndjekur studimet në shkollë për drejtësi, X; i akuzuar në Aktakuzën e përmendur me veprat penale:

Akuza 1:

Krim lufte kundër popullatës civile dhe të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK1, NS, AK, BS, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X dhe **SS2** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, **cenuan integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, të ftohtit e tepruar, mungesën e kushteve higjieno-sanitare, ushqyerjen e papërshtatshme, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me dëshmitarin bashkëpunues X, **NS, SS1, BS, torturoi katër të burgosur ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës dhe të paktën tre prej të cilëve u identifikuan përmes ADN-së si **BC, ZF** dhe **ZT**, duke i rrahur ata në mënyrë të përsëritur; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 3:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **NK1, NS** dhe dy ushtarë të paignifikuar të UÇK-së, **mori pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës, tre prej të cilëve u identifikuan përmes ADN-së si **BC, ZF** dhe **ZT**, të cilët u ekzekutuan me disa plumba të armës së zjarrit AK-47 nga një grup i përbërë nga **NK1, NK2, NS**, dhe dy ushtarë të paignifikuar të UÇK-së; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 4:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK1, cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb**, i paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritur; më pas viktimë u vra dhe mbetjet trupore të tij u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës, ku ndodheshin pesë trupa; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 5:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK1, NS, RM, AK** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb**, të përmendur nën Akuzën 4 më lart; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke e vënë të burgosurin të shkonte me marsh deri në pikën e ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë, **NS**, megjithëse ai e dinte, sepse u informua qartë për qëllimin e **NS** për të varurë të burgosurin, nga biseda e mëparshme ndërmjet këtij të fundit dhe **FL**, se i burgosuri do të ekzekutohej; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 6:

Krim lufte kundër popullatës civile, në shkelje të neneve 22, 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK1, NS** dhe **RM, vrau AA**, civil shqiptar i Kosovës, i cili më parë ishte paraburgosur dhe liruar nga qendra e paraburgimit në Kleçkë, duke e qëlluar atë me një armë zjarri AK-47; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, më ose rreth datës 03/04 prill 1999;

Akuza 7:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK1, NS, AK, BL** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e ND dhe VM, dy policë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, të cilët u ekzekutuan nga dëshmitari bashkëpunues X me disa të shtëna arme zjarri të shkrepura nga një pistoletë; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke i mbajtur viktimat në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, megjithëse ai e dinte, sepse u informua qartë për qëllimin e **FL** për të vrrarë të burgosurit, çka do t'u ndodhte atyre; në një vend të quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, më ose rreth datave 04/05 prill 1999;

- IV. **BL**, emri i babait X, emri i nënës X, lindur më X, në fshatin X, Komuna e x, shqiptar i Kosovës, banues në fshatin X, Komuna e X, ka kryer shkollën fillore, X; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1:

Krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FLN, NK1, NK2, NS, AK, BS, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, **cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, të ftohtit e tepruar, mungesën e kushteve higjeno-sanitare, ushqyerjen e papërshtatshme, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK2, NS, NK1, AK** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e ND dhe VM, të dy policë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, të cilët u ekzekutuan nga dëshmitari bashkëpunues X me disa të shtëna arme zjarri të shkrepura nga një pistoletë; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke i vënë të dy të burgosurit të marshojnë në vendin e ekzekutimit dhe duke i mbajtur viktimat në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, megjithëse ai e dinte (sepse u informua qartë për urdhrat e **FL**), ose të paktën mund ta parashihte lehtë nga urdhrat e marrë (duke i vënë të dy të burgosurit serbë të marshojnë deri

në një vend të largët në pyll) çka do t'u ndodhte atyre; në një vend të quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, më ose rreth datave 04/05 prill 1999;

- V. **FL**, pseudonimet 'X' dhe 'X', emri i babait X, emri i nënës X, lindur më X, në fshatin X, Komuna e X, shqiptar i Kosovës, banues në X, X, ka ndjekur studimet në fakultetin juridik, X; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1:

Krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar dhe komandant i UÇK-së, dhe si person që ushtronte kontroll të përgjithshëm mbi qendrën e paraburgimit në Kleçkë, në bashkëkryerje me **NK1, NK2, NS, AK, BL, BS, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, **cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, të ftohtit e tepruar, mungesën e kushteve higjeno-sanitare, ushqyerjen e papërshtatshme, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të

PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar dhe komandant i UÇK-së, **torturoi një të burgosur ushtarak serb**, i paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilit u gjetën në një varr masiv ku ndodheshin pesë trupa, afër Kleçkës, duke e grushtuar dhe shqelmuar atë gjatë një marrjeje në pyetje; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 3:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar dhe komandant i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK2, NS, NK1, AK, BL** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e ND dhe VM, të dy policë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, të cilët u ekzekutuan nga dëshmitari bashkëpunues X me disa të shtëna të shkrepura nga një pistoletë; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke e urdhëruar dëshmitarin bashkëpunues X t'i ekzekutonte të burgosurit; në një vend të quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, më ose rreth datave 04/05 prill 1999;

- VI. **RM**, pseudonimi 'X', emri i babait X, emri i nënës X, lindur më X, në X, shqiptar i Kosovës, banues në X, ka kryer shkollën e mesme, X; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1:

Krim lufte kundër popullatës civile, në shkelje të neneve 22, 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të

PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK1**, **NK2** dhe **NS, vrau AA**, civil shqiptar i Kosovës, i cili më parë ishte paraburgosur dhe liruar nga qendra e paraburgimit në Kleçkë; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke e mbajtur viktimën në dispozicion të kryerësve dhe duke e shtyrë atë në një gropë, ku më pas ai u ekzekutua nga **NK1** dhe **NK2** me armë zjarri AK-47; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, më ose rreth datës 03/04 prill 1999;

Akuza 2:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK1**, **NS**, **NK2**, **AK** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb**; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke e vënë të burgosurin të shkonte me marsh deri në pikën e ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë, **NS**, megjithëse ai e dinte, sepse u informua qartë për qëllimin e **NS** për të vrarë të burgosurin, nga biseda e mëparshme ndërmjet këtij të fundit dhe **FL**, se i burgosuri do të ekzekutohej; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

- VII. **NS**, pseudonimi 'X', emri i babait X, emri i nënës X, lindur më X, në fshatin X, Komuna e X, shqiptar i Kosovës, banues në X, X, ka ndjekur studimet në fakultetin ekonomik, X; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1:

Krim luftime kundër popullatës civile dhe krim luftime kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, duke mbajtur pozitë përgjegjësie brenda qendrës së paraburgimit në Kleçkë, në bashkëkryerje me **FL, NK1, NK2, AK, BL, BS, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, **cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, të ftohtit e tepruar, mungesën e kushteve higjieno-sanitare, ushqyerjen e papërshtatshme, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2:

Krim luftime kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me dëshmitarin bashkëpunues X, **NK2, SS1, BS, torturoi katër të burgosur ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës dhe të paktën tre prej të cilëve u identifikuan përmes ADN-së si **BC, ZF** dhe **ZT**, duke i rrahur ata në mënyrë të përsëritur; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 3:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **NK1, NK2** dhe dy ushtarë të pidentifikuar të UÇK-së, **mori pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës, tre prej të cilëve u identifikuan përmes ADN-së si **BC, ZF** dhe **ZT**, të cilët u ekzekutuan me disa plumba të armës së zjarrit AK-47 nga një grup i përbërë nga **NK1, NK2, NS**, dhe dy ushtarë të pidentifikuar të UÇK-së; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 4:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK1, NK2, RM, AK** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **vrau një të burgosur ushtarak serb**, i paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilit u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës ku ndodheshin pesë trupa, duke e goditur disa herë në trup (dhe veçanërisht në qafë) me një kosë; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999 por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

Akuza 5:

Krim lufte kundër popullatës civile, në shkelje të neneve 22, 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK1**, **NK2** dhe **RM**, **mori pjesë në vrasjen e AA**, civil shqiptar i Kosovës, i cili më parë ishte paraburgosur dhe liruar nga qendra e paraburgimit në Kleçkë; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke e mbajtur viktimën në dispozicion të kryerësve dhe duke e shtyrë atë në një gropë në tokë, ku më pas ai u ekzekutua nga **NK1** dhe **NK2** me armë zjarri AK-47; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, më ose rreth datës 03/04 prill 1999;

Akuza 6:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL**, **NK1**, **NK2**, **AK**, **BL** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, **mori pjesë në vrasjen e ND dhe VM, dy policë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, të cilët u ekzekutuan nga dëshmitari bashkëpunues X me disa të shtëna të shkrepara nga një pistoletë; më konkretisht, i pandehuri mori pjesë në krim duke i mbajtur viktimat në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, megjithëse ai e dinte, sepse u informua qartë për qëllimin e **FL** për të vrarë të burgosurit, se çka do t'u ndodhte atyre; në një vend të quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, më ose rreth datave 04/05 prill 1999;

VIII. SS1, pseudonimi 'X', emri i babait X, emri i nënës X, lindur më X, në fshatin X, Komuna e X, shqiptar i Kosovës, banues në fshatin X, Komuna e X, ka kryer shkollën fillore, X; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1:

Krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK1, NK2, NS, AK, BL, BS**, dëshmitarin bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, **cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, të ftohtit e tepruar, mungesën e kushteve higjieno-sanitare, ushqyerjen e papërshtatshme, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me dëshmitarin bashkëpunues X, **NK2, NS, BS, torturoi katër të burgosur ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës dhe të paktën tre prej të cilëve u identifikuan përmes ADN-së si **BC, ZF dhe ZT**, duke i rrahur ata në mënyrë të përsëritur; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

- IX.** **SS2**, emri i babait X, emri i nënës X, lindur më X, në fshatin X, Komuna e X, shqiptar i Kosovës, banues në fshatin X, Komuna e X, ka kryer shkollën fillore, X; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1:

Krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK1, NK2, NS, AK, BL, BS, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X, dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, **cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, të ftohtit e tepruar, mungesën e kushteve higjeno-sanitare, ushqyerjen e papërshtatshme, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

- X.** **BS**, emri i babait X, emri i nënës X, lindur më X, në fshatin X, X, shqiptar i Kosovës, banues në X, X, i diplomuar për drejtësi, X; i akuzuar sipas Aktakuzës me veprat penale:

Akuza 1:

Krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave

të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK1, NK2, NS, AK, BL, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tani të paidentifikuar, **cenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, duke i mbajtur ata në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, mjediset e papërshtatshme, të ftohtit e tepruar, mungesën e kushteve higjeno-sanitare, ushqyerjen e papërshtatshme, rrahjet e shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999;

Akuza 2:

Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së; i akuzuari, në cilësinë e tij si pjesëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **NK2, NS dhe SS1, torturoi katër të burgosur ushtarakë serbë**, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë, mbetjet trupore të të cilëve u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës dhe të paktën tre prej të cilëve u identifikuan përmes ADN-së si **BC, ZF dhe ZT**, duke i rrahur ata në mënyrë të përsëritur; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill të vitit 1999, por jo përpara 11 prillit të vitit 1999;

PAS mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor të hapura për publikun më 18, 23, 24, 25 dhe 30 prill, 14, 15, 21, 28 dhe 29 maj; 5 qershor; 3, 16 dhe 18 korrik; 2, 4, 10, 11 dhe 17 shtator 2013, në prani të të akuzuarve **AK**, mbrojtëses së tij FGi-B; **NK1**, mbrojtësve të tij FV dhe XM; **NK2**, mbrojtësve të tij MH dhe BS; **BL**, mbrojtësit të tij MD; **FL**, mbrojtësve të tij KAAKQC, TR

dhe TG; **RM**, mbrojtësit të tij HM; **NS**, mbrojtësve të tij BT dhe Dr. DE; **SS1**, mbrojtësit të tij MS; **SS2**, mbrojtësit të tij TH; **BS**, mbrojtësit të tij AQ, përveç seancave kur mbrojtësit dërguan përfaqësuesit e tyre; dhe në prani të Prokurorit Special të EULEX-it, Maurizio Salustro, të Prokurorisë Speciale të Kosovës;

PAS këshillimit dhe votimit të mbajtur më 16 shtator 2013;

Në bazë të nenit 392 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, sot më 17 shtator 2013, në seancë të hapur dhe në prani të të gjithë të akuzuarve, mbrojtësve të tyre dhe Prokurorit Special të EULEX-it, shqipton këtë

AKTGJYKIM

1. **AK**, me shënimet personale si më lart, në arrest shtëpiak nga data 11 dhjetor 2012 deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor deri në datën 4 korrik dhe nga data 13 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (këtej e tutje “KPPK”)

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 142, 144 të KPRSFJ-së, veprë e parashikuar edhe në nenet 120, 121 të KPK-së, lidhur me nenet 22, 24, 26 të KPRSFJ-së dhe 23, 25, 26 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3

të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 3: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e policëve serbë **ND** dhe **VM**), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Më tej, në bazë të nenit 389 (1) të KPPK-së

Akuza 2: **HIDHET POSHTË** vepra e krimit të luftës kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb)¹, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së sepse prokurori e tërhoqi akuzën gjatë shqyrtimit gjyqësor;

2. **NK1**, me shënimet personale si më lart, në paraburgim nga data 24 dhjetor 2012 deri në datën 6 mars 2013 dhe në arrest shtëpiak nga data 6 mars deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor deri në datën 4 korrik dhe nga data 27 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së

¹Akuza 2 u tërhoq nga Prokurori Special i EULEX-it në bazë të Tërheqjes së Pjesshme të Aktakuzës, datë 9 nëntor 2011, të paraqitur në gjykatë më 11 nëntor 2011, të paraqitur në seancën e datës 11 nëntor 2011. Megjithatë, ajo Akuzë mbeti në Aktakuza.

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 2: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile (vrasjen e **AA**), në shkelje të neneve 22, 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 3: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 4: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një të burgosuri ushtarak serb), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së,

sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 5: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 6: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e policëve serbë **ND** dhe **VM**), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

3. **NK2**, me shënimet personale si më lart, në paraburgim nga data 24 nëntor 2012 deri në datën 6 mars 2013 dhe në arrest shtëpiak nga data 6 mars deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor deri në datën 4 korrik dhe nga data 27 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të pidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të

Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 2: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (torturim të katër të burgosurve ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 3: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 4: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një të burgosuri ushtarak serb), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 5: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në

shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 6: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile (vrasjen e **AA**), në shkelje të neneve 22, 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 7: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e policëve serbë **ND** dhe **VM**) në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

4. **BL**, me shënimet personale si më lart, në paraburgim nga data 11 dhjetor 2012 deri në datën 6 mars 2013 dhe në arrest shtëpiak nga data 6 mars deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor deri në datën 4 korrik dhe nga data 27 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani

vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 2: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e policëve serbë **ND** dhe **VM**), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

5. **FL**, me shënimet personale si më lart, në paraburgim nga data 24 nëntor 2012 deri në datën 6 mars 2013 dhe në arrest shtëpiak nga data 6 mars deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor deri në datën 4 korrik dhe nga data 27 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të pidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 2: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (torturim të një të burgosuri ushtarak serb), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 3: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e policëve serbë **ND** dhe **VM**), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

6. **RM**, me shënimet personale si më lart, në paraburgim nga data 11 dhjetor 2012 deri në datën 6 mars 2013 dhe në arrest shtëpiak nga data 6 mars deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor deri në datën 4 korrik dhe nga data 27 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile (vrasjen e **AA**), në shkelje të neneve 22, 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 2: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

7. **NS**, me shënimet personale si më lart, në paraburgim nga data 24 nëntor 2012 deri në datën 6 mars 2013 dhe në arrest shtëpiak nga data 6 mars deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor 2013 deri në datën 4 korrik 2013 dhe nga data 27 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 2: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (torturim të katër të burgosurve ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 3: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 4: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 5: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile (pjesëmarrje në vrasjen e **AA**), në shkelje të neneve 22, 142 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 6: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (pjesëmarrje në vrasjen e policëve serbë **ND** dhe **VM**), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

8. **SS1**, me shënimet personale si më lart, në paraburgim nga data 11 dhjetor 2012 deri në datën 6 mars 2013 dhe në arrest shtëpiak nga data 6 mars deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor 2013 deri në datën 4 korrik 2013 dhe nga data 27 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të paidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 2: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (torturim të katër të burgosurve ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

9. **SS2**, me shënimet personale si më lart, në arrest shtëpiak nga data 11 dhjetor 2012 deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor 2013 deri në datën 4 korrik 2013 dhe nga data 27 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të pidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani veprë e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

10. **BS**, me shënimet personale si më lart, në paraburgim nga data 11 dhjetor 2012 deri në datën 6 mars 2013 dhe në arrest shtëpiak nga data 6 mars deri në datën 6 qershor 2013 dhe nga data 13 qershor deri në datën 4 korrik dhe nga data 27 korrik deri në datën 2 shtator 2013, u gjet si më poshtë:

Në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së

Akuza 1: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës (cenim të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të pidentifikuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 142, 144 të KPRSFJ-së, tani veprë e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

Akuza 2: **JO FAJTOR** për krim lufte kundër të burgosurve të luftës (torturim të katër të burgosurve ushtarakë serbë), në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani veprë e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit

1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHI-së, sepse nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën me të cilën është akuzuar;

SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE DHE KËRKESË-PADIA PASURORE

Meqenëse të akuzuarit u gjetën jo fajtorë, shpenzimet e procedurës penale sipas nenit 99 (2) 1) deri në 5) të KPPK-së, shpenzimet e nevojshme të të pandehurve dhe shpërblimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësve, si dhe shpenzimet e përkthimit me gojë e me shkrim, do të paguhen nga buxheti i gjykatës sipas normave të zbatueshme, në bazë të nenit 103 (1) të KPPK-së .

Asnjë kërkesë-padi pasurore nuk është ushtruar. Prandaj, asnjë vendim nuk është marrë në bazë të nenit 396 (4) KPPK.

ARSYETIM

PËRMBAJTJA

A. Hyrje.....	38
i. Historia procedurale.....	38
ii. Juridiksioni.....	41
B. Konteksti politik dhe social.....	42
C. Ekzistenca dhe cilësimi i konfliktit të armatosur.....	43
D. Ligji.....	51
i. Ligji i zbatueshëm penal.....	51
ii. Ligji i zbatueshëm në Kosovë në kohën e veprave të pretenduara.....	51
iii. Natyra e konfliktit të armatosur.....	56
iv. Elementet e veprave përbërëse.....	59
a. Cenimi i integritetit trupor dhe shëndetit.....	59
b. Tortura.....	60
c. Vrasja.....	62
E. Shqyrtime lidhur me vlerësimin e prpvave.....	63
i. Barra dhe standardi i provës.....	63
ii. Vërtetimi i provave dhe deshmive.....	64
iii. Besueshmëria.....	65
F. Besueshmëria e AZ.....	66
i. Dëshmia e AGt.....	67
ii. Gjetjet.....	73

a.	Ditarët.....	73
b.	Historia psikiatrike.....	79
c.	Deklaratat.....	90
	(i) Vendet e varreve.....	91
	(ii) Vrasja e katër të burgosurve serbë.....	91
	(iii) Vrasja e të burgosurit serb të pestë.....	94
	(iv) Vrasja e VM dhe ND	97
	(v) Vrasja e AA	98
	(vi) Vrasja e SA dhe YG	98
d.	Provat mjeko-ligjore.....	99
	(i) Arkeologu mjeko-ligjor.....	99
	(ii) Patologu mjeko-ligjor.....	103
e.	Përfundime.....	105
	1. Pretendimet materiale.....	105
	2. Çështje të tjera lidhur me besueshmërinë.....	120
	(i) SD	120
	(ii) Deklarata e KFOR-it.....	127
	(iii) Deklaratat e TPNJ-së.....	128
	(iv) Faqetat e supozuara të bëra nga FL	131
	(v) Tentativat e supozuara për vetëvrasje	127
	(vi) Aksidentet rrugore.....	132
	(vii) ZK	132
	(viii) Prerja e paligjshme e pyjeve.....	134
	iii. Gjetjet lidhur me besueshmërinë e AZ	134
G.	Vlerësimi i provave	140
	i. Struktura e UÇK-së në vitin 1999.....	144
	ii. Ekzistenca e një burgu të UÇK-së në fshatin Kleçkë.....	149
	iii. Përgjegjësia për mbikëqyrjen e burgut të UÇK-së në fshatin Kleçkë.....	156
	iv. Trajtimi i të burgosurve të paraburgosur nga UÇK në fshatin Kleçkë.....	160
	a. Kushtet e paraburgimit.....	160
	b. Trajtimi i të burgosurve gjatë paraburgimit të tyre.....	164
	i. SA dhe YG	168

ii.	Vëllezërit B, E dhe NK2	170
iii.	Dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij.....	172
iv.	Torturimi i katër të burgosurve ushtarakë serbë.....	175
v.	Vrasja e një të burgosuri ushtarak serb.....	178
vi.	Vrasja e VM dhe ND	181
vii.	Vrasja e AA	182
H.	Përgjegjësia e të akuzuarve	184
i.	Mënyra e përgjegjësisë.....	184
a.	Përgjegjësia e komandimit.....	185
b.	Deklarimi i Përgjegjësisë së Lartë.....	197
ii.	Ligji mbi format e përgjegjësisë së të akuzuarve në Aktakuzë.....	207
I.	Gjetjet mbi përgjegjësinë e të akuzuarve	211
i.	AK	211
ii.	NK1	214
a.	Roli në burgun e Kleçkës.....	217
b.	Përgjegjësia.....	222
iii.	NK2	225
iv.	BL	234
v.	FL	236
a.	Roli në burgun e Kleçkës.....	237
b.	Përgjegjësia.....	247
vi.	RM	248
vii.	NS	250
a.	Roli në burgun e Kleçkës.....	253
b.	Përgjegjësia.....	254
viii.	SS1	255
ix.	SS2	257
x.	BS	259
	MJETI LIGJOR	261
	SHTOJCA I Dëshmitë e dëshmitarëve	262

SHTOJCA II Provat e paraqitura nga Akuza.....	265
SHTOJCA III Provat e paraqitura nga Mbrojtja.....	278

Shtojcat e bashkëngjitura janë pjesë përbërëse e këtij Aktgjykimi.

A. HYRJE

I. Historia procedurale

Aktakuza e Prokurorit Special të EULEX-it, PPS nr. 07/10, datë 25 korrik 2011, i akuzonte të akuzuarit **AK, NK1, NK2, BL, FL, RM, NS, SS1, SS2** dhe **BS**, me krime të supozuara të kryera prej tyre nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999, kundër civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë në dhe afër fshatit Kleçkë në Kosovë.

Aktakuza i ka akuzuar të akuzuarit me 34 akuza për krime lufte kundër popullatës civile dhe të burgosurve serbë të luftës, në shkelje të neneve 142, 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, vepër e parashikuar edhe në nenet 120 dhe 121 të Kodit Penal të Kosovës, lidhur me nenet 22, 24 dhe 26 të KPRSFJ-së dhe nenet 23, 25 dhe 26 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949, dhe nenet 4, 5 (1) të Protokollit II Shtesë të katër Konventave të Gjenevës, të gjitha rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë.

Akuza 2² kundër të akuzuarit **AK** u tërhoq nga Prokurori Special i EULEX-it më 9 nëntor 2011.³ Aktakuza nuk u ndryshua para fillimit të rishqyrtimit gjyqësor. Megjithatë, më 18 prill 2013, në fillim të rishqyrtimit gjyqësor, prokurori konfirmoi se Akuza 2 kundër AKt ishte tërhequr.

² Krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 22, 144 të KPRSFJ-së, tani vepër e dënueshme sipas neneve 23, 120 të KPK-së, në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe neneve 4, 5(1) të PSHII-së

³ Tërheqje e pjesëshme e Aktakuzës nga PSRK, 9.11.2011, PPS 07/10, Dosja 4 e Shqyrtimit Gjyqësor.

Aktakuza pretendonte se një numër i papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurish ushtarakë serbë u paraburgosën në një qendër paraburgimi të improvizuar të UÇK-së, të ndodhur në fshatin Kleçkë në Komunën e Lipjanit, në kushte çnjerëzore dhe u bënë objekt rrahjesh në mënyrë rutinë. Aktakuza tregoi emrat e katërmbëdhjetë personave të cilët pretendohesh se kishin qenë të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në fjalë.

Aktakuza pretendonte se dy prej të paraburgosurve të treguar me emër u ekzekutuan me armë zjarri në një vend të quajtur Livadhi i Canit afër fshatit Kleçkë më ose rreth datave 4 ose 5 prill 1999. Njëri prej të paraburgosurve të treguar me emër pretendohesh se u torturua dhe më pas u ekzekutua me një teh kose në prill të vitit 1999, jo përpara datës 11 prill 1999. Katër prej të paraburgosurve të treguar me emër pretendohesh se u rrahën një ditë të tërë dhe disa ditë më pas, dhe u ekzekutuan me armë zjarri në Kleçkë në prill të vitit 1999, jo para datës 11 prill 1999.

Aktakuza pretendonte se një i paraburgosur tjetër i treguar me emër, pasi ishte liruar, ishte ekzekutuar me armë zjarri në Kleçkë më ose rreth datave 3 ose 4 prill 1999.

Të akuzuarit **AK, NK1, NK2, BL, FL, RM, NS, SS1, SS2** dhe **BS** u akuzuan me përgjegjësi penale individuale për kinse kryerjen dhe, në shkallë të ndryshme, pjesëmarrjen në kryerjen e krimeve.

Në Aktakuzë, i akuzuari **FL** përmendet si komandant dhe si person që ushtronte kontroll të përgjithshëm mbi qendrën e paraburgimit në Kleçkë në lidhje me cenimin e integritetit trupor dhe shëndetit të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë⁴, dhe si komandant⁵ në lidhje me torturimin e një të burgosuri ushtarak serb dhe vrasjen e dy oficerëve ushtarakë serbë, të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në Kleçkë.

⁴ Akuza 1 kundër **FL**

⁵ Akuzat 2 dhe 3 kundër **FL**

Në Aktakuzë, i akuzuari **NK1** përmendet si komandant dhe person që mbante pozitë përgjegjësie mbi qendrën e paraburgimit në Kleçkë⁶ në lidhje me cenimin e integritetit trupor dhe shëndetit të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë.

Në Aktakuzë, i akuzuari **NS** përmendet si person në pozitë përgjegjësie brenda qendrës së paraburgimit në Kleçkë⁷.

Më 30 mars 2012, gjykata e ndau lëndën kundër **NK1, NK2, FL** dhe **NS**.

Më 2 maj 2012 u shqiptua Aktgjykimi në lëndën P. nr. 425/11, në procedurën penale kundër **NK1, NK2, FL** dhe **NS**. Të katër të pandehurit u liruan nga akuzat në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së.

Më 30 mars 2012 u shqiptua Aktgjykimi në lëndën P. nr. 425/11 në procedurën penale kundër **AK, BL, RM, SS1, SS2** dhe **BS**. Të gjashtë të pandehurit u liruan nga akuzat në bazë të nenit 390 (3) të KPPK-së.

Më 20 nëntor 2012⁸ dhe 11 dhjetor 2012⁹, Gjykata Supreme i ktheu për rishqyrtim gjyqësor lëndët kundër të dhjetë të pandehurve. Gjykata Supreme nuk hoqi, as komentoji në kundërshtim me gjetjet faktike të trupave gjykuese të shqyrtimit të parë gjyqësor.

Gjetjet e Gjykatës Supreme në të dy lëndët kishin të bënë pikësëpari me pranueshmërinë e dëshmisë së **AZ**. Njëra prej çështjeve që duhej të përcaktohej nga ky Trup Gjykues ishte çfarë peshe, nëse ka, mund t'i bashkëngjitej dëshmisë së **AZ**.

⁶ Akuza 1 kundër **NK1**

⁷ Akuza 1 kundër **NS**

⁸ Lënda numër Ap-Kz. nr. 453/2012 (**NK1, NK2, FL** dhe **NS**)

⁹ Lënda numër Ap-Kz. nr. 527/2012 (**AK, BL, RM, SS1, SS2** dhe **BS**)

Meqenëse të dyja lëndët u kthyen për rishqyrtim gjyqësor, më 11 shkurt 2013 gjykata shqiptoi një aktvendim që i bashkonte sërish të dyja lëndët.

Të akuzuarit u deklaruan jo fajtorë për të gjitha akuzat kundër tyre në Aktakuzë.

II. JURIDIKSIONI

Në bazë të Nenit 23 (1) të KPPK-së, 'Kompetencë e gjykatës së qarkut është të gjykojë në shkallë të parë veprën penale të dënueshme me të paktën pesë vjet burgim ose burgim afatgjatë'. Aktakuza e Prokurorit Special të EULEX-it i ngarkon të akuzuarit me krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës, që është e dënueshme me të paktën pesë vjet burgim. Prandaj, gjykata e qarkut ka kompetencë lëndore në këtë lëndë.

Ligji për Gjykatat që hyri në fuqi më 1 janar 2013, i riklasifikoi gjykatat e qarkut si gjykata themelore.

Krimet e pretenduara u kryen në ose afër fshatit Kleçkë, Komuna e Lipjanit. Komuna e Lipjanit përfshihet brenda juridiksionit të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Për rrjedhojë, kjo gjykatë ka kompetencë territoriale në lëndë, në bazë të nenit 27 (1) të KPPK-së.

Neni 5.1 i Ligjit për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës¹⁰ i jep PSRK-së kompetencë ekskluzive të hetojë dhe ndjekë penalisht krimet e luftës.

Neni 3.2 i Ligjit për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë¹¹ parashikon që gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetencë në lëndët e ndjekura penalisht nga PSRK. Rrjedhimisht, Gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetencë në këtë lëndë.

¹⁰ Numër 03/L-052

¹¹ Numër 03/L-053

B. KONTEKSTI POLITIK DHE SOCIAL

Gjykata bën shënim gjyqësor të faktit se Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (“RSFJ”) e vitit 1974 e emëroi Kosovën si provincë autonome brenda Republikës së Serbisë dhe subjekt përbërësi i RSFJ-së¹².

Më tej, më 28 mars 1989, Kuvendi i Republikës së Serbisë e ndryshoi Kushtetutën duke e hequr statusin autonom të Kosovës.

Më tej, në vitin 1990, Kuvendi i Kosovës dhe qeveria krahinore u shfuqizuan.

Më tej, në mars të vitit 1990, Kuvendi i Republikës së Serbisë miratoi ligje të reja që i ndalonin shqiptarët e Kosovës të punonin në institucione politike dhe ekonomike. Studentëve dhe profesorëve shqiptarë të Kosovës iu refuzua qasja në universitete.

Pas kësaj vijoi një periudhë trazirash gjatë së cilës u formuan parti të ndryshme politike. Pothuajse pashmangshëm, tensionet politike dhe sociale u shndërruan në rezistencë të armatosur. Fillimisht këto ishin disi sporadike dhe të fshehta. Megjithatë, në ose rreth marsit 1993 lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës (këtej e tutje “UÇK”).

UÇK mbështeti rezistencën e armatosur kundër regjimit zyrtar. Organi drejtues i UÇK-së ishte Shtabi i Përgjithshëm.

Ndërmjet viteve 1993 dhe 1997 situata në Kosovë vazhdoi të përkeqësohej. Nga fundi i vitit 1997 dhe fillimi i vitit 1998 pati konflikt të hapur ndërmjet UÇK-së dhe forcave serbe.

¹² Nenet 1, 2 dhe 4 të Kushtetutës së vitit 1974.

C. EKZISTENCA DHE CILËSIMI I KONFLIKTIT TË ARMATOSUR

Aktakuza e ngarkon secilin të akuzuar me veprat penale të krimit të luftës kundër popullatës civile dhe krimit të luftës kundër të burgosurve të luftës.

Në bazë të Rregullores 1999/24 të UNMIK-ut¹³, të ndryshuar me Rregulloren 2000/59 të UNMIK-ut¹⁴, dispozita të zbatueshme të ligjit penal material ishin dispozitat e Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, me ndryshimet e miratuara përmes Rregulloreve të lart-përmendura të UNMIK-ut.¹⁵

Në bazë të nenit 142 të KPRSFJ-së, vepra penale e krimit të luftës kundër popullatës civile kryhej nga

'Çdo njeri i cili në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në kohë lufte, konflikti të armatosur ose pushtimi, urdhëron që popullata civile të bëhet objekt i vrasjes, torturës, trajtimit çnjerëzor, eksperimenteve biologjike, vuajtjeve të mëdha, ose cenimit të integritetit trupor ose shëndetit; shpërnguljes ose zhvendosjes, ose shndërrimit me forcë në një kombësi ose fe tjetër; prostituimit me forcë ose përdhunimit; zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit, marrjes së pengjeve, caktimit të dënimit kolektiv, dërgimit të paligjshëm në kampe përqendrimi, dhe arrestimeve dhe paraburgimeve të tjera të paligjshme, heqjes së të drejtave për shqyrtim gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm; shërbimit të detyruar në forcat e armatosura të ushtrisë armike, ose shërbimit të kundërzbulimit ose administratës së saj; punës së detyruar, urisë së popullatës, konfiskimit të pasurisë, plaçkitjes, shkatërrimit të paligjshëm dhe të vetë-dëshiruar dhe vjedhjes së

¹³ 12 dhjetor 1999

¹⁴ 27 tetor 2000

¹⁵ Dënimi me vdekje u shfuqizua në bazë të nenit 1.5. Në bazë të nenit 1.6 të Rregullores 2000/59 të UNMIK-ut, për çdo vepër të dënueshme me vdekje sipas ligjit në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, ky dënim me vdekje shndërrohet të burgim afatgjatë nga minimumi i parashikuar në ligj për atë vepër deri në maksimumi dyzet (40) vjet.

pasurisë në shkallë të gjerë, që nuk është e justifikuar me nevojat ushtarake, marrjes së një kontributi ose rekuizimit të paligjshëm dhe shpërpjesëtimor, zhvlerësimit të monedhës vendase ose emetimit të paligjshëm të monedhave, ose i cili kryen ndonjërin nga aktet e mësipërme’.

Në bazë të nenit 144 të KPRSFJ-së, vepra penale e krimit të luftës kundër të burgosurve të luftës kryhet nga

‘Çdo njeri i cili në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare urdhëron vrasje, torturë, ose trajtim çnjerëzor të të burgosurve të luftës, përfshirë këtu eksperimentet biologjike, duke shkaktuar vuajtje ose lëndim të rëndë të integritetit trupor ose shëndetit, rekrutim të detyrueshëm në forcat e armatosura të një fuqie armike, ose privim të së drejtës për proces gjyqësor dhe të paanshëm, ose i cili kryen ndonjërin prej veprimeve të mësipërme’.

Aktakuza pretendon se të akuzuarit vepruan në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 (këtej e tutje “Neni i Përbashkët 3 i KGJ 1949”) dhe neneve 4 dhe 5 (1) të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konfliktit të Armatosur Jo-ndërkombëtar të 8 qershorit 1977.

Neni 3 i Përbashkët i Konventave të Gjenevës të vitit 1949 parashikon:

Në rast konflikti të armatosur të karakterit jo ndërkombëtar, që ndodh në territorin e njëjës prej Palëve të Larta Kontraktuese, secila Palë në konflikt është e detyruar të zbatojë, më së paku, këto dispozita:

(1) Personat të cilët nuk marrin pjesë aktive në luftime, përfshirë pjesëtarët e forcave të armatosura të cilët kanë dorëzuar armët dhe ata të cilët janë nxjerrë jashtë luftimit për

shkak të mundjes, plagosjes, paraburgimit, ose për ndonjë shkak tjetër, në të gjitha rrethanat duhet të trajtohen në mënyrë njerëzore, pa asnjë dallim të kundërt të bazuar në racë, ngjyrë, fe ose besim, gjini, lindje ose pasuri, ose ndonjë kriter tjetër të ngjashëm.

Për këtë qëllim, aktet vijuese janë dhe do të mbeten të ndaluara në çfarëdo kohe dhe vendi për sa u përket personave të lart-përmendur: (a) dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasjet e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi çnjerëzor dhe torturimi; (b) marrja e pengjeve; (c) sjellja e dhunshme ndaj dinjitetit personal, në veçanti trajtimi poshtëruës dhe denigrues; (d) shqiptimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa aktgjykim paraprak të shpallur nga gjykatat me përbërje të rregullt, që jep të gjitha garancitë ligjore që janë të njohura si të pandashme nga popujt e qytetëruar.

(2) Të plagosurit dhe të sëmurët do të grumbullohen dhe për ta do të ketë përkujdesje.

Një organ i paanshëm humanitar, si Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, mund t'u ofrojë shërbimet e tij palëve në konflikt.

Palët në konflikt duhet të bëjnë çmos që të sjellin në fuqi, me anë të marrëveshjeve të veçanta, të gjitha apo disa pjesë të dispozitave të tjera të Konventës aktuale.

Zbatimi i dispozitave paraprake nuk e cenon statusin ligjor të palëve në konflikt.

Neni 4 i Protokollit Shtesë II të vitit 1977 (trajtimi çnjerëzor) parashikon:

1. Të gjithë personat të cilët nuk marrin pjesë drejtpërdrejt, ose kanë pushuar së marri pjesë në luftime, pa marrë parasysh nëse liria e tyre është kufizuar apo jo, gëzojnë të drejtën e respektit ndaj personit, nderit dhe ndaj bindjeve dhe praktikave fetare të tyre. Në të gjitha rrethanat, ata do të trajtohen në mënyrë njerëzore, pa dallime të kundërta. Është e ndaluar të urdhërohet që të mos ketë asnjë të mbijetuar.

2. Pa paragjykuar përgjithësimet e mësipërme, aktet vijuese kundër personave të përmendur në paragrafin 1 janë dhe do të mbeten të ndaluara në çfarëdo kohe dhe vendi: (a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike apo mendore të personave, veçanërisht vrasja dhe trajtimi mizor i tillë si tortura, gjymtimi apo çdo formë e ndëshkimit trupor; (b) ndëshkimet kolektive; (c) marrja e pengjeve; (d) aktet e terrorizmit; (e) sjellja e dhunshme ndaj dinjitetit personal, veçanërisht trajtimi poshtërues dhe degradues, përdhunimi, prostitucioni i detyruar dhe çdo formë sulmesh seksuale; (f) skllavëria dhe tregtia me skllavër të të gjitha formave; (g) plaçkitja; (h) kërcënimet për kryerjen e ndonjë akti ose ndonjërit prej akteve të mësipërme.

3. Fëmijëve do t'u ofrohet kujdesi dhe ndihma e nevojshme, dhe veçanërisht: (a) atyre do t'u ofrohet arsim, përfshirë arsimin fetar dhe moral, në përputhje me dëshirat e prindërve të tyre, ose, në mungesë të prindërve, të atyre që janë përgjegjës për kujdesin ndaj tyre; (b) do të ndërmerren të gjitha hapat e duhur për të lehtësuar bashkimin e familjeve të ndara përkohësisht; (c) fëmijët që nuk e kanë arritur moshën 15 vjeç, nuk do të rekrutohen në forcat apo grupet e armatosura, as do të lejohen të marrin pjesë në luftime; (d) mbrojtja e veçantë që ky nen u siguron fëmijëve të cilët nuk e kanë arritur ende moshën 15 vjeçare, do të mbetet e zbatueshme për ta nëse ata marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime, pavarësisht dispozitave të nën-paragrafit (c) dhe nëse ata zihen robër; (e) nëse shihet e nevojshme dhe, kurdo që është e mundur, me pëlqimin e prindërve të tyre, apo të personave të cilët me ligj apo zakon janë përgjegjës për kujdesin ndaj tyre, do të ndërmerren masa për t'i larguar fëmijët përkohësisht nga zonat e luftimeve në një zonë më të sigurt brenda shtetit të tyre dhe do të sigurohet që ata të jenë të shoqëruar nga personat që janë përgjegjës për sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

Neni 5 (1) të Protokollit Shtesë II të vitit 1977 (Personat të cilëve u është kufizuar liria) parashikon:

Krahas dispozitave të nenit 4, dispozitat vijuese do të respektohen më së paku lidhur me personat të cilëve u është privuar liria për arsyet që lidhen me konfliktin e armatosur, pa marrë parasysh nëse janë të internuar ose të paraburgosur (a) të plagosurit dhe të sëmurët do të trajtohen në përputhje me Nenin 7; (b) personave të cilët përmenden në këtë paragraf do t'u ofrohet, në të njëjtën mënyrë si popullatës vendore civile, ushqim dhe ujë i pijshëm dhe do t'u jepen garanci lidhur me shëndetin dhe higjienën dhe mbrojtjen kundër klimës së ashpër dhe rreziqeve të konfliktit të armatosur; (c) ata do të lejohen të marrin ndihmë individuale dhe kolektive; (d) ata do të lejohen të praktikojnë besimin e tyre dhe, nëse kërkohet dhe është e mundur, të marrin ndihmë shpirtërore nga persona, si kapelanët, të cilët kryejnë funksione fetare; (e), nëse vihen të punojnë, ata do të përfitojnë kushte dhe mbrojtje në punë, të ngjashme me ato që gëzon popullata civile vendore

Me qëllim që të përcaktohet nëse veprat penale të pretenduara përbëjnë krime lufte, trupi gjykses duhet të përcaktojë së pari nëse, gjatë periudhës përkatëse në vitin 1999 konflikti në Kosovë arriti shkallën e konfliktit të armatosur. Vetëm ekzistenca e konfliktit të armatosur do të shkaktoje zbatimin e neneve 142 dhe 144 të KPRSFJ-së.

Prandaj, që veprat penale të përbëjnë krime lufte, duhet të vendoset lidhja me konfliktin e armatosur. Trazirat dhe tensionet e brendshme (siç janë revoltat, aktet e izoluar dhe sporadike të dhunës, ose akte të tjera me natyrë të ngjashme) nuk arrijnë deri në konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar.

Sipas Konventave të Gjenevës, konflikti i armatosur ndërkombëtar përkufizohet si:

“të gjitha rastet e luftës së shpallur, ose të ndonjë konflikti tjetër të armatosur, që mund të lindin mes dy apo më shumë Palëve të Larta Kontraktuese, edhe nëse gjendja e luftës nuk njihet nga njëra palë’.

‘Konflikti i armatosur’ si i tillë nuk është përkufizuar në Konventat e Gjenevës.

Përkufizimi i përdorur më gjerësisht për *konfliktin e armatosur të brendshëm* është përkufizimi i formuluar nga Dhoma e Apelit e Tribunalit Penal Ndërkombëtar të Hagës për ish-Jugosllavinë (këtej e tutje “TPNJ”) në lëndën *Tadić*:

‘Konflikti i armatosur ekziston kurdoherë që ka përdorim të forcës së armatosur ndërmjet shteteve, apo kur ka dhunë të armatosur të zgjatur mes autoriteteve shtetërore dhe grupeve të organizuara të armatosura brenda një shteti. E drejta ndërkombëtare humanitare zbatohet që në fillim të konflikteve të tilla dhe vazhdon përtej pushimit të luftimeve, deri në arritjen e një vendosjeje të përgjithshme të paqes; ose, në rastin e konflikteve të brendshme, deri në arritjen e një zgjidhjeje paqësore. Deri në atë moment, e drejta ndërkombëtare humanitare vazhdon të zbatohet në të gjithë territorin e shteteve ndërluftuese apo, në rastin e konflikteve të brendshme, në të gjithë territorin që gjendet nën kontrollin e njëres palë, pavarësisht nga fakti nëse atje zhvillohen luftime konkrete apo jo.’¹⁶

Neni 3 i Përbashkët i KGJ 1949 i referohet konfliktit të armatosur jo me ‘karakter ndërkombëtar’ dhe parashikon se ai duhet të ndodhë ‘në territorin e njëres prej Palëve të Larta Kontraktuese’.

Pragu sipas Protokollit Shtesë II është më i qartë. Në bazë të Neni 1.1, Protokollin zbatohet vetëm për konfliktet mes forcave të armatosura të një Pale të Lartë Kontraktuese ‘*dhe forcave të armatosura disidente ose grupeve të tjera të armatosura të organizuara, të cilat, nën komandën përgjegjëse, ushtrojnë kontroll të tillë mbi një pjesë të territorit, që u mundëson atyre të kryejnë operacione të qëndrueshme dhe të përqendruara ushtarake*’. Ashtu si Neni i

¹⁶ *Prokurori kundër Duško Tadićit*, TPNJ, Vendim i Dhomës së Apelit lidhur me Kërkesën e Mbrojtjes për Ankesën e Përkohshme mbi Juridiksionin, 02.10.1995, paragrafi 70.

Përbashkët 3 i KGJ 1949, ky Nen parashikon që konflikti duhet të zhvillohet “*brenda territorit të një Pale të Lartë Kontraktuese*’.¹⁷

Informacionet dhe provat ekzistuese lidhur me strukturën dhe veprimtarinë e UÇK-së në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999, siç është konstatuar nga trupi gjykues i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (TPNJ), duke filluar së paku nga mesi i vitit 1998, ilustron se UÇK ishte një ‘*grup i armatosur i organizuar*’. Ndërkohë që aspekte të ndryshme të organizimit dhe veprimtarive të UÇK-së në atë periudhë u zhvilluan me hapa të ndryshëm, pati një progres gradual drejt centralizimit të autoritetit dhe bashkërendimit të përpjekjeve kundër forcave të RSFJ-së/serbe. Gjatë vitit 1998, UÇK formoi shtabin e përgjithshëm dhe shtatë qendra të zonave operative nën varësinë e saj, vendosi rregulla që përcaktonin strukturën e trupave dhe disiplinën ushtarake, ndërmori sulme të bashkërenduara kundër forcave të RSFJ-së/serbe, ngriti një operacion financiar, kontrabandoi dhe/ose bleu sasi të mëdha armësh, institucionalizoi përdorimin e emblemës dalluese të UÇK-së, dhe zbatoi politika strategjike në përputhje me qëllimet e saj të mëtejshme.¹⁸

Praktika gjyqësore e TPNJ-së dhe e Gjykatës Supreme të Kosovës ka përcaktuar se në Kosovë ka pasur një konflikt të vazhdueshëm të armatosur, të paktën që në fillim të pranverës së vitit 1998 e tutje, mes forcave (qeveritare) të armatosura serbe dhe UÇK-së, që vazhdoi deri në vitin 1999.¹⁹ Në lëndën *Milutinović* dhe *Đorđević*, TPNJ përcaktoi shprehimisht se konflikti i armatosur vazhdoi deri në qershor të vitit 1999.²⁰

¹⁷ Manuali mbi Të Drejtën e Konfliktit të Armatosur Jo-ndërkombëtar me Komentar, Instituti Ndërkombëtar i së Drejtës Humanitare, San Remo 2006, gjendet në: <http://ëëë.dur.ac.uk/resources/laë/NIACManualIYBHR15th.pdf>

¹⁸ *Prokurori kundër Milan Milutinović*, TPNJ, Aktgjykim i datës 26 shkurt 2009, paragrafët 840-841.

¹⁹ Shih, p.sh. *Prokurori kundër Milan Milutinović*, TPNJ, Aktgjykim i Shqyrtimit Gjyqësor, 26 shkurt 2009, paragrafët 840-841; *Prokurori kundër Vlastimir Đorđević*, TPNJ, Aktgjykim i Shqyrtimit Gjyqësor, 23 shkurt 2011, paragrafi 1579 ff; *Prokurori kundër FL*, Haradin Balës, Isak Musliut, TPNJ, Aktgjykim i Shqyrtimit Gjyqësor, 30 nëntor 2005, paragrafi 171 ff (Trupi Gjykues shqyrtoi një periudhë në vitin 1998, por gjithashtu vërejtë se konflikti i armatosur vazhdoi shumë më gjatë se korriku i vitit 1998); *Prokurori kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt, Lahi Brahimajt*, TPNJ, Aktgjykim i Shqyrtimit Gjyqësor, 03 prill 2008, paragrafi 100 (Dhoma e Apelit më 21 korrik 2012 urdhëroi rishqyrtim të pjesshëm të çështjes që gjendet në zhvillim e sipër).

²⁰ Shih lëndët përkatëse me numër reference po aty.

Për sa i përket periudhës së mbuluar nga Aktakuza në lëndën aktuale, ekzistenca e konfliktit të armatosur është përcaktuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës në Vendimin në lëndën *Kolasinac* më 5 gusht 2004 dhe në Vendimin në lëndën e *Latif Gashit* më 21 korrik 2005.

Trupi gjykues gjen se konflikti i armatosur ekzistoi vërtet në Kosovë gjatë gjithë periudhës përkatëse që përmendet në Aktakuzë dhe vazhdoi deri sa u vendosën kushtet e planit ndërkombëtar të paqes, për të cilin u ra dakord ndërmjet NATO-s dhe RFJ-së më 9 qershor 1999.

Ndërkohë që cilësimi i konfliktit të armatosur si konflikt i brendshëm i armatosur përpara përfshirjes së NATO-s është përcaktuar më së miri, ngrihet pyetja nëse me fillimin e sulmeve ajrore të NATO-s në mars të vitit 1999 konflikti arriti nivelin e *konfliktit të armatosur ndërkombëtar*. Trupi gjykues i TPNJ-së në çështjen *Dorđević* e trajtoi këtë çështje dhe iu përgjigj në mënyrë pozitive. Trupi gjykues i TPNJ-së arriti në këtë përfundim:

*'Trupi gjykues është i siguarar se nga fundi i muajit maj të vitit 1998 në Kosovë ekzistonte konflikt i armatosur mes forcave serbe, në veçanti të UJ-së dhe policisë serbe, dhe UÇK-së. Ky konflikt i armatosur vazhdoi së paku deri në qershor të vitit 1999. Më 24 mars 1999, NATO filloi operacionet e saj ushtarake në RFJ. Në të njëjtën ditë, qeveria e RFJ-së shpalli gjendjen e luftës. Mbi këtë bazë, trupi gjykues pajtohet se që nga data 24 mars 1999 e deri në përfundim të luftimeve në qershor të vitit 1999, në Kosovë ekzistoi një konflikt i armatosur ndërkombëtar mes forcave serbe dhe forcave të NATO-s.'*²¹

Me qëllim përcaktimin e ligjit të zbatueshëm në këtë lëndë, trupi gjykues, megjithatë, nuk ka nevojë të bëjë një përcaktim të natyrës së konfliktit të armatosur ekzistues. Edhe nëse konflikti i armatosur pas përfshirjes së NATO-s duhet cilësuar si konflikt i armatosur ndërkombëtar, detyrimet e mishëruara në Nenin e Përbashkët 3 të KGJ 1949 dhe PSHII 1977 do të vazhdonin të zbatoheshin. Vlefshmëria e Nenit të Përbashkët 3, siç është theksuar në mënyrë vazhdueshme

²¹ *Prokurori kundër Vlastimir Dorđevićit*, TPNJ, Aktgjykim i trupit gjykues, 23 shkurt 2011 paragrafët 1579, 1580 (ankesa në këtë çështje është ende në pritje të vendosjes përpara Dhomës së Apelit).

nga komentuesit, nuk kufizohet në konfliktin e brendshëm të armatosur. Ky i fundit përfaqëson *minimumin* që duhet të zbatohet në konfliktet më pak të përcaktuara. Prandaj kushtet e këtij Neni duhet të respektohen *a fortiori* në rastin e konflikteve tipike ndërkombëtare, kur janë të zbatueshme të gjitha dispozitat e Konventave të Gjenevës.²²

D. LIGJI

I. Ligji i zbatueshëm penal

Aktakuza e ngarkon secilin të akuzuar me përgjegjësi për krim lufte kundër popullatës civile dhe krim lufte kundër të burgosurve të luftës, në shkelje të neneve 142 dhe 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe neneve 120 dhe 121 të Kodit Penal të Kosovës. Veprat e pretenduara përbërëse përfshijnë këto: cenim i integritetit trupor dhe shëndetit të civilëve; vrasje e civilëve; cenim i integritetit trupor dhe shëndetit të të burgosurve ushtarakë; torturë dhe vrasje e të burgosurve ushtarakë. Më tej pretendohet se sjellja e të akuzuarve ishte në shkelje të Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe lidhur me Mbrojtjen e Viktimave të Konflikteve të Armatosura Jo-ndërkombëtare.

I. Ligji i zbatueshëm në Kosovë në kohën e kryerjes së veprave të pretenduara

Në bazë të Nenit 1.1 të Rregullores 1999/24 të UNMIK-ut, të ndryshuar me Rregulloren 2000/59 të UNMIK-ut, ligji i zbatueshëm në Kosovë përfshin:

- (a) Rregulloret e miratuara nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të miratuara në bazë të tyre; dhe

²² Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (ICRC), Komentari i Nenit 3 të Përbashkët, gjendet në: <http://ëëë.icrc.org/ihl.nsf/COM/375-590006?OpenDokument>.

(b) Ligji në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Më 22 mars 1989 në Kosovë ishte në fuqi KPRSFJ dhe, kështu, ky është ligji i zbatueshëm në këtë lëndë. Në lidhje me veprën e krimit të luftës kundër popullatës civile, Neni 142 i KPRSFJ-së, në pjesën përkatëse, parashikon se:

“Çdo njeri i cili, në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në kohë lufte, konflikti të armatosur ose pushtimi, urdhëron që popullata civile të bëhet objekt i vrasjes [...] trajtimit çnjerëzor [...] ose cenimit të integritetit trupor ose shëndetit [...] ose i cili kryen ndonjërin nga aktet e mësipërme, dënohet me burgim jo më pak se pesë vjet ose me vdekje’.

Për sa i përket veprës së krimit të luftës kundër të burgosurve të luftës, Neni 144 i KPRSFJ-së, në pjesën përkatëse të tij, parashikon se:

“Çdo njeri, i cili në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare, urdhëron vrasje, torturë, ose trajtim çnjerëzor të të burgosurve të luftës, përfshirë këtu [...] shkaktimin e vuajtjeve të mëdha ose lëndimit të rëndë të integritetit trupor ose shëndetit, [...] ose i cili kryen ndonjërin prej veprimeve të mësipërme, dënohet me burgim për jo më pak se pesë vjet, ose me vdekje.”

Rregullorja 1999/24 e UNMIK-ut, e ndryshuar me Rregulloren 2000/59 të UNMIK-ut, e shfuqizoi dënimin me vdekje, duke vendosur që për çdo vepër të dënueshme me vdekje sipas ligjit në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, dënimi do të zëvendësohet me burgim në afat nga ai minimal i parashikuar në ligj për atë vepër, deri në maksimumi dyzet vjet.

Nenet 142 dhe 144 të KPRSFJ-së kërkojnë që vepra e krimit të luftës, e kryer përmes një ose më shumë prej akteve përbërëse të renditura këtu, të jetë *“në shkelje të rregullave të së drejtës ndërkombëtare”*. Për rrjedhojë, zbatimimi i dy dispozitave është i kushtëzuar nga e drejta

ndërkombëtare e zbatueshme në Kosovë në vitin 1989. Në lidhje me këtë, Neni 210 i Kushtetutës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, që hyri në fuqi në vitin 1974 dhe ishte në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, parashikonte që:

“Traktatet ndërkombëtare do të zbatohen nga dita që ato hyjnë në fuqi, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe nga instrumenti i ratifikimit ose me marrëveshje të organeve kompetente. Traktatet ndërkombëtare që janë miratuar do të zbatohen drejtpërdrejt nga gjykatat.”

Të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 u ratifikuan nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë në vitin 1950 dhe Protokollet Shtesë I dhe II u ratifikuan në vitin 1979. Për rrjedhojë, këto instrumente ndërkombëtare ishin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, siç kërkohej nga Rregullorja 1999/24 e UNMIK-ut dhe Rregullorja 2000/59 e UNMIK-ut.

Neni i Përbashkët 3 për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 parashikon, në pjesën përkatëse, si më poshtë:

“Në rastin e konfliktit të armatosur të karakterit jo ndërkombëtar që zhvillohet në territorin e njëres prej Palëve të Larta Kontraktuese, secila Palë në konflikt është e detyruar të zbatojë, minimumi, dispozitat në vijim:

(1) Personat të cilët nuk marrin pjesë aktive në luftime, përfshirë anëtarët e forcave të armatosura, të cilët kanë dorëzuar armët dhe ata të cilët gjenden jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, lëndimeve, paraburgimit, ose çdo shkak tjetër, do të trajtohen në të gjithë rrethanat në mënyrë të njerëzishme, pa ndonjë dallim të kundërt të bazuar në racën, ngjyrën, besimin fetar, gjininë, prejardhjen ose pasurinë, apo ndonjë kriter tjetër të ngjashëm.

Për këtë qëllim, aktet vijuese janë dhe do të mbeten të ndaluara në çfarëdo kohe dhe vendi për sa u përket personave të lart-përmendur:

(a) dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi çnjerëzor dhe torturimi [...]”

Si rregull i së drejtës ndërkombëtare zakonore, dispozitat materiale të Nenit të Përbashkët 3 janë të zbatueshme si për konfliktet e brendshme, ashtu dhe për ato ndërkombëtare.²³

Që të ndodhë një shkelje e Nenit të Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës, kërkohet që viktima të mos jetë duke marrë pjesë në luftime në kohën e veprës.²⁴ Ndërsa as e drejta e traktateve, as e drejta zakonore nuk e përkufizojnë nocionin e pjesëmarrjes aktive në luftime, ky nocion është përkufizuar në jurisprudencën e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavinë si pjesëmarrje në veprime luftarake që për nga natyra ose qëllimi i tyre janë të synuara të shkaktojnë dëmtim konkret të personelit ose pajisjeve të forcave të armatosura të kundërshtarit.²⁵ Mbrojtja e Nenit të Përbashkët 3 shtrihet tek viktimat që janë pjesëtarë të forcave të armatosura, të cilët kanë dorëzuar armët ose janë nxjerrë jashtë luftimit, për shembull, si pasojë e sëmundjes, plagosjes ose paraburgimit.

Neni 4 i Protokollit Shtesë II, që zhvillon më tej mbrojtjen e ofruar nga Neni i Përbashkët 3, parashikon, në pjesën përkatëse, se:

“1. Të gjithë personat të cilët nuk marrin pjesë drejtpërdrejt, ose të cilët kanë pushuar së marri pjesë në luftime, pa marrë parasysh nëse liria e tyre është kufizuar apo jo, gëzojnë të drejtën e respektit, nderimit dhe bindjeve dhe

²³Prokurori kundër Zejnir Delalić dhe të tjerët., Lënda nr. IT-96-21-A, Aktgjykimi, 20 shkurt 2001 (Aktgjykimi i “Apelit Čelebići”), paragrafi 420. Shih gjithashtu po aty, paragrafët 147-150. Në lëndën *Nicaragua*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpalli se: “Neni 3 që është i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 përkufizon rregulla të caktuara që duhen zbatuar në konfliktet e armatosura me karakter jo-ndërkombëtar. Nuk ka dyshim se, në rast të konflikteve të armatosura ndërkombëtare, këto rregulla përbëjnë edhe matësin minimal, krahas rregullave më të hollësishme që duhen zbatuar edhe në konfliktet ndërkombëtare; dhe ato janë rregulla që, për mendimin e gjykatës, pasqyrojnë ato që gjykata në vitin 1949 i quajti “vlerësime elementare të humanitetit” (Kanali i Korfuzit, Meritat, Raporte të GJND-së, 1949, f. 22). Në lidhje me dispozitat materiale të përmbajtura në paragrafët 1(a)-(d) të Nenit të Përbashkët 3, Komentari i ICRC-së thekson: “Vlera e dispozitës nuk është e kufizuar në fushën e trajtuar nga Neni 3. Duke përcaktuar, siç dhe bën, minimumin që duhet të zbatohet në konfliktet më pak të përcaktuara, kushtet e tij duhet të respektohen a fortiori në rastin e konflikteve ndërkombëtare të mirëfillta, kur të gjitha dispozitat e Konventës janë të zbatueshme. Por “detyrimi më i madh përfshin më të voglin”, siç mund të thoshte dikush.” (Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, *Komentar: Konventa IV e Gjenevës Lidhur me Mbrojtjen e Civilëve në Kohë Luftë*, Gjenevë, Pictet, (red.), 1958, f. 14).

²⁴ Shih Nenin e Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Apelit Čelebići, paragrafët 420, 424.

²⁵Prokurori kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerëve, Lënda nr. IT-04-84-bis-T, Aktgjykimi Publik me Shtojcë Konfidenciale, 29 nëntor 2012 (rishqyrtimi gjyqësor), paragrafi 398, duke bërë fjalë për lëndën *Prokurori kundër Pavle Strugar*, Lënda nr. IT-01-42-A, Aktgjykimi, 17 korrik 2008, paragrafi 178.

praktikave fetare të tyre. Në të gjitha rrethanat, ata do të trajtohen në mënyrë njerëzore, pa ndonjë dallim në të kundërt. [...]

2. Pa paragjykuar të përgjithshmen e sa më lart, aktet e mëposhtme kundër personave të përmendur në paragrafin 1 janë dhe do të mbeten të ndaluara në çfarëdo kohe dhe vendi:

(a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike apo mendore të personave, veçanërisht vrasja dhe trajtimi mizor, i tillë si tortura, gjymtimi ose çdo formë e ndëshkimit trupor; [...]"

Neni 5 i Protokollit Shtesë II parashikon, në pjesën përkatëse, si më poshtë:

"1. Krahas dispozitave të nenit 4, dispozitat vijuese do të respektohen minimumi lidhur me personat të cilëve u është privuar liria për arsyt që lidhen me konfliktin e armatosur, pa marrë parasysh nëse janë të internuar ose të paraburgosur:

[...]

(b) personave të cilët përmenden në këtë paragraf do t'u ofrohet, në të njëjtën mënyrë si popullatës vendore civile, ushqim dhe ujë i pijshëm dhe do t'u jepen garanci lidhur me shëndetin dhe higjienën dhe mbrojtje kundër klimës së ashpër dhe rreziqeve të konfliktit të armatosur; [...]"

Qëllimi i Nenit 5 të Protokollit Shtesë II është të sigurojë trajtimin njerëzor të personave liria e të cilëve është kufizuar për arsye që lidhen me konfliktin.²⁶ Këtyre personave duhet t'u sigurohen nevojat më të domosdoshme minimale: ushqim, ujë i pijshëm, higjienë dhe strehim.²⁷ Mbrojtja kundër motit të egër përfshin pajisjen me veshmbathje për të ftohtët dhe strehim nga dielli dhe kushtet e skajshme.²⁸ Ndonëse detyrimi i autoritetit paraburgosës në

²⁶ Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, *Komentar për Protokollin Shtesë të 8 qershorit 1977 të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949*, Gjenevë, Sandoz, Sëinarski dhe Zimmermann (red.), 1986 ("Komentari i ICRC-së për Protokollin Shtesë"), paragrafi 4565.

²⁷ Komentari i ICRC-së për Protokollin Shtesë, paragrafi 4573.

²⁸ Komentari i ICRC-së për Protokollin Shtesë, paragrafi 4574.

këtë drejtim mbetet absolut, përmbajtja e tij ndryshon, në varësi të kushteve të jetesës që mbizotërojnë në atë zonë.²⁹

II. Natyra e konfliktit të armatosur

Aktakuza pretendon shprehimisht se në kohën e kryerjes së veprave ekzistonte gjendja e konfliktit të armatosur të brendshëm, gjë që shkaktoi zbatimin e Nenit të Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës dhe neneve 4 dhe 5(1) të Protokollit Shtesë II.

Në përcaktimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur, Dhoma e Apelit e TPNJ-së ka artikuluar këtë test:

“konflikti i armatosur ekziston sa herë që ka përdorim të forcës së armatosur ndërmjet shteteve, ose dhunë të armatosur të zgjatur ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe grupeve të armatosura të organizuara, ose ndërmjet këtyre grupeve brenda një shteti. E drejta humanitare ndërkombëtare zbatohet që në nisjen e këtyre konflikteve të armatosura dhe shtrihet përtej ndërprerjes së luftimeve, deri sa të arrihet vendosja e përgjithshme paqes; ose, në rastin e konflikteve të brendshme, deri sa të arrihet zgjidhja paqësore. Deri në atë moment, e drejta humanitare ndërkombëtare vazhdon të zbatohet në tërë territorin e shteteve që janë në luftë ose, në rastin e konflikteve të brendshme, tërë territorin nën kontrollin e një pale, si kur atje ndodhin luftime konkrete, ashtu dhe kur nuk ndodhin.”³⁰

²⁹ Komentari i ICRC-së për Protokollin Shtesë, paragrafi 4573.

³⁰ Prokurori kundër Duško Tadić aka “Dule”, Lënda nr. IT-94-1-AR72, Vendim për kërkesën e mbrojtjes për Apelin e Ndërkohshëm për Juridiksionin, 2 tetor 1995, paragrafi 70. Shih gjithashtu Prokurori kundër Thomas Lubanga Dyilo, Lënda nr. ICC-01/04-01/06, Aktgjykimi në bazë të nenit 74 të Statutit, 14 mars 2012 (“Lubanga Dyilo, Aktgjykim i Shqyrtimit Gjyqësor”), paragrafi 533.

Kriteret që duhet të trajtohen nën këtë test janë: (i) intensiteti i konfliktit dhe (ii) organizimi i palëve në konflikt.³¹ Qëllimi është të dallohet konflikti i armatosur “nga banditizmi, kryengritjet e paorganizuara dhe jetëshkurtra, ose veprimtaritë terroriste, që nuk janë objekt i së drejtës humanitare ndërkombëtare”.³² Veçanërisht në lidhje me konfliktet e armatosura me karakter jo-ndërkombëtar, grupi i armatosur duhet të ketë “një farë shkalle organizimi”, dhe udhëheqja e tij duhet, më së paku, të ketë aftësinë për të ushtruar një farë kontrolli mbi anëtarët e tij, me qëllim që detyrimet bazë të Nenit të Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës të mund të zbatohen.³³ Praktika gjyqësore e TPNJ-së ka shqyrtuar këta faktorë kur ka vlerësuar shkallën e organizimit të një grupi të armatosur: (i) prania e strukturës komanduese (ii) aftësia e grupit të armatosur për të kryer operacione në mënyrë të organizuar (iii) niveli i logjistikës (iv) niveli i disiplinës dhe aftësia për të zbatuar detyrimet bazë të Nenit të Përbashkët 3 dhe (v) aftësia për të “folur me një zë”.³⁴

Më tej, në lëndën *Tadić*, Dhoma e Apelit e TPNJ-së ka përcaktuar rrethanat në të cilat konflikti i armatosur, që *prima facie* është i brendshëm, mund të shndërrohet në ndërkombëtar:

“[...]konflikti i armatosur i brendshëm mund të bëhet ndërkombëtar (ose, në varësi të rrethanave, të ketë karakter ndërkombëtar, krahas konfliktit të

³¹*Prokurori kundër Vlastimir Đorđević*, Lënda nr. IT-05-87-T, Aktgjykim, 23 shkurt 2011 (Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor “*Đorđević*”), paragrafi 1522, duke bërë fjalë për *Prokurori kundër Duško Tadić pseudonimi “Dule”*, Lënda nr. IT-94-1-T, Mendimit dhe Aktgjykim, 7 maj 1997 (Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor “*Tadić*”), paragrafi 562; *Prokurori kundër Zejnil Delalić dhe të tjerët*, Lënda nr. IT-96-21-T, Aktgjykim, 16 nëntor 1998 (“Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *Čelebić*”), paragrafi 184; *Prokurori kundër FL dhe të tjerët.*, Lënda nr. IT-03-66-T, Aktgjykimi, 30 nëntor 2005 (“Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *L*”), paragrafi 84; *Prokurori kundër Mile Mrkšić dhe të tjerët.*, Lënda nr. IT-95-13/1, Aktgjykimi, 27 shtator 2007 (“Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *Mrkšić*”), paragrafi 407. Shih gjithashtu *Lubanga Dyilo* Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor, paragrafët 535-536.

³²Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *Đorđević*, paragrafi 1522, duke bërë fjalë për Aktgjykimin e Shqyrtimit Gjyqësor *Tadić*, paragrafi 562; *Prokurori kundër Ljube Boškosi dhe Johan Tarčulovski*, Lënda nr. IT-04-82-T, Aktgjykimi, 8 korrik 2008 (“Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *Boškosi dhe Tarčulovski*”), paragrafi 175; Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *Limaj*, paragrafi 89. Shih gjithashtu Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *Lubanga Dyilo*, paragrafi 538.

³³Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *Đorđević*, paragrafi 1525, duke bërë fjalë për Aktgjykimin e Shqyrtimit Gjyqësor *Boškosi dhe Tarčulovski*, paragrafët 196-198; Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *L*, paragrafi 89; *Prokurori kundër Naser Orić*, Lënda nr. IT-03-68-T, Aktgjykimi, 30 qershor 2006, paragrafi 254.

³⁴Aktgjykimi i Shqyrtimit Gjyqësor *Đorđević*, paragrafi 1526, duke bërë fjalë për Aktgjykimin e Shqyrtimit Gjyqësor *L*, paragrafët 46, 94, 96-111; *Prokurori kundër Ramush Haradinaj dhe të tjerët*, Lënda nr. IT-04-84, Aktgjykimi, 3 prill 2008, paragrafët 60, 65-69, 76-86, 88; *Prokurori kundër Slobodan Milošević*, Lënda nr. IT-02-54-T, Vendim lidhur me kërkesën për Aktgjykim Pafajësie, 16 qershor 2004, paragrafët 23-24. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Shqyrtimit Gjyqësor *Lubanga Dyilo*, paragrafi 537.

armatosur të brendshëm) në rast se (i) në atë konflikt ndërhyjnë një shtet tjetër me trupat e tij, ose alternativisht në rast se (ii) disa prej pjesëmarrësve në konfliktin e armatosur të brendshëm veprojnë në emër të atij shteti tjetër.”³⁵

Në shtjellimin më të hollësishëm të shkallës së kontrollit që duhet të ushtrohet nga një shtet i huaj mbi forcat e armatosura që luftojnë në emër të tij, për ta bërë ‘ndërkombëtar’ një konflikt të armatosur që është *prima facie* ‘i brendshëm’, Dhoma e Apelit e TPNJ-së vendosi testin e kontrollit të përgjithshëm, sipas të cilit:

“kontrolli nga një shtet mbi forcat e armatosura ose milicinë ose njësitë paraushtarake në varësi të tij mund të ketë karakter të përgjithshëm (dhe duhet të përfshijë më shumë se thjesht dhënien e ndihmës financiare ose pajisjen ose stërvitjen ushtarake). Kjo kërkesë, megjithatë, nuk shkon aq larg sa të përfshijë nxjerrjen e urdhrave të posaçëm nga shteti, ose drejtimin prej tij të çdo operacioni të veçantë. Në bazë të së drejtës ndërkombëtare, nuk është aspak e nevojshme që autoritetet kontrolluese të planifikojnë të gjitha operacionet e njësive në varësi të tyre, të zgjedhin objektivat e tyre, ose të japin udhëzime të posaçme lidhur me kryerjen e operacioneve ushtarake dhe çdo shkelje të pretenduar të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Kontrolli i kërkuar nga e drejta ndërkombëtare mund të quhet se ekziston kur një shtet (ose, në kontekstin e konfliktit të armatosur, pala në konflikt) ka rol në organizimin, bashkërendimin ose planifikimin e veprimeve ushtarake të grupit ushtarak, krahas financimit, trajnimit dhe ofrimit ose dhënies së mbështetjes operacionale për atë grup.”³⁶

³⁵Prokurori kundër *Duško Tadić*, Lënda nr. IT-94-1-A, Aktgjykimi, 15 korrik 1999 (“Aktgjykimi i Apelit në Lëndën *Tadić*”), paragrafi 84. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Shqyrtimit Gjyqësor *Lubanga Dyilo*, paragrafi 540.

³⁶Aktgjykimi i Apelit në *Tadić*, paragrafi 137. Shih gjithashtu Aktgjykimin e Shqyrtimit Gjyqësor *Lubanga Dyilo*, paragrafi 541.

Përkufizimet e vendosura nga TPNJ dhe të miratuara nga Gjykata Penale Ndërkombëtare (“GJPN”) trupi gjykues i gjen bindëse dhe do t’i ketë parasysh në përcaktimin e natyrës së konfliktit të armatosur në këtë lëndë.

III. Elementet e veprave përbërëse

Lidhur me elementet e veprave përbërëse të akuzuara në Aktakuzë, trupi gjykues është i mendimit se ato duhet të përkufizohen në dritën e rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në Kosovë në kohën e kryerjes së tyre të pretenduar. Kjo konfirmohet nga referimi i qartë në rregullat e së drejtës ndërkombëtare të përmbajtura në nenet 142 dhe 144 të KPRSFJ-së. Më tej, trupi gjykues nënvizon se elementet e veprave do të ndryshojnë domosdoshmërisht në varësi të natyrës së konfliktit të armatosur.

a. Cenimi i integritetit trupor dhe shëndetit

Siç u kujtua më lart, Neni i Përbashkët 3 dhe Neni 4(2.a) i Protokollit Shtesë II ndalojnë shprehimisht, ndër të tjera, dhunën ndaj jetës dhe shëndetit të personave dhe, në veçanti, trajtimin mizor. Elementet e veprës së trajtimit mizor, siç përkufizohen në të drejtën ndërkombëtare zakonore, janë artikuluar nga TPNJ si vijon: veprim ose mosveprim i qëllimtë, që shkakton vuajtje ose lëndim të rëndë mendor ose fizik, ose përbën sulm të rëndë mbi dinjitetin njerëzor, dhe që kryhet kundër një personi që nuk po merr pjesë aktive në luftime.³⁷ Elementet e Krimeve për GJPN-në e përkufizojnë veprën e trajtimit mizor si vijon: (i) kryerësi ka shkaktuar dhimbje ose vuajtje të rëndë fizike ose mendore mbi një ose më shumë persona; (ii) ky person ose këta persona ose ishin jashtë luftimit, ose ishin civilë, personel mjekësor, ose personel fetar, që nuk po merrte pjesë aktive në këto luftime; (iii) kryerësi ishte në dijeni të rrethanave faktike që e vendosnin këtë status; (iv) sjellka ka ndodhur në kuadrin e konfliktit të armatosur jo me karakter ndërkombëtar, dhe ishte e lidhur me të; (v) kryerësi ishte në dijeni të rrethanave

³⁷Aktgjykim i Apelit në *Čelebići*, paragrafi 424.

faktikë që përcaktonin ekzistencën e konfliktit të armatosur.³⁸ Trupi gjykues e gjen bindës këtë përkufizim të hollësishëm.

I vetmi element dallues, krahas natyrës së konfliktit të armatosur, ndërmjet veprës së trajtimit mizor, të kryer në një konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar, dhe veprës së trajtimit çnjerëzor, të kryer në një konflikt të armatosur ndërkombëtar, është kërkesa që viktima e trajtimit çnjerëzor të jetë person i mbrojtur.³⁹

Po kështu, organizatat e të drejtave të njeriut kanë gjetur shkelje të ndalimit të trajtimit çnjerëzor në rastet e keqtrajtimit aktiv të të paraburgosurve, si dhe në rastet e izolimit individual, kushteve shumë të këqija të paraburgimit, mungesës së ushqimit të mjaftueshëm, ujit ose trajtimit mjekësor për të paraburgosurit.⁴⁰

b. Tortura

Përkufizimi i krimit të torturës, siç është përcaktuar në Konventën kundër Torturës ose Trajtimit Tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar ose Ndëshkimit (“Konventa për Torturën”) mund të konsiderohet se pasqyron të drejtën ndërkombëtare zakonore.⁴¹ Neni 1 i Konventës për Torturën e përkufizon torturën si:

“çdo veprim me të cilin shkaktohet qëllimisht dhimbje ose vuajtje e rëndë, qoftë fizike ose mendore, ndaj një personi, për qëllime të tilla si sigurimi prej tij ose një personi të tretë i informatave ose rrëfimit, duke e dënuar atë për një veprim që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet të ketë kryer, ose e

³⁸ Elemente e Krimeve, Shkresat Zyrtare të Asamblesë së Shteteve Palë të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare, sesioni i parë, Neë York, 3-10 shtator 2002 (botim i Kombeve të Bashkuara, Sales nr. E.03.V.2 dhe korrigjimet), pjesa II.B (“Elemente e Krimeve”), Neni 8 (2) (c) (i)-3.

³⁹ Čelebići Aktgjykim i Apelit, paragrafi 426.

⁴⁰ Shih të Drejtën Humanitare Zakonore Ndërkombëtare, Vëllimi I: Rregullat, Jean-Marie Henckaerts, Louise Dosëald-Beck, Cambridge University Press, 2009 (“E Drejta Humanitare Ndërkombëtare Zakonore”), f. 318-319.

⁴¹ Prokurori kundër Dragoljub Kunarac dhe të tjerëve, Lënda nr. IT-96-23 & IT-96-23/1-A, Aktgjykim, 12 qershor 2002 (Aktgjykim i Apelit në lëndën “Kunarac”), paragrafi 146, që i referohet, ndër të tjera, lëndës Prokurori kundër Anto Furundžija, Lënda nr. IT-95-17/1-A, Aktgjykim, 21 korrik 2000, paragrafi 111.

kërcënon ose shtrëngon atë ose një person të tretë, ose për çdo arsye të bazuar në diskriminim të ndonjë lloji, kur kjo dhimbje ose vuajtje shkaktohet nga ose me nxitjen ose pëlqimin ose pajtimin e një zyrtari publik ose të ndonjë personi tjetër që vepron në cilësinë e personit zyrtar. Kjo nuk përfshin dhimbjen ose vuajtjen që lind vetëm nga dënimet e ligjshme, është pjesë përbërëse e tyre ose pasojë e këtyre dënimeve.”⁴²

TPNJ ka zhvilluar një praktikë të gjerë gjyqësore në lidhje me krimin e torturës. Në veçanti, në lëndën *Kunarac dhe të tjerët*, Dhoma e Apelit e TPNJ-së miratoi këto aspekte të përkufizimit të vendosur nga Trupi Gjyqësor i Shqyrtimit Gjyqësor në atë lëndë: (i) shkaktimi, nëpërmjet veprimit ose mosveprimit, i dhimbjes ose vuajtjes së rëndë, qoftë fizike a mendore; (ii) veprimi ose mosveprimi duhet të jetë i qëllimtë; (iii) veprimi ose mosveprimi duhet të synojë sigurimin e informatave ose rrëfimit, ose dënimin, kanosjen ose shtrëngimin e viktimës ose të një personi të tretë, ose diskriminimin, mbi çfarëdo baze, kundër viktimës ose një personi të tretë.⁴³ Në lidhje me kërkesat e përmbajtura në Konventën e Torturës që në aktin e torturës të marrë pjesë një zyrtar publik, ose ndonjë person tjetër që vepron në cilësi jo private, Dhoma e Apelit e TPNJ-së në lëndën *Kunarac et al.* shpalli se Konventa e Torturës përqiej të rregullonte sjelljen e shteteve, dhe vetëm për këtë qëllim dhe deri në atë shkallë ajo merret me aktet e individëve të cilët veprojnë në kapacitet zyrtar.⁴⁴ Për rrjedhojë, rregulli për zyrtarin publik nuk është rregull sipas së drejtës ndërkombëtare zakonore në lidhje me përgjegjësinë penale të një individi për torturë jashtë kuadrit të Konventës së Torturës.⁴⁵

Në të njëjtën frymë, Elementet e Krimeve e GJPN-së nuk përmban ndonjë rregull që zyrtari publik ose ndonjë person tjetër që vepron në kapacitet zyrtar të marrë pjesë në aktin e torturës. Elementet e krimit të torturës, kur kjo është kryer në kuadrin e konfliktit të armatosur

⁴² Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit Tjerët Mizor, Çnjerëzor ose Poshtëruar ose Ndëshkimit, I-24841, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuar më 10 dhjetor 1984, Neni 1.

⁴³ *Kunarac dhe të tjerët*, Aktgjykim i Apelit, paragrafët 142, 144.

⁴⁴ *Kunarac dhe të tjerët*, Aktgjykim i Apelit, paragrafët 146-147.

⁴⁵ *Prokurori kundër Miroslav Kvočka dhe të tjerët*, Lënda nr. IT-98-30/1-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2005, paragrafi 284, duke bërë fjalë për *Kunarac dhe të tjerët*. Aktgjykim i Apelit, paragrafi 148.

të brendshëm, janë përkufizuar për qëllimin e Statutit të Romës si më poshtë: (i) kryerësi ka shkaktuar dhimbje ose vuajtje të rëndë fizike ose mendore mbi një ose më shumë persona; (ii) kryerësi ka shkaktuar dhimbje ose vuajtje për këto qëllime si: sigurimit të informatave ose rrëfimit, ndëshkimi, kanosja ose shtrëngimi, ose për ndonjë arsye bazuar në diskriminimin e çfarëdo lloji; (iii) ky person ose këta persona ishin jashtë luftimit, ose ishin civilë, personel mjekësor ose personel fetar që nuk merrte pjesë në luftime; (iv) kryerësi kishte dijeni për rrethanat faktike që e vendosnin këtë status; (v) sjellja ndodhi në kuadrin e konfliktit të armatosur me karakter jo-ndërkombëtar dhe ishte e lidhur me këtë konflikt; (vi) kryerësi kishte dijeni për rrethanat faktike që përcaktonin ekzistencën e konfliktit të armatosur.⁴⁶

Në lidhje me *actus reus*, elementi i vetëm dallues ndërmjet veprës së torturës të kryer në konfliktin e armatosur jo-ndërkombëtar, dhe torturës së kryer në konfliktin e armatosur ndërkombëtar, është rregulli që viktima e kësaj të fundit të jetë person i mbrojtur.⁴⁷

Më tej, dallimi ndërmjet veprave të torturës dhe trajtimit mizor qëndron në rregullin që, në rastin e torturës, kryerësi duhet të ketë vepruar me qëllimin e sigurimit të informatave ose rrëfimit, ndëshkimit, kanosjes ose shtrëngimit ose për çfarëdo arsye të bazuar në diskriminimin e çfarëdo lloji. Asnjë qëllim i tillë nuk kërkohet nga *actus reus* i veprës së trajtimit mizor.⁴⁸

c. Vrasja

Elementet e krimit të vrasjes përfshijnë privimin nga jeta të një personi tjetër.⁴⁹ Megjithatë, që vrasja të karakterizohet si shkelje e rëndë e së drejtës humanitare ndërkombëtare, ajo duhet të

⁴⁶ Elementet e Krimeve, Neni 8 (2) (c) (i)-4. Shih gjithashtu *Prokurori kundër Callixte Mbarushimana*, Lënda nr. ICC-01/04-01/10, Vendim për Konfirmimin e Akuzave, 16 dhjetor 2011 ("Vendim i Konfirmimit në lëndën *Mbarushimana*"), paragrafët 168-169. Për diskutimin e elementeve të krimit të torturës shih gjithashtu *Prokurori kundër Jean-Pierre Bemba Gombo*, Lënda nr. ICC-01/05-01/08, Vendim në bazë të nenit 61(7)(a) dhe (b) të Statutit të Romës për Akuzat e Prokurorit kundër Jean-Pierre Bemba Gombo, 15 qershor 2009, paragrafët 289-296.

⁴⁷ *Čelebić*, Aktgjykim i Apelit, paragrafi 425.

⁴⁸ Shih E drejta Humanitare Ndërkombëtare Zakonore, f. 318. Shih gjithashtu Vendimi i Konfirmimit në lëndën *Mbarushimana*, paragrafi 169.

⁴⁹ Shih E drejta Penale e Provincës Socialiste Autonome të Kosovës, PS nr. 011-25/77, 28 qershor 1977, Neni 30(1); Neni 178 i KPK-së.

jetë kryer kundër një personi që nuk merrte pjesë aktive në konfliktin e armatosur. Është situata specifike e viktimës në momentin kur u krye krimi ajo që duhet të merret parasysh në përcaktimin e mbrojtjes së viktimës sipas Nenit të Përbashkët 3. Statusi i viktimës duhet të pasqyrohet në *mens rea* të kryerësit.⁵⁰

E. SHQYRTIME LIDHUR ME VLERËSIMIN E DËSHMIVE DHE PROVAVE

I. Barra dhe standardi i provës

Neni 6 (2) i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (këtej e tutje “KEDNJ”), Kushtetuta e Kosovës dhe Neni 3 (1) i KPPK-së mishërojnë prezumimin e pafajësisë, të drejtë të cilën e gëzon i akuzuari. Ky prezumim vendos mbi Akuzën barrën e vërtetimit të fajësisë së të akuzuarit, një barrë që mbetet mbi Akuzën gjatë gjithë procesit gjyqësor.

Neni 396 (7) i KPPK-së përcakton që *‘grykëta paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, si dhe arsyet për këtë’*. Për rrjedhojë, trupi gjyqësor duhet të përcaktojë, në lidhje me secilën prej akuzave të vëna në barrë kundër secilit prej të akuzuarve, nëse ai është e bindur për bazën e të gjitha dëshmive dhe provave, me qëllim që të jetë i sigurt se është vërtetuar çdo element i atij krimi. Çdo dyshim duhet të zgjidhet në dobi të të akuzuarve.

Në bazë të nenit 7 (1), (2) të KPPK-së, trupi gjyqësor *‘...detyrohet që saktësisht dhe tërësisht t’i vërtetojë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm’* dhe *‘...detyrohet që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërteton faktet kundër të pandehurit si dhe ato në ... favor ...’*.

⁵⁰Prokurori kundër Milan Milutinovićit dhe të tjerëve, IT-05-87-T, Aktgjykim, 26 shkurt 2009, vëll. 1, paragrafi 134.

II. Vërtetimi i provave dhe dëshmive

Neni 157 i KPPK-së parashikon si më poshtë:

*(3) Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor **vetëm ose duke i dhënë rëndësi vendimtare** dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin.*

*(4) Gjykata nuk e shpall personin fajtor **vetëm** mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.*

Nën-paragrafi (3) vendos rregullin e vërtetimit të dëshmive dhe provave në rastin e dëshmitarit anonim dhe më tej parashikon se gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor vetëm ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga dëshmitari anonim.

Nën-paragrafi (4) vendos rregullin e vërtetimit të dëshmive dhe provave në rastin e dëshmitarit bashkëpunues.

Nën-paragrafi (4) nuk i referohet dëshmisë 'vendimtare'. Akuza ka parashtruar se cdo dëshmi dhe provë mund ta vërtetojë dëshminë e një dëshmitari bashkëpunues.

Është ligj i vjetër tashmë se dëshmitë dhe provat vërtetuese duhet të jenë dëshmi dhe prova të pavarura, që e implikojnë të akuzuarin në kryerjen e veprës. Vërtetimi në atë kuptim është dëshmi dhe provë e mbështetshme, e pavarur, që konfirmon, mbështet ose u shton peshë dëshmive dhe provave të tjera të lëndës.

Baza e Akuzës mbështetet në masë të madhe në dëshminë e **AZ**. Shënimet në ditar që pretendohet se u shkruan prej tij, nuk i vërtetojnë dëshmitë dhe provat e mëpasme, sepse ato nuk janë të pavarura. Vërtetimi duhet të dalë nga një burim tjetër i besueshëm.

Disa shënime në ditarin kinse të shkruara nga **AZ** janë të pajtueshme me dëshminë që ai dha para prokurorit. Për shembull, ditari përmban emrat e disa të burgosurve të cilët u paraburgosën në Kleçkë më ose rreth datave të shënuara atje. Në disa raste këto shënime në ditar vërtetohen me prova të tjera, për shembull, deklaratat e dëshmitarëve. Ndonëse kjo mund t'i shtojë peshë besueshmërisë së **AZ**, ajo nuk e vërteton dëshminë e tij lidhur me identitetin e personave të cilët, siç thotë ai, kryen veprat e vëna në barrë.

Një gënjeshtër kinse e treguar nga një i akuzuar nuk përbën vërtetim. I akuzuari mund të gënjejë për një numër arsyesh. Në disa raste edhe një i akuzuar i pafajshëm mund të gënjejë, me qëllim që të përforcojë atë që ai e percepton si mbrojtje e dobët. Gënjeshtera nuk mund të provojë fajësinë në vetvete.

III. Besueshmëria

Çështja e besueshmërisë është çështje faktike dhe nuk mund të përcaktohet duke zbatuar një tërësi rregullash. Në mënyrë të pashmangshme, një trup gjykues duhet ta peshojë dëshminë e dëshmitarit, të shqyrtojë meritat dhe mangësitë dhe, pasi të ketë vepruar kështu, të vendosë nëse ajo është e besueshme dhe nëse, me gjithë faktin se në dëshmi ka të meta ose mangësi ose kontradikta, ai është i bindur se është treguar e vërteta.

Kur vlerësohet besueshmëria, duhet të merren parasysh një numër faktorësh.

Integriteti dhe inteligjenca e përgjithshme e dëshmitarit, aftësia e tij për të vëzhguar e vrojtuar, kapaciteti i tij për të mbajtur mend dhe saktësia e tij në deklaratë janë të rëndësishme. Gjithashtu është e rëndësishme të përcaktohet nëse ai po përpiqet të tregojë të vërtetën me ndershmëri, nëse ai është i sqertë dhe i çiltër, apo nëse ai është i njëanshëm, jo bashkëpunues dhe dredharak. Të gjitha këtyre çështjeve dhe të tjerave mund t'u jepet përgjigje duke vëzhguar dhe vrojtuar dëshmitarin, sjelljen dhe qëndrimin e tij.

Në shtator 2011, **AZ** kreu vetëvrasje. Për shkak të kësaj ai nuk mund të ishte i pranishëm për të dhënë dëshmi para kësaj gjykate. Trupi gjykues kishte në dispozicion të vet dëshminë e mëparshme të tij dhe pati mundësinë të këqyrte një pjese të dëshmisë së tij në regjistrimet në DVD. Po kështu, gjykata pati mundësinë të shqyrtonte dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë, të cilët ishin në gjendje të përshkruajnë sjelljen dhe karakterin e përgjithshëm të tij. Gjukata pati në dispozicion të vet edhe raporte dhe shkresa të ndryshme psikiatrike.

Megjithatë, trupit gjykues iu mohua mundësia që t'i bënte pyetje të tjera **AZ**, me qëllim që të testonte dëshminë e tij; për ta vënë përballë kundërthëniesve të dukshme në dëshminë e tij; për të vlerësuar sjelljen dhe qëndrimin e tij gjatë dhënies së dëshmisë⁵¹; për të vlerësuar mënyrën se si do të dëshmonte⁵²; për të vlerësuar përmasat e plota të kapacitetit të tij për të perceptuar, rikujtuar ose përcjellë ato ngjarje për të cilat ai dha dëshmi; për të vlerësuar karakterin e tij për ndershmëri ose vërtetësi, ose për të testuar ekzistencën apo mosekzistencën e njëanshmërisë, interesit, ose ndonjë motivi tjetër prapa dëshmisë që ai kishte dhënë.

Këta ishin faktorë të rëndësishëm që, sikur **AZ** të kishte qenë i qasshëm për gjykatën, do ta kishin ndihmuar trupin gjykues në vlerësimin e besueshmërisë së tij.

F. BESUESHMËRIA E AGT

Meqenëse **AZ** nuk ishte i pranishëm për të dhënë dëshmi para trupit gjykues, në vlerësimin e besueshmërisë së tij trupi gjykues duhet të ketë parasysh provat dhe dëshmitë e pranueshme, që mund ta ndihmojnë gjykatën në bërjen e këtij vlerësimi.

I. Dëshmia e **AZ**⁵³

⁵¹ Krahas rishikimit në DVD të një pjese të dëshmisë së mëparshme të tij.

⁵² Po aty.

⁵³ Urdhër i Trupit Gjykues për Zbulimin e Provave, 20 janar 2012, Dosja 5 e shqyrtimit gjyqësor. Urdhri revokoi statusin e mbrojtur të **AZ**. Urdhri shënonte, ndër të tjera, se identiteti i Dëshmitarit Bashkëpunues X ishte bërë i njohur gjerësisht si rezultat i vdekjes së tij dhe raportimeve nga shtypi të ditëve të tij dhe dokumenteve të tjera.

Argumenti i Akuzës mbështetet në masë të madhe në dëshminë e **AZ**. Besueshmëria e **AZ** është çështja kyçe në këtë lëndë. Vërtet, Aktakuza deklaroi shprehimisht se *‘në këtë lëndë, dyshimi i mirë-bazuar kundër të gjithë të pandehurve lind kryesisht nga deklaratat e Dëshmitarit Bashkëpunues X, ish i dyshuar brenda të njëjtit hetimi’*.

Deklaratat dhe ditari i **AZ** ndahen në këtë kategori: (1) deklaratat e dhëna si dëshmitar para policisë së EULEX-it më 20 dhe 30 nëntor 2009 dhe të vazhduara më 3 dhjetor 2009; (2) deklaratat e dhëna si i dyshuar / i pandehur para prokurorit të PSRK-së më 4 shkurt 2010, 9 shkurt 2010, 11 shkurt 2010, 16 shkurt 2010 dhe 17 shkurt 2010; 10 mars 2010, 16 mars 2010, dhe 25 mars 2010; 6 qershor 2010 dhe 20 gusht 2010; (3) deklaratat e dhëna si dëshmitar bashkëpunues para prokurorit të PSRK-së më 5 dhe 7 tetor 2010; (4) deklaratat e dhëna gjatë marrjes në pyetje nga mbrojtësit më 5, 6, 7 dhe 9 korrik 2011; (5) ditari i përfunduar gjatë konfliktit në Kosovë në 1999⁵⁴; (6) ditarët e përfunduar pas konfliktit në Kosovë⁵⁵ dhe (7) ditarët e përfunduar në Gjermani (2011)⁵⁶

Më 25 gusht 2010, **AZ** u deklarua Dëshmitar Bashkëpunues. **AZ** vdiq më 28 shtator 2011 dhe, për këtë arsye, nuk mund të ishte më i pranishëm për shqyrtimin gjyqësor ose rishqyrtimin gjyqësor të kësaj lënde.

Mbrojtësit e të pandehurve patën mundësinë ta marrin në pyetje **AZ** dhe e bënë këtë më 5, 6, 7 dhe 9 korrik 2011. Megjithatë, në kohën e marrjes në pyetje, mbrojtësit nuk patën në dispozicion të tyre deklaratat e bëra nga **AZ** më 20 dhe 30 nëntor 2009 dhe të vazhduara më 3 dhjetor 2009. Krahas kësaj, mbrojtësit nuk patën në dispozicion të tyre deklaratat e

⁵⁴ Provat e përmbajtura në të ashtuquajturit ‘ditarë të luftës’, të shënuara si: 0096-09-EWC2/008, 0096-09-EWC2/009, 0096-09-EWC2/010, 0096-09-EWC2/011, 0096-09-EWC2/012, 0096-09-EWC2/013, 0096-09-EWC2/014, 0096-09-EWC2/015, 0096-09-EWC2/016

⁵⁵ Provat e përmbajtura në të ashtuquajturit ‘ditarë të luftës’, të shënuara si: 0096-09-EWC2/001, 0096-09-EWC2/002, 0096-09-EWC2/003, 0096-09-EWC2/004, 0096-09-EWC2/005, 0096-09-EWC2/006, 0096-09-EWC2/017, 0096-09-EWC2/018

⁵⁶ Provat e përmbajtura në të ashtuquajturin ‘Ditari Gjerman’, i paraqitur nga SPRK në seancën e shqyrtimit gjyqësor më 11 nëntor 2011, të shënuar nga gjykata as Ekspoziti P1(b)

dëshmitarëve dhe provat mjeko-ligjore që ishin në posedim të Akuzës para marrjes në pyetje nga mbrojtësit⁵⁷.

Dëshmia e **AZ** ngre shumë pikëpyetje të cilave nuk u është dhënë përgjigje. Për arsye se Akuza nuk bëri zbulimin e provave dhe dëshmive të tjera në posedim të saj para 5 korrikut 2011, mbrojtësve iu mohua mundësia për ta marrë në pyetje **AZ** për çështje që ishin vendimtare për vërtetimin e fakteve në fjalë nga trupat gjykuese. Ndonëse disa prova të caktuara shpresore u vunë në dispozicion të mbrojtësve para datës 5 korrik 2011, fakti që **AZ** nuk mund të ishte i pranishëm për shqyrtimin gjyqësor krijoi shumë më tepër paragjykim për të pandehurit në vërtetimin e pretendimeve.

Në shqyrtimin e parë, Mbrojtja e kundërshtoi pranueshmërinë e deklaratave dhe ditarëve të **AZ**. Trupi i parë gjykues vendosi që dëshmitë dhe provat e AGt janë të papranueshme⁵⁸.

Më pas Gjykata Supreme e Kosovës e përmbysi atë Aktvendim dhe i deklaroi⁵⁹ të pranueshme deklaratat dhe ditarët e **AZ**.

Ndërsa pranueshmëria e dëshmive dhe provave të **AZ** nuk është më çështje për zgjidhje, pesha që duhet t'i bashkëngjitet dëshmisë së tij është. E tillë është edhe shkalla në të cilën trupi gjykues mund të mbështetet në dëshminë e tij për vërtetimin e çështjeve në fjalë.

Neni 157 (4) i KPPK-së parashikon se *'gjkata nuk e shpall personin fajtor vetëm mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues'*.

Gjetja e mbetjeve mortore në fshatin Kleçkë ose afër tij mund të mbështeste argumentin e Akuzës se krimet u kryen. Në mungesë të provave të tjera, gjetja e mbetjeve NUK provon se nga

⁵⁷ Përmendur në Aktvendimin për Pranueshmërinë, datë 21 mars 2012

⁵⁸ Aktvendim i datës 21 mars 2012

⁵⁹ Aktvendime të datës 20 nëntor dhe 11 dhjetor 2012

kush u kryen ato krime ose, vërtet, kur ose ku u kryen ato krime. Gjetja e mbetjeve mortore nuk e vërteton dëshminë e **AZ** lidhur me identitetin e kryerësve të atyre krimeve.

Më tej, edhe sikur Akuza t'i kapërcente pengesat e paraqitura nga Neni 157 (4) prapëseprapë, gjykata duhet të jetë e bindur lidhur me besueshmërinë e **AZ**. Vlerësimi nga trupi gjykues i besueshmërisë së **AZ** është qendror në vërtetimin e akuzave kundër çdo të akuzuari.

Prandaj, besueshmëria e **AZ** është çështja paraprake që duhet të trajtohet nga trupi gjykues.

AZ e dha punësimin e tij si 'vinçier'. Ai nuk kishte kualifikime zyrtare.

Sipas shkresave ushtarake, **AZ** ishte pjesëtar i UÇK-së nga 16 maji 1998 deri më 19 shtator 1999⁶⁰. Duket se ai njihej me pseudonimin 'Murrizi'. Ai ishte kyçur në Brigadën 121 të UCK-së. Kjo Brigadë u bë e njohur si Brigada "Kumanova". Funkzioni i tij u përshkrua si "polic ushtarak". Megjithatë, në një sërë dokumentesh **AZ** e përshkroi veten ose përshkruhej si "kujdestar burgu"⁶¹.

AZ dëshmoi⁶² se ishte në Kleçkë nga shkurti 1999 deri në fund të luftës. Kjo është në pajtim me provat e tjera shkresore⁶³.

AZ i pajisi hetuesit me dokumentacionin⁶⁴ që është i pajtueshëm me dëshmi dhe prova të tjera⁶⁵ që konfirmojnë identitetin e personave të paraburgosur në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë.

⁶⁰ 0096-09-EWC2/021 dosja F

⁶¹ 0096-09-EWC2/024, dosja F, 0096-09-EWC2/027, dosja F, 0096-09-EWC2/030, dosja F, 0096-09-EWC2/031, dosja F, 0096-09-EWC2/032, dosja F

⁶² Faqe 12 (anglisht) e proces-verbalit të marrjes në pyetje më 7 korrik 2011

⁶³

⁶⁴ Dokumenti numër 0096-09-EWC2/024; Vendimi i gjykatës datë 17 maj 1999 (0096-09-EWC2/025) i nënshkruar nga X; Urdhri i datës 14 shkurt 1999 për të sjellë një të burgosur në gjykatë. Emri i të burgosurit del në listën e personave, të datës 6 maj 1999 i paraburgosur [në Kleçkë]. Lista shënon se i burgosuri ishte pranuar më 4 shkurt 1999 dhe liruar më 20 mars 1999.

Dëshmia se **AZ** ishte prezent në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë është e pajtueshme me dëshmi e prova të tjera. **SD**⁶⁶ dëshmoi⁶⁷ se gjatë periudhës dhjetor 1998 deri në 4 prill 1999, ai ishte stacionuar në shtabin e UÇK-së në fshatin Divjakë. Ai tha se e vizitonte qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë rregullisht. Dëshmia e tij ishte se gjatë njëjës prej këtyre vizitave, ai shpërndau një manual për trajtimin e të paraburgosurve. Në dëshminë e tij⁶⁸ **AZ** tha se kishte marrë një kopje të manualit⁶⁹ nga **SD**.

Në dëshminë e tij **SD** iu referua rastit të Blerim Kuqit. Më 6 maj 1999, **AZ** përpiloi një listë të të burgosurve. Ajo listë përfshinte emrin Blerim Kuqi.

Dëshmitari Anonim C dëshmoi⁷⁰ se e kishin paraburgosur në fshatin Kleçkë gjatë periudhës 20 mars – 3/4 prill 1999. Ai tha se atë e kishte liruar **AZ**.

UK⁷¹ dëshmoi⁷² se ai e pa **AZ** në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë më ose rreth majit/qershorit 1999.

Dëshmitari Anonim B dëshmoi⁷³ se ai e takoi **AZ** në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë. Edhe Dëshmitari V dëshmoi se e pa **AZ** në qendrën e paraburgimit në fshatin Kleçkë. Në mënyrë interesante, të dy dëshmitarët mendonin se **AZ** mbante pozitë përgjegjësie brenda qendrës së paraburgimit.

⁶⁵ Deklaratat e: Dëshmitarit Anonim C, datë 21 shtator 2010; Blerim Kuqit, datë 4 tetor 2010; Dëshmitari F, datë 2 janar 2011; Dëshmitarit V, datë 18 prill 2011; Dëshmitarit W, datë 16 qershor 2011; Dëshmitarit D, datë 24 dhjetor 2010 dhe 18 janar 2011.

⁶⁶ I njohur edhe si Dëshmitari A

⁶⁷ Deklaratë e datës 23 shtator 2010

⁶⁸ Deklaratë e datës 9 shkurt 2010

⁶⁹ 0096-09-EWC2/022, dosja F

⁷⁰ Deklaratë e datës 21 shtator 2010

⁷¹ Më parë i njohur si Dëshmitari Anonim I

⁷² Deklaratë e datës 22 nëntor 2010

⁷³ Deklaratë e datës 8 dhjetor 2010

Në deklaratat të ndryshme për Prokurorin Special të EULEX-it dhe për Policinë, **AZ** dha një përshkrim të ngjarjeve në Kleçkë, ku ai tha se kishte qenë dëshmitar dhe/ose kishte marrë pjesë. Dëshmia e tij ishte se ai mbajti ditar gjatë gjithë periudhës së shërbimit të tij në UÇK. Ditari në fjalë nuk ishte si një libër i vetëm, i lidhur në kuptimin tradicional të ditarit, por përbënte një koleksion letrash dhe blloqesh shënimesh. Shënimet në atë ditar thuhej se ishin bërë kryesisht në të njëjtën kohë me ngjarjet e përshkruara. Formati i ditarit ngriti një shqetësim të dukshëm për mbrojtësit, të cilët e vunë në pikëpyetje autenticitetin, mbështetshmërinë dhe bashkëkohësinë e ngjarjeve të përshkruara në të dhe peshën që gjykata duhet t'i japë atij.

AZ pohoi se ai i kishte ruajtur dhe fshehur ditarët e tij nga fundi i konfliktit deri sa ia kishte dorëzuar ata Policisë. **GZ** dëshmoi se **AZ** ia dha asaj ditarët dhe i kërkoi asaj t'ua dorëzonte ato autoriteteve, në rast se atij i ndodhte ndonjë gjë.⁷⁴

AG dëshmoi⁷⁵ se ai vrau **ND** dhe **VM**. Të dy ishin policë serbë⁷⁶. Ai tha se i vrau ata më ose rreth datave 4 ose 5 prill 1999, sipas urdhrave të **FL**. Emrat e tyre dhe fshati i tyre u shënuan nga **AZ** në një bllok shënimesh.

AG i dërgoi hetuesit në vendin ku ai tha se ishin varrosur trupat e të dy policëve. Trupat u zhvarrosën nga dy vende. Në një vend⁷⁷ hetuesit gjetën trupa. Në një vend të dytë⁷⁸ hetuesit gjetën dy trupa.

AZ përshkroi se kishte marrëdhëniet të afërta me **FL**. Dukej se gjatë luftës familja e ngushtë e **FL** kishte banuar për një farë kohe në shtëpinë e **AZ**⁷⁹.

⁷⁴ Deklaratë e datës 20 prill 2010

⁷⁵ Deklaratë e datës 11 shkurt 2010, faqe 12 pf 20 (A82)

⁷⁶ Raportet para Vdekjes, bashkëngjitur Raporteve pas Vdekjes, datë 19 prill 2001; deklaratë e Dëshmitarit U, datë 26 qershor 2011.

⁷⁷ KER01

⁷⁸ KEQ

⁷⁹ Dëshmi e Dëshmitarit Y, deklaratë e datës 20 prill 2010

FL iu referua periudhës gjatë luftës, kur familja e tij kishte banuar në shtëpinë e **AZ**, por mohoi se ndërmjet familjes së tij dhe asaj të **AZ** kishte pasur ndonjë marrëdhënie të veçantë. Ai përshkroi se familjen e tij e kishin zhvendosur dhe ishte në kërkim të strehimit.

Sipas dëshmisë së **GZ**⁸⁰ duket se marrëdhëniet ndërmjet **AZ** dhe **FL** u bënë të tendosura pas fillimit të një hetimi të TPNJ-së kundër **FL** dhe të tjerëve.

Argumenti i Akuzës ishte se pas arrestimit të **FL** në vitin 2003, bashkëpunëtorët e **FL**, përfshirë **NS**, **SS1** dhe **BS** e dërguan **AZ** në Shqipëri me synimin që ai të mos kthehej. Mirëpo ai u kthye por më pas u fsheh. **GZ** dëshmoi për kërcënimet që ajo tha se **AZ** kishte marrë, ku e paralajmëronin atë që të mos jepte dëshmi për ngjarjet e kohës së luftës⁸¹.

Në vitin 2007, **AZ** zbuloi një bombë dore nën veturën e tij⁸². Në qershor 2009 ai u qëllua dhe u plagos ndërkohë që ishte në shtëpi në Prizren. Ai besonte se **FL** ishte prapa të gjithë këtyre tentativave të dukshme për t'i marrë jetën.

Më 24 nëntor 2005, **AZ** po voziste automjetin e tij në Shtime, kur ai bëri ndeshje me një automjet tjetër që vozitej nga **SF**. Policia shkoi në vendngjarje. Raporti i policisë duket se përgjegjës për aksidentin bën vozitësin palë e tretë.

Më 28 tetor 2006, **AZ** po voziste automjetin e tij në Prizren, kur ai bëri ndeshje me një automjet tjetër. Policia shkoi në vendngjarje. Raporti i policisë duket se bën **AZ** përgjegjës për aksidentin.

Më 3 tetor 2007 **AZ** po voziste automjetin e tij për në Komorane, kur ai bëri ndeshje me një automjet tjetër që vozitej nga **BS**. Policia shkoi në vendngjarje. Raporti i policisë duket se përgjegjës për aksidentin bën vozitësin palë e tretë.

⁸⁰ I njohur edhe si Dëshmitari Y

⁸¹ Dëshmi e Dëshmitarit Y, deklaratë e datës 20 prill 2010

⁸² Raport i Incidentit, datë 16 korrik 2007

AZ dëshmoi se secili prej këtyre aksidenteve rrugore ishte montuar me qëllimin e vetëm të heshtjes së tij. Ai tha se këto aksidente i kishte orkestruar **FL**.

AZ u shtrua dy herë në spitale psikiatrik në vitet 2005 dhe 2006.

i. Gjetjet

(a) Ditarët

I ashtuquajturi 'ditar' kinse i shkruar nga **AZ** është pjesë qendrore e argumentit të Akuzës.

Argumenti i Akuzës ishte se shënimet në ditar ishin shkruar nga dora e **AZ**. **AZ** dëshmoi se *"Ai kishte mbajtur shënime, por ato ishin shënime personale të miat. Askush nuk kishte dijeni se unë po mbaja ditarë."*⁸³ Ai tha *"Unë i shkrova këta ditarë në burgun e Kleçkës gjatë kohës që punoja atje si rojë. Kur, për shembull, dikush sillej brenda, unë shkruaja emrin e tij në një copë letër në fshehtësi dhe pastaj e kopjoja atë në ditarin tim, kur ndjehesha i sigurt për ta bërë këtë."*⁸⁴ **AZ** dëshmoi se askush nuk kishte qasje në ditarët e tij. Ai tha *"Unë i kam mbajtur ato në vende sekrete, të fshehta dhe jam 100% i sigurt se askush nuk ka pasur qasje në këta ditarë"*⁸⁵. Nga mbrojtja u sugjerua se shënimet në ditar ishin shkruar nga autorë të ndryshëm.

Në vlerësimin e dëshmisë së tij, gjykata u referohet raporteve të **Profesor AB**, datë 30 dhjetor 2012⁸⁶ dhe 2 korrik 2013⁸⁷, ekspert i udhëzuar nga Akuza, dhe raporteve të **Dr. HK**, datë 2 shkurt 2012⁸⁸, 26 shkurt 2012⁸⁹ dhe 30 maj 2013⁹⁰, ekspert i udhëzuar nga mbrojtja.

⁸³ Deklaratë më 9 shkurt 2010 në dosjen A, faqe A36

⁸⁴ Deklaratë më 9 shkurt 2010 në dosjen A, faqe A37

⁸⁵ Deklaratë më 9 shkurt 2010 në dosjen A, faqe A37

⁸⁶ Eksponati P50

⁸⁷ Eksponati P51

⁸⁸ Eksponati D (FL) 9

⁸⁹ Eksponati D (FL) 10

⁹⁰ Eksponati D (FL) 11

Pasi shqyrtoi me kujdes raportet e paraqitura nga ekspertët përkatës të dorëshkrimit, gjykata gjen se nënshkrimi në fund të dokumenteve të shënuara si eksponatet 0096-09-EWC2/023, 0096-09-EWC2/013, data e shënimit 16.02.2010, data e shënimit 17.02.2010, data e shënimit 10.03.2010, data e shënimit 16.03.2010, data e shënimit 16.03.2010, data e shënimit 25.03.2010, data e shënimit 09.06.2010 dhe data e shënimit 20.08.2010 dhe dokumentet e shënuara si eksponatet 0096-09-EWC2-038, 0096-09-EWC2/039, 0096-09-EWC2/040, 0096-09-EWC2/041 dhe bashkëngjitja e shënimit të datës 16.03.2010 (fotografi) është i **AZ**.

Trupi gjykues gjen se dokumenti i shënuar si eksponati 0096 – 09 – EWC2 -003 (faqe 7) i atribuohet një autori.

Trupi gjykues gjen se dokumentet e shënuara si eksponatet 0096-09-EWC2 -001; 0096-09-EWC2 -001 – page7 (datë 30.07.2007); 0096-09-EWC2 -001 – faqe 9 (datë 22.09.2007); 0096-09-EWC2 -001 – faqe 11 (datë 26.11.2007); 0096-09-EWC2 -001 – faqe 13 (datë 14.02.2008); 0096-09-EWC2 -001 – faqe 19 (datë 04.03.2008); 0096-09-EWC2 -001 – faqe 23 (datë 01.06.2008); 0096-09-EWC2 -001 – faqe 31 (datë 12.12.2008); 0096-09-EWC2 -001 – faqe 41 (datë 07.07.2009); 0096-09-EWC2 -001 – faqe 43 (datë 4 to 5.08.2009); 0096-09-EWC2 -002 – faqe 14 (datë 28.05.2006); 0096-09-EWC2 -002 – faqe 15 (datë 29.05.2006); 0096-09-EWC2 -002 – faqe 16 (datë 30.05.2006); 0096-09-EWC2 -002 – faqe 18 (datë 02.09.2006); 0096-09-EWC2 -002 – faqe 42 (datë 07.05.2007); 0096-09-EWC2 -003 – faqe 1 (datë 21.01.2009); 0096-09-EWC2 -003 – faqe 5 (datë 23.12.2005); 0096-09-EWC2 -003 – faqe 7 (Ankesë); 0096-09-EWC2 -003 – faqe 9 (datë 26.06.2004); 0096-09-EWC2 -003 – faqe 36 (datë 06.08.2004); 0096-09-EWC2 -005 – faqe 1 (datë 04.01.2008); 0096-09-EWC2 -006 – faqe 11 (datë 19.09.2006, me titullin “Oje Familja L”); 0096-09-EWC2 -008 – faqet 1, 2, 3, 4 dhe 5; 0096-09-EWC2 -010; 0096-09-EWC2 -011; 0096-09-EWC2 -011 – faqet 2 – 15 përfshirë; 0096-09-EWC2 -012 – mbulesë; 0096-09-EWC2 -012 – faqet 1 – 6 përfshirë; 0096-09-EWC2 -013 – faqe 17; 0096-09-EWC2 -014 – faqet 1 – 5 përfshirë; 0096-09-EWC2 -016; 0096-09-EWC2 -018 – faqe 1 (datë 18.02.2010) dhe dokumenti i përbërë nga 32 faqe (faqja e parë përmban tekstin “Lineatur 51”) i atribuohen autorit të dytë, me përjashtim të zgjatimeve në shkrim dore të zakonshëm të vendosur në shkrimin e shënuar si 0096 – 09 – EWC2 – 011 – f. 4, që i atribuohen një autori tjetër. Më tej, trupi gjykues gjen se,

përveç shënimeve shpjeguese me dorëshkrim të zakonshëm, këto dokumente u shkruan nga **AZ**.

Dr. HK është i mendimit se dokumenti i shënuar si eksponati 0096 – 09 –EWC2 – 003 – faqe 7, mund t'i atribuohet një autori; dokumentet e shënuara si eksponatet 0096 – 09 – EWC2 – 003 – faqe 5, 0096 – 09 – EWC2 – 003 – faqe 9, 0096 – 09 – EWC2 – 003 – faqe 36, mund t'i atribuohen një autori të dytë. Trupi gjykues e pranon dëshminë e **Profesor AB** se ndryshimet e dukshme në dorëshkrim në secilin prej këtyre dokumenteve mund t'u atribuohen ndryshimeve të natyrshme që janë produkt i të njëjtit autori.

Duke bërë fjalë për eksponatin 0096 – 09 - EWC2 – 013, faqet 1, 3, 5, 6, 12, 16, 16a dhe 18, Dr. Kotri shprehu mendimin se këto dokumente ishin shkruar nga tre autorë të ndryshëm.

Më e habitshme është se, lidhur me gjetjet e caktuara të Dr. Kotrit në raportin e tij të datë 30 maj 2013, **Profesor AB** nuk i trajtoi këto gjetje në raportin e mëpasëm të tij të datës 2 korrik 2013. Në vend të kësaj, ai thjesht iu referua metodologjisë së përdorur nga **Dr. K**, kur vlerësoi dokumentet e tjera. Kjo mungesë është edhe më befasuese sepse gjetjet e **Dr. K** minojnë ndjeshëm argumentin e Akuzës se ditarin e kishte shkruar vetëm **AZ**.

Pasi ka shqyrtuar me kujdes secilin prej dokumenteve të cilave u referohet **Dr. K**, trupi gjykues gjen se 0096-09-EWC2 -013 – faqet 1, 12, 16 dhe 16a në të ashtuquajturit ditarë të luftës qartazi nuk ishin shkruar nga e njëjta dorë si shumica e dokumenteve që iu atribuan **AZ**. Më tej, gjykata gjen se shënimet shpjeguese në 0096 – 09 – EWC2 – 011 – në faqen 4, nuk u shkruan nga **AZ**.

Edhe pa përfitimin e mendimit ekspert të Dr. K., është e dukshme se dokumentet e shënuara si eksponati 0096-09-EWC2 -013 – faqet 1, 12, 16 dhe 16a, nuk u shkruan nga e njëjta dorë si shumica e dokumenteve që përbëjnë ditarin e luftës. Trupi gjykues gjen se këto dokumente nuk

u shkruan nga **AZ**. Më tej, trupi gjykues gjen se këto shënime u bënë nga tre autorë të ndryshëm.

Kur u intervistua nga policia më 3 dhjetor 2009, **AZ** u pyet përse i kishte mbajtur ditarët. Në përgjigje ai tha *“Vetëm sa për t’i pasur për të më ndihmuar kujtesën në rast se do të më nevojitej ndonjë informacion më pas.”*⁹¹ Megjithatë, trupi gjykues ka gjetur se disa shënime në ditar nuk u shkruan nga **AZ**. Në rast se shënimet do të ishin bërë nga persona të tjerë, atëherë qartazi ky nuk ishte ditari personal që mbante **AZ** *“për të ndihmuar kujtesën [e tij]”*.

Në rast se ditari i luftës i **AZ** përmban faqet e shkruara nga persona të tjerë, atëherë në kuptimin e logjikës së thjeshtë vijojnë disa pyetje. Pyetja më e dukshme është cila ishte natyra dhe qëllimi i të ashtuquajturit ‘ditar’ i luftës? Qartazi ai nuk ishte ditar personal i mbajtur nga **AZ**. Në vend të kësaj, trupi gjykues gjen se ai përmban kontribute të bëra nga autorë të tjerë. Trupi gjykues gjen se i ashtuquajturi ditar i luftës ishte një koleksion shkresash në të cilin kishin kontribuar persona të tjerë.

Ndërsa trupi gjykues gjen se pjesa më e madhe e shënimeve në ditarin e luftës u bënë nga **AZ**, fakti që disa shënime u bënë nga persona të tjerë ngre pyetjen nëse shënimet e bëra nga **AZ** ishin çështje brenda njohurive personale të tij.

Më tej, fakti që shënimet u bënë nga persona të tjerë, bie ndesh me përshkrimin e tij se ky ishte ditar personal ku ai kishte shënuar informata në fshehtësi. Kjo ishte thjesht gënjeshtër. Në vend të kësaj, ai ka më shumë të ngjarë të ishte një regjistër i mbajtur për ngjarjet në qendrën e paraburgimit, në të cilin kishin kontribuar edhe persona të tjerë, dhe që **AZ** e mbajti pas luftës dhe thjesht ‘e përvetësoi’ si të tijin.

Një pyetje tjetër që shtrohet është njëkohësia e shënimeve në ditar. Për datën konkrete se kur u bënë shënimet në ditar, nuk mund të ketë siguri. E vetmja provë në lidhje me këtë është

⁹¹ Deklaratë e datës 30 nëntor 2009, vazhduar më 3 dhjetor 2009

dëshmia e **AZ**, që u referohet disa ngjarjeve të cilat përmenden në atë ditar, dhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë.

Disa pjesë të 'ditarit' përfshinin një koleksion letrash të palidhura, që mund të ishin shtuar në çdo kohë, ose ndryshuar. Shënime të tjera duket se janë shtuar më pas. Për shembull, shënimet në ditar për datat 15, 18 21 dhe 26 dhjetor 2006 janë shkruar në një fletë të vetme letre, që është bashkëngjitur duke përdorur shirit ngjitës në faqen e parë të një blloku të lidhur, që përmban shënime të tjera në ditar.⁹² Në faqen e prapme që është ngjitur në librin e lidhur, gjendet një shënim i rëndësishëm që u referohet pagesave që **AZ** pretendonte se kishte marrë nga **FL**. Ky shënim ishte vendosur më pas dhe ishte tentativë e dukshme dhe e trashë nga **AZ** për ta përfshirë si ngjarje në kronologjinë e shënimeve të mëpasme në ditar.

Më tej, faqja që është futur në ditar i referohet periudhës 15 – 26 dhjetor 2006. Shënimi tjetër në atë ditari është i datës 27 dhjetor 2006. Gjatë asaj periudhe **AZ** ishte pacient në spitalin psikiatrik në Prishtinë dhe, siç duket, mbante një ditar tjetër. Për shembull, në ditarin e shënuar si eksponati 0096 – 09 – EWC2/006, gjendet një shënim që i referohet 26 janarit 2007.⁹³ Ai shënim në ditar deklaron “deri më sot 26.1.2007”, por është vazhdim i një faqeje të shënuar data “1.12.2006”.⁹⁴ Megjithatë, shënimet në ditar për periudhën ndërmjetëse u shkruan në blloqe të tjera shënimesh.

Nga mbrojtësi i **FL** u pohua se një shënim në ditar ishte ndryshuar. Mbrojtësi iu referua dy faqeve që trupi gjykues gjen se u shkruan nga **AZ**. Këto dokumente u analizuan nga Dr. Kotri dhe janë objekt i raportit të tij të datës 26 shkurt 2012⁹⁵.

Njëri prej dokumenteve mban datën 29 dhjetor 2010 dhe përmban dy kolona datash. Dokumenti i dytë qartazi u shkrua më pas, sepse i referohet një bisede telefonike me

⁹² Ekspionati 0096 – 09 – EWC2/001

⁹³ Ekspionati 0096 – 09 – EWC2/006

⁹⁴ Ekspionati 0096 – 09 – EWC2/006, faqet 25 dhe 26

⁹⁵ Të referuara në raportin e Dr. HK të datës 26 shkurt 2012 si ekspionatet D (FL) 1 dhe D (FL) 2

prokurorin më 6 korrik 2011. Trupi gjykues gjen se dokumenti i dytë i fundit është zbardhje e pjesshme e dokumentit të parë – përveç një mungese të rëndësishme. Të dy dokumentet përmbajnë një listë të datave kur **AZ** u intervistua nga prokurori. Versioni më i hershëm i dokumentit përmban fjalinë “Unë nënshkrova pa e ditur se çfarë është në të, ai nuk m’u përkthye”. Ndërkohë që substanca e dokumentit të mëhershëm është transpozuar në dokumentin e mëpasëm, kjo fjali vendimtare është hequr. Kjo ngriti një shqetësim të dukshëm të mbrojtjes se një shënim në ditar ishte ndryshuar. Trupi gjykues gjen se ky dokument u rishkruajt, por trupi gjykues nuk bën gjetje të mëtejshme në këtë drejtim, përveç se të shënojë se kjo nuk ishte veç se njëra prej një numri çështjesh që mund dhe duhej të ishin hetuar nga prokurori në fazën e procedurës paraprake.

(b) Historia psikiatrike e AZ

Historia psikiatrike e **AZ** ishte e rëndësishme për të vlerësuar besueshmërinë e përgjithshme të tij. Palët siguruan shkresa të ndryshme psikiatrike. Trupi gjykues emëroi sipas detyrës zyrtare **Dr. RL**. Akuza vuri si provë një raport të ekspertit të vet, **Dr. FR**. Më tej, trupi gjykues përfitoi nga marrja e raporteve dhe shkresave të psikiatërve të cilët trajtuan **AZ**.

AZ u shtrua për herë të parë në spitalin psikiatrik në Prizren nga 15 dhjetori 2005 deri më 4 janar 2006. Asnjë diagnozë nuk u shënuar pas shtrimit të tij, por diagnozat e mëparshme të çrregullimit të stresit post-traumatik (këtëj e tutje “PTSD”) dhe “cephalea post traumatica” nuk ishin shënuar.

Shënimet klinike tregojnë se ai u shtrua për shkak të dhimbjeve të kokës dhe çrregullimeve të tjera që kishin vazhduar për tre javë pas një aksidenti rrugor.

Është shënuar se “kur u shtrua në spital, ai kishte një gjendje pak konfuzë, përgjigjej me dembelizëm, i rezervuar, ai pranoi se kishte çrregullime të gjumit etj. Veshjet e tij dhe higjiëna

personale normale". Po kështu shënohej *"i vetëdijshëm, në ankth, i trembur, hipobulik, dinamizmi i reduktuar lascivioze vitale, pa shenja të të menduarit, kujtesës ose perceptimeve të çrregulluara"*.

Analizat e gjakut ishin normale. Aty përmendej *"myalagia intercodstalis"*.

Ai u *"lirua në gjendje të përmirësuar"* dhe iu përshkrua Fluoxeting⁹⁶

AZ u shtrua për trajtim në një rast të dytë ndërmjet 30 nëntorit 2006 dhe 19 janarit 2007 në Prishtinë. Në këtë rast diagnoza e tij u shënuar si *"episode të turbullirës psikotike akute F23.8"*⁹⁷

Ai u trajtua me haldol (antipsikotik), lorazepam (hipnotik) dhe largactil (i njohur edhe si klorpromazine – një antipsikotik tjetër).

Ai u përshkrua se ishte sjellë në spital nga pjesëtarët e familjes për shkak të *"pagjumësisë, sjelljes së çorganizuar, ndjekjes së ideve që filluan para një muaji"*. Ai u përshkrua si *"vetëdije e konservuar, i çorientuar, në pamje të jashtme duket konfuz, në ankth, kontakti verbal me vështirësi, jep përgjigje të papërshtatshme brenda kontekstit të pyetjes, raport të pamjaftueshëm afektiv, ai nuk di si ta përshkruajë gjendjen e tij, jep perceptimin e halucinacioneve dëgjimore, të menduarit i çorganizuar me paraqitjen e ideve iluzive dhe ndjekje dhe persekutim, ide vrasjeje, gjykimi dhe kujtesa të cenuara, i pavetëdijshëm për gjendjen e tij."*

Ai u përshkrua si i përmirësuar me trajtim dhe kalimin e disa fundjavave në shtëpi.

Ka prova se më 1 dhjetor 2006 ai u shtrua në një repart të kujdesit psikiatrik intensiv për shkak të *"keqësimit të sëmundjes së tij që manifestohet përmes axhitimit psikomotor të spikatur."* Ai u përshkrua si *"i axhituar, disforik dhe komunikimi verbal i vendosur me vështirësi"*. Aty ishte shënuar, *"Gjatë qëndrimit të tij pacienti filloi të përmirësohet dhe deklaroi "Kam vuajtur nga pagjumësia edhe para se të shtrohesha në spital për herë të parë në departamentin psikiatrik në"*

⁹⁶ Mendohet se bëhet fjalë për fluoxetine, mjekim anti-depresant, Raport i datës 12 gusht 2012, Dr. L

⁹⁷ F23.8 i korrespondon diagnozës ICD-10 çrregullim tjetër akut dhe kalimtar, Raport i datës 12 gusht 2012 Dr. L

X për shkak të një aksidenti rrugor të motivuar qëllimisht për likuidimin tim". Në këtë departament ai është i qetë, komunikativ, i trishtuar, me afekt të hapur, ai informon se është kërcënuar vazhdimisht nga shumë persona, "ata më kërcënojnë me telefon dhe thonë se do të më hedhin në hava mua dhe familjen time, unë shoh se disa persona më kërkojnë të vras këtë apo atë person në shkëmbim të shumë parave; u kam dërguar letra shumë politikanëve për të më dhënë siguri sepse luftova dy vjet".

Gjithashtu është shënuar, "Ky është shtrimi i parë në repartin psikiatrik në Prishtinë që kur sëmundja e tij nisi të përkeqësohet një muaj para shtrimit në spital, kur ai filloi të vuajë nga mendime të çuditshme" se ai ishte kërcënuar përmes telefonit, se ai dhe familja e tij do të zhdukeshin, dhe ata nuk më linin rehat, nuk e linin të punonte", pastaj vuan nga pagjumësia, biseda me veten, flet shumë, dhe është i inatosur. Pas përdorimit të terapisë, axhitimi, disforia ranë dhe idetë iluzive fikse u zhdukën".

Shënime të tjera përfshijnë këto që vijojnë, të cilat nuk kanë datë: "Ai vjen bashkë me bashkëshorten për shkak të një gjendjeje pas një aksidenti rrugor të pësuar 3 javë më parë. Ai duket i frikësuar, i brengosur, pa gjumë, herë pas here konfuz. Gjendje shumë e stresuar (deklaron se unë do të vras veten) dhe flet se kush do të kujdeset për fëmijët..."⁹⁸ "pohon se ai ishte përfshirë në lëndën e FL lidhur me deklaratën në Hagë. Ndjehet i frikësuar...." "Ai pati një aksident në vitin 2005 pas kësaj nuk ndjehet mirë. Gjendja mendore: pamja e jashtme përputhet me moshën, kujdesi dhe higjiena e mbajtur, flet ngadalë dhe me qetësi, me efekte të papërshtatshme (turbullirë, frikë, konfuzion, humor të rënë, rrjedha e mendimeve është e ngadaltë, pa përgjigje në mënyrën e duhur, mohon turbullirën në zonën perceptivë ... pjesërisht i vetëdijshëm për gjendjen mendore të tij." "Gjendja psikiatrike: i orientuar (ndonjëherë konfuz). Pak vetëdije, kur pyetet ai përgjigjet pas një pauze, flet ngadalë, i zhgënjyer, shpesh me gjendjen financiare, pa elemente sporadike". "Aksidenti më 24.11 në X.....Pohon se është përfshirë në rastin e FL në lidhje me dyshimet në X.....Ndjehet i fiksuar, i fyer, me frikën se po e ndjekin dhe është mundur që aksidenti nuk ishte i rastësishëm!?" Skaneri i trurit u raportua si normal.

⁹⁸ Dr. L. mendoi se kjo i referohej shtrimit të tij të parë.

AZ u shtrua në spitale psikiatrike në dy raste të veçanta. Në secilin rast u dha një diagnozë e ndryshme.

Shtrimi i parë në spital në dhjetor 2005 iu referua një diagnoze të mëparshme të PTSD-së. Në raportin e tij **Dr. RL** shkruan se PTSD zakonisht ndodh pas një përvoje traumatike të rrezikimit të jetës ose katastrofike. Është e paqartë se cili mjek e dha këtë diagnozë.

AZ u përshkrua se kishte simptoma të ankthit, por nuk ka përshkrim të simptomave të shmangies ose ripërjetimit. Është shënuar mungesë e simptomave psikotike në kohën e këtij shkrimi. Asnjë diagnozë tjetër nuk u zbatua në atë kohë.

Shtrimi i dytë nga nëntori 2006 rezultoi në një diagnozë të përafërt me *çrregullime psikotike të tjera akute dhe kalimtare*.

Në raportin e tij **Dr. RL** vrojton se në terma më të drejtpërdrejta ky është një person i cili është konstatuar se ka disa simptoma që do të klasifikoheshin si psikotike, por kjo nuk do të përmbushte kriteret për skizofreni dhe vërtet nuk u ngjajnë simptomave të para në skizofreni. Në kohën e kësaj diagnoze duket se ka pasur një farë sjelljeje të turbulluar, por pak hollësi ka në përshkrimin e simptomave që ai kishte me sa duket. Kjo e bën të vështirë çdo vlerësim të mëpasëm të rëndesës së gjendjes.

Në terma të manifestimit të simptomave, **Dr. RL** vrojtoi se shënimet tregojnë se në vitin 2005 **AZ** përjetoi kryesisht simptoma të ankthit, përfshirë frikën, vështirësi në fjetje si dhe një sugjerim se ai kishte shprehur disa mendime vetëvrasjeje. Në vitin 2006 bëhet fjalë për më shumë simptoma, përfshirë simptomat që do të klasifikoheshin si psikotike (halucinacione dëgjimore, mani persekutimi dhe çrregullim të mendimit). Halucinacionet dëgjimore (dëgjimi i zërave ose zhurmave) duket se janë dyshuar nga sjellja e tij, por nuk ka përshkrim të tyre dhe prandaj në mendimin e tij duhet të ketë një farë rezerve në pranimin se ato ishin të pranishme.

Dr. RL mendonte se do të ishte e zakonshme që të bëheshin shënime nëse dikush dëgjonte zëra ose zhurma, si dhe natyra, shpeshtësia dhe përmbajtja e zërave. Po kështu, do të ishte e zakonshme të shënohej nëse zërat dëgjohehin në hapësirën e jashtme. Asnjë prej këtyre hollësive nuk duket në shkresat mjekësore. Manitë fikse të persekutimit (mbajtja e besime të rreme fikse me gjithë provat në të kundërtën dhe jo të kuptueshme brenda kulturës së një personi) janë bazuar vetëm në besimet e **AZ** se atë po e ndiqnin, se ishin bërë tentativa për t'i marrë jetën dhe se ai kishte qenë objekt i kërcënimeve.

Dr. RL vrojton se vështirësia në çdo pohim të sigurt tani që këto ishin mani fikse është se substanca e besimeve duket se është faktikisht e diskutueshme. Me fjalë të tjera, në rast se **AZ** po e kërcënonin, po e ndiqnin dhe ishin bërë tentativa për t'i marrë jetën, atëherë ato ishin besime të arsyeshme dhe jo simptoma të një çrregullimi psikiatrik.

Megjithatë, në atë kohë ato u identifikuan si mani fikse nga ata mjekë që e trajtuan atë. Çrregullimi në mendim është sugjeruar duke iu referuar mendimeve të çorganizuara, por edhe në këtë rast nuk ka përshkrim të mëtëjshëm të kësaj. Janë shënuar edhe simptoma të tjera të gjendjes anormale të humorit dhe turbullira të sjelljes.

Dr. RL është i mendimit se në dokumentet mjekësore ka pak prova të qarta të një gjendjeje të psikozës dhe pa mbështetje në besimet e tij se po e ndiqnin, kjo diagnozë nuk mund të ishte dhënë – simptomat janë renditur, por hollësitë ose provat për këto simptoma mungojnë.

Asnjë diagnozë skizofrenie nuk u dha dhe **Dr. RL** është i mendimit se nuk ka prova që do të sugjerinin se diagnoza e skizofrenisë do të ishte e justifikuar në kohën e shtrimeve në spital ose më pas. Por ai vrojtoi se simptomat psikotike të izoluara dihet se janë faktor rreziku për zhvillimin më pas të skizofrenisë, megjithëse ai nuk mendonte që kjo të ishte gjasa nga provat më të fundit, përfshirë vrojtimin nga ana e tij të gjendjes mendore të **AZ** gjatë intervistave në vitin 2011, që u regjistruan në DVD, dhe dëshmitë e pjesëtarëve të familjes që kështu kishte

ndodhur. **Dr. RL** përfundon duke deklaruar se, ndërsa gjendja mendore e tij mund të kishte evoluar në skizofreni, kjo nuk duket të ketë ndodhur.

Në raportin e tij **Dr. RL** iu referua përshkrimit të ilaçeve haldol, largactil dhe lorazepam dhe ishte i mendimit se kjo ishte e përshtatshme për turbullirën e menjëhershme që paraqiste **AZ** – duke vrojtuar se këto përdoren zakonisht për ‘qetësim të shpejtë’ kur dikush është tejet i axhituar ose agresiv.

Dr. RL mendonte se dy ilaçet antipsikotike mund të jenë synuar për t’u përdorur për parandalimin afatgjatë të përsëritjes së simptomave. Për mendimin e tij, përshkrimi i këtyre ilaçeve sugjeron se shkalla e turbullirës në sjellje ishte e rëndë, por jo domosdo se e tillë ishte edhe psikoza. Unë nuk mund të komentoj për atë se cilat janë praktikatat e zakonshme të përshkrimit të ilaçeve në Kosovë.

Dr. RL nuk e mendonte të mundshme që gjendja të ishte afatgjatë. Në vitin 2005 u shënuar mungesa e simptomave psikotike, megjithëse ai vërtet kishte simptoma ankthi. Këto dy episode nuk ka të ngjarë të përbëjnë prova të çrregullimit afatgjatë. Nga informacioni i mëtutjeshëm nuk ka prova që ai të kishte ndonjë sëmundje mendore në vitet më pas.

Dr. RL vrojtoi se, sipas përkufizimit, PTSD përshpejtohet nga një ngjarje traumatike dhe episodet e psikozës zakonisht janë të lidhura me një lloj shkaktari traumatik. Për mendimin e tij, episodi i dytë mund të shpjegohet në tërësi me një ngjarje traumatike të tij. Me fjalë të tjera, po të ishte kërcënuar dhe po të ishin bërë tentativa për t’i marrë jetën, atëherë ai nuk kishte mani dhe sjellja e trazuar e tij mund të lidhej me stresin akut të kësaj situatë. Kështu që kjo nuk do të përshkruhej si psikozë akute. Është e pamundur të jesh i sigurt për këtë, për shkak të pakësisë relative të përshkrimeve të qarta klinike të gjendjes mendore të tij në shkresat mjekësore.

Dr. RL ishte i mendimit se të dy çrregullimet mendore që ishin shënuar, mund të kishin pasur efekt në të kuptuarit dhe perceptimin prej tij të një incidenti të veçantë, por për mendimin e tij kjo kishte gjasa të ishte problem vetëm gjatë episodeve akute kur ishte prezent psikoza.

Gjendja e përgjithshme gjatë shtrimit të dytë të tij në spital ishte se ai ndjehej i persekutuar, në ankth dhe i axhituar. Kjo mendohej të ishte tipar i çrregullimit mendor. **Dr. RL** vrojtoi se kjo gjendje mund të shpjerë në keqinterpretim të veprimeve të njerëzve, duke zbatuar një prirje persekutimi ose paranoje ndaj çdo sjelljeje ose veprimi. Në këtë mënyrë, kuptimi ose perceptimi i një incidenti mund të ndryshohet. Aksidenti me veturë në të cilin u përfshi **AZ** mund të shihej ose si aksident pa keqdashje të qëllimtë, ose si tentativë e organizuar ose e qëllimtë nga dikush, për ta lënduar atë. Ky mund të ishte fakt ose rezultat i përjetimit nga **AZ** i manive të përndjekjes, kështu që ai mund ta kishte keqkuptuar një aksident sikur ishte një akt më i qëllimtë ose keqdashës. Ai mund të ketë zbatuar një interpretim të ngjarjeve të llojit të manisë.

Në raportin e tij **Dr. RL** deklaroi se **AZ** nuk duket se ishte i sëmurë mendor në kohën e ndonjë dëshmie që dha dhe nuk ka sugjerim se ai ishte psikotik para vitit 2006. Nuk ka prova se ai ishte i sëmurë mendor në kohën e ndonjë incidenti për të cilin ai ka dhënë dëshmi. Gjithashtu është për t'u shënuar se diagnoza e psikozës u bë si një çrregullim "akut dhe kalimtar". Duket pa gjasa që interpretimi i ngjarjeve nga ana e tij të ketë pasur ndonjë ndikim të madh nga ndonjë sëmundje mendore.

Dr. RL deklaroi se, për mendimin e tij, është edhe më pak e mundshme që **AZ** t'i kujtonte ngjarjet historike në mënyrë të pasaktë. Ai vrojtoi se disa njerëz me psikozë kanë simptoma të njohura si kujtime të rreme (ku formohen besime të rreme për të shkuarën), por kjo duket shumë e pamundur nga dëshmitë që ai ka parë dhe zakonisht është e lidhur me një gjendje më të rëndë psikotike, të tillë si skizofrenia. **Dr. RL** nuk besonte se përshkrimi nga **AZ** i ngjarjeve të viteve 1998 ose 1999 mund të ishte nga mani të rreme dhe ai nuk besonte që provat psikiatrike

kanë ndonjë rol në vlerësimin e mbështetshmërisë së deklaratave që ai dha rreth ngjarjeve të asaj kohe në vitet 2009 dhe 2010.

Dr. RL vrojtoi se, në rast se **AZ** ishte në gjendjen e përshkruar në shkresat e spitalit në vitin 2006, atëherë ai mund të ketë luftuar me kujtimin me saktësi të ngjarjeve, sepse ai ishte tejet i axhituar, në ankth dhe i qetësuar me ilaçe. Megjithatë, nuk ka prova që të sugjerojnë se ai dha dëshmi gjatë ndonjë episodi të tillë.

Dr. RL vrojtoi se gjendjet mendore afatgjata janë të lidhura me rënien kognitive, që mund të përfshijë probleme me kujtesën. Megjithatë, në rastin e **AZ** ai nuk gjeti prova të një gjendjeje afatgjatë, por edhe sikur të ishte kështu, do të kishte më shumë të ngjarë që ai thjesht të mos ishte në gjendje të kujtonte asnjë ngjarje, në vend që të kujtonte ngjarje të rreme ose ngjarje që nuk kanë ndodhur kurrë. Në vitin 2005 u shënua mungesa e problemeve me kujtesën.

Dr. RL deklaroi se nuk ka prova të tjera nga ndonjëra prej të dhënave psikiatrike se ai kishte ndonjë problem kujtese të konsiderueshëm dhe afatgjatë, megjithëse në shtrimin në spital në vitin 2006 përmenden disa probleme me kujtesën, por nuk ka shtjellim lidhur me natyrën e ndonjë problemi.

Dr. RL ishte i mendimit se **AZ** nuk kishte nevojë për trajtim të mëtejshëm për atë që ishte gjendje e shkurtër dhe kalimtare. Ai mund të jetë ndjekur deri sa u konfirmua se ai nuk kishte përkeqësim të mëtejshëm. Në rast se gjendja mendore e tij do të kishte evoluar deri në skizofreni, atëherë trajtimi do të ishte treguar, por nuk ka prova që kjo të ketë ndodhur. Po të kishte vazhduar të vuante nga PTSD, atëherë trajtimi për këtë do të kishte ndihmuar, por përsëri kjo duket e pamundur, sepse edhe në vitin 2005 u përshkruan pak simptoma.

Dr. RL është i mendimit se provat për një çrregullim psikiatrik të rëndë, që do të kishte ndikuar në mbështetshmërinë e tij si dëshmitar, janë të dobëta. Ai e mendonte pa gjasa që të kishte një

lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet ndonjë çrregullimi mendor dhe dëshmisë së tij: me fjalë të tjera, nuk ka gjasa që bazën e dëshmisë së tij ta kenë formuar besimet e fiksuara të tij.

Dr. RL vëren se **AZ** kishte qartazi dyshime për sjelljen e njerëzve të tjerë dhe kishte frikë. Ai nuk mundi të thotë nëse kjo ishte simptomë e çrregullimit mendor. Nëse besimet e tij se po e përndiqnin, ndiqnin etj., ishin fiksime apo jo, kjo mund të vërtetohet vetëm nëpërmjet një pozicioni ligjor ndaj fakteve. Për mendimin e tij, në rast se **AZ** kishte fiksime dhe mbeti me fiksime në kohën e dëshmisë së tij, atëherë kjo do të sugjeronte sa më poshtë:

1. Dëshmia e tij për ngjarjet në vitet 1998 dhe 1999 nuk duhet të shihet si e pambështetshme për shkak të çrregullimit mendor.
2. Pësia e dëshmisë së tij për kërcënimet dhe tentativat e mëpasme për t'i marrë jetën duhet të përshtaten sipas fakteve që janë vërtetuar për këto incidente.

Në përfundim, **Dr. RL** është i mendimit se çrregullimit mendor të **AZ** nuk duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë, kur vlerësohet mbështetshmëria ose besueshmëria e dëshmisë së tij. Ai nuk ka ndonjë çrregullim mendor që të mund të thuhet se ndikon në ndershmërinë. Pa dyshim do të merren parasysh edhe faktorë të tjerë, por këta janë faktorë që nuk janë objekt i dëshmisë së ekspertit psikiatrik, për shembull, ndershmëria e tij ose nëse ai ishte i aftë të gënjente.

Akuza u mbështet në dëshminë e një eksperti psikiatër, **Dr. FR**. Mendimi i tij ishte se nuk kishte prova të sëmundjes së shëndetit mendor në përgjithësi dhe, në veçanti, nuk kishte prova të një gjendjeje që mund të prodhonte ndonjë dëmtim të konsiderueshëm në kujtesën lidhur me ngjarjet e shkuara.

Dr. FR e mendonte pa gjasa që simptomat e diagnostifikuara të mos ishin vënë re veçanërisht nga pjesëtarët e familjes. Për mendimin e tij, simptomat e përshkruara në shkresat e spitaleve ishin rezultat i “*simulimit të qëllimtë*” të **AZ**. Për mendimin e tij, **AZ** “*veproi në një situatë ku ishte e lehtë të simuloje, edhe për një jo ekspert të shëndetit mendor.*”

Dr. RL dhe **Dr. FR** nuk pajtohen se nuk ka prova për të mbështetur gjetjen e çrregullimit psikiatrik. Vërtet, **AZ** u shtrua në spital në dy raste në vitin 2005 dhe vitin 2006 dhe ishte nën kujdesin e tre doktorëve psikiatër.

Më tej, shënimet e **AZ** në ditar përshkruajnë një person që vuante nga një sëmundje mendore.

Shënimi i tij në ditar më 18 dhjetor 2006 lexon:

“KTHIMI NË SPITAL, 18.12.2006

*Ajo ditë ishte dita e hidhërimit për mua dhe familjen time. Ata thanë – udhë të mbarë babi, dhe gruaja ime me lot në sy tha - udhë të mbarë, oh bashkëshorti im i dashur, shpresoj të bëhesh më mirë së shpejti dhe pastaj do të kthehesh tek familja jote. Mallkuar...X bashkë me vozitësin **SRF** që shkatërruan dashurinë ndërmjet teje dhe meje, oh bashkëshorti im. **Mos u brengos për fëmijët sepse të dhashë fjalën që do të kujdesem; vetëm ti eja në shtëpi. Unë dua vetëm që ti të bëhesh mirë sa më shpejt. Tung. Shko tash, fëmijët nuk duhet ta kuptojnë që je sëmurë. Ajo m’i tha këto fjalë në vesh.”***

Në rast se **AZ** e mbajti ditarin e tij pas luftës pa ndonjë pritshmëri që ai do të lexohej nga persona të tjerë, ky shënim në ditar hedh dritë të qartë në shëndetin mendor të tij. Në rast se **AZ** e mbajti ditarin e tij me pritshmërinë – ose parashikimin – se ai mund të lexohej nga persona të tjerë dhe ky shënim në ditar kishte për qëllim të mashtronte, atëherë kjo demonstroi aftësinë e tij për të manipuluar rrethanat, për t’ia përshtatur një plani të para-konceptuar.

Në përgatitjen e ekspertizës së tij, **Dr. RL** është mbështetur në mendimet e doktorëve të cilët e trajtuan fillimisht **AZ**.

Dr. RL pranoi se simptomat e përshkuara në raporte të ndryshme psikiatrike mund të ishin montuar nga **AZ**. Vërtet, kjo ishte dëshmia e **AZ**. Edhe **IZ**⁹⁹ dhe **AZ**¹⁰⁰ dëshmuan se **AZ** nuk ishte vërtet i sëmurë.

Dr. RL dhe **Dr. FR** ranë dakord se ata nuk mund të përjashtonin mundësinë që **AZ** thjesht gënjeu kur dha dëshmi.

Gjykata gjen se është e mundshme që **AZ** nuk ishte i sëmurë mendor në vitet 2005 dhe 2006, por se ai vetëm pretendoi të kishte simptomat e një sëmundjeje psikiatrike. Në të vërtetë, ky është argumenti i Akuzës.

Në rast se argumenti i Akuzës është i saktë, **AZ** ishte gënjeshtar manipulues. Ai u shtrua në spitalin psikiatrik në X nga 15 dhjetori 2005 deri më 4 janar 2006. Ai u trajtua me ilaçe të ndryshme përfshirë anti-depresantë. Ai u shtrua në spitalin psikiatrik në X nga 30 nëntori 2006 deri më 19 janar 2007. Më 1 dhjetor 2006, ai u transferua në repartin e kujdesit psikiatrik intensiv të spitalit për shkak të një përkeqësimi të gjendjes së shëndetit mendor të tij. Ai u mbajt në repartin e kujdesit intensiv deri në daljen e tij nga spitali më 19 janar 2007. Diagnoza që iu dha në atë kohë ishte “trazira psikotike”.

AZ bindi tre psikiatër se ai ishte i sëmurë mendor, kur ai nuk ishte.

Nëse ishte apo jo i sëmurë mendor në vitet 2005 dhe 2006, kur **AZ** dha dëshmi ai tha se vetëm pretendoi të kishte simptomat e një sëmundjeje psikiatrike me qëllim që (a) të stërmadhonte padinë për dëmshpërblim pas aksidentit rrugor¹⁰¹, (b) t'i siguronte vetes mbrojtje të pjesshme ndaj vrasjes së **FL**¹⁰² dhe/ose (c) të diskreditonte një deklaratë që ai tha se nuk ia kishte dhënë KFOR-it¹⁰³.

⁹⁹ Deklaratë e datës 23 nëntor 2011, Dosja I e Provave të Prokurorisë Evidence, faqe P23

¹⁰⁰ Deklaratë e datës 23 nëntor 2011, Dosja I e Provave të Prokurorisë Evidence, faqe P22

¹⁰¹ Proces-verbal i marrjes në pyetje nga mbrojtësit më 7 korrik 2011 në pikën 470

¹⁰² Proces-verbal i marrjes në pyetje nga mbrojtësit më 7 korrik 2011 në pikën 298

¹⁰³ Deklaratë dhënë Policisë së Kosovës më 16 korrik 2007

Në rasti e parë ai gënjeu me qëllimin për të mashtruar një kompani sigurimi. Në rastin e dytë ai gënjeu me qëllim që të ndërtonte një mbrojtje të pjesshme ndaj vrasjes. Në rastin e tretë ai gënjeu për të diskredituar një deklaratë që, në fakt, ai nuk e kishte dhënë kurrë. Secila prej këtyre arsyeve e minon në masë besueshmërinë e **AZ**.

Trupi gjykues gjen se, nëse **AZ** kishte sëmundje mendore apo jo në vitet 2005 dhe 2006, kur dha dëshmi në vitet 2009 dhe 2010, ai nuk kishte ndonjë çrregullim psikiatrik të njohur, që mund të kishte cenuar aftësinë e tij për të dhënë dëshmi të saktë rreth ngjarjeve në vitin 1999. Më tej, trupi gjykues nuk gjen prova se ai vuante nga ndonjë sëmundje psikiatrike para vitit 2005.

Në fund të fundit, trupi gjykues erdhi në përfundim se historia psikiatrike e dëshmitarit, **AZ** nuk ishte një çështje vendimtare në këtë rast. Edhe nëse mjekët të cilët e kanë trajtuar **AZ** dhe ekspertët të cilët i kanë shqyrtuar raportet e tyre të jenë pajtuar se ai vuante nga psikoza, gjë që do të kishte mundur të ndikonte në aftësinë e tij për t'i kujtuar saktë ngjarjet e mëhershme, kjo gjithsesi nuk do të thotë se dëshmia e tij nuk ishte e saktë. Shumë më shqetësuese për trupin gjykues ishte (a) fakti se **AZ** mund të jetë shtirur për ndonjë sëmundje, e madje edhe më shqetësuese (b) mospërputhjet e shumta faktike në dëshminë e tij, të cilave u jemi referuar në mënyrë të detajuar më poshtë. Natyrisht, një faktor i rëndësishëm që i është shtuar këtyre shqetësimeve ishte fakti se **AZ** vdiq para shqyrtimit gjyqësor dhe prandaj nuk ishte e mundur të dëshmonte para trupit gjykues dhe mundësisht të sqaronte këto mospërputhje.

(c) Deklaratat

AZ dha deklarata në cilësinë e dëshmitarit para policisë së EULEX-it më 20 dhe 30 nëntor 2009 dhe vazhdoi më 3 dhjetor 2009. Ai dha deklarata në cilësinë e të dyshuarit / të pandehurit para prokurorit të PSRK-së më 4 shkurt 2010, 9 shkurt 2010, 11 shkurt 2010, 16 shkurt 2010 dhe 17 shkurt 2010; 10 mars 2010, 16 mars 2010, dhe 25 mars 2010; 6 qershor 2010 dhe 20 gusht

2010. Ai dha deklarata në cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues para prokurorit të PSRK-së më 5 dhe 7 tetor 2010. Ai u mor në pyetje nga mbrojtësit më 5, 6, 7 dhe 9 korrik 2011.

i. Vendet e varreve

Në gusht 2009 **AZ** identifikoi katër vende varresh.

Duke bërë fjalë për një vend¹⁰⁴ ai u tregoi hetuesve se atje ishin varrosur 9 trupa.

Gjithashtu ai identifikoi dy vende të tjera¹⁰⁵ që, ai tha, përmbanin secili dy trupa. Hetuesit i identifikuan ato vende si KEQ01 dhe KEQ02.

Duke bërë fjalë për vendin e katërt që kishte identifikuar, **AZ** deklaroi se ky vend përmbante trupat e 10 personave. Megjithatë, ai mendonte se trupat ishin larguar nga ky vend në vitin 2002.

Nga fotot¹⁰⁶ ai identifikoi vendet e varrimit që ai tha se ndodheshin në Livadhin e Canit.

Ai identifikoi fotot e tjera¹⁰⁷ që përshkruanin fshatin Kleçkë.

ii. Vrasja e katër ushtarëve serbë

AZ dëshmoi se **AA** u vra një ditë pas lirimit të tij. Një shënim në ditarin e tij e tregon datën e lirimit si 2 prill 1999¹⁰⁸.

¹⁰⁴ KER, shih dosjen M, faqe M72, M123

¹⁰⁵ KEQ, shih dosjen M, M72, M121, M122

¹⁰⁶ Fotot 9 dhe 10

¹⁰⁷ Fotot 11 – 16 përfshirë

¹⁰⁸ Eksponati 0096 – 09 – EWC2/012

AZ dëshmoi¹⁰⁹ se rreth 20 ditë para vrasjes së **AA**, ai kishte dëshmuar vrasjen e katër të burgosurve serbë. Ai e dha atë dëshmi në dy raste të veçanta¹¹⁰.

Duke përshkruar vrasjen e katër të burgosurve serbë, ai tha se ai ishte afërsisht 40 – 50 metra larg kur ata ishin vrarë. Ai tha se të burgosurit ishin veshur në uniforma të rregullta të ushtrisë serbe¹¹¹. Ai tha se dy prej të burgosurve ua kishin lidhur duart pas shpine. Dy të tjerët i kishin lidhur bashkë. Ai tha se për t'i lidhur ata ishte përdorur tel.

Ai tha se *“NK1, NK2, NK1 dhe dy të tjerë emrat e të cilëve nuk mund t'i kujtoj, i kishin marrë serbët nga Kleçka...”* Ai tha se *“X”*¹¹² ishte gjithashtu i pranishëm, por ai nuk mori pjesë në vrasjet. Ai tha se *“Të burgosurit u dërguan poshtë livadhit tek një gropë dhe pastaj unë dëgjova të shtënat e kallashnikovëve. Ndërmjet meje dhe vendit të ekzekutimit ishin disa pemë, prandaj nuk munda të shoh me saktësi kush shtiu, por dëgjova zhurmën e disa kallashnikovëve, jo vetëm të njërit”*.

Duke bërë fjalë për vendin e varrimit, ai tha se **AA** u varros në *“vendin ku u varrosën 9”*¹¹³.

Mbetjet trupore të **DT, BC, ZF, ZT** dhe **DV** u gjetën në vendin KER01. Ky ishte vendi që **AZ** e kishte identifikuar për hetuesit si varri që përmbante trupat e ushtarëve serbë, vrasjen e të cilëve ai tha se e kishte parë 20 ditë para vrasjes së **AA**. Ai dha të njëjtën dëshmi në raste të ndryshme¹¹⁴. Megjithatë, **DT, BC, ZF, ZT** dhe **DV** u kapën nga UÇK vetëm më 11 prill 1999¹¹⁵.

Në vitin 2009 **AZ** u pyet¹¹⁶ për një shënim në ditar ku thuhet se *“D TA N, 16.10.1946, u soll më 11.04.1999, u lirua më 18.04.1999; T S Z, 13.07.1951; S, B S, 05.09.1972 dhe F P Z, 12.03.1962”*.

¹⁰⁹ Intervistë në polici më 30 nëntor 2009, vazhduar më 3 dhjetor 2009

¹¹⁰ 30 nëntor 2009, vazhduar më 3 dhjetor 2009 dhe më 11 shkurt 2010

¹¹¹ Deklaratë më 3 dhjetor 2009

¹¹² **RM**

¹¹³ Deklaratë më 3 dhjetor 2009 (vazhdim i deklaratës së nisur më 30 nëntor 2009)

¹¹⁴ Intervista më 3 dhjetor 2009 dhe 11 shkurt 2010

¹¹⁵ Deklaratë e **TM** datë 27 janar 2005, SPRK dosja I, në P21B dhe P21C

¹¹⁶ Intervistë para Policisë më 30 nëntor 2009, vazhduar më 3 dhjetor 2009

Ai tha se *“Pasi mbërritën, ata u dërguan tek **FL** dhe pas kësaj disa persona që i përkisnin ‘bandës’ së **F**, m’i sollën mua”*. Ai tha se ata u liruan më 18 prill 1999.

Ai tha se më pas atë natë ai kishte *dëgjuar* se ata të burgosur ishin vrarë. Pastaj ai deklaroi, *“Nuk jam i sigurt për këtë, por këta të katërt mund të ishin ata serbë që unë i përmenda më herët dhe besoj se punonin për një farë kompanie elektriku”*. Ai tha se ata ishin civilë. Të katër të burgosurit serbë në vrasjen e të cilëve ai tha se kishte qenë dëshmitar dhe trupat e të cilëve ai tha se kishte ndihmuar të varroseshin, ai ua kishte identifikuar hetuesve se nuk ishin civilë. Ata u vranë ndërkohë që kishin veshur uniforma ushtarake.

Më tej, kur u intervistua në vitin 2009, ai i tregoi policisë se vetëm kishte dëgjuar për vrasjen e katër të burgosurve serbë të cilët ishin liruar më 18 prill 1999¹¹⁷. Kur u mor në pyetje më 11 shkurt 2010, ai tha *“Jam mjaft i sigurt se në Kleçkë u sollën dy grupe të ndryshme prej katër serbësh.”*

Ai dha një përshkrim shumë grafik të vrasjeve të të katër të burgosurve serbë dhe madje i dërgoi hetuesit në vendin ku ishin gjetur trupat e tyre.

Përshkrimi prej tij i njërit prej viktimave të vrarë me teh kose përputhet me provat mjekoligjore. Në të vërtetë, në varr u gjet një teh kose. Gjetja e tehut të kosës në varr duket se mbështet përshkrimin e tij se ai ka qenë dëshmitar i vrasjeve. Megjithatë, dëshmia e tij lidhur me kronologjinë e ngjarjeve dhe identitetin e viktimave kundërshtohet nga shënimet në ditarin e tij dhe nga prova të tjera.

Në komentin përmbyllës të tij¹¹⁸, prokurori tha se, nisur nga koha që ka kaluar, nuk ishte tërësisht befasuese që kishte disa gabime në kujtimet e **AZ**. Megjithatë, data se kur **AZ** thotë të katër të burgosurit serbë u liruan, është shënuar në ditarin e tij, siç është data kur ai thotë se u lirua **AA**.

¹¹⁷ Deklaratë më 3 dhjetor 2009 (vazhdimi i deklaratës së datës 30 nëntor 2009)

¹¹⁸ Proces-verbal i datës 11 shtator 2013

Dëshmia që dha **AZ** lidhur me vrasjen e të katër të burgosurve serbë, është kundërthënëse dhe kontradiktore dhe kundërshtohet nga prova të tjera, përfshirë provat mjeko-ligjore të cilat përmenden më poshtë.

iii. Vrasja e ushtarit serb të pestë

AZ dëshmoi¹¹⁹ se 10 ditë pas vrasjes së katër të burgosurve serbë, **NS** kërkoi atij t'i gjente një kosë. Duke bërë fjalë për të burgosurin e pestë serb, **NS** tha atij “Unë do ta çaj këtë thi”. Ai tha se i burgosuri kishte mbërritur në burg”... të njëjtën ditë, vetëm pak ditë më herët.” **AZ** dëshmoi se i burgosuri serb i pestë u vra “të njëjtën ditë që mbërriti ai”.¹²⁰

AZ dëshmoi se “Edhe **FL** e mori në pyetje serbin me të tjerët...” **AZ** e përshkroi të burgosurin serb si 45 – 50 vjeçar. Ai tha se ai nuk kishte uniformë por një këmishë me mëngë të shkurtra dhe pantallona të zeza. Ai tha se dikush e kishte përshkruar të burgosurin “të rangut të lartë”. Gjithashtu ai e përshkroi këtë të burgosur si “në një farë lloj pozite të lartë”¹²¹.

DT ishte njëri prej të pesë ushtarëve serbë të marrë nga UÇK më 11 prill 1999. Atë e morën bashkë me **BC, ZF, ZT** dhe **DV**.

DT ishte kapiten në Ushtrinë e Rezervistëve. Ai ishte lindur më 16 tetor 1946. Në fillim të vitit 1999, ai do të kishte qenë 52 vjeç.

AZ tha se **FL** “i bëri atij pyetje në fillim dhe e grushtoi dhe shqelmoi atë.”¹²² Ai tha se ata ishin në oborr. Të pranishëm ishin edhe ishin **NS, NK2, NK1, BL, SS1, BS** dhe **ST**.

¹¹⁹ Deklaratë më 11 shkurt 2010, dosja A faqe A76

¹²⁰ Deklaratë më 11 shkurt 2010, dosja A faqe A75

¹²¹ Deklaratë më 11 shkurt 2010, dosja A faqe A76

¹²² Deklaratë më 11 shkurt 2010

AG tha se kur **FL** kishte përfunduar marrjen në pyetje të të burgosurit, ai kishte thënë *“largojeni këtë derr”*. **AZ** tha se ai kuptoi se kjo do të thoshte ‘vriteni të burgosurin’.¹²³ Ai tha se **NS** tha **FL** *“Do ta vras unë këtë thi”*. Pastaj **FL** ishte larguar. Më tej i burgosuri ishte rrahur nga **NK2** dhe **NS**.

AZ dëshmoi se pasi i burgosuri ishte rrahur, **NS** “bërtiti ‘më gjej një kosë dhe do ta ther’”. Ai m’u drejtua mua drejtpërdrejt”.

AZ dha dëshmi se e gjeti tehun e kosës në një shtëpi të djegur. Ai tha se doreza prej druri ishte djegur. Ai tha se ia dha tehun **AK** i cili ia dha **NS**. Ai tha se **NS** lidhi një rrobë përreth fundit të tehut.

Ai tha se **NS**, **NK1**, **NK2** dhe “X”¹²⁴ e dërguan të burgosurin serb në fushë. Ai tha se i burgosuri serb ishte ulur dhe në këtë kohë **NS** filloi ta presë atë me kosën. Ai tha se ai e goditi atë në qafë, në shpinë dhe në këmbë. Ai tha se kur vdiq, atë e shtynë brenda një grope. Ai tha se ai mendonte se tehu i kosës ishte lënë në vendin e ngjarjes.

Ai tha se **NK1** dhe **NK2** e urdhëruan atë dhe **AK** ta varrosin trupin. Ai tha se nuk mendonte se e kishte parë tehun e kosës në varr në atë kohë.

Përshkrimi prej tij se i burgosuri serb i pestë u vra me teh kose përputhet me provat mjekoligjore. Trupat e pesë ushtarëve serbë u gjetën në këtë varr. Dy prej trupave tregonin shenja se ishin vrarë me një instrument të mprehtë. Në të vërtetë, në varr u gjet një teh kose.

Gjetja e tehut të kosës në varr duket se mbështet përshkrimin e tij se kishte qenë dëshmitar në këto vrasje. Megjithatë, dëshmia e tij lidhur me kronologjinë e ngjarjeve dhe identitetin e viktimave kundërshtohet nga shënimet në ditarin e tij dhe nga prova të tjera të cilat përmenden më poshtë.

¹²³ Deklaratë më 11 shkurt 2010

¹²⁴ **RM**

AZ tha se më pak se një javë pasi i burgosuri serb ishte vrarë me kosë, ai dëgjoi të shtëna me armë zjarri. Ai tha se **NK1**, **NK2**, **SS1** dhe **NS** shkuan tek ai dhe i thanë atij të gjente dikë për të mbuluar trupat. Ai tha se shkoi me **AK** tek gropa ku kishte parë trupat e tre meshkujve shqiptarë. Ai tha se të tre kishin veshur tesha civile. Ai nuk i njohu ata.

Kur u mor në pyetje më 11 shkurt 2010, **AZ** u pyet për tre të burgosurit shqiptarë të cilët ishin qëlluar me armë. Ai u pyet “A është kjo e njëjta gropë ku u vranë dhe u hodhën të katër serbët dhe serbi tjetër?” Në përgjigje ai tha, “Po”.

Ai u pyet gjithashtu: “A jeni i sigurt për radhën e vrasjeve: në fillim **AA**, pastaj të katër serbët, pastaj serbi i vrarë me kosën, pastaj të tre shqiptarët?” Në përgjigje ai tha, “Po”.

Kjo përgjigje kundërshtonte dëshminë e mëparshme të tij që ai e kishte konfirmuar në fillim të marrjes në pyetje. Më parë ai kishte thënë se të katër të burgosurit serbë ishin vrarë 20 ditë përpara **AA**.

Kur u mor në pyetje më 16 mars 2010, ai tha se “Më duhet t’ju paralajmëroj, megjithatë se, sipas informacionit që kam, trupat u hoqën nga ky vend”.

iv. **Vrasja e VM dhe ND**

Kur u mor në pyetje më 16 mars 2010 **AZ** identifikoi vendin¹²⁵ ku ai tha se ndodheshin trupat e **VM** dhe **ND**.

Kur u intervistua më 11 shkurt 2010, duke bërë fjalë për **ND** dhe **VM**, ai tha se ata ishin “civilë”. Ata nuk ishin. Ata ishin të dy policë. Ata u morën nga UÇK më 9 shkurt 1999.

¹²⁵ Proces-verbal i marrjes në pyetje më 16 mars 2010, foto 9 në dosjen A, faqe A175

Kur u intervistua më 30 nëntor 2009, duke bërë fjalë për **ND** dhe **VM**, ai tha se ata u liruan më 5 prill 1999. Ai tha se *“Gjysmë ore pasi u liruan G [si në origjinal] dhe M, unë dëgjova disa të shtëna të shkrepura nga dy kallashnikovë nga drejtimi i fshatit Shalë. **AS** kishte shkuar diku me **AK** me lopata para se të burgosurit të nxirreshin jashtë burgut nga **NK2**, **NS** dhe **BL**. Pak kohë më pas, **AS** erdhi dhe tha ‘Mbaruam dhe i mbuluam’”*.

Dy herë **AZ** përmendi *“**AS**”*. **AS** nuk është i pandehur në këtë procedurë.

Megjithatë, kur **AZ** u mor në pyetje më 11 shkurt 2010, ai tha se ai kishte vrarë **ND** dhe **VM**.

AZ dha dëshmi më 11 shkurt 2010 se ai, **AK** dhe **BL** i dërguan **VM** dhe **ND** në Livadhin e Canit. Atje ata takuan **FLN**, **NK1**, **NS** dhe **NK2**. Ai tha se kur ata mbërritën, **FL** tha *“Të gjithë largoni armët. Tani dua që **A** t’i vrasë ata, sepse kurrë s’kam parë, as kam dëgjuar që **A** të vrasë njeri”*. Ai tha se **VM** dhe **ND** ishin përballë tij kur ai i qëlloi ata me armë. Ai tha *“Unë i qëllova ata nga distanca dy metra me pistoletën time 9mm Walter (si në origjinal). Shkrepa një krehër të tërë. Ata ishin përballë meje. Unë vetëm qëllova mbi ta. Nuk e mbaj mend se ku i qëllova sepse u trondita.”*

Ai tha se pas vrasjeve **FL** e përqafoi.

Ai tha se **AK** dhe **SS2** përdorën lopata për të mbuluar trupat me dhe.

v. Vrasja e AA

Kur u intervistua më 16 mars 2010, **AZ** identifikoi vendin¹²⁶ e varrit të **AA** dhe deklaroi se *“Vendi që ju tregova nga largësia është ai ku u varrosën nëntë persona”*.

¹²⁶ Proces-verbal i marrjes në pyetje më 16 mars 2010, foto 12 në dosjen A, faqe A178

AZ dëshmoi se **AA** u lirua më 2 prill 1999¹²⁷. Ai tha se “një ditë pas lirim të tij atë e arrestuan përsëri dhe e vranë afër fshatit Kleçkë (vendi ku u varrosën 9 persona)”. Ai tha se ai kishte dëshmuar vrasjen e **AA** nga një distancë prej rreth 50 metra. Ai tha se **AA** ishte qëlluar nga **NK1** dhe **NK2**, të cilët kishin përdorur AK47. Ai tha se **NS** ishte gjithashtu i pranishëm, por se ai nuk vërejtë nëse edhe ai shtiu me armë. Ai tha se “X” ishte gjithashtu i pranishëm.

Kur u mor në pyetje më 11 shkurt 2010, **AZ** u pyet për vrasjen e **AA**. Konkretisht, ai u pyet: “A jeni i sigurt për radhën e vrasjeve: në fillim **AA**, pastaj të katër serbët, pastaj serbi i vranë me kosë, pastaj të tre shqiptarët?” në përgjigje ai tha se “Po”.

vi. Vrasja e SA dhe YG

Kur u intervistua nga policia më 30 nëntor 2009 **AZ** deklaroi se **IG** dhe **SA** ishin marrë nga burgu nga **AK**, **NK1** dhe **NK2** dhe se më pak se tridhjetë minuta më pas ai kishte dëgjuar të shtëna me armë zjarri. Ai tha se kjo kishte ndodhur më 3 prill 1999. Ai tha se të nesërmen ai kishte parë atë që ai mendoi se ishte një varr i ri.

Më pas në të njëjtën deklaratë, duke bërë fjalë për **ND** dhe **VM**, ai tha se ata u liruan më 5 prill 1999. Ai tha se ata u liruan në të njëjtën ditë me **SA** dhe **IG**.

Kur u intervistua më 9 shkurt 2010, **AZ** tha se **IG** dhe **SA** ishin marrë nga burgu nga **NK1**, **NK2** dhe **NS** dhe se fill pas kësaj ai kishte dëgjuar të shtëna me armë zjarri. Ai tha se ai nuk ishte i sigurt nëse **AK** ishte në grupin që i mori të dy të burgosurit me vete. Kjo bie ndesh me ato që ai deklaroi kur u intervistua nga policia më 30 nëntor 2009. Në atë rast, ai dukej i sigurt se **AK** ishte në radhët e grupit që i mori të dy të burgosurit me vete.

AZ tha se më pas **NK1**, **NK2** dhe **NS** i treguan atij se ata kishin vranë **IG** dhe **SA** në një vend të quajtur Livadhi i Canit.

¹²⁷ Intervista e policisë më 30 nëntor 2009, dhe e vazhduar më 3 dhjetor 2009

Ai tha se ai shkoi në atë zonë dhe gjeti atë që dukej se ishte një varr i ri.

Kur u mor në pyetje më 11 shkurt 2010, ai tha se **NS**, **NK2** dhe **NK1** e morën **SA** dhe **IG** në një veturë dhe shkuan në drejtim të maleve. Ai nuk tha se dëgjoi të shtëna me armë zjarri. Ai tha se më pas ai kishte parë **NS**, **NK2** dhe **NK1** dhe tha se ata kishin vrrarë **SA** dhe **IG**.

(d) Provat mjeko-ligjore

i. Arkeologia mjeko-ligjore

AZ identifikoi katër varreza të mundshme në të cilat ai tha se ishin vendosur trupat. Gjeografikisht, këto varre ishin afër njëri-tjetrit. Trupat u gjetën në në dy varre. Në varrin KER01 hetuesit gjetën pesë trupa. Në varrin KEQ01 hetuesit gjetën dy trupa.

Në varrin që **AZ** tha se përmbante 9 trupa, u gjetën pesë trupa¹²⁸.

Duke bërë fjalë për vendin KER01, Arkeologia mjeko-ligjore **CC** dëshmoi se kur u gërmua ky varr, trupat ishin depozituar sipas kësaj radhe: trupi i parë depozituar në varr ishte trupi 007B¹²⁹. Ai trup u gjet në fund të varrit. Trupi i dytë i depozituar në varr ishte 006B¹³⁰. Trupi i tretë i depozituar në varr ishte 005B¹³¹. Trupi i katërt i depozituar në varr ishte 001B¹³². Trupi i fundit i depozituar në varr ishte 004B¹³³.

¹²⁸ KER01

¹²⁹ Më pas i identifikuar si **DT**

¹³⁰ Më pas i identifikuar si **DV**

¹³¹ Më pas i identifikuar si **BC**

¹³² Më pas i identifikuar si **ZF**

¹³³ Më pas i identifikuar si **ZT**

Këmbët e trupit 001B ishin nën trupin 004B, duke sugjeruar se 001B ishte viktimi e parafundit e futur në varr, se 004B ishte trupi i fundit që e futën në varr mbi këmbët e 001B dhe se trupi i 001B u tërhoq pastaj prapa që ta vendosnin mbi 004B.

Në varr u gjet një tek kose. Ai u gjet paralel me këmbën e trupit 001B dhe nën këmbët e trupit 004B.

Në varr u gjetën tri lidhëse dhe këto u shoqëruan nga arkeologu mjeko-ligjor me trupat 001B, 004B dhe 005B. Trupat 004B dhe 005B u vu re se i kishin duart të lidhura prapa shpinës¹³⁴.

Në varr u gjetën edhe ato që dukeshin si mbetje uniforme ushtarake¹³⁵.

Trupat e gjetur në vendin KER01 më vonë u identifikuan si **DT, BC, ZF, ZT** dhe **DV**.

Në kohën e zhvarrosjes, nuk kishte tregues se gropa e varrit. Dheu brenda tij, trupat e depozituar me kujdes dhe objektet e mbetura të ishin trazuar. Në shtresën e dheut nuk kishte ndonjë ndryshim që di të tregonte trazim të shtresave fillestare të dheut në kohën e depozitimit.

CC dëshmoi se ndërmjet trupave të vendosur sipër njëri-tjetrit nuk kishte dhe.

CC deklaroi se ajo nuk gjeti prova se vendet e varreve ishin trazuar, duke deklaruar *“Pozicioni i trupave nuk më tregonte që ata të ishin trazuar.”*

Dëshmia e saj ishte se nuk ishte e mundur të përcaktoje nëse trupat ishin lëvizur fill pas varrimit të parë. Ajo tha se nëse do të kishte kaluar kohë, ndoshta 6 muaj ose më shumë, atëherë do të kishte pasur një farë dekompozimi dhe është e mundur që eshtrat e vogla mund të ishin lënë prapa trupave që mund të ishin lëvizur.

¹³⁴ Dosja e PSRK L, page L432

¹³⁵ Dosja e PSRK I, nw P28a; Dosja e PSRK L, faqet L432 dhe L433

Dëshmia e saj ishte se në vitin 2001, trupat do të kishin qenë në fazë të avancuar dekompozimi. Në rast se trupat do të ishin lëvizur në ose pas vitit 2001, ajo do të kishte qenë në gjendje të shquante faktin se trupat ishin lëvizur. Midis arkeologes mjeko-ligjore dhe prokurorit u zhvillua ky diskutim:

Prokurori: *“Përfytyroni që një numër i caktuar trupash në një vend të ngjashëm me atë, përfytyroni që disa trupa janë larguar që andej para se të mbulohen me dhe, a do të ishte në gjendje hetimi juaj të jepte ndonjë informacion për këtë?”*

CC: *“Doni të thoni para se trupat të ishin mbuluar plotësisht me dhe herën e parë?”*

Prokurori: *“Para se të mbuloheshin me dhe, po.”*

CC: *“Sikur trupat të ishin larguar para se të ishin mbuluar, do të ishte shumë e vështirë të thoshe nëse atje kishte më shumë trupa.”*

Megjithatë, kjo nuk ishte çështja e akuzës. **AZ** dëshmoi se pasi u vra secila viktimë ose grup viktimash, trupat u varrosën.

Dëshmia që dha **AZ** lidhur me vendet e varreve dhe largimin e trupave është interesante.

Raporti i Vlerësimit i Policisë i hartuar më 26 – 28 gusht 2009, që i referohej **AZ**, deklaroi *“...ai përmendi një vend të katërt që deri në këtë vend rreth 300 metra larg 10 trupa u hoqën dhe u dërguan në drejtim të paditur në vitin 2002...ai është 100 i sigurt se viktimat u varrosën në vendet e përmendura dhe më vonë u dërguan në drejtim të paditur. Kur trupat u hoqën nga të dy vendet. Ai po priste dru në anën tjetër të malit dhe pa gjithcka.”*¹³⁶

Pas luftës, **AZ** banoi në X me familjen e tij¹³⁷. Trupi Gjykues nënvizon faktin se në kohën përkatëse koha e udhëtimit në rrugë ndërmjet X dhe Kleçkës ishte rreth 45 minuta – 1 orë. Është e pamundur që, sikur **AZ** të kishte dëshiruar të priste dru, ai të kishte vozitur nga X në

¹³⁶ Dosja M, faqe M71, M72

¹³⁷ Deklaratë e **GZ**, datë 20 prill 2010

Kleçkë. Është edhe më e pamundur që, nisur nga fakti se ai banonte paksa larg nga Kleçka, ai të kishte rastisur të kishte qenë duke prerë dru pikërisht në kohën që ai thotë se u hoqën trupat. Është e paqartë në dëshminë e tij se në çfarë ore ai thotë se i pa trupat të largohen prej andej. Duke pa gjasa që, nëse kjo gjë do të ishte bërë, ajo të bëhej në orët e ditës.

Në çdo rast, komentet e tij para hetuesve në vitin 2009 lidhur me largimin e trupave kundërshtohen nga dëshmia që ai dha në vitin 2010. Kur u mor në pyetje më 11 shkurt 2010, **AZ** dëshmoi se pas luftës dhe para arrestimit të **FL** nga TPNJ, ndoshta dikur në vitin 2001 ose 2002, ai kishte marrë një thirrje nga **FL** që e urdhëronte atë “*hiqi trupat*” dhe “*pastro zonën*”. **AZ** tha se ai shkoi “atje” me **SS1** dhe **NS**. Kur mbërritën në vend, **SS1** deklaroi “*mos prekim asgjë dhe vetëm largohemi*”. Duket se pastaj ata u larguan. **AZ** deklaroi më tej “*Pas një farë kohe, brenda një viti pas herës së parë, unë u ktheva në atë vend mund të shoh se asgjë nuk ishte prekur. E përsërita kontrollin disa herë kur isha rrugës për tek shtëpia e babait. Mendoj se hera e fundit që shkova atje ishte dikur në vitin 2009.*”¹³⁸

Nuk kishte prova që të sugjerojnë ndonjë përpjekje ose qëllim për të trazuar varret para vitit 2001. Duke iu referuar vendit KER01, **CC** dëshmoi se, sikur varret të ishin trazuar në vitin 2001 ose edhe 6 ose më shumë muaj pas varrimit të parë, ajo do të kishte parë prova se trupat ishin trazuar. Ajo nuk gjeti prova të tilla.

Në asnjë vend tjetër të identifikuar nga **AZ** hetuesit nuk gjetën ndonjë provë se dheu ishte trazuar. Nuk pati prova se vendet e varreve ishin trazuar në vitin 2002 siç u deklaruar nga **AZ**.

ii. Patologu Forenzik

Mbetjet mortore të pesë kufomave janë gjetur në lokacionin KERO1. Nëpërmes analizës ADN këto janë identifikuar si **DT, DV, BC, ZF** dhe **ZT**.

¹³⁸ Deklaratë e 11 shkurtit 2010, dosja A faqe A83

Raportet e autopsisë mbi **BC**, **ZF** dhe **ZT** cekin si shkak të vdekjes plagë në kokë nga të shtëna me armë zjarri.

Raporti i autopsisë mbi **BC** cekë një plagë nga e shtëna me armë zjarri në pjesën e prapme të kafkës¹³⁹.

Raporti i autopsisë mbi **ZF** cekë dy plagë nga të shtëna me armë zjarri në pjesën e prapme të kafkës¹⁴⁰.

Raporti i autopsisë mbi **ZT** cekë dy plagë nga të shtëna me armë zjarri në pjesën e prapme të kafkës¹⁴¹.

Raporti i autopsisë i **Dr. MK** i datës 18 nëntor 2009¹⁴² në vijim të ekzaminimit të tij të mbetjeve mortore të **DV** cekë shkakun e vdekjes si *“prerje e qafës me një instrument të mprehtë” dhe përshkruan lëndimet vijuese në trup: “në aspektin anterior të vertebrës cervikale numër 3 (tre) prerje e mbrehtë e orientuar tërthorazi. Prerje në corpus vertebrae deri në disa mm (disa milimetra) thellë”*

Raporti i autopsisë i **Dr. MK** i datës 19 nëntor 2009¹⁴³ në vijim të ekzaminimit të tij të mbetjeve mortore të **DT** cekë si shkak të vdekjes *“prerje të qafës me instrument të mprehtë. Traumë e shkaktuar nga mjeti i topitur në kraharor dhe në parakrahun e djathtë” dhe përshkruan lëndimet vijuese në trup: “në aspektin anterior të vertebrës cervikale numër 3 (tre) prerje e mprehtë e orientuar tërthorazi. Prerje në corpus vertebrae deri në disa mm (milimetra) thellë. Prerje në corpus vertebrae e zgjatur në processus costarius dexter në vertebrën e tretë cervikale.”*

¹³⁹ Dosja L, faqet L238-L335

¹⁴⁰ Dosja L, faqet L10-L96

¹⁴¹ Dosja L, faqet L97-L237

¹⁴² Autopsia e kryer më 29 tetor 2009

¹⁴³ Autopsia e kryer më 29 tetor 2009

Patologu gjithashtu ka vërejtur traumë të shkaktuar nga mjeti i topitur në brinjën numër 4 në anën e majtë. Është dy fraktura të corpus që gjenden në +/- 20 cm nga caput costae dhe fraktura e dytë gjendet në +/- 26 cm nga caput costae dhe fraktura e dorës së djathtë.

Më tej, raportet e zhvarrosjes nga lokacioni KERO1 në fshatin Kleçkë cekin që një kosë është gjetur në mesin e mbetjeve mortore.¹⁴⁴

Mbetjet mortore të pesë kufomave janë gjetur në lokacionin KEQ)1. Nëpërmes analizave ADN këto janë identifikuar si kufomat e **VM** dhe **ND**.¹⁴⁵

Raporti i autopsisë për **VM** cekë si shkak të vdekjes një të shtënë në kokë dhe trung.¹⁴⁶

Raporti i autopsisë për **ND** cekë si shkak të vdekjes të shtëna në kokë¹⁴⁷. Raporti i njëjtë i referohet tri të shtënave në kokë. Një prej plagëve nga të shtënat ka qenë në pjesën e prapme të kokës.

e. Përfundimet

1. Pretendimet substantive

¹⁴⁴ Raporti i Policisë mbi zhvarrosjen, supra shënim 122.

¹⁴⁵ Zyra e EULEX për Personat e Zhdukur dhe Mjekësinë Ligjore, konfirmimi i identitetit, 10.12.2010, lënda nr. KEQ01-001B, MPU 1999-000043 (Veljko Markovic), dosja e PSRK I; Zyra e EULEX për Personat e Zhdukur dhe Mjekësinë Ligjore, konfirmimi i identitetit, 10.12.2010, lënda nr. KEQ01-001B, MPU 2001-000001 (**ND**), dosja e PSRK I.

¹⁴⁶ Ministria e Drejtësisë e Kosovës, Zyra për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore, raporti i autopsisë, lokacioni i varrit Malishevë, 14.09.2010, lënda nr. KEQ)1/002B, dosja e PSRK I.

¹⁴⁷ Ministria e Drejtësisë e Kosovës, Zyra për Persona të Pagjetur dhe Mjekësi Ligjore, raporti i autopsisë, lokacioni i varrit Malishevë, 14.09.2010, lënda nr. KEQ)1/002B, dosja e PSRK I.

AZ ka përshkruar vrasjen e katër ushtarëve serbë si të kishte ndodhur 20 ditë para vrasjes së **AA**. Ai ka qenë i sigurt për këtë. Në fakte, ai ka dhënë dëshminë e njëjtë në dy raste.¹⁴⁸

Në ditarin e tij është shënuar që **AA** është liruar më 2 prill 1999. Ai ka thënë që **AA** është vrarë të nesërmen. Ai ka thënë që një javë pas vrasjes së katër ushtarëve serbë ai ka qenë dëshmitar i vrasjes së një ushtari të pestë serb. Ai i ka çuar hetuesit në lokacionin e varrit. Kufomat e zhvarrosura më vonë janë identifikuar si **DT, DV, BC, ZF** dhe **ZT**. Nëse katër ushtarët serbë janë vrarë 20 ditë para **AA** ata janë vrarë në gjysmën e parë të marsit 1999. Trupi Gjykues është i sigurt për datën kur **AA** është liruar nga Kleçka, dëshmitarët tjerë që janë liruar në të njëjtën kohë kanë dhënë dëshmi për këtë.

Por, **DT, DV, BC, ZF** dhe **ZT** nuk janë kapur nga UÇK deri më 11 prill 1999¹⁴⁹.

Në të vërtetë, një shënim në ditar cekë “D TA N, 16.10.1946, i sjellur më 11.04.1999, i liruar më 18.04.1999; T S Z 13.07.1951; S, B S, 05.09.1972 dhe F P Z, 12.03.1962”

Duke iu referuar këtij shënimi në ditar, **AZ** ka thënë që të burgosurit serbë kanë qenë civilë të cilët kanë arritur në burg më 11 prill 1999. **AZ** ka menduar që ata mund të kenë punuar në kompaninë e energjisë elektrike. Ata nuk kanë qenë civilë. Ata kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë së Serbisë dhe kanë qenë në uniformë kur janë kapur nga UÇK më 11 prill 1999. Uniformat janë gjetur kur janë zhvarrosur mbetjet e tyre mortore. **AZ** ka thënë që ata janë mbajtur në bodrum të shtëpive të djegura dhe janë “liruar” më 18 prill 1999.¹⁵⁰

AZ ka dëshmuar që **AK** i ka ndihmuar atij që të i varrosë të burgosurit serbë. Megjithatë, nëse katër ushtarët serbë janë varë më 18 prill 1999 **AK** nuk mund të ketë qenë prezent. Prokurori ka pranuar që **AK** është plagosur më 18 prill 1999. Në të vërtetë, avokati i **AK** ka paraqitur dëshmi mjekësore dhe fotografi të cilat sipas Trupit Gjykues mbështesin lëndën e mbrojtjes, që

¹⁴⁸ 2 dhjetor 2009 dhe 11 shkurt 2010

¹⁴⁹ Supra, deklarata e **TM**

¹⁵⁰ Ekzaminimi më 11 shkurt 2010

AK është plagosur rëndë më 18 prill 1999 dhe që për këtë arsye ai nuk mund të ketë qenë prezent më 18 prill 1999 siç pretendon **AZ**.

AZ ka dëshmuar që **NK1** dhe **NK2** e kanë urdhëruar atë dhe **AK** që të i varrosin kufomat. Trupi Gjykues gjen që **AK** nuk ka qenë prezent dhe prandaj nuk mund ta ketë bërë këtë.

AZ ka dëshmuar për një të burgosur të pestë serb i cili është vrarë dhjetë ditë pas katër të burgosurve serbë. **AZ** e ka përshkruar atë si “me gradë të lartë”.¹⁵¹ Ai ka thënë që ai ka qenë i veshur me “rroba civile”.¹⁵²

Duke iu referuar të burgosurit të pestë serb, **AZ** ka dëshmuar që **FL** “i ka bërë atij pyetje i pari dhe e ka goditur me grusht dhe me shkelmë”¹⁵³ Ai ka thënë që ata kanë qenë në oborr. Ai ka thënë që **NS**, **NK2**, **NK1**, **BL**, **SS1**, **BS** dhe **ST** gjithashtu kanë qenë të pranishëm. Kur ai është intervistuar nga policia më 3 dhjetor 2009, duke iu referuar kësaj ngjarjeje, **AZ** ka deklaruar “*FL gjithashtu e ka intervistuar të burgosurin serb me të tjerët, por unë nuk kam dëgjuar se për çfarë po e pyetnin.*”¹⁵⁴ Në 2009 **AZ** nuk ka bërë asnjë pretendim që **FL** e kishte grushtuar dhe shkelmuar të burgosurin siç pretendoni më vonë.

AZ ka thënë që kur **FL** ka përfunduar me marrjen në pyetje të të burgosurit ai ka thënë “merreni këtë derr”. **AZ** ka thënë që ai e ka kuptuar këtë që të thotë vriteni të burgosurin.¹⁵⁵ Përsëri, **AZ** nuk e ka përmendur këtë kur ai është intervistuar në 2009¹⁵⁶.

AZ ka thënë që **NS** ka thënë **FL** “*unë do ta vras këtë derr*”. Ai ka thënë që **FL** ka qenë prezent kur **NS** e ka thënë këtë. Ai ka thënë që i burgosuri më tej është rrahur nga **NK2** dhe **NS**.

¹⁵¹ Deklarata e 3 dhjetorit 2009

¹⁵² Deklarata e 11 shkurtit 2010

¹⁵³ Deklarata e 11 shkurtit 2010

¹⁵⁴ Deklarata e 3 dhjetorit 2009, dosja M, faqja M22

¹⁵⁵ Deklarata e 11 shkurtit 2010

¹⁵⁶ ibid

AZ ka dëshmuar në 2010 që pasi që i burgosuri ishte rrahur **NS** “ka bër titur “ma gjeni një kosë dhe unë do ta ther atë”. Ai më është drejtuar mua direkt”.

Kur ka dëshmuar në 2009 **AZ** ka deklaruar “...një javë më vonë **NS** ka ardhur shtëpinë burg në Kleçkë dhe ka kërkuar që unë të ja gjej një kosë, duke deklaruar që “unë do ta prej këtë derr”...**FL** ka qenë prezent kur **S** e ka përmendur këtë.”¹⁵⁷ Nëse rrahja e një të burgosuri serb ka ndodhur në oborr dhe në prani të **AZ**, siç pretendoi ai në 2010, pse, në 2009, **AZ** dëshmoi që **NS** “ka ardhur në shtëpinë burg në Kleçkë dhe më ka kërkuar që të ja gjej një kosë”¹⁵⁸

Më tej, **AZ** ka thënë që ai e ka gjetur një teh të kosës dhe ia ka dhënë atë **AK** i cili ia ka dhënë atë **NS**. Nëse i burgosuri i pestë serb është vrarë 10 ditë pas vrasjes së katër të burgosurve serb më 18 prill 1999 atëherë **AK** nuk mund të ketë qenë prezent.

Fakti që një teh i kosës është gjetur në varr duket se i jep peshë tregimit të **AZ**.

Përdorimi i tehut të kosës është interesant. Pse do të kërkonte **NS** një teh të kosës? Duket zgjedhje e çuditshme e armës. Dëshmia e **AZ** është që, pasi që është udhëzuar nga **NS** që ta gjej një kosë, ai ka shkuar ta kërkoj dhe e gjeti një teh të kosës në një ndërtesë të djegur. **AZ** e ka dhënë këtë dëshmi për herë të parë më shumë se tetë javë pasi që varri ishte zhvarrosur dhe tehu i kosës ishte gjetur. Trupi gjykues nuk mund te perjashtojë mundësinë se **AZ** morri vesh për këtë prove për herë të parë pasi që u hap varri.

AZ ka thënë që i burgosuri i pestë serb për të cilin ai ka thënë që **NS** e ka vrarë duke e përdorur tehun e kosës ka qenë, sa e di ai, i vetmi i burgosur i vrarë me kosë¹⁵⁹. Ai e ka përshkruar këtë të burgosur si “me gradë të lartë”. **AZ** ka menduar që ai ka qenë në mes 45 dhe 50 vjeçar.

¹⁵⁷ ibid

¹⁵⁸ Ibid, dosja M, faqja M22

¹⁵⁹ Ekzaminimi i 11 shkurtit 2010

Shënimi në ditar cekë emrat “D TA N, 16.10.1946, i sjellur më 11.04.1999, i liruar më 18.04.1999; T S Z, 13.07.1951; S, B S, 05.09.1972 dhe F P Z, 12.03.1962”.

Referenca që këta të burgosur janë “sjellur më 11.04.1999” konfirmon që këta ishin në mesin e pesë ushtarëve serbë që janë kapur nga UÇK më 11 prill 1999.

Referenca në ditar për “D TA N, 16.10.1946” është qartësisht referencë për **DT**. Emri është i saktë. Referenca për “TA N” duket të jetë gabim në shënim të mbiemrit. **DT** ka lindur më 16 tetor 1946¹⁶⁰.

DV ka qenë njëri prej pesë ushtarëve serb që janë marrë nga UÇK më 11 prill 1999. Është interesant që emri i tij nuk është në mesin e atyre të shënuara në këtë shënim në ditar.

AZ ndryshe e ka përshkruar të burgosurin e pestë serb si jo të veshur në uniformë por “rroba civile”¹⁶¹ dhe një këmishë me mangë të shkurtra dhe pantallona të zeza.¹⁶² Megjithatë, kur janë gjetur mbetjet mortore të **DT** ai ka pasur të veshur një “xhaketë të trashë”¹⁶³. Shënimet e DML konfirmojnë që “rroba të ushtrisë” dhe një “xhemper shumëngjyrës” janë gjetur me mbetjet e tij mortore¹⁶⁴.

I burgosuri tjetër për të cilin Trupi Gjykses konstaton që është vrarë me kosë ishte **DV**. Ai nuk ka qenë oficeri “me gradë të lartë” për të cilin **AZ** ka thënë se e ka parë kur është vrarë me teh të kosës. Së pari, **DV** nuk ka qenë “me gradë të lartë”. Ai ka qenë ushtarë i thjeshtë. Më tej, në kohën e vdekjes **DV** ka qenë në moshë 31 vjet. **AZ** ka thënë që njeriu që e ka parë të vrarë me kosë ka qenë në moshën në mes 45 dhe 50 vjet. Më tej, “rrobat ushtarake” dhe “këpucët ushtarake” janë gjetur me mbetjet mortore më vonë të identifikuar si **DV**.¹⁶⁵

¹⁶⁰ Dosja L e PSRSK, faqja L416

¹⁶¹ Deklarata e 11 shkurtit 2010

¹⁶² Deklarata e 2 dhjetorit 2009

¹⁶³ Dosja L e PSRK, faqja 433

¹⁶⁴ Dosja I e Provave të Prokurorisë, faqja P28b

¹⁶⁵ Dosja I e Prokurorisë, faqja P28d

Trupi Gjykues gjen që i burgosuri i pestë serb të cilin **AZ** e ka përshkruar si të vrarë me teh të kosës ka qenë **DV**. Ai ka qenë Kapiten Rezervist dhe vartës direkt i Komandantit të Ushtrisë së Serbisë për X. Ai ka qenë pjesëtari i vetëm i grupit që është kapur nga UÇK më 11 prill 1999 i cili mund të përshkruhej si “me gradë të lartë”. Ai ka qenë 52 vjeçar në kohën kur ka vdekur.

Nëse, siç ka gjetur Trupi Gjykues, i burgosuri i pestë të cilin **AZ** e ka përshkruar si të vrarë me teh të kosës ka qenë **DT**, dëshmia e **AZ** kundërshtohet nga një shënim në ditar. **AZ** ka dëshmuar që **DT** nuk është vrarë më 18 prill 1999 por 10 ditë më vonë. Megjithatë, një shënim në ditar cekë “D TA N, 16.10.1946, i sjellur më 11.04.1999, i liruar më 18.04.1999”. Ai shënim në ditar sugjeron që **DT** ishte njëri prej katër të burgosurve serb që janë vrarë me armë zjarri 10 ditë para se i burgosuri i pestë serb të vritet nga **NS** me teh të kosës.

AZ e ka përshkruar hollësisht vrasjen e katër të burgosurve serb. Në të vërtetë, ai ka thënë që ai ka ndihmuar me varrosjen e kufomave. Megjithatë, kur i ka çuar hetuesit në vendndodhje ai dukej i pasigurve se në cilin prej dy lokacioneve ishin të varrosura kufomat.

Kufomat e **DT**, **DV**, **BC**, **ZF** dhe **ZT** janë gjetur në lokacionin KERO1.

Arkeologu Forenzik ka dëshmuar që kur është zhvarrosur varri kufomat ishin të vendosura në këtë renditje: kufoma e parë e vendosur në varr ishte **DT**. Trupi i tij ishte në fund të varrit. Trupi i dytë i vendosur në varr ishte **DV**. Trupi i tretë i vendosur në varr ishte **BC**. Trupi i katër i vendosur në varr ishte **ZF**. Trupi i fundit i vendosur në varr ishte **ZT**.

Një teh i kosës është gjetur në varr. Ai është gjetur paralel me këmbën e **ZF** dhe nën këmbët e **ZT**.

AZ ka thënë që dy prej të burgosurve i kanë pasur duart të lidhura prapa shpinës. Dy të tjerët kanë qenë të lidhur së bashku. Ai ka thënë që ata janë lidhur me tel. Lidhëse teli janë gjetur në

varrin KERO1. Këto ishin përdorur për të i lidhur duart i disa prej të burgosurve. AG ka përmendur “konop ose tel metali”¹⁶⁶ për herë të parë gjatë intervistës së tij më 3 dhjetor 2009. Lidhëset e telit janë gjetur kur lokacioni KERO1 është zhvarrosur më 23-25 shtator 2009 – për afërsisht dy muaj para se që e ka atë deklaratën. Trupi gjykues nuk mund të perjashtojë mundësinë se **AZ** morri vesh për këtë provë për herë të parë pasi që u hap varri.

AZ ka dëshmuar që katër të burgosurit serb dëshmitar i vrasjes së të cilëve ka qenë ai janë vrarë me AK47. Ai ka dëshmuar që dhjetë ditë pas vrasjes dhe varrosjes së katër ushtarëve serb ai e kishte gjetur një teh të kosës të cilin **NS** e kishte përdorur për ta vrarë të burgosurin e pestë serb. **AZ** ka dëshmuar “serbi ka qenë i burgosuri i vetëm i cili është varë me kosë sa e di unë”.¹⁶⁷

Megjithatë, raportet e autopsisë tregojnë që dy prej kufomave që janë gjetur në varr – **DV** dhe **DT** – kanë pasur shenja të lëndimeve të shkaktuara me një instrument të mprehtë. Lëndimet e vërejtura në trupat e të dy viktimave janë shënuar si të shkaktuara ante mortem.

Patologu forenzik **MG** i ka dhënë dy deklarata në lidhje me lëndimet që ai i ka vërejtur në mbetjet mortore të **DV** dhe **DT**. Në deklaratën e tij të dhënë më 20 janar 2010¹⁶⁸ Dr. **MG** është pyetur nga prokurori “A mund të kenë qenë lëndimet që i keni gjetur në vertebra të shkaktuara me përdorim të një drapëri ose kose?” Në përgjigjen e tij **Dr. MG** cekë “Është e mundur. Lëndimet përputhen me përdorimin e një instrumenti të tillë”. Në përgjigje të pyetjes së Trupit Gjykues, në një raport të datës 13 korrik 2013 **Dr. MG** ka thënë që ai nuk mund të “perjashtojë” mundësinë që lëndimet janë shkaktuar me instrumentin e njëjtë.

Gjykata gjen që lëndimet që i janë shkaktuar ante mortem **DT** përputhen me lëndimet ante mortem që i janë shkaktuar **DV**. Më tej, Trupi Gjykues gjen që lëndimet që i janë shkaktuar të dy viktimave janë në përputhje me atë që ata janë vrarë me teh të kosës.

¹⁶⁶ Deklarata e 3 dhjetorit 2009, dosja M, faqe M23

¹⁶⁷ Dëgjimi i 11 shkurtit 2010

¹⁶⁸ PSRK dosja L, faqet L1-L3

Dëshmitë forenzike kundërshtojnë dëshmitë e **AZ**.

AZ ka thënë që ai vetëm e ka gjetur te huan e kosës dhjetë ditë pasi që katër të burgosurit serbë janë vrarë me armë zjarri. Pesë trupa janë gjetur në lokacionin KERO1. Tre ishin qëlluar me armë zjarri dhe dy ishin vrarë me një instrument të mprehtë për të cilin Trupi Gjykues gjen që ishte një teh i kosës.

Dëshmia e tij kundërshtohet nga shënimi në ditar që i referohet asaj që **DT** ishte njëri prej katërve që ishin “liruar” më 18 prill 1999 kur sipas dëshmisë së **AZ**, siç ka gjetur Trupi Gjykues, **DT** nuk është vrarë deri dhjetë ditë më vonë.

Më tej, në deklaratën e tij të 20 janarit 2010, duke iu referuar lëndimeve në mbetjet mortore të **DT** dhe **DV**, **Dr. MG** i përshkruan lëndimet në vertebrën e tretë cervikale. Ai vazhdon të thotë “...vertebra e tretë cervikale është shumë lart, pra për ta zbuluar atë dhe shkaktuar një goditje që e prenë atë nga ajo e para personi duhet të ngritë kokën e viktimës me mjekër lart...në një situatë normale do të ishte gati e pamundur për një person të vetëm që të ngre kokën e viktimës prapa dhe ta goditë në të njëjtën kohë me forcë të mjaftueshme për të i prerë të gjitha indet dhe për të arritur te vertebra”. Në dëshminë e tij **AZ** i referohet vetëm “prerjes” së viktimës nga **NS**. Ai ka thënë “...**NS** ka filluar ta prenë atë disa herë me kosë. Ai e ka goditur në qafë, në shpinë dhe në këmbë...”¹⁶⁹ Ai nuk i referohet askujt tjetër si pjesëmarrës në sulm. Sipas dëshmisë së **AZ** sulmin e ka kryer vetëm **NS**.

AZ nuk ka përmendur pjesëmarrjen e një personi tjetër në jo një por dy prej vrasjeve.

AZ ka dëshmuar që trupi i **DT** ka qenë i fundit prej të burgosurve serb që është vendosur në varr. Megjithatë, dëshmitë forenzike kanë zbuluar që trupi i **DT** është gjetur në fund të varrit – që sugjeron që, në fakt, ka qenë trupi i parë që është vendosur në varr. Edhe nëse Trupi Gjykues ka gabuar identitetin e të burgosurit të pestë serb të vrarë 10 ditë më vonë, qëndron

¹⁶⁹ Deklarata e 11 shkurtit 2010 në A76 që konfirmon deklaratën e mëparshme në polici

fakti që trupi i **DV** ka qenë mbi atë të **T**. Trupat e tre ushtarëve tjerë serb – të gjithë të vdekur si rezultat i të shtënave me armë zjarri kanë qenë mbi ta. Kjo dëshmi kundërshton dëshminë e **AZ**.

AZ ka dëshmuar që më pak se një javë pasi që i burgosuri serb është vrarë me teh të kosës ai ka dëgjuar të shtëna. Ai ka thënë që **NK1**, **NK2**, **SS1** dhe **NS** kanë shkuar te ai dhe i kanë thënë që ta gjej dikë që të i mbulojë trupat. Ai ka thënë që ka shkuar me **AK** te vrma ku i ka parë trupat e tre burrave shqiptarë. Ai ka thënë që të tretë kanë qenë të veshur me rroba civile. Ai nuk i ka njohur ata. Trupi Gjykues gjen që **AK** nuk mund të ketë qenë prezent për arsyet e cekura këtu.

Para gjykatës nuk është paraqitur asnjë provë për ndonjë qëllim të trazimit të varrit para 2001. Arkeologu Forenzik ka dëshmuar që në 2001 trupat do të kishin qenë në stazh të avancuar të dekompozimit.

Në kohë të zhvarrimit, nuk ka pasur asnjë indikacion që gropa e varrit, dheu në të, trupat e vendosura me kujdes ose artikujt që kanë mbetur ishin trazuar. Nuk kishte asnjë ndryshim në shtresat e dheut që tregonte ndonjë trazim të shtresave origjinale të dheut në kohë të vendosjes. Arkeologu Forenzik ka dëshmuar që *“pozita e trupave nuk më ka dhënë indikacion që ato janë trazuar”*.

Prokurori e pyeti **Znj. C**: *“Paramendo që një numër trupash në një vend të ngjashëm me atë, imagjino që disa prej trupave janë larguar nga ty para se të mbulohen me dhe, a do të mund të jepte hetimi juaj ndonjë informacion për këtë?”* Arkeologu Forenzik është përgjigjur: *“Nëse trupat janë larguar para se të mbulohen do të ishte shumë e vështirë të thuhet nëse ka pasur më shumë trupa aty.”*

Sidoqoftë, kjo nuk ka qenë pozita e prokurorisë. **AZ** ka dëshmuar që pas vrasjes së çdo viktime ose grupi të viktimave trupat janë varrosur. Kjo ka qenë një parashtrësë e çuditshme e prokurorisë, e pambështetur me ndonjë provë.

Arkeologu Forenzik ka dëshmuar që nuk ka pasur dhe në mes të trupave dhe që ato kanë qenë të vendosura shumë ngushtë së bashku. Kjo gjithashtu ka kundërshtuar dëshminë e **AZ** i cili ka thënë që pas vrasjes së katër ushtarëve serbë ai dhe **AK** i kishin varrosur trupat. Nëse trupat e katër të burgosurve serbë kanë qenë të mbuluara me dhe do të kishte qenë e nevojshme që të hiqet shtresa më e lartë e dheut për të u varrosur i burgosuri i pestë serb. Jo vetëm që nuk ka pasur dhe në mes të trupave por dy trupat që kanë shfaqur shenja që viktimat janë vrarë me instrumente të mprehta kanë qenë në fund të varrit.

Sidoqoftë, edhe po të ishin trazuar pesë trupat në varr kjo nuk e shpjegon si dy prej trupave (**DV** dhe **DT**) kanë shfaqur lëndime ante mortem që përputhen me vrasjen e viktimës me një instrument të mprehtë kur, sipas dëshmive të **AZ**, ai nuk e ka gjetur tehun e kosës deri 10 ditë pas vrasjes së katër prej pesë të burgosurve me të shtëna nga armë zjarri.

AZ ka dëshmuar që trupi i **AA** ishte varrosur në të njëjtin varr si pesë të burgosurit serbë.

Nëse **AA** është vrarë 20 ditë pas katër të burgosurve serbë atëherë trupi i tij do të kishte qenë mbi pesë viktimat serbe (i burgosuri i pestë serb, sipas dëshmisë së **AZ**, ishte vrarë 10 ditë pas të katërve). Nëse **AA** është vrarë me 3 prill 1000 atëherë ai është vrarë për afërsisht dy javë para katër të burgosurve serb.

Trupi Gjykues gjen që pesë të burgosurit serb nuk mund të ishin vrarë para 11 prillit 1999.

Nëse **AA** është vrarë më 3 prill 1000 dhe pesë të burgosurit serb janë vrarë pas 11 prillit 1999 atëherë trupi i **AA** do të ishte në fund të varrit. Gjatë zhvarrosjes më 23-25 shtator 2009 trupi i **AA** nuk është gjetur. Më tej, Arkeologu forenzik ka dëshmuar që nuk ka pasur shenja të trazimit të varrit.

Kur është marrë në pyetje më 11 shkurt 2010 **AZ** është pyetur për tre të burgosurit shqiptarë të cilët ishin vrarë me të shtëna. Ai është pyetur “A është kjo gropa e njëjtë ku janë vrarë dhe gjuajtur katër serbët dhe serbi tjetër?” Në përgjigje ai ka thënë “po”.

Ai më tej është pyetur: “A je i sigurt për sekuencën e vrasjeve: së pari **AA**, pastaj katër serbët, pastaj serbi i vrarë me kosë, pastaj tre shqiptarët?” Në përgjigje ai ka thënë “Po”.

AZ ka dëshmuar që **IG** dhe **SA** janë marrë nga burgu nga **AK**, **NK1** dhe **NK2** dhe që më pak se tridhjetë minuta më vonë ai i ka dëgjuar të shtënat. Ai ka thënë që kjo ka qenë më 3 prill 1999. Ai ka thënë që të nesërmen ai ka parë diçka për çfarë ka menduar që është një varr i freskët.

Kur është intervistuar më 9 shkurt 2010 **AZ** ka thënë që **IG** dhe **SA** janë marrë nga burgu nga ana e **NK1**, **NK2** dhe **NS** dhe që pas pak kohe ai ka dëgjuar të shtëna. Ai ka thënë që nuk është i sigurt nëse **AK** ka qenë në grupin që i ka marrë dy të burgosurit. Kjo kundërshton atë që ai e ka deklaruar kur është intervistuar nga policia më 30 nëntor 2009 kur ai dukej i sigurt që **AK** kishte qenë prezent.

Në 2009 **AZ** i ka thënë hetuesve që disa kufoma janë larguar në 2002.¹⁷⁰ Megjithatë, kjo e kundërshton dëshminë që ai e ka dhënë në 2010. Kur është marrë në pyetje më 11 shkurt 2010 ai ka dëshmuar që pas luftës dhe para arrestimit të **FL** nga TPNJ, me gjasë dikur në 2001 ose 2002, ai e kishte marrë një thirrje telefonike nga **FL** duke e urdhëruar atë që të “i largoj kufomat” dhe “pastroj zonën”. **AZ** jak thënë që ai ka shkuar “atje” me **SS1** dhe **NS**. Kur kanë arritur në vendngjarje **SS1** ka deklaruar “nuk po prekim asgjë dhe vetëm po largohemi”. Duket që pastaj janë larguar. **AZ** më tej ka deklaruar “Pas një kohe, brenda një viti pas herës së parë, unë jam kthyer në lokacion dhe kam mundur të shoh që asgjë nuk ishte prekur. Unë e kam përsëritur kontrollimin disa herë kur kam shkuar për në shtëpinë e babait tim. Mendoj që hera e fundit që kam shkuar atje ka qenë dikur në 2009.”¹⁷¹

¹⁷⁰ Dosja M, faqet M71, M72

¹⁷¹ Deklarata e 11 shkurtit 2010, dosja A në faqen A83

Znj. C. ka dëshmuar që, po të ishte trazuar varri 6 ose më shumë muaj pas varrimit fillestar, ajo do të ishte parë shenja që kufomat janë trazuar. Ajo nuk ka gjetur prova të tilla. Nuk ka asnjë provë që sugjeron ndonjë qëllim të trazimit të varrit para 2001. Në të vërtetë, në 2010 **AZ** ka dëshmuar që nga 2001 ose 2002 deri në 2009 ai në mënyrë të përsëritur e kishte kontrolluar “lokacionin” dhe varret nuk ishin trazuar.

AZ i ka identifikuar disa lokacione të mundshme të varreve në një lokacion relativisht të vogël gjeografik. Kufomat janë zhvarrosur në KERO1 dhe KEQ)1. Në asnjë lokacion tjetër të identifikuar nga **AZ** hetuesit nuk kanë gjetur mbetje ose prova të varrimit ose mbulimit të mbetjeve mortore të njeriut. Ata nuk kanë gjetur dëshmi që do të sugjeronin zhvarrimin e varreve.

Dëshmia që **AZ** e ka dhënë në lidhje me lokacionet e varreve, viktimat e varrosura aty dhe largimin e kufomave ka qenë në kundërshtim dhe është kundërshtuar nga dëshmi të tjera, duke përfshirë prova forenzike. Trupi Gjykues gjen që **AZ** nuk ka qenë prezent kur katër të burgosurit serbë janë vrarë po, siç ka deklaruar në 2009, ai vetëm ka dëgjuar më vonë që ata ishin vrarë. Dëshmia e tij në lidhje me atë që ai e ka gjetur te huan e kosës dhe që ka qenë dëshmitar i vrasjes së të burgosurit të pestë serb është gjithashtu aq e pabesueshme që Trupi Gjykues gjen që ai nuk ka qenë prezent.

Kur është intervistuar nga policia më 3 dhjetor 2009 **AZ** ka thënë që **ND** dhe **VM** janë liruar më 5 prill 1999.

Ai ka thënë “Gjysmë ore pasi që **G** (sic) dhe **M** janë liruar unë i kam dëgjuar disa të shtëna nga dy Kalashnikovë nga drejtimi i fshatit Shala. **AS** kishte shkuar diku me **AK** me lopata para se që të burgosurit të nxirren nga burgu nga **NK2**, **NS** dhe **BL**. Dikur më vonë **AS** ka ardhur dhe ka thënë “e kemi kryer dhe i kemi mbuluar”.

Është e paqartë se kujt i referohet **AZ** kur thotë “**AS**”.

Në dhjetor 2009 ai ka thënë që ai vetëm ka “dëgjuar” të shtëna. Ai nuk e ka përmendur fare që **FL** ka qenë prezent. Në të vërtetë, në atë fazë ai nuk e ka përmendur përfshirjen e tij.

Ai më vonë¹⁷² ka thënë që ai ka gënjyer për këtë dhe që, në fakt, ai i kishte vrarë të dy burrat me urdhër të **FL**. Natyrisht, kur është intervistuar në 2009, ai mund të mos ketë dashur të përmend pjesëmarrjen e tij në vrasjen e tyre por ai gjithashtu fare nuk e ka përmendur **FL** në lidhje me atë ngjarje. Kjo është e çuditshme duke marrë parasysh që, gjatë intervistës së njëjtë, ai e kishte implikuar **FL** në vrasjen e të burgosurve të tjerë.

Kur është intervistuar më 3 dhjetor 2009 ai i ka thënë hetuesve që **ND** dhe **VM** ishin marrë nga burgu nga ana e **NK2**, **NS** dhe **BL**. Ai ka thënë që “dikur më vonë **AS** ka ardhur dhe ka thënë “ne e kemi kryer dhe i kemi mbuluar ata”. Kur ka dëshmuar me atë rast ai ka premtuar të tregoj të vërtetën. Ai ka gënjyer.

Kur është marrë në pyetje nga avokati i **FL** më 7 korrik 2011 **AZ** është pyetur se kur ka vendosur që ta tregojë të vërtetën. Në përgjigje ai ka deklaruar “Nga momenti kur e kam hequr idenë që ta vras **FL** dhe e kam dorëzuar armën time, unë kam qenë i paarmatosur, dhe pastaj gjithmonë kam menduar të arrij një përfundim me anë të një marrëveshje”. Ai ka thënë që nga ai moment ai ka qenë i vendosur që të tregojë të vërtetën.

AZ ia ka dorëzuar armën e tij KFOR-it më 24 nëntor 2006.¹⁷³ Megjithatë, më 30 nëntor 2009 dhe 11 shkurt 2010 ai i ka dhënë dy tregime kundërthënëse për vrasjen e **ND** dhe **VM**. Në 2009 ai i ka thënë hetuesve “Gjysmë ore pasi që **G** (sic) dhe **M** janë liruar unë i kam dëgjuar disa të shtëna nga dy Kalashnikovë nga drejtimi i fshatit Shala.” Në 2010 ai ka thënë që ai i kishte vrarë të dy të burgosurit me urdhër të **FL**. Kur kjo mospërputhje i është paraqitur atij më 7 korrik 2011 ai ka thënë që të dy versionet e dëshmisë së tij janë të vërteta. Ai ka thënë “Fillimisht ata janë liruar dhe pastaj ata janë vrarë, sepse është një shenjë plus pranë emrave të tyre”. Kjo nuk e ka shpjeguar kundërthënien e qartë në dëshminë e tij. Kjo është vetëm një shembull i

¹⁷² 11 shkurt 2010

¹⁷³ Letër nga KFOR datuar 3 shtator 2013

mospërputhjeve në dëshminë e **AZ** që trupi gjykues nuk ka arritur që ta zgjidh sepse ai nuk ka qenë në dispozicion.

AZ ka dëshmuar që ai i ka qëlluar **VM** dhe **ND**. Ai ka thënë që të dy burrat i ka pasur përballë kur i ka qëlluar.

Ekzaminimet e autopsisë së të dy viktimave janë kryer më 14 shtator 2010. Raporti i autopsisë mbi **VM**¹⁷⁴ shënon dy plagë nga armë zjarri në anën e djathtë të kokës dhe një plagë me armë zjarri në pjesën e prapme të kokës. Raporti i autopsisë mbi **ND**¹⁷⁵ shënon një të plagë me armë zjarri në kokë dhe një plagë me armë zjarri në trung.

AZ kurrë nuk e ka përmendur faktin që **VM** ishte qëlluar një herë në pjesën e prapme të kokës. Është e mundur që kjo ka ndodhur kur viktimja ka qenë e shtrirë në tokë. Nëse ai ka qenë aq “i shokuar” sa dëshiron që të besoj Trupi Gjykues që ka qenë, është e çuditshme që ai, si duket, do ta kishte qëlluar në mënyrë klinike një të prej viktimave në pjesën e prapme të kokës. Nëse ai nuk e ka shkrepur atë të shtënë është e çuditshme që ai nuk e ka përmendur se kush e ka bërë këtë. Sipas tregimit të tij ai ka qenë i vetmi përgjegjës për të qëlluarit e të dy të burgosurve.

Nëse **AZ** nuk i ka vrarë **VM** dhe **ND** është e çuditshme që do të thoshte që ai i ka vrarë ata. Në të vërtetë, ai e ka bërë atë pretendim para se të shpallet dëshmitar bashkëpunues. Kjo mund të duket se i shton peshë dëshmisë së tij. Megjithatë, pretendimi i tij që ai i ka vrarë të dy burrat ishte qartë i krijuar për të i shtuar peshë besueshmërisë së tij dhe pretendimit të tij që ai i kishte vrarë të dy burrat sipas urdhrit të **FL**.

Është interesante që kur ai është marrë në pyetje më 11 shkurt 2010 kufomat e **VM** dhe **ND** nuk ishin zhvarrosur. Nuk kishte pasur kurrfarë ekzaminimi forenzik të mbetjeve mortore të **VM**

¹⁷⁴ Dosja I

¹⁷⁵ Dosja I

dhe **ND** dhe nuk kishte kurrfarë konkluzioni në lidhje me të shtënat me armë zjarri që ata i kishin pësuar.

Provat forenzike duket se e kundërshtojnë tregimin e tij të pozitës së të burgosurve kur, ai thotë, që ai i ka qëlluar ata.

Megjithatë, edhe nëse ai i ka ekzekutuar **VM** dhe **ND**, kjo nuk e mbështetë dëshminë e tij që kjo është bërë sipas urdhrave të **FL**.

2. Çështje tjera që janë relevante për besueshmërinë

a. **SD**

AZ e ka përshkruar **SD** *“si baba për mua”*¹⁷⁶. Kur ka dëshmuar **SD** është pyetur për një person me nofkën “Murrizi”, një emër i përdorur nga **AZ**. Ai ka thënë *“Po, ai më kujtohet shumë mirë. Ai ka qenë një ushtar i thjeshtë. Unë gjithashtu kam folur me të kur jam sjellur përreth. Unë e kam parë kohë pas kohe në Divjakë në shtabin kryesor dhe në Berishë”*¹⁷⁷. Ai është pyetur nëse e di emrin **AZ**. Në përgjigje ai ka thënë *“Unë definitivisht e di emrin, edhe pse nuk mund ta përputhë emrin me një fytyrë”*¹⁷⁸. Përshkrimi që e ka dhënë **AZ** për marrëdhënien e tij me **SD** duket mjaft i zbrazët.

Kur është marrë në pyetje më 7 korrik 2011 **AZ** është pyetur për **PU**, të cilit i ishte referuar në deklaratën e tij të 5 tetorit 2010. Ai e ka përshkruar **PU** si përafërsisht 30-35 vjeçar, *“disi mesatar, jo i hollë”*. Ai ka thënë që e ka takuar atë 2-3 herë. **SD** ka dëshmuar që **PU** është emri të cilin ai e ka përdorur për të fshehur identitetin e tij të vërtetë. **SD** dhe **PU** kanë qenë personi i njëjtë.

¹⁷⁶ Procesverbali i marrjes në pyetje i 9 shkurtit 2010, PSRK dosja A, faqja A27

¹⁷⁷ Dosja e PSRK B, faqja B96

¹⁷⁸ Dosja e PSRK B, faqja B96

AZ i është referuar në dëshminë e tij rastit të **BK**, një ish komandanti i cili ishte dënuar me vdekje. Kur është intervistuar më 9 shkurt 201 **AZ** ka thënë që **FL** *“personalisht e ka arrestuar atë dhe personalisht e ka çuar në burg në Kleçkë.”* Ai ka thënë që **FL** i ka thënë atij *“Nëse e liron këtë unë do të të vras. Ky duhet të ekzekutohet.”*

Ai ka thënë që disa ditë më vonë ai e ka marrë një urdhër nga **SD** që ta sjell **BK** te ai. Ai ka thënë që ka refuzuar, duke e nënshkruar pjesën e prapme të urdhrit që ai nuk ka mundur ta ekzekutojë urdhrin. Ai ka thënë që disa ditë më vonë ai ka shkuar te **SD** dhe i ka thënë atij që ai nuk ishte i gatshëm që ta *“merr një plumb”* për **BK**.

Në fakt, **BK** ishte gjykuar dhe dënuar nga një Gjykatë Ushtarake të kryesuar nga **SD** i cili e kishte dënuar atë me vdekje. Ky ka qenë një vendim i ligjshëm, juridik – jo një vendim arbitrar i **FL**.

Duke marrë parasysh që **BK** ishte ndaluar në bazë të një vendimi të ligjshëm juridik të lëshuar nga **SD**, është e çuditshme që **AZ** do të refuzonte një urdhër për ta çuar **BK** përpara asaj gjykate.

Kur **SD** është intervistuar në shtator 2010 ai është pyetur nëse Drejtori i burgut i ishte ankuar atij që **FL** dukej i vendosur që **BK** të ekzekutohej, si një shembull për të tjerët. Në përgjigje ai ka thënë *“Mua nuk më kujtohet një tregim i tillë. Askush nuk është ankuar te unë. Ajo që mund të them është që jo askush brenda UÇK ka qenë i lumtur me vendimin tim që të mos ekzekutohet K”*¹⁷⁹.

Kur ka dëshmuar përpara kësaj gjykate **SD** ka thënë *“Askush nuk ka kundërshtuar. Mund të konfirmojë që ata kurrë nuk janë përzier në çështje ligjore...”*¹⁸⁰ Ai ka thënë që **K** është paraqitur para tij *“disa herë. Së paku dy herë”*¹⁸¹

¹⁷⁹ Deklarata e 23 shtatorit 2010 paragrafi 23

¹⁸⁰ Dëshmia e 23 prillit 2013

¹⁸¹ Dëshmia e 23 prillit 2013

Duke iu referuar rastit kur ai kishte refuzuar që ta çonte **BK** te **SD**, **AZ** ka dëshmuar që **SD** pastaj i kishte dërguar katër policë ushtarak për të e marrë **BK**.

SD ka thënë që nuk i kujtohet se kush e ka transportuar **BK** ndërmjet burgut dhe gjykatës. Kur është intervistuar në shtator 2010 ai është pyetur nëse ka dërguar ndonjëherë policinë ushtarake në burg në Kleçkë për ta marrë **BK**. Në përgjigje ai ka thënë “*Është shumë e mundur sepse kjo ka qenë pjesë e procedurës së rregullt*”¹⁸².

Sipas lëndës së prokurorisë, policia ushtarake e ngarkuar me përcjelljen e **BK** te **SD** ka qenë nën komandën e **FL**. Kjo është një mospërputhje e qartë logjike në dëshminë e **AZ**. **AZ** ka refuzuar që të zbatojë urdhrin që ta çojë **BK** përpara gjykatës ushtarake sepse ai ka qenë i frikësuar nga reagimi i **FL** përderisa **SD** e ka dërguar policinë ushtarake që ta merr atë.

Kur ka dëshmuar përpara gjykatës **SD** është pyetur nëse koordinatori i burgut ndonjëherë kishte refuzuar ta transferojë **BK** nga burgu në Kleçkë për në gjykatë. Në përgjigje ai ka thënë që nuk i kujtohet.

Ai është pyetur nëse koordinatori kishte shprehur ndonjë brengë për rastin e **BK**. Ai ka thënë “ka qenë një akt nëpërmes të cilit ai e ka shprehur brengën e tij dhe, në bazë të kësaj, unë kam shkuar te ai dhe i kam shpjeguar që nuk kishte asgjë për të u brengosur sepse “unë qëndroj menjëherë pas teje”.¹⁸³

SD është pyetur nëse **AZ** ka deklaruar ndonjëherë që ai nuk do të “merrte një plumb” për **K**. Në përgjigje ai ka thënë “Jo. Kurrë.”¹⁸⁴

b. Deklarata e KFOR

¹⁸² Deklarata e 23 shtatorit 2010 paragrafi 24

¹⁸³ Dëshmia e 24 prillit 2013

¹⁸⁴ Dëshmia e 24 prillit 2013

Në aktakuzë pretendohet që *“pas marrjes së kërcënimeve vijuese shtesë dhe presionit, në 2006 dëshmitari bashkëpunues X ka vendosur të shkoj në KFOR në X, të ju dorëzojë atyre armën e tyre dhe të jep një deklaratë të plotë në lidhje me kohën e luftës...Kur L dhe bashkëpunëtorët e tij e kanë mësuar këtë, dhe të frikësuar për një reagim vijues juridik, ata e kanë detyruar dëshmitarin X që të pranohet në spitalin Psikiatrik në Prishtinë për një kohë për të diskredituar besueshmërinë e tij.”*

AZ është pranuar në spital psikiatrik në dy raste. Më 15 dhjetor 2005 ai është pranuar në spitalin psikiatrik në X. Ai është lëshuar më 4 janar 2006. Më 30 nëntor 2006 ai është pranuar në spitalin psikiatrik në Prishtinë. Ai është liruar më 19 janar 2007.

Kur është intervistuar më 16 mars 2010 ai ka thënë që ai ishte pranuar në spitalin psikiatrik në rastin e dytë kur ai ia kishte dorëzuar armën e tij KFOR-it dhe, ai ka thënë, ia ka treguar atyre *“tregimin e plotë”*.

Kur është intervistuar nga policia më 16 dhe 17 korrik 2007 ai i është referuar në mënyrë të përsëritur deklaratës që ai thotë që ia ka dhënë KFOR-it, duket se në 2006. Ai i është referuar kësaj deklaratë në KFOR në disa raste tjera duke përfshirë më 16 mars 2010 dhe 7 korrik 2011. Në secilin rast ai ka premtuar të tregojë të vërtetën.

Në deklaratën e tij në polici më 16 korrik 2007 ai ka thënë që **FL** e ka pyetur se sa të holla i do për të e *“tërhequr deklaratën ne KFOR”*. Ai ka thënë që, në përgjigje, ai kishte deklaruar *“si ta tërheq, tani nuk mundem”*.

Gjatë intervistës më 16 mars 2010 ai ka thënë që ai i ka thënë **FL** që ai *“ka dashtë”* që të shkojë në KFOR për të i *“paraqitur ata”*. Ai ka thënë që **FL** ka insistuar që të takohen për të diskutuar *“çështjen”*. Ai ka thënë që gjatë atij takimi **FL** i ka thënë atij që ai duhet të shkojë në spitalin psikiatrik, duke deklaruar që kjo është mënyra e vetme për të *“diskredituar”* tregimin që ai ia ka treguar KFOR-it. Ai ka thënë që është *“dashtë”* të shkojë në spital të nesërmen pas atij takimi.

GZ ka dëshmuar që **AZ** është pranuar në spitalin psikiatrik me qëllim që të “diskreditohet” një deklaratë që, ai ka thënë, ai ia ka dhënë KFOR-it.¹⁸⁵

Duket e çuditshme që **FL** ishte në gjendje që ta bind **AZ** që të shkojë në spitalin psikiatrik me qëllim që të “diskreditojë” tregimin e tij, pse nuk ishte në gjendje që të bind **AZ** mos të i jep fare deklaratë KFOR-it ose që të kthehet në KFOR për ta ndryshuar atë ose për ta tërhequr në tërësi?

Kur është intervistuar më 5 tetor 2010 ai është pyetur për Fletë lëshimin nga Klinika Psikiatrike në Qendrën Klinike Universitare që përshkruan, në mes tjerash, simptomet që ai i ka paraqitur kur ka arritur në klinikë. Këto përfshijnë “...pagjumësinë, sjelljen e çrregulluar, ide për përndjekje dhe dyshime.” Në përgjigje ai thënë “Unë në të vërtetë jam shtirë kinse i kam simptomet që janë listuar këtu. Mjekët vetëm kanë përshkruar se si jam sjellur unë dhe simptomet që ata i kanë përcaktuar. Por unë jam sjellur ashtu në bazë të udhëzimeve që më i ka dhënë **FL**”.

Megjithatë, pas arritjes së tij në spitalin psikiatrik në Nëntor 2006 dhe pastaj ai i ka thënë stafit që ai ishte kërcënuar. Në të vërtetë, shënimet nga koha prej dhjetorit 2006 kur ai është transferuar në spitalin psikiatrik në njësinë për përkujdesjen intensive cekin që ai ka thënë “ata më kërcënojnë me telefon dhe thonë që do të më hedhin në ajër mua dhe familjen time, unë i shoh disa persona që më kërkojnë ta vras këtë ose atë në shkëmbim për shumë para; unë i kam dërguar letra shumë politikanëve që të më japin sigurim sepse unë kam luftuar për dy vite”.

Është thjeshtë e palogjikshme që **AZ** do të bashkëpunonte në pranimin e tij në spitalin psikiatrik dhe që të shtirej që i ka simptomet e shënuara, kinse sipas udhëzimeve të **FL**, me qëllim që të “diskreditojë” një deklaratë që, ai thotë, e kishte dhënë në KFOR por pastaj ta informojë stafin e spitalit për kërcënime që, ai thotë, ai i ka marrë.

¹⁸⁵ Deklarata e Ganimete Zogaj me datë 20 prill 2010

Prokuroria nuk e ka paraqitur si provë deklaratën që **AZ** thotë që ia ka dhënë KFOR-it. Gjykata prandaj e ka kontaktuar KFOR-in me qëllim që të vërtetojë nëse **AZ** i kishte dhënë deklaratë KFOR-it. Kjo është qartazi relevante për besueshmërinë e tij. Nëse ai nuk i ka dhënë deklaratë KFOR-it atëherë kjo në masë domethënëse minon besueshmërinë e tij në lidhje me tregimin e tij për kërcënimet që ai thotë që i ka pranuar nga ose në emër të **FL**. Kjo gjithashtu ngritë pyetje për arsyen e vërtetë ose motivimin për pranimin e tij në spitalin psikiatrik në 2006. Disa herë në ditarin e tij ai i referohet deklaratës që ai thotë që ia ka dhënë KFOR-it.

AZ ia ka dorëzuar armën e tij të zjarrit KFOR-it më 24 nëntor 2006. Lënda e prokurorisë cekë që ai i ka dhënë KFOR-it *“një deklaratë të plotë për kohën e luftës”*. Lënda e prokurorisë cekë që ai është pranuar në spitalin psikiatrik më 30 nëntor 2006 me qëllim që të diskreditojë atë deklaratë. Prandaj, po të i kishte dhënë **AZ** deklaratë KFOR-it kjo do të kishte ndodhur gjatë periudhës 24-30 nëntor 2006. Në fakt, **AZ** kurrë nuk i ka dhënë deklaratë KFOR-it gjatë asaj periudhe.¹⁸⁶ Prokuroria në mënyrë të ndryshme ka paraqitur që **AZ** ndoshta është habitur në mes të KFOR dhe UNMIK ose që mund të ketë dhënë një deklaratë me gojë. Trupi Gjykues i gjen këto shpjegime të pabesueshme. Në të vërtetë, në deklaratat e tij **AZ** diferencon në mes të KFOR, UNMIK dhe TPNJ.

KFOR ka konfirmuar¹⁸⁷ që më 24 nëntor 2006 **AZ** e ka dorëzuar një armë zjarri dhe i ka informuar ata që e posedon një granatë dore. Raporti i Situatës, të cilit i është referuar në atë letër, ka cekur që **AZ** *“i është dorëzuar njësisë për krime lufte në Prishtinë”*.

Në shënim në ditar i **AZ** më 24 nëntor 2006¹⁸⁸ i referohet asaj që ai ka shkuar në KFOR dhe pastaj në *“KB”* ku, siç duket, ai ka qëndruar nga ora 1 e mëngjesit deri në ora 10 të mëngjesit të nesërmen. Është kyçe që shënimi në ditar më tej cekë *“Pa deshmi-”*, një përkthim i fjalëpërfjalë i cilës është *“pa dëshmi”*. I vetmi interpretim logjik i asaj fjalie është që ai nuk ka dhënë

¹⁸⁶ Letër nga KFOR me datë 27 gusht 2013 në Volumin 17 te tab 5

¹⁸⁷ Letra e 3 shtatorit 2013

¹⁸⁸ Prova 0096-09-EWC2/006, faqja 30

deklaratë – me shkrim ose gojarisht. Prandaj është e qartë që shënimi i vet atij në ditar e kundërshton dëshminë e tij të mëvonshme që ai e ka treguar “tregimin e plotë” dhe që kjo është arsyeja për pranimin e tij vijues në spital.

Sidoqoftë, Gjykata e ka kontaktuar UNMIK dhe TPNJ dhe ka kërkuar informacione nëse, gjatë periudhës 24-30 nëntor 2006, **AZ** kishte dhënë deklaratë. UNMIK¹⁸⁹ dhe TPNJ¹⁹⁰ të dy kanë konfirmuar që **AZ** nuk e ka dhënë asnjë deklaratë gjatë asaj periudhe.

Po të kishte dhënë **AZ** deklaratë me shkrim ka pak gjasë që ai do të ishte shtruar vet në një spital psikiatrik me qëllim që ta “diskreditojë” atë. Ai thjeshtë do ta kishte mohuar atë. Më tje, po të kishte folur me hetues për krime lufte në lidhje me krime të pretenduara lufte duket e pabesueshme që ata mos të kishin marrë një deklaratë nga ai apo mos të kishin bërë ndonjë shënim të bisedës me të. Asnjë shënim i tillë nuk është paraqitur si provë. Sidoqoftë, duket sipas shënimit të tij në ditar, të cilit i referohet më lart, që **AZ** kurrë nuk i ka dhënë deklaratë UNMIK-ut.

Trupi Gjykues gjen që **AZ** nuk ka dhënë deklaratë me shkrim e as me gojë te asnjë hetues për krime lufte gjatë periudhës 24-30 nëntor 2006. Kjo minon konsiderueshëm dëshminë e tij në lidhje me arsyen pse ai ka thënë që është pranuar në spitalin psikiatrik më 30 nëntor 2006. Kjo ishte një gënjeshtër dhe më tej e minon besueshmërinë e tij.

Më tej, **AZ** ka dëshmuar¹⁹¹ që KFOR i kishte ofruar atij “mbrojtje”. Nëse ai kurrë nuk i ka dhënë deklaratë KFOR-it duket e pabesueshme që ata do të kishin ndonjë arsye që të i ofrojnë atij mbrojtje. Edhe kjo ishte një gënjeshtër.

¹⁸⁹ Prova C17, letër e datës 9 shtator 2013 nga Zyra e Shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Sundimit të Ligjit të UNMIK

¹⁹⁰ Prova C 18, email I dates 11 shtator 2013 nga Zyra e Prokurorit, k Mekanizmi për Tribunale Penale Ndërkombëtare, Hagë

¹⁹¹ Marrja në pyetje e 7 korrikut 2011

c. Deklaratat e TPNJ

AZ i është referuar në raste të ndryshme gjatë dëshmisë së tij asaj që ai ishte kërcënuar nga **DL**, vëllai i **FL**.

Kur është marrë në pyetje më 9 shkurt 2010 ai ka thënë që **DL** i ka thënë atij që të mos i thotë asgjë UNMIK-ut dhe që nëse thirret në Hagë *“ata do të më tregojnë se çfarë të them”*.

Kur është ekzaminuar më 17 shkurt 2010 ai ka thënë që **DL** i ka thënë atij që nëse thirret për të dëshmuar në Hagë ai duhet të konsultohet me **FL** para se jep ndonjë deklaratë. Gjatë asaj marrje të njëjtë në pyetje **AZ** i është referuar një takimi të mëtejme me **DL** gjatë të cilit ai ka thënë që **DL** i ka thënë atij kopje të deklaratave që i kanë dhënë në TPNJ **FL**, HB dhe IM. Duke iu referuar **DL**, **AZ** ka thënë *“ai e ka sjellur me vete një kopje të deklaratave që F, B dhe M ia kanë dhënë TPNJ-së. Ai më ka thënë që të i lexojë ato dhe të përgatis versionin tim të fakteve nëse arrestohem”*.

Kur është marrë në pyetje nga avokati i **FL** më 7 korrik 2011 **AZ** është pyetur për takimin e pretenduar me **DL** në shtëpinë e axhës së tij. Duke iu referuar deklaratave të **FL**, HB dhe IM ai ka thënë *“i kam lexuar ato”*. Më vonë, kur është pyetur *“a i ke lexuar deklaratat?”* ai është përgjigjur *“kam lexuar pjesë të tyre...”* Ai pastaj ka thënë *“Unë vetëm e kam lexuar të B të gjitha të tjerat ishin aty”*. Ai është pyetur nëse deklaratat ishin lënë te ai. Në përgjigje ai ka thënë *“Ata i kanë marrë ato”*:

Në fakt, pasi që është interesuar në TPNJ Gjykata e ka vërtetuar që **FL** dhe IM kurrë nuk i kanë dhënë deklarata TPNJ-së¹⁹². Prandaj **DL** nuk mund të ia ketë treguar **AZ** deklaratat në TPNJ të **FL** dhe IM. Edhe kjo ishte gënjeshtër.

d. Pagesat që pretendohet të jenë bërë nga FL

¹⁹² Letra nga TPNJ me datë 31 korrik dhe 13 gusht 2013 respektivisht

AZ ka dëshmuar që ai ka marrë pagesa të ndryshme nga **FL**. Këto pagesa, në thelb, kanë qenë një tentim që të “blihet heshtja e tij”.

Një shënim në ditar për 29 nëntor 2006¹⁹³ cekë *“F më ka ofruar një rrogë mujore prej 500 euro. Më 1 maj ai ia ka dhënë shokut tim 5000 euro që të më i jep mua me qëllim që të i ndihmoj F...Kur kam shkuar në spital **NK1** më i ka ofruar edhe 2000 euro. Në total 7000 euro.”*

AZ ka qenë në spital nga 30 nëntori 2006 deri më 19 janar 2007.

Më tej, nuk ka asnjë shënim në ditar për 1 majin ku i referohet ndonjë pagese prej 5000 euro. Duke marrë parasysh rëndësinë e qartë të këtij pretendimi kjo është një lënie jashtë e çuditshme.

AZ ka dëshmuar që përderisa ai ka qenë në spitalin psikiatrik në Prishtinë **NK1** ia ka dhënë atij 2,000 euro. Ai ka thënë që “gjatë periudhës së njëjtë” **BT** ia kishte dhënë 5000 euro gruas së tij në emër të **FL**”.¹⁹⁴

Një shënim në ditar¹⁹⁵ i referohet asaj që **AZ** i janë dhënë 2000 euro dhe gruas së tij 5000 euro. Ai shënim në ditar cekë: *“Sot **N** ka ardhur dhe më i ka sjellur 2000 euro, **F** i ka çuar këto dhe 5000 euro ata ia kanë dhënë vëllait të gruas tënde që të i jepen gruas tënde”*. Ai shënim në ditar është pa datë por është i shkruar në pjesën e prapme të faqes që i përmban shënimet e datave 15, 18, 21 dhe 26 dhjetor 2006. Shënimi i ardhshëm është i datuar 27 dhjetor 2006. Duket që ky është një shtesë e mëvonshme në ditar. Në të vërtetë, faqja në të cilën është bërë shënim nuk ka qenë faqja e parë në librin e lidhur por një faqe ndaras që është ngjitur në pjesën e përparme të atij libri duke përdorur shirit ngjitës.¹⁹⁶

¹⁹³ 0096-09-EWC2/006, faqja 25

¹⁹⁴ Deklaratat e 10 dhe 16 marsit 2010

¹⁹⁵ 0096-09-EWC2/001, faqja 2a

¹⁹⁶ Prova 0096-09-EWC2/001

Është pretenduar që kjo shumë është dhënë gjatë periudhës kur **AZ** ishte në spital me qëllim që të diskreditohet deklarata që, siç thotë ai, ia ka dhënë KFOR-it.

Kur është intervistuar më 16 mars 2010 ai ka thënëq **NK1** ia ka dhënë gruas së tij 5000 euro. **GZ** ka thënë që takimi ka ndodhur në odën e kushëririt të saj **GT** në Lapushnik. Ajo ka thënë që ai takim ka ndodhur përderisa **AZ** ishte në spital. Ajo thotë që i biri i **G** gjithashtu ka qenë prezent¹⁹⁷.

Megjithatë, kur **BT** është marrë në pyetje nga prokurori ai ka thënë që ai nuk di asgjë për 5000 eurot që i janë dhënë **GZ**.¹⁹⁸

Shënimi në ditar i 29 nëntorit 2006 i referohet një shume prej 5000 euro që i janë dhënë një shoku të **AZ** me qëllim që të i “ndihmojë **F**”. Shënimi thotë që shuma është dhënë më “1 maj”. Ai shënim i referohet edhe një shume “tjetër” prej 2000 euro që **NK1** ia ka “ofruar” **AZ** përderisa ky i dyti ishte në spital. Shënimi në ditar cekë “në total 7000 euro”.

Megjithatë, shënimi në ditar pas 27 janarit 2007 cekë “sot më ka vizituar **N** dhe më i ka dhënë 2000 euro...” Ky shënim i njëjtë i referohet shumës prej 5000 euro që i janë dhënë **GZ**.

AZ dhe **GZ** të dy kanë dëshmuar që **GZ** e ka pranuar shumën prej 5000 euro përderisa **AZ** ka qenë në spital. **AZ** ka dëshmuar që ai e ka marrë shumën prej 2,000 euro nga **NK1**. Shënimet në ditar janë kundërthënëse për atë se cilat pagesa janë bërë dhe kur.

Kur **GZ** ka dëshmuar përpara kësaj Gjykate më 14 maj 2013 ajo ka pretenduar që nuk i kujtohet asgjë për një pagesë prej 5000 euro¹⁹⁹.

¹⁹⁷ Deklarata e 20 prillit 2010

¹⁹⁸ Deklarata e BT e datës 5 prill 2011

¹⁹⁹ Procesverbal i 14 majit 2013, faqja 16 (versioni anglisht).

Kur është intervistuar nga policia më 17 korrik 2007²⁰⁰ **AZ** i është referuar asaj që ai ka shkuar në KFOR dhe ka dhënë deklaratë. Ai ka thënë që është pajtuar që të shtrihet në spital, qëllimi i të cilit ishte që të diskreditohet ajo deklaratë. Ai është pyetur “A ke pranuar të shtrihesh në spital?” Në përgjigje ai ka thënë “Pasi që jam kërcënuar dhe kam qenë i frikësuar, dhe pasi që ata më kanë premtuar që do të kujdesen për familjen time dhe të më i japin 500 E në muaj, *pastaj* unë e kam pranuar këtë propozim.”

Më vonë në atë deklaratë **AZ** është pyetur “Sipas mendimit tënd a të ka borxh ty **FL**?” Në përgjigje **AZ** ka deklaruar “Po, më ka borxh, sipas marrëveshjes tonë që ai çdo muaj të më i jep 500 E derisa të ma gjej një punë por nga Dhjetori 2006 deri më sot ai më ka borxh 500 E për çdo muaj dhe ai nuk e ka përmbushur marrëveshjen.” Megjithatë, sipas dëshmisë së tij atij i janë “ofruar” 2000 euro nga **NK1** më 29 nëntor 2006 dhe i janë “dhënë” 2000 euro nga “**N**” më 21 janar 2007. Më tej, ai ka pohuar që **GZ** i ka marrë 5000 euro më 21 janar 2007. Gjithashtu është një referencë për një pagesë prej 5000 euro që janë paguar më “1 maj”.

Tregimet e **AZ** në lidhje me paratë që ai thotë që i ka marrë nga **FL** janë kontradiktore dhe me aq shumë mospërputhje që Trupi Gjykses nuk mund të gjen asgjë mbi këtë çështje.

e. Tentim Vrasjet e Pretenduara

AZ ka bërë pretendime të ndryshme për kërcënime që ai thotë që i ka marrë nga personat që vepronin në emër të **FL**.

Më 16 korrik 2007 **AZ** i ka thënë policisë që ai i ka parë dy burra duke ndërhyrë në veturën e tij. Më pas është gjetur një granatë dore e ngjitur në veturën e tij. Në atë kohë, **AZ** i ka thënë policisë²⁰¹ që **FL** ishte disi i përfshirë. Nuk ka pasur asnjë provë që lidh **FL** me këtë ngjarje. Në të vërtetë, kur **AZ** është marrë në pyetje më 7 korrik 2001 ai është pyetur nga avokati i **FL**...A

²⁰⁰ Vazhdimi i deklaratës më 16 korrik 2007

²⁰¹ Intervista me policisë e Kosovës më 16 korrik 2007

nuk është e vërtetë që ti fare nuk e ke ditur se kush janë këta njerëz?” Në përgjigje ai ka thënë “nuk e di por i kam dyshimet e mia”.

Më 21 qershor 2009 **AZ** ka pësuar plagë nga armë zjarri në dorën e tij të majtë dhe në kofshën e djathtë. Ajo ngjarje është shënuar në ditarin e tij nën datën 21 qershor 2009 me fjalët “*tentim vrasje*”.

Kur është intervistuar më 17 shkurt 2010 ai është pyetur “*A ke qenë i përfshirë në ngjarje tjera?*” Në përgjigje ai i është referuar ngjarjes ku përfshihet granata e dorës. Befasisht, ai nuk e ka përmendur që është qëlluar në kofshën e djathtë dhe dorën e majtë.

Trupi Gjykues gjen që më 16 korrik 2007 **AZ** e ka lajmëruar policinë që ai i kishte parë dy burra duke ndërhyrë në veturën e tij dhe që një granatë dore është gjetur nga policia. Më tej, Trupi Gjykues gjen që **AZ** ka pësuar plagë nga të shtënat në dorën e tij të majtë dhe kofshën e djathtë gjatë një ngjarjeje më 21 qershor 2009.

Nuk ka pasur prova të pavarura për të mbështetur pretendimin e **AZ** që **FL** ose, në të vërtetë, ndonjëri prej të pandehurve ka qenë prapa ndonjërës ngjarje.

Në deklaratën e saj të 20 prillit 2010 Znj. **GZ** ka thënë që ajo e ka dëgjuar një bisedë telefonike në mes të burrit të saj dhe **DL** gjatë së cilës, ajo ka pretenduar, **DL** ka thënë “Unë do të ju hedh në ajër, ty dhe familjen tënde!” Ajo ka thënë që **AZ** i ka thënë asaj që **FL** frikohej që **AZ** “do të fliste për atë që ka ndodhur gjatë luftës”.²⁰²

Nuk ka asnjë provë që **FL** ishte prapa ndonjërit prej tentimeve të pretenduara mbi jetën e **AZ**. Prova e vetme e thirrjes së pretenduar telefonike në mes të **AZ** dhe **DL** është dëshmia e **AZ** dhe **GZ**.

²⁰² Deklarata e 20 prillit 2010

f. Aksidentet e Trafikut

AZ ka dëshmuar për aksidentet e trafikut që ai pohoi kanë qenë të orkestruara nga **FL** me qëllim që ta heshtë atë.

Kur është marrë në pyetje më 7 korrik 2011 **AZ** është pyetur për një aksident me veturë kur përfshihej vajza e tij kur ajo i ka pasur 18 vjet. Ai thotë që ai ka besuar që kjo ka qenë e qëllimshme. Ai ka pranuar që pas atij aksidenti dhe sepse ai ka menduar që kjo kishte qenë e qëllimshme ai është zhvendosur nga shtëpia e tij²⁰³. Ai ka menduar që vajza e tij është shënjestruar me qëllim. Ai ka menduar që **FL** është prapa aksidentit. Ai ka pretenduar që **NK2** e ka falë shoferin e veturës dhe që **FL** ishte prapa tentimeve që të zgjidhet miqësisht puna me shoferin e veturës.

Ai ka thënë që ka besuar që **FL** ishte prapa tentimeve që janë bërë pastaj që të inkurajohet ai që të “arrij paqe” me shoferin e veturës që e ka goditur vajzën e tij.

Më 24 nëntor 2005 **AZ** e drejtonte veturën e tij në Shtime kur u ndesh me një veturë tjetër të drejtuar nga **SF**. Policia shkoi në vendngjarje. Raporti i policisë duket që e mbanë shoferin e palës së tretë si përgjegjës për aksidentin. Më 28 tetor 2006 **AZ** e drejtonte veturën e tij në X kur u ndesh me një veturë tjetër. Policia shkoi në vendngjarje. Raporti i policisë duket se e mbanë **AZ** përgjegjës për aksidentin. Më 3 tetor 2007 **AZ** e drejtonte veturën e tij në Komoran kur u ndesh me një veturë tjetër të drejtuar nga **BS**. Policia shkoi në vendngjarje. Raporti i policisë duket se e mbanë shoferin e palës së tretë përgjegjës për aksidentit.

Ai pastaj është pyetur për aksidentin e dytë kur vetura e tij është goditur nga një kamion. Ai ka thënë që ka menduar që edhe ky aksident ishte i qëllimshëm.

²⁰³ Faqja 18 (anglisht) e procesverbalit të marrjes në pyetje 7 korrik 2011

Duke iu referuar dy rasteve ku shoferi i palës së tretë u mbajt përgjegjës, ai pranoi që në të dy rastet shoferët e veturave e kanë pritur policinë, që policia ka shkuar në vendngjarje dh eka folur me shoferët e veturave tjera dhe që shënimet e tyre personale janë shënuar nga policia.

Nuk ka asnjë provë që **FL** ose në të vërtetë ndonjëri prej të pandehurve ishte disi prapa këtyre aksidenteve të trafikut.

g. ZK

AZ e ka fajësuar **FL** për faktin që daja i tij, **ZK**, është akuzuar për vrasje të dyfishtë. Ai ka thënë *“...para rreth tri viteve daja im është rrahur nga tre-katër njerëz përpara auto punëtorisë së dajës tim në Prishtinë, jo larg nga binarët e trenit afër semaforit. Ai ka shkuar në shtëpi, e ka marrë Kalashnikovin e tij, i ka gjetur personat në një kafene, i ka vrarë dy prej tyre dhe e ka plagosur të tretin. Më vonë e kam marrë vesh që **HS** ka qenë brenda në kafene. Unë kam menduar që i tërë tregimi disi lidhej me problemet e mia. Daja im aktualisht është duke e vuajtur dënimin në Dubravë.”²⁰⁴*

Në fakt, ai tregim nuk ishte i vërtetë. **ZK** është dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë më 19 mars 2013 për, inter alia, veprën penale Vrasje e Rëndë sipas nenit 147 (9) dhe (11) të KPK. Duket sipas aktgjykimit që ka qenë një mosmarrëveshje në lidhje me përdorimin e pronës. Nuk ka asnjë provë që **FL** ose ndonjëri prej të pandehurve ishin të implikuar në ngjarjet në fjalë në atë procedurë.

h. Prerja e kundërligjshme e druve

²⁰⁴ Deklarata e datës 17 shkurt 2010

Kur është marrë në pyetje më 7 korrik 2011 **AZ** është pyetur për një rast kur ai është raportuar nga policia për prerje të kundërligjshme të druve. Ai ka thënë që kushëri i tij i ka marrë drutë. Ai ka thënë që beson që **FL** ka qenë prapa raportimit të tij në polici.

III. Gjetjet në lidhje me Besueshmërinë e **AZ**

Trupi Gjykes nuk propozon që këtu të recitohen të gjitha mospërputhjet dhe kundërthëniet në dëshminë e **AZ** të cilave i është referuar më lart.

AZ ka dëshmuar që ai i kishte shkruar ditarët. Ai e ka përshkruar se këtë e ka bërë fshehtazi. Ai frikohej se çfarë mund të ndodhë nëse zbulohet që ai mbante shënim me shkrim të ngjarjeve në burg në Kleçkë. Kjo ishte një gënjeshtër. Trupi Gjykes ka gjetur që disa nga shënimet në ditar janë shkruar nga persona të tjerë. Disa shënime në ditar duken se janë shtuar më vonë, janë futur për të u përputhur me kronologjinë.

AZ i ka dhënë deklaratë policisë së EULEX më 20 dhe 30 nëntor 2009 dhe ka vazhduar më 3 dhjetor 2009²⁰⁵; Më 4 shkurt 2010, 9 shkurt 2010, 11 shkurt 2010, 16 shkurt 2010 dhe 17 shkurt 2010; 10 mars 2010, 16 mars 2010, dhe 25 mars 2010; 6 qershor 2010 dhe 20 gusht 2010²⁰⁶ dhe më 5 dhe 7 tetor 2010²⁰⁷. Ai është marrë në pyetje nga avokatët mbrojtë më 5, 6, 7 dhe 9 korrik 2011.

Deklaratën e parë ia ka dhënë hetuesve më 20 nëntor 2009 – gati 8 javë pas zhvarrimit të varrit të parë dhe gjetjes së trupave të pesë viktimave serbe.

Dëshmia e tij në lidhje me vrasjen e pesë të burgosurve serbë është kontradiktore, kundërthënëse dhe kundërshtohet nga dëshmitë tjera, duke përfshirë dëshmitë forenzike.

²⁰⁵ Deklaratat të dhëna në rolin e dëshmitarit

²⁰⁶ Deklaratat të dhëna në rolin e të dyshuarit/pandehurit

²⁰⁷ Deklaratat të dhëna në rolin e Dëshmitarit Bashkëpunues

Ai ka thënë që **AK** i ka ndihmuar atij që të i varrosë trupat e pesë të burgosurve serbë. Ai në mënyrë grafike e ka përshkruar se si ai ia ka dhënë tehun e kosës **AK** i cili ia ka dhënë atë **NS**. Kjo ishte një gënjeshtër. **AK** nuk mund të ketë qenë prezent në rastet e përshkruara nga **AZ** sepse ai ishte plagosur rëndë dhe ishte i shtrirë në spital dhe këtë e ka pranuar prokuroria.

Nëse ai nuk ka gënjyer për **AZ** por thjeshtë ka gabuar në fund rezultati është i njëjtë – dëshmia e tij është e pasigurt.

AZ është pyetur kur ka vendosur të tregojë të vërtetën. Në përgjigje ai ka deklaruar “Nga momenti kur e kam hequr idenë që ta vras **FL** unë e kam dorëzuar armën time, kam qenë i paarmatosur, dhe pastaj unë gjithmonë kam menduar për të arritur përfundim nëpërmes një marrëveshje.” Ai ka thënë që nga ai moment ai ka qenë i vendosur që të tregojë të vërtetën.

AZ ia ka dorëzuar armën e tij të zjarrit KFOR-it më 24 nëntor 2006.²⁰⁸ Megjithatë, më 30 nëntor 2009 dhe 11 shkurt 2011 ai i ka dhënë dy tregime kundërthënëse për vrasjen e **VM** dhe **ND**. Në 2009 ai i ka thënë hetuesve “Gjysmë ore pasi që janë liruar **G** (sic) dhe **M** unë i kam dëgjuar disa të shtëna nga dy Kalashnikovë nga drejtimi i fshatit Shala.” Në 2010 ai ka thënë që ai i kishte vrarë të dy të burgosurit me urdhër të **FL**. Kur i është paraqitur kjo mospërputhje më 7 korrik 2011 ai ka thënë që të dy versionet e dëshmisë së tij janë të vërteta. Ai ka thënë “Fillimisht ata janë liruar dhe pastaj janë vrarë, sepse është një shenjë plus pranë emrave të tyre”. Ky ka qenë një pohim absurd. Në 2009 ai ka thënë që kishte “dëgjuar” të shtëna. Në 2010 ai ka thënë që ai i kishte vrarë të dy të burgosurit. Edhe i ballafaquar me një mospërputhje të qartë ai i ka turbulluar gjërat.

Natyrisht është e mundur që ai i ka vrarë **VM** dhe **ND**. Megjithatë, dëshmitë forenzike duket se e kundërshtojnë tregimin e tij mbi të shtënat. Sidoqoftë, duke pretenduar që ai i ka vrarë **ND** dhe **VM** kjo në vetvete nuk e vërteton dëshminë e tij që ai ia qëlluar ata me urdhër të **FL**.

²⁰⁸ Letra nga KFOR me datë 3 shtator 2013

AZ ka dhënë shpjegime të ndryshme për pranimin e tij në një spital psikiatrik në 2005. **AZ** u pyet nga avokati i **FL** që “pranimi i parë në spital ishte për të përgatitur mbrojtjen tuaj për vrasjen e **FL** jo për të fabrikuar një kërkesë kompensimi nga kompania e sigurimit...” Në përgjigje ai ka thënë “të dyja janë të vërteta”²⁰⁹. Ai përsëri refuzon të pranojë mospërputhjet në dëshminë e tij.

GZ ka thënë që **AZ** i ka thënë asaj që ai do të futet në spital psikiatrik “*për të marrë më shumë para nga kompania e sigurimit.*”²¹⁰

Në fakt, **AZ** ka dhënë arsye të ndryshme për pranimin e tij në spitalet psikiatrike në 2005 dhe 2006. Ai i ka thënë hetuesve që ka dashtë të fryjë një kërkesë për kompensim nga sigurimi në vijim të një aksidenti trafiku. Ai i ka thënë hetuesve që ka dashtë të ketë një mbrojtje nëse e vret **FL**. Ai i ka thënë hetuesve që ai është pranuar me qëllim që të diskreditojë një deklaratë që ia ka dhënë KFOR-it. Në rastin e parë ai ka gënjyer me qëllim që të mashtrojë një kompani të sigurimeve. Në rastin e dytë ka gënjyer për të krijuar një mbrojtje të pjesshme për vrasje. Në rastin e tretë ka gënjyer për të diskredituar një deklaratë që thotë që ia ka dhënë KFOR-it.

Kur është intervistuar më 16 mars 2010 ai ka thënë që ai ishte pranuar në spitalin psikiatrik në rastin e dytë pasi që e ka dorëzuar armën e tij në KFOR dhe, ai ka thënë, ia ka treguar atyre “*tregimin e plotë*”. Kjo ka qenë gënjeshtër.

Kur është intervistuar nga policia më 16 dhe 17 korrik 2007 ai i është referuar në mënyrë të përsëritur deklaratës që ai thotë që ia ka dhënë KFOR-it, duket se në 2006. Ai i është referuar deklaratës së tij në KFOR në raste tjera duke përfshirë 16 marsin 2010 dhe 7 korrikun 2011. Në secilin rast ai ka premtuar të tregojë të vërtetën. Ai ka gënjyer. Ai kurrë nuk i ka dhënë deklaratë KFOR-it.

²⁰⁹ Faqja 35 (anglisht) e procesverbalit të marrjes në pyetje të 7 korrikut 2011

²¹⁰ Deklarata e **GZ** e datës 20 prill 2010

AZ ka pranuar që ai i ka gënjyer hetuesit e TPNJ në 2004²¹¹.

Kur është marrë në pyetje më 17 shkurt 2010 **AZ** i është referuar një takimi të mëtejshëm me **DL** gjatë të cilit ai thotë që **DL** i ka dhënë atij kopje të deklaratave që i kanë dhënë në TPNJ **FL**, **HB** dhe **IM**. Ai ka thënë *“Ai i ka sjellur me vete deklaratat që F, B dhe M ia kanë dhënë TPNJ-së. Ai më ka thënë që të i lexojë ato dhe të përgatis versionin tim të fakteve nëse arrestohem”*. Kjo ishte gënjeshtër.

Kur është marrë në pyetje nga avokati i **FL** më 7 korrik 2011 **AG** është pyetur për atë takim të pretenduar me **DL** në shtëpinë e axhës së tij. Duke iu referuar deklaratës së **FL**, **HB** dhe **IM** ai ka thënë *“unë i kam lexuar ato”*. Më vonë, kur është pyetur *“a i ke lexuar deklaratat?”* ai është përgjigjur *“I kam lexuar pjesë të tyre..”* Pastaj ai ka thënë *“unë e kam lexuar vetëm të B të gjitha të tjerat kanë qenë aty”*. Kjo ishte një gënjeshtër. **FL** dhe **IM** kurrë nuk i kanë dhënë deklaratë TPNJ-së.

Ai ka mohuar që e ka urreyer **FL**. Kjo ishte një gënjeshtër. Ai e ka pranuar që ai është futur në një spital psikiatrik në 2005 me qëllim që të ketë një mbrojtje për vrasjen e **FL**.²¹²

Kur është marrë në pyetje më 10 mars 2010 i është referuar një shënimi në ditar ku **AZ** ka deklaruar *“Unë gjithashtu kam tentuar disa herë të shkoj dhe ta vras F”*²¹³ Kur është pyetur për këtë nga avokati i **FL** më 7 korrik 2011 ai ka deklaruar *“Kam menduar për këtë...Unë kurrë nuk kam tentuar ta vras atë.”* Kjo është edhe një paqëndrueshmëri që ndikoi në besueshmërinë e **AZ**.

AZ është pyetur nga avokati i **FL** nëse ai ka besuar që të gjitha të këqijat në jetën e tij kanë pasur të bëjnë me **FL**. Në përgjigje ai ka thënë *“nga 2003 e më tej”*²¹⁴.

²¹¹ Marrja në pyetje më 7 korrik 2011

²¹² ibid

²¹³ Prova 0096-09-EWC2/006, faqja 30

²¹⁴ Faqja 21 (anglisht) e procesverbalit të marrjes në pyetje të 7 korrikut 2011

AZ pranoi që, në vijim të dënimit të **ZK**, ai i ka thënë **NK1** “Unë dëshiroj të i heq qafe të gjithë ata”²¹⁵.

Ka mospërputhje dhe kundërthënie substanciale në dëshminë e **AZ**. Dëshmia e tij gjithashtu kundërshtohet nga dëshmitë tjera. Dëshmia e tij ishte plot gënjeshtër. Ai vet e ka pranuar që i ka gënjyer hetuesit në të kaluarën.

Mbi lëndën e prokurorisë, **AZ** i ka trilluar simptomat gjatë një periudhe kohore që i kanë bindur tre psikiatër që ai me të vërtetë ishte i sëmurë mendërisht. Nëse kjo është e vërtetë, **AZ** ishte një gënjeshtar i bindshëm, manipulativ.

Në dëshminë e tij ai ka demonstruar armiqësi ndaj **FL**. Ai e ka fajësuar **FL** për të gjitha të këqijat që kanë ndodhur në jetën e tij pas 2003. Ditari tij përmban shumë faqe të sharjes kundër **FL** dhe familjes së tij. Ai ka pranuar që ka menduar për ta vrrarë **FL**. Nëse kjo ka qenë produkt i kërcënimeve që, ai thotë, i ka marrë nga **FL**, nuk pakëson armiqësinë e tij ndaj **FL**. Në të vërtetë, nuk ka asnjë provë që vërteton që **FL** ka qenë prapa ndonjë kërcënimi që ai thotë që e ka marrë. Disa prej dëshmive që ai i ka dhënë rreth kërcënimeve të pretenduara kanë qenë thjeshtë të trilluara.

Lënda e prokurorisë bazohet dukshëm mbi dëshminë e **AZ**.

Mospërputhjet, kundërthëniet dhe kundërshtimet paraqiten gati pashmangshëm në çdo rast të kësaj natyre, ku përfshihen një numër dëshmitarësh të cilët kanë parë ngjarje të ndryshme në kohë të ndryshme ose ngjarjen e njëjtë në të njëjtën kohë. Dëshmia e dëshmitarëve shpesh ngjyroset nga faktorët duke përfshirë afërsinë e tyre me ngjarjen ose perceptimin e tyre, kuptimin dhe kujtesën e një ngjarjeje. Gabime të tilla nuk janë domosdo fatale për një lëndë.

Megjithatë, në lidhje me shumë gjëra të rëndësishme, të cilave i referohemi këtu, dëshmia e **AZ** është jo vetëm e paqëndrueshme por dukshëm e kundërshtuar nga dëshmitë tjera.

²¹⁵ Faqja 31 (anglisht) e procesverbalit të marrjes në pyetje të 7 korrikut 2011

Mospërputhjet dhe kundërthëniet e gjetura nga gjykata nuk janë mospërputhje që mund të jenë produkt i një kujtese të ndershme por jo perfekte, një vëzhgimi apo riprodhimi të ngjarjeve për të cilat ka dëshmuar.

Trupi gjykues gjen që shumë prej ngjarjeve të cilave i referohet **AZ** në ditarin e luftës janë të sakta. Për shembull, dëshmia e dhënë nga dëshmitari për datat kur ata thonë që janë ndaluar në burg në Kleçkë përputhet me shënimet në ditar, duke përfshirë informata në lidhje me identitetin e personave të tjerë të ndaluar gjatë periudhës së njëjtë. Megjithatë, asnjë nga ato dëshmi nuk mbështetë dëshminë e **AZ i cili**, ai thotë, i ka kryer veprat e pretenduara në aktakuzë.

Çdo konstatim i këtij Trupi Gjykues në lidhje me identitetin e kryerësve të krimeve nga aktakuza mbështetet dukshëm mbi dëshminë e **AZ**. Besueshmëria e tij prandaj është qendrore për lëndën e prokurorisë Pas konsiderimit të të gjitha dëshmive në këtë lëndë, Gjykata gjen që **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe si pasojë do të ishte e pasigurt që të mbështetet në dëshminë e tij.

Edhe po ta kishte gjetur Trupi Gjykues **AZ** si dëshmitar të besueshëm, kjo në vetvete nuk do të paraqiste mbështetjen e kërkuar nga ligji. Gjetja e mbetjeve mortore mund të mbështetë lëndën e Prokurorisë që krimet janë kryer. Duke supozuar që viktimat janë vvarë në mënyrë të paligjshme, në mungesë të ndonjë prove tjetër, gjetja e mbetjeve mortore nuk mbështet dëshminë e dhënë nga **AZ** në lidhje me identitetin e personave nga të cilët, ai thotë, janë kryer krimet. Është thjeshtë absurde të sugjerohet që pasi që janë gjetur mbetjet mortore aty ku thotë një dëshmitar kjo e vërteton dëshminë e dëshmitarit në lidhje me identitetin e kryerësve. Vërtetimi në lidhje me këtë mund të jepet vetëm nga dëshmi të pavarura dhe të besueshme. Kjo është e meta thelbësore në lëndën e prokurorisë.

G. VLERËSIMI I PROVAVE

Para se të merremi me vlerësimin e Trupit Gjykues në lidhje me dëshmitë materiale është e rëndësishme të thuhet diçka për frikësimin e dëshmitarëve.

Në një lëndë sikur kjo, çështjet e frikësimit real apo të perceptuar të dëshmitarëve fatkeqësisht pashmangshëm paraqiten.

Në këtë lëndë, asnjë dëshmi për frikësim të vërtetë të dëshmitarëve nuk është paraqitur përpara Gjykatës.

Kjo ka qenë një çështje e ndjeshme. Ka ngritur çështje që disa pjesë të komunitetit nuk janë të gatshme të i diskutojnë. Lufta për një Kosovë të pavarur ka prodhuar tensione politike, shoqërore dhe etnike që vazhdojnë deri sot. Dëshmitarit pritej të dëshmonin në një situatë të tillë. Ekzistonte një perceptim në mesin e disave që ata që dëshmojnë për prokurorinë janë tradhtarë. Ata dëshmitarë mund të kenë qenë të frikësuar nga brenda vet komuniteteve të tyre nëse do të zbulohesh identiteti i tyre. Të tjerët mund të jenë frikësuar nga hakmarrja fizike. Nuk është tërësisht e befasishme që disa dëshmitarë kanë zgjedhur që të tërheqin dëshmitë e tyre të mëparshme.

Dëshmitari Anonim I ishte një shembull i qartë. Ai kishte dhënë deklarata në polici më 22 nëntor 2010 dhe në prokurori më 2 nëntor 2011. Kur është paraqitur para gjykatës me video lidhje më 29 maj 2013 ai përnjëherë shpalli që më nuk dëshiron të mbetet anonim. Ai e informoi gjykatën për emrin e tij dhe më pas u paraqit para gjykatës për të dëshmuar. Statusi i tij ndërroi dhe ai më nuk ishte një dëshmitar “anonim”.

Ai i ka thënë gjykatës që ai ishte “shantazhuar” nga prokurori dhe i ishte nënshtruar formave të ndryshme të presionit. Megjithatë, i pyetur nga gjykata që të përshkruaj veprimet e prokurorit për të cilat është ankuar, gjykata gjeti që sjelljet e pretenduara të prokurorit siç i prezantoi

dëshmitari ishin shumë nën atë që mund të karakterizohet si presion i pavend ose ndikim. Në ato rrethana, gjykata nuk e ka pranuar dëshminë e tij në lidhje me këtë. Gjkata ka gjetur që dëshmia që ai e ka dhënë në nëntor 2010 dhe nëntor 2011 është dhënë vullnetarisht dhe pa asnjë presion të paligjshëm. Në të vërtetë, pasi që ka dhënë deklaratë në nëntor 2010 ai e ka kontaktuar prokurorin para se të jep një deklaratë të mëtejme në 2011. Këto nuk janë veprimet e një dëshmitari të cilit i është bërë presion që të dëshmojë. Pasi që ka konsideruar dëshminë e tij në tërësi Trupi Gjykes ka vendosur që të pranojë si prova deklaratat e tij të mëparshme.

Një shembull tjetër është Dëshmitari Anonim M. Ai i ka dhënë deklaratë policisë më 30 mars 2011 dhe prokurorit më 20 maj 2011. Ai ka dëshmuar përpara kësaj gjykate më 21 maj 2013.

Dëshmia që ai e ka dhënë në polici dhe para prokurorit ka qenë e qëndrueshme sa i përket të gjitha aspekteve materiale.

Kur ka dëshmuar Dëshmitari Anonim M përpara kësaj gjykate ai e ka konfirmuar që të dy deklaratat i janë lexuar në shqip para se që ai i ka nënshkruar ato. Megjithatë, ai ka thënë që ka qenë “në frikë” nga Eulex kur i ka nënshkruar ato. Duke iu referuar deklaratës së 30 marsit 2011, frika e tij duket se është manifestuar si rezultat i asaj që ai është vendosur në një veturë të Eulex dhe është çuar rreth 15 km larg shtëpisë së tij. Ai nuk ka pretenduar që është kërcënuar ose frikësuar nga policët e Eulex ose, në të vërtetë, më pas nga prokuroria. Kur është intervistuar më 20 maj 2011, duke iu referuar deklaratës së tij të 30 marsit 2011, ai ka thënë “i konfirmoj të gjitha”.

Në të dy rastet Dëshmitari Anonim M është udhëzuar për pasojat e dëshmisë së rrejshme. Në përfundim të dëshmisë së tij para prokurorit dëshmitari e ka nënshkruar një deklaratë që thotë, inter alia, “e nënshkruaj pa detyrim”.

Në deklaratën e tij të parë ai ka thënë që nuk dëshiron të dëshmojë në gjykatë.

Në disa aspekte të rëndësishme materiale dëshmia e tij përpara gjykatës e ka kundërshtuar atë që ai e ka deklaruar më parë.

Dëshmia e Dëshmitarit Anonim M para kësaj gjykate ka qenë selektive. Ai dukej se kishte kujtesë të mirë për disa ngjarje. Megjithatë, dëshmia e tij përpara kësaj gjykate e ka kundërshtuar dëshminë e tij të mëparshme mbi disa çështje të rëndësishme. Në të vërtetë, dëshmia e tij përpara kësaj gjykate ka qenë në disa raste kontradiktore. Pasi që ka konsideruar në tërësi dëshminë e tij, Gjykata ka vendosur që të pranojë si më të besueshme dëshminë që ai ia ka dhënë policisë më 30 mars 2011 dhe prokurorit më 20 maj 2011.

Një shembull i mëtejshëm është Dëshmitari Anonim C. Ai i ka dhënë deklaratë prokurorit më 21 shtator 2010. Ai ka dëshmuar përpara kësaj gjykate më 30 prill 2013.

Kur Dëshmitari Anonim C ka dëshmuar përpara kësaj gjykate ai në mënyrë të qëndrueshme ka deklaruar që nuk është në gjendje të i kujtojë disa ngjarje të rëndësishme për të cilat kishte dëshmuar përpara prokurorit në shtator 2010.

Dëshmia e Dëshmitarit Anonim C para kësaj gjykate ka qenë selektive. Ai dukej se kishte kujtesë të mirë për disa ngjarje. Megjithatë, dëshmia e tij përpara kësaj gjykate kundërshtoi dëshminë e tij të mëhershme mbi çështje të rëndësishme në këtë lëndë. Në të vërtetë, dëshmia e tij përpara kësaj gjykate ka qenë, në disa raste, kontradiktore. Pasi që ka konsideruar dëshminë e tij në tërësi, Gjykata ka zgjedhur që të pranojë si dëshmi më të besueshme dëshminë e tij përpara prokurorit në shtator 2010.

Edhe një shembull tjetër ishte Dëshmitari Anonim B. Ai i ka dhënë deklaratë policisë më 4 dhjetor 2010. Ai ka dëshmuar në këtë gjykatë më 28 maj 2013.

Dëshmia e Dëshmitarit Anonim B përpara kësaj gjykate ka kundërshtuar dëshminë e tij të mëparshme mbi çështje të rëndësishme në këtë lëndë. Pasi që ka konsideruar dëshminë e tij

në tërësi, duke përfshirë sjelljet e dëshmitarit në gjykatë, Trupi Gjykues ka zgjedhur që të pranojë si më të besueshme dëshminë që ai ia ka dhënë policisë në dhjetor 2010.

Një shembull tjetër ishte **GZ** Ajo është marrë në pyetje nga prokurori më 20 prill 2010. Ajo ka dëshmuar përpara kësaj gjykate më 14 dhe 15 maj 2013.

Kur ka dëshmuar përpara kësaj gjykate ajo në mënyrë qëndrueshme ka deklaruar që ajo nuk mund të kujtojë disa ngjarje të rëndësishme për të cilat kishte dëshmuar në prokurori në prill 2010. Në të vërtetë, kujtesa e saj mbi ngjarjet mund të përshkruhet, në rastin më të mirë, si “selektive”. Pjesërisht dukej se ishte për shkak të armiqësisë së saj të qartë ndaj prokurorit të cilin e fajësonte për vdekjen e burrit të saj.

Duke iu referuar një deklaratë që e ka dhënë në prill 2010 ajo ka deklaruar që **AZ** e ka udhëzuar atë se çfarë të thotë. Ajo ka thënë “A i ka sugjeruar të gjitha. Unë nuk kam ditur asgjë për këtë.”²¹⁶

Sa i përket secilit prej dëshmitarëve dëshmia e të cilëve përpara këtij Trupi Gjykues është kundërshtuar nga dëshmitë e tyre të mëparshme Trupi Gjykues ka vendosur që të pranojë si prova deklaratat e mëparshme.

a. Struktura e UÇK-së 1999

BZ ka dëshmuar që nga qershori 1998 ai ka qenë përgjegjës për zhvillimin e kapacitetit profesional të UÇK-së në strukturë të drejtorisë. Nga prilli deri në nëntor 1998 ai ka qenë drejtori operativ dhe nga nëntori 1998 deri në prill 1999 ai ka qenë shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në mes të janarit dhe prillit 1999 Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ka qenë në fshatin Divjakë.

²¹⁶ Procesverbali i 14 majit 2013

Ai ka dëshmuar që Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Divjakë përbëhej prej tri shtëpive. Në shtëpinë e parë ishte vendosur JK i cili ishte njëri prej dy Zëvendës Komandantëve. Ai ka qenë përgjegjës për aktivitetet politike. Zëvendës Komandanti tjetër, **SB**, ka qenë përgjegjës për çështjet operative. Ai kohë pas kohe e ka vizituar Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në Divjakë. Në atë ndërtesë gjithashtu ishin të vendosura tri drejtori: Administrata dhe Personeli; marrëdhëniet ushtarake dhe civile dhe drejtoria politike. **SD** gjithashtu e ka pasur një zyrë në atë ndërtesë. Ai ka dëshmuar që ai i ka raportuar drejtpërsëdrejti AS i cili në atë kohë ka qenë Komandanti i UÇK-së.

Në shtëpinë e dytë ishin të vendosur **BZ** dhe stafi tjetër që përbënte pjesë të departamentit të operacioneve. Gjithashtu, në atë ndërtesë ishte e vendosur drejtoria për komunikime.

Në shtëpinë e tretë ishte e vendosur Policia Ushtarake. Ata ishin përgjegjës për sigurinë e Shtabit të Përgjithshëm.

Ai ka dëshmuar që nga janari deri në prill 1999 Drejtori i Drejtorisë së Policisë Ushtarake ishte **FL**. Në deklaratën e tij ai ka thënë që **FL** ka qenë *“shef i tërë policisë ushtarake të UÇK-së”*.²¹⁷ Në dëshminë e tij përpara kësaj gjykate, duke iu referuar asaj deklaratë, ai ka thënë *“Kur e kam dhënë deklaratën time në këtë datë unë e kam shpjeguar që ai ka qenë përgjegjës për pjesën profesionale”*.

Ai ka thënë që detyrat e drejtorit të policisë ushtarake kanë qenë që të *“trajnojë policinë, të lëshojë rregullore dhe të inspektojë punën.”*

Ai ka dëshmuar që Drejtori i Drejtorisë së Policisë Ushtarake nuk ka pasur funksion ekzekutiv.

²¹⁷ Deklarata e 5 prillit 2011

Lidhur me këtë ai është pyetur nga prokurori nëse Drejtori ka mundur të i jep urdhra policisë ushtarake. Në përgjigje ai ka thënë “vetëm në lidhje me pjesën profesionale të batalionit të Shtabit në lidhje me çështje të sigurisë”. Ai e ka elaboruar këtë duke thënë “Kur them çështje sigurie të Shtabit të Përgjithshëm, është që të sigurohet Shtabi i lokaleve dhe të përcillen anëtarët nga komanda qendrore në lokacione të ndryshme.”

Duke iu referuar “pjesës profesionale” prokurori e ka pyetur atë “çfarë pjesë tjera kanë ekzistuar?” Në përgjigje ai ka deklaruar “Sikur policia ushtarake dhe Shtabi ka pasur polici tjetër ushtarake në zonën operative.” Ai më tej ka deklaruar “Kur i referohem çështjeve profesionale siç i kam përmendur më parë, ata kanë lëshuar rregullore dhe trajnime dhe inspektime...Inspektimin e policisë ushtarake ka mundur ta bëj në zonat ku ka shkuar.”

Avokati i FL i ka bërë një sërë pyetjesh atij në lidhje me strukturën e UÇK-së në atë kohë:

KK: A pajtohesh që njëri prej qëllimeve i të gjitha ushtrive është që të ketë linja të qarta komanduese?

BZ: Po.

KK: Çdo ushtri dëshiron të shmangë komandë të dyfishtë?

BZ: Po.

KK: Në organizimin e UÇK-së, janë caktuar zona të ndryshme, saktë?

BZ: Po.

KK: Dhe këto zona kanë qenë në kohë të ndryshme?

BZ: Po.

KK: Zona e Drenicës ka qenë e para që e ka organizuar vetveten?

BZ: Po.

KK: Nën propozimet dhe instruksionet tuaja qëllimi ka qenë që siç piqej dhe organizohej UÇK-ja do të kishte një strukturë për secilën zonë?

BZ: Po.

KK: Unë nuk do të flas për nivelet organizative por në lejoni të ju pyes për nivelin e Brigadës dhe do të shkoj përpjetë. Komandanti i Brigadës ka qenë vartës i komandantit të zonës?

BZ: Po.

KK: Pra për shembull kur flasim për Brigadën 121, **HS** ka qenë vartës i komandantit të zonës për zonën e Pashtrikut, saktë?

BZ: Po.

KK: Dhe çdo Brigadë duke përfshirë Brigadën 121 e ka pasur një togë që merrej me policinë ushtarake?

BZ: Po.

KK: Komandanti i policisë ushtarake në nivel të Brigadës ka qenë vartës i komandantit të brigadës?

BZ: Po. Drejtpërsëdrejti.

KK: Prandaj një komandant Brigade i policisë ushtarake ka qenë vartës i drejtpërdrejtë i komandantit të Brigadës së Zonës dhe dëshmitari ka thënë po. Saktë?

BZ: Po. Është e vërtetë.

KK: Në nivel të zonës, në të njëjtën mënyrë siç ka Shtabi staf, ka pasur oficerë të stafit në nivel të zonës?

BZ: Po.

KK: Këta oficerë të stafit në nivel të zonës, roli i tyre është që të merren me mbështetje dhe administratë dhe logjistikë për komandantin e zonës?

BZ: Po.

...

KK: Oficerët e nivelit të zonës nuk kanë pasur kontroll operativ në rolin e tyre, ata nuk mund të japin urdhra, a punojnë ata drejtpërdrejtë me komandantin e zonës?

BZ: Po. Komandanti i zonës është personi kryesor përgjegjës dhe organizimi i sistemit është i njëjtë si në shtabin e përgjithshëm.

KK: Duke iu kthyer periudhës në fillimit të 1999 a ju kujtohet që **FL** i ka kryer përgjegjësitë e tij si oficer stafi i drejtorisë së policisë ushtarake në Lladrovc, a të kujtohet?

BZ: Po. I bazuar në Lladrovc.

...

KK: ...nuk ka asnjë dyshim a kam të drejtë që vetëm komandanti i Brigadës mund të i jep urdhër komandantit të policisë ushtarake?

BZ: Të gjitha njësitë që kanë qenë i kanë raportuar komandës.

KK: Pra një oficer stafi nuk ka mundur të jep urdhra në nivel të brigadës?

BZ: Po. Kjo është e vërtetë pa lejen e komandantit nuk mundet.

KK: Puna e **FL** si shef i drejtorisë së policisë ushtarake ka qenë që të ndihmojë reorganizimin e policisë ushtarake të UÇK-së?

BZ: Po.

KK: Për shembull duke lëshuar rregullore?

BZ: Po.

KK: Që janë aprovuar nga stafi i përgjithshëm?

BZ: Po.

KK: Aprovimi i stafit të përgjithshëm është përcjellur në të njëjtën mënyrë?

BZ: Po.

KK: Një brengë ka qenë njëtrajtshmëria e uniformave?

BZ: Kjo është rregulluar me politikat se si duhej të dukeshin ato.

KK: Një prej detyrave ka qenë distinktivët identifikues?

BZ: Ato të gjitha janë rregulluar me rregullore; letërnjoftimet, uniformat; të gjitha janë rregulluar.

KK: Në rregullore këto janë mostra të detyrave të oficerit të stafit **FL** në drejtorinë e policisë ushtarake a është kështu?

BZ: Rregulloret janë shkruar nga vet policia ushtarake në lidhje me sjelljet e tyre dhe kjo është shkruar.

KK: **FL** nuk ka mundur ta shmangë zinxhirin komandues si oficer stafi?

BZ: Jo, nuk ka mundur.

KK: Ai nuk ka mundur të i jep urdhër një polici ushtarak të Brigadës apo ka mundur?

BZ: Ai ka mundur të inspektojë por jo të urdhërojë pa leje të komandantit.

Ai ka dëshmuar që në nëntor ose dhjetor 1998 është bërë një ristrukturim i Shtabit të UÇK-së. Ai ka thënë që para kësaj **FL** ka qenë komandant i brigadës 121. Zëvendësi i tij në atë kohë ka qenë **HS**. Gjatë ristrukturimit, **FL** është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Policisë Ushtarake.

ii. Ekzistenca e një burgu të UÇK-së në fshatin Kleçkë

Veprimet e ngarkuara në aktakuzë pretendohet të kenë ndodhur në ose në lidhje me një burg të UÇK-së, gjithashtu të përshkruar si qendër ndalimi, të themeluar në fshatin Kleçkë, kur civilët shqiptarë të dyshuar për bashkëpunim me regjimin serb, civilët serbë dhe policët dhe ushtarakët sertë janë ndaluar. Burgu i Kleçkës gjithashtu ka shërbyer si qendër ndalimi për ushtarët e UÇK-së të hetuar ose të dënuar për vepra disiplinore.

Komanda e brigadës 121, gjithashtu e njohur si Brigada “Kumanova”²¹⁸ ishte e vendosur në Kleçkë. I akuzuari **BL** ka deklaruar që ka qenë ushtar në Brigadën 121 nga fillimi deri në fund të konfliktit, dhe ka qenë ushtar në fshatin Panorc. Ai ka dëshmuar që komanda e Brigadës 121 ka qenë e vendosur në Kleçkë.²¹⁹

I akuzuari **SS1** ka dëshmuar që shtëpia e tij në Kleçkë është përdorur nga UÇK-ja në 1998. Sidoqoftë, gjatë 1998 Kleçka është shkatërruar nga forcat serbe.

Nga janari 1999 deri në qershor 1999 **SS1** ka qenë i caktuar në Brigadën 121 në Luzhnicë. Megjithatë, ai ka dëshmuar që në prill 1999 komandanti i Brigadës 121 ka qenë i vendosur në Kleçkë.²²⁰

I akuzuari **BS** ka dëshmuar që edhe ai ka qenë pjesëtar i brigadës 121. Ai ka dëshmuar që shtabi i Brigadës 121 ka qenë i vendosur në Kleçkë.²²¹

²¹⁸ QK, 14.06.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, f.3, PSRK dosja C; IA, supra, f.3; NH, 02.12.2010, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, f.3, PSRK dosja C; dëshmitari G, supra

²¹⁹ BL, 11.05.2011, PSRK procesverbali i dëgjimit të të dyshuarit në hetime, f.3, dosja O e PSRK.

²²⁰ SSH, 11.05.2011, PSRK procesverbali i dëgjimit të të dyshuarit në hetime, f. 3, 4, PSRK dosja O.

²²¹ BSH, 12.05.2011, PSRK procesverbali i dëgjimit të të dyshuarit në hetime, f. 4, PSRK dosja O.

I akuzuari **AK** ka dëshmuar që në 1999, derisa është lënduar më 18 prill 1999, ai kohë pas kohe ka shkuar në Kleçkë kur këtë e ka kërkuar shtabi ose komanda e Brigadës 121. Nga deklarata e të akuzuarit **AK** nuk është tërësisht e qartë nëse shtabi i përgjithshëm i UÇK-së ka qenë gjithashtu i bazuar në Kleçkë apo vetëm shtabi i Brigadës 121.²²²

Dëshmitarët tjerë, duke përfshirë Dëshmitarin Anonim **M**²²³, **BZ**²²⁴, **SHTH**²²⁵, **FK**²²⁶, **AQ**²²⁷, **AO**²²⁸ kanë dëshmuar që ose shtabi i Brigadës 121 ose Brigada 121 kanë qenë të vendosur në Kleçkë

BK ka dëshmuar që në 1999 ai ka qenë në bazën e UÇK-së në Kleçkë.

Ish pjesëtari i UÇK-së **IZ** ka dëshmuar që ai nuk ka qenë në Kleçkë por ka dëgjuar që një bazë e UÇK-së ka qenë e vendosur aty.²²⁹

BZ ka dëshmuar që shtabi i Brigadës 121 kohë pas kohe ka lëvizur për në Berishë.²³⁰

Disa dëshmitarë kanë cekur që shtabi i përgjithshëm i UÇK-së ka qenë i vendosur në fshatin Divjakë²³¹ afër Kleçkës. Sipas BZ nga janari 1999 deri në mes të prillit 1999 ai ka qenë shef i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së. Ai ka dëshmuar që shtabi ka qenë në fshatin Divjakë deri në prill 1999 dhe pastaj ka lëvizur për në Devetak, afër Shtimes.

²²² AK, 14.04.2011, procesverbali i seancës mbi paraburgim, dosja e Gjykatës GJPP dosja 3.

²²³ Dëshmitari Anonim M, 20.05.2011, PSRK procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në hetime, f. 3, Dosja D e PSRK.

²²⁴ BZ, 23.05.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, PSRK dosja D.

²²⁵ SHTH 25.05.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, PSRK dosja D.

²²⁶ FK 31.05.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, PSRK dosja D.

²²⁷ AQ, supra

²²⁸ AO, supra

²²⁹ IZ, 19.05.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, PSRK dosja D.

²³⁰ BZ, supra

²³¹ Është vërejtur që shtabi i përgjithshëm i UÇK-së gjithashtu mund të shtrihet në lokacione tjera. Dëshmitari W e ka përshkruar keqtrajtimin në një lokacion tjetër, ku ai ka thënë që ka qenë shtabi i UÇK-së; Dëshmitari W, 16.06.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, PSRK dosja D. BZ ka dëshmuar që deri në prill 1999 shtabi i përgjithshëm ka qenë në Divjakë dhe pastaj ka lëvizur për në Devetak, afër Shtimes: BZ, supra shënim 42. f.2.

NM ka dëshmuar që në fund të 1998 ai është emëruar në shtabin e UÇK-së në Divjakë. Ai ka dëshmuar që **BZ** ka qenë shef i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së. Departamenti ligjor ishte i bazuar në Divjakë. Atij i kujtohej që **SD** dhe Dëshmitari E kanë punuar aty.²³²

AH, i cili i është bashkëngjitur policisë ushtarake të UÇK-së në fund të dhjetori 1998 ose në fillim të janarit 1999 kujtoi që **SD** ka qenë gjykatës në gjykatën ushtarake dhe në një rast ai e ka përcjellur një ushtarë të arrestuar te **SD**²³³

SB e ka njohur **SD** si gjykatës, i cili ia ka dhënë atij disa formularë në një takim i cili ka ndodhur ose në Kleçkë ose në Divjakë.²³⁴

SD ka deklaruar që në fund të 1998 ai i ka marrë përsipër detyrat e Shefit të departamentit ligjor në UÇK, në fshatin Divjakë. Ai ka shërbyer si gjykatësi i vetëm në zonën e Divjakës deri në prill 1999. Janë mbajtur gjykime ushtarake, gjithashtu me pjesëmarrjen e prokurorit **HK**, dhe një avokati mbrojtës sipas detyrës zyrtare, Dëshmitarit E²³⁵. Deklarata e Dëshmitarit E konfirmon që ai ka punuar me **SD** në Divjakë, afër Kleçkës gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ai i ka ndihmuar **SD** në përpilimin e dokumenteve juridike dhe, si është zhvilluar me praktikë, ka vepruar në mbrojtje të ushtarëve të akuzuar të UÇK-së²³⁶. Deklarata e **HK** e konfirmon që ai ka qenë me **SD** nga Dhjetori 1998 deri në mars 1999 në Divjakë, afër Kleçkës, por ata nuk kanë kryer asnjë punë²³⁷.

SD e ka konfirmuar që në Kleçkë ka qenë një burg. Ai ka thënë që Komandant M ka qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e përditshme të burgut.

²³² NM, 05.04.2011, PSRK procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit në hetime, PSRK dosja C.

²³³ AH, 27.05.2011, PSRK procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit në hetime, PSRK dosja D.

²³⁴ SHB, 27.05.2011, PSRK procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit në hetime, PSRK dosja D.

²³⁵ Dëshmitari A, 23.09.2010. PSRK procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në hetime, PSRK dosja D.

²³⁶ Dëshmitari E, supra

²³⁷ HK, 20.10.2010, PSRK procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në hetime, PSRK dosja C.

Nga deklarata e **HK** rrjedh që afër Kleçkës ka qenë një burg ku ai i ka parë njerëzit që mbaheshin ndaluar²³⁸.

Befasisht, **BZ**, i cili nga nëntori 1998 deri në prill 1999 ka qenë shef i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, nuk e ka ditur që në Kleçkë ka qenë një burg i UÇK-së²³⁹. Në dëshminë e tij ai i është referuar **BK** dhe dy të burgosurve serbë²⁴⁰, njëri prej të cilëve kishte vdekur. Ai ka menduar që ata kanë qenë të ndaluar në Lladrovc.

Disa dëshmitarë në deklaratat e tyre të mëparshme kanë dëshmuar që ata nuk kanë qenë në dijeni për ekzistimin e një burgu në Kleçkë ose nuk kanë parë asnjë të burgosur aty.²⁴¹

Disa prej të akuzuarve kanë dëshmuar që ata kanë qëndruar në lokacione tjera dhe nuk kanë qenë në dijeni për një burg në Kleçkë. Disa prej të Akuzuarve kanë shkuar në Kleçkë në disa raste por nuk kanë parë asnjë të burgosur atje.

Më tej, **SD** ka deklaruar që ai shpesh e ka vizituar burgun në Kleçkë, menjëherë jashtë Divjakës. Sipas **SD**, në burg të Kleçkës nuk ka pasur shumë të burgosur. Burgjet e improvizuara ishin themeluar në pjesë tjera të zonës operative të Pashtrikut, në Lladroc dhe Kervasari.²⁴²

SD i është kujtuar rasti i **BK**, komandant brigade, i cili ishte dënuar me vdekje pasi që ishte dënuar për dezertim. Në fakt, **SD** ka dëshmuar që ai e ka dënuar **BK** me vdekje. **BK** është dërguar në burgun e Kleçkës në pritje të zbatimit të dënimit.²⁴³

²³⁸ Ibid.

²³⁹ Procesverbali i marrjes në pyetje më 5 qershor 2013

²⁴⁰ Dëshmitari anonim H dhe vëllai I tij

²⁴¹ Dëshmitari E, procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në hetime, f. 3, 4; Dëshmitari G, 11.01.2011, Policia e EULEX deklarata e dëshmitarit, f. 3, 4 PSRK dosja B; AQ, 07.06.2011, Policia e EULEX deklarata e dëshmitarit, f. 3, 5 PSRK dosja C, IA, 07.04.2011 Policia e EULEX deklarata e dëshmitarit, f. 3, PSRK dosja C, BZ, 05.04.2011 PSRK procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në hetime, f. 4, PSRK dosja C, DD, 04.04.2011, Policia e EULEX deklarata e dëshmitarit, f. 3, PSRK dosja C; BK, 08.01.2011, Policia e EULEX deklarata e dëshmitarit, f. 4, PSRK dosja C; AO, 30.11.2010, Policia e EULEX deklarata e dëshmitarit, f. 5, PSRK dosja C.

²⁴² SD, supra

²⁴³ Ibid, f. 1, 5, 6.

HK²⁴⁴, Dëshmitari **E**²⁴⁵ kanë pasur njohuri të niveleve të ndryshme për rastin e **BK**. Përderisa **BZ** ka ditur për rastin e **BK**, sa e ka ditur ai, **BK** është mbajtur në Lladroc²⁴⁶. **BK** ka konfirmuar që ai ka qenë komandant i Brigadës 123, dhe më vonë, në 15 ose 16 janar 1999 ai është arrestuar dhe ndaluar deri në 23 mars 1999. **BK**, megjithatë, ka refuzuar të specifikojë lokacionin ku është mbajtur in ndaluar²⁴⁷. Megjithatë, në dëshminë e tij Dëshmitari **V** ka dëshmuar që ai ka qenë pjesëtar i UÇK-së dhe që më vonë ai ishte akuzuar se ka qenë spiun. Ai ka dëshmuar që ai ka qenë i ndaluar në burgun në Kleçkë. Dëshmitari **V** ka dëshmuar që përderisa ka qenë i ndaluar në Kleçkë ai e ka parë **BK** së bashku me të burgosur të tjerë.²⁴⁸

Dëshmitari **F** gjithashtu ka dëshmuar që në mars 1999 ai është arrestuar nga ushtarët e UÇK-së dhe është çuar në një shtëpi në Kleçkë ku është mbajtur në një dhomë të cilën e ka përshkruar si një bodrum. Ai ka thënë që ai është ndaluar së bashku me pesë ose gjashtë të ndaluar të tjerë.²⁴⁹

Dëshmitari Anonim **B** ka dëshmuar që në fund të Prillit ose në fillim të Majit 1999 ai është ndaluar në bodrum të një shtëpie dy katëshe në Kleçkë. Pas pesë ose gjashtë ditëve Dëshmitari Anonim **B** është sjellur në katin e lartë dhe është marrë në pyetje. Disa ditë më vonë Dëshmitarit Anonim **B** i është dhënë një vendim gjyqësor me të cilin caktohej një periudhë 30 ditore ndalimi.²⁵⁰

Kur është marrë në pyetje nga Prokurori Special i EULEX Dëshmitarit Anonim **B** i është prezantuar një dokument, i datuar 17 maj 1999, me titull “Vendim mbi Ndalim”, i lëshuar nga gjykata ushtarake e UÇK-së. Vendimi në fjalë përmban emrin e gjykatësit hetues **PU**²⁵¹. **SD** ka dëshmuar që ai e ka përdorur emrin “**PU**” në vend të emrin të tij të vërtetë me qëllim që të fshehë identitetin e tij dhe të mbrohet nga hakmarrja e mundshme në të ardhmen. Më tej, **SD**

²⁴⁴ HK, supra

²⁴⁵ Dëshmitari **E**, supra

²⁴⁶ **BZ**, supra

²⁴⁷ **BK**, 04.10.2010, PSRK procesvesverballi i dëgjimit të dëshmitarit në hetime, f. 2, PSRK dosja B.

²⁴⁸ Dëshmitari **V**, 18.04.2011, intervista përpara Prokurorit Federal të Zvicrës, PSRK dosja C.

²⁴⁹ Dëshmitari **F**, 02.01.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, f. 3, PSRK dosja B.

²⁵⁰ Dëshmitari Anonim **B**, 04.12.2010, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, f. 4, 5, PSRK dosja B. Aktgjykimi 0096-09-EWC2/025 dosja F

²⁵¹ Ibid, f. 5

gjithashtu ka konfirmuar që nënshkrimi i tij është në vendimin në fjalë të gjykatës ushtarake të UÇK-së.²⁵²

Dëshmitari Anonim C ka dëshmuar që në mars 1999 në shtabin e UÇK-së në Llapushnik atij i është thënë që i biri i tij është duke u mbajtur në Kleçkë. Dëshmitari Anonim C ka ecur deri në Kleçkë dhe nga aty është çuar me veturë në Tërpezë ku është ndaluar. Pas gjashtë ditëve Dëshmitarin Anonim C e kanë kthyer në Kleçkë dhe e kanë vendosur në një bodrum. Dëshmitari Anonim C ka dëshmuar që ai i ka kaluar rreth shtatë ditë atje para se që të lirohej më 3 prill 1999.²⁵³

Dëshmitari Anonim M ka dëshmuar që ai është arrestuar në mars ose prill 1999 dhe është dërguar në Kleçkë. Përderisa ishte në Kleçkë Dëshmitari Anonim M është marrë në pyetje nga pjesëtarë të UÇK-së dhe gjithashtu nga një gjykatës para se të lirohej më.²⁵⁴

Dëshmitari O ka dëshmuar që në 1998 ose 1999, së bashku me Dëshmitarin P, Dëshmitarin Q dhe SS, të gjithë civilë, ai është ndaluar nga ushtarët e UÇK-së. Ai ka dëshmuar që ata fillimisht janë dërguar në Likoc ku janë mbajtur dy ditë para se të dërgohen në Kleçkë ku janë vendosur në një dhomë me disa burra të tjerë duke përfshirë BK. Dëshmitari O ka dëshmuar që ai është mbajtur në Kleçkë një muaj.²⁵⁵

Dëshmitarit Q nuk i kujtohej data e saktë kur është arrestuar por mendon që ka kjo ka ndodhur në dimër 1999. Ai ka thënë që ende kishte borë në tokë. Dëshmitari Q ka dëshmuar që ai është dërguar në Likoc ku është mbajtur dy ditë para se të dërgohet në Kleçkë. Dëshmitari Q ka deklaruar që përderisa ka qenë në Kleçkë ai ka qenë i ndaluar në një dhomë me disa burra të tjerë duke përfshirë BK.²⁵⁶

²⁵² Dëshmitari A, supra

²⁵³ Dëshmitari Anonim C, 21.09.2010 PSRK procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në hetime, f. 2, 3, 4, PSRK dosja B

²⁵⁴ Dëshmitari Anonim M, 30.03.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, PSRK dosja D.

²⁵⁵ Dëshmitari O, 24.05.2011 Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, f. 2, 3, 4 PSRK dosja D.

²⁵⁶ Dëshmitari Q, 26.05.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, f. 2, 3, 4 PSRK dosja D.

Dëshmitari P ka dëshmuar që, pasi që është arrestuar, ai është dërguar së bashku me Dëshmitarin O, Dëshmitarin Q dhe **SS** së pari në Likoc dhe pastaj në Kleçkë.

Dëshmitari P ka dëshmuar që gjatë asaj kohe ai nuk shihte mirë, por i kujtohet që në Kleçkë ata janë vendosur në një dhomë me të burgosur të tjerë, mund të kishin qenë dy.²⁵⁷ Dëshmitari O, Dëshmitari P dhe Dëshmitari Q kanë deklaruar që ata janë liruar në të njëjtën kohë dhe SS është liruar më vonë.

Trupi Gjykses gjen që në 1999 UÇK-ja e ka drejtuar një burg/qendër ndalimi në fshatin Kleçkë.

Trupi Gjykses gjen që burgu/qendra e ndalimit ka qenë një ndërtesë banimi me dy kate. Kati përdhes duket se ka qenë pjesërisht nëntokë me dy dhoma, ku janë ndaluar individët. Një tualet gjendej në oborr. Kati i parë është përdorur nga UÇK-ja për të i marrë në pyetje të ndaluarit.

Trupi Gjykses gjen që pjesëtarët e UÇK-së kanë qenë përgjegjës për të ruajtur burgun.

Më tej, Trupi Gjykses gjen që ndërtesa tjera në ose përreth fshatit Kleçkë janë përdorur për ndalimin e të burgosurve.

iii. Përgjegjësia për mbikëqyrjen e burgut të UÇK-së në fshatin Kleçkë

BZ ka dëshmuar që nga nëntori 1998 deri në prill 1999 ai ka qenë shefi i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së në fshatin Divjakë. Ai ka thënë që **FL** ka qenë Drejtor i Inspektoratit të Policisë Ushtrake²⁵⁸

²⁵⁷ Dëshmitari P, 25.05.2011, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, f. 2, 3, 4, PSRK dosja D.

²⁵⁸ Dëshmia e BZ e dhënë më 5 qersor 2013.

BZ ka thënë që funksioni i Inspektoratit të Policisë ka qenë që të trajnojë policinë, të inspektojë policinë dhe të lëshojë rregullore në lidhje me policinë. Ai ka dëshmuar që Drejtori i Inspektoratit nuk ka pasur funksion ekzekutiv. Ai ka thënë që shefi i Policisë Ushtarake ka mundur të i jep urdhra vetëm policisë ushtarake në lidhje me sigurinë e shtabit dhe përcjelljen e pjesëtarëve të shtabit. Megjithatë, ai ka pranuar që policia ushtarake mund të ketë bërë sigurimin në burg:

***XM:** Ata që fizikisht e kanë bërë sigurimin e lokaleve të burgut, ju thoni policia ushtarake, ky është një kuptim i gjerë. A ka qenë siguri i burgut pjesë e përgjegjësisë së batalionit?*

***BZ:** Nuk e di kush kanë qenë ata persona. **SD** ka qenë përgjegjës dhe shef i departamentit ligjor.*

***XM:** Nëse ju them që **SD** ka deklaruar që ata i përkasin batalionit, a pajtoheni me atë deklaratë?*

***BZ:** Nëse ai ka thënë ashtu, ai ka qenë përgjegjës dhe ai e di më mirë se çdokush tjetër.*

BZ ka dëshmuar që në 1998 UÇK-ja ka qenë duke u ristrukturuar në një ushtri profesionale sipas shembullit të NATO-s. Ai e ka përshkruar një strukturë komanduese të formës së caktuar me Komandantë të Brigadave si vartës të Komandantëve të Zonave. Ai ka thënë që komandanti i brigadës së Policisë Ushtarake ka qenë vartës i Komandantit të Zonës. Në nivel të zonës ka pasur oficerë të ndryshëm të shtabit. Duket që struktura e gradave në nivel të zonës ka qenë pasqyrim i asaj në nivel të shtabit²⁵⁹. Oficerët e shtabit në nivel të Zonës i kanë dhënë mbështetje logjistike dhe organizative komandantit të Zonës. Komanda operative ka qenë përgjegjësi e komandantëve të Zonave. Komandantët e Zonave i kanë raportuar Shtabit të Përgjithshëm.

BZ ka dëshmuar që **HS** ka qenë komandant i Brigadës 121. I ka qenë vartës i komandantit të Zonës së Pashtrikut. Ai ka thënë që vetëm komandantët e Brigadave kanë mundur të i japin urdhra Policisë Ushtarake. Ai ka thënë që oficerët e shtabit nuk kanë mundur të i japin urdhra policisë ushtarake në nivel brigade.

²⁵⁹ Dëshmia e Bislim Zyrapit e dhënë më 5 qershor 2013

Kur ka dëshmuar përpara kësaj Gjykate **SD** ka thënë që burgu në Kleçkë ka qenë nën kontrollin e përgjithshëm të Departamentit të Shërbimeve Juridike të UÇK-së. Ai ka thënë që koordinatori i burgut ka qenë përgjegjës për mbikëqyrjen e përditshme të burgut.

Ai ka dëshmuar që *“...askush nuk ka mundur të ndikojë në çështje të burgut. Kjo ka qenë kompetencë ekskluzive e Shërbimeve Juridike, do të thotë gjykatës..”*²⁶⁰

Megjithatë, kur është marrë në pyetje nga prokurori në 2010, duke iu referuar vizitave të tij në burg, ai ka thënë *“Natyrisht, kjo nuk do të thotë që unë kam mundur të kontrollojë se çfarë ka bërë policia atje. Pasi që unë në thelb kam qenë vetëm unë vetëm kam mundur të bëj aq sa kam mundur të bëj. Unë kam lëshuar rregullore, kam vizituar burgun, por atëherë të burgosurit kanë qenë nën kontrollin fizik të Policisë Ushtarake të UÇK-së”*.

Kur është intervistuar nga prokurori në shtator 2010 ai ka thënë që ai “rregullisht” e ka vizituar burgun në Kleçkë. Ndonjëherë e ka vizituar burgun dy herë në javë²⁶¹. Ndonjëherë e ka vizituar vetëm një herë në muaj. Kur ka dëshmuar përpara kësaj gjykate ai ka thënë që ai ka shkuar në burgun e Kleçkës “Kur e kam parë të nevojshme të interesohem ose inspektojë...”²⁶²

Ai më tej i ka përshkruar inspektimet “e rregullta”. Ai ka thënë që ka lëvizur në burg pa asnjë kufizim²⁶³.

Ai ka thënë që nuk i kujtohet ta ketë parë ndonjëherë **FL** në burg në Kleçkë²⁶⁴.

Ai ka thënë që të gjithë të burgosurit kanë qenë nën juridiksion të gjykatës.

²⁶⁰ Dëshmia e 23 prillit 2013

²⁶¹ Deklarata e 23 shtatorit 2010

²⁶² Dëshmia e 23 prillit 2013

²⁶³ Dëshmia e 24 prillit 2013

²⁶⁴ Dëshmia e 24 prillit 2013

Megjithatë, kur është intervistuar nga prokurori në 2010 ai ka thënë që disa civilë janë mbajtur në burg në Kleçkë. Ai ka thënë që ata kanë qenë “nën juridiksion të policisë”²⁶⁵.

Ai ka dëshmuar përpara kësaj gjykate që **AZ** e ka mbikëqyrur burgun. Ai ka thënë që **AZ** i ka raportuar atij në lidhje me të gjitha që kanë të bëjnë me burgun. Ai ka thënë që ka pasur bashkëpunim të “ngushtë” me **AZ**. Ai ka thënë që kur e ka vizituar burgun “vetëm koordinatori më ka dhënë informata”.

Ai ka dëshmuar përpara kësaj gjykate që “**FL** nuk ka pasur kompetencë që të i lirojë ata”. Ai ka vazhduar duke thënë “Megjithatë, është e mundur që koordinatori më ka thënë që pas konsultimeve me **FL** ai i ka liruar ata”.²⁶⁶

Megjithatë, kur është marrë në pyetje në shtator 2010, duke iu referuar lirimimit të vëllezërve K, ai ka thënë “L ka qenë i vetmi që ka pasur fuqi të tillë, pasi që ai ka qenë shefi i Policisë Ushtarake”. Ai ka thënë që ky ishte një keqkuptim dhe që ai i referohej personave të cilët kanë qenë në ndalim e jo të burgosurve që kanë qenë nën juridiksion të gjykatës.

Ai ka thënë që në rrethana të “jashtëzakonshme” koordinatori mund të i lirojë të burgosurit. Në rrethana tjera vetëm gjykatësi ose prokurori ka mundur të lirojë një të burgosur.

SD ka dëshmuar për lirimimin e dy të burgosurve serbë²⁶⁷. Ai ka thënë që është konsultuar me **BZ** e jo me **FL**.

Ai ka thënë që **FL** kurrë nuk e ka urdhëruar që të lirojë ndonjë të burgosur.

Më 3 prill 1999, Dëshmitari Anonim C është liruar nga “M” / Z, për të cilin Dëshmitari Anonim C ka menduar që ka qenë drejtor i burgut.²⁶⁸

²⁶⁵ Deklarata e 23 shtatorit 2010 paragrafi 15

²⁶⁶ Dëshmia e 23 prillit 2013

²⁶⁷ Dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij

Dëshmitari **V** ka dëshmuar që komandant dhe shef i burgut ka qenë “**M**”, me emrin **A**²⁶⁹, dhe **HS** dhe “**M**” kanë kontrolluar kush ka hy dhe ka dalë nga burgu.

Dëshmitari Anonim **B** ka dëshmuar²⁷⁰ që e ka takuar **AZ** në qendrën e ndalimit në fshatin Kleçkë. Ai ka menduar që **AZ** ka mbajtur pozitë me përgjegjësi brenda qendrës së ndalimit.

SD ka thënë që ai kurrë nuk ka dëgjuar pretendime që **FL** i ka keqtrajtuar të burgosurit²⁷¹.

SD ka thënë që askush kurrë nuk është ankuar te ai se ka qenë i keqtrajtuar²⁷². Natyrisht, kjo nuk do të thotë që të burgosurit nuk janë keqtrajtuar.

iv. Trajtimi i personave të ndaluar nga UÇK-ja në fshatin Kleçkë

Prokuroria ka pretenduar që të Akuzuarit **AK, NK1, NK2, BL, FI, NSH, SS1, SS2, BS**, si pjesëtarë të UÇK-së, në bashkëkryerje me **AZ** dhe ushtarë të tjerë të paidentifikuar të UÇK-së, kanë mbajtur një numër të padefinuar të civilëve shqiptarë dhe serbë dhe të burgosur ushtarak serbë në kushte çnjerëzore, lokale të papërshtatshme, në të ftohtë të tepruar, mungesë të kushteve higjienike, ushqim joadekuat dhe të burgosurit të lidhur me zinxhirë dhe/ose të nënshtruar rrahjeve të shpeshta.

a. Kushtet e ndalimit

Prokuroria ka pohuar që, përveç burgut/qendrës së ndalimit të përmendur këtu, ndërtesa tjera në fshatin Kleçkë janë përdorur nga UÇK-ja për të ndaluar të burgosur. Prokuroria thotë që

²⁶⁸ Dëshmitari Anonim C

²⁶⁹ Dëshmitari V, supra

²⁷⁰ Deklarata e 8 dhjetorit 2010

²⁷¹ Dëshmia e 24 prillit 2013

²⁷² Dëshmia e 24 prillit 2013

atyre lokaleve iu kanë munguar kushtet më thelbësore të jetesës, dhe që të burgosurit ndonjëherë janë mbajtur të lidhur me zinxhirë në to²⁷³.

Duke iu referuar burgut kryesor në Kleçkë, **AZ** ka dëshmuar që ai ishte një shtëpi banimi me dy kate. Ai ka thënë që ndërtesa ka qenë e re. Në mure ka pasur llaç. Shtëpia është ngrohur me dy kaldaja. Ai ka thënë *“ngrohja edhe në qelia ka qenë e mirë”*. Kati përdhes ka qenë pjesërisht nëntokë. Qasja në katin përdhes ka qenë në pjesën e përparme të ndërtesës. Kati përdhes përbëhej prej dy dhomave. Ai ka thënë që 4 ose 5 të burgosur janë mbajtur në një dhomë dhe 4 në dhomën tjetër. Ai ka thënë që janë furnizuar me dyshek sfungjeri. Ai ka thënë që kurrë nuk kanë qenë më shumë se 10 të burgosur përnjëherë. Ai ka thënë që të burgosurit nuk kanë qenë të lidhur me zinxhirë. Tualeti ishte përjashta. Të burgosurit e kanë pasur të lejuar të dalin përjashta 2 ose 3 herë në ditë. Ndonjëherë të burgosurit edhe janë lejuar të shkojnë në shtëpi natën dhe të kthehen në shtëpi. Jashtë shtëpisë ka qenë një bunar që ka mundur të përdoret nga të burgosurit. Të burgosurit kanë ngrënë ushqimin e njëjtë si rojet²⁷⁴.

Duke iu referuar kushteve në shtëpitë e djegura, **AZ** ka thënë kushtet nuk kanë qenë aq të mira. Ai ka thënë që ishte një kaldajë për ngrohje. Dyshemeja ishte e dheut – jo e betonit. Nuk kishte ujë të rrjedhshëm. Të burgosurve i jepeshin shishe me ujë. Atyre i është dhënë ushqimi i njëjtë si të burgosurve në qendrën kryesore të ndalimit. Nuk kishte dyshekë por kishte batanije. Ai ka thënë që të burgosurit nuk kanë qenë të lidhur me zinxhirë – përveç dy prej tyre. Ai ka thënë që zinxhirët e atyre të burgosurve ishin rreth dy metra të gjatë. Atij nuk i kujtohej identiteti i atyre të burgosurve. Ai ka thënë që të burgosurit janë lejuar që të dalin përjashta²⁷⁵.

UK, i cili ka thënë që ka qenë ushtar i UÇK-së, ka dëshmuar që ai ka qenë në Kleçkë në maj/qershor 1999. Në një rast ai ka kaluar pranë qendrës së ndalimit dhe ka shikuar në dritare. Ai ka përkthyer që ka parë rreth 30 të burgosur brenda. Ata të gjithë ishin në bodrum. Ai ka thënë që nga jashtë dukej si një kat përdhes por në të vërtetë ishte bodrum. Policia ushtarake

²⁷³ Aktakuza, f. 23

²⁷⁴ Procesverbali i marrjes në pyetje më 9 shkurt 2010

²⁷⁵ Procesverbali i marrjes në pyetje i 9 shkurtit 2010

ka qëndruar në katin e parë. **AZ** ka dëshmuar që jo më shumë se 10 të burgosur janë mbajtur në burgun kryesor përnjëherë.

Dëshmitari Anonim B ka dëshmuar që në maj 1999 ai është ndaluar në Kleçkë, në një shtëpi dy katëshe. Kati i sipërm dukej se përdorej nga policia ushtarake e UÇK-së. B është vendosur në një prej dy dhomave në bodrum. B ka mundur të del në oborr, ku është takuar me dy ushtarë tjerë të ndaluar të UÇK-së dhe ka mundur të flas me ta. B më vonë ka lëvizur në të njëjtën qeli me dy të ndaluarit e tjerë. B i ka përshkruar kushtet si të mira. Ata i kanë pasur tre shtretër metali, kanë mundur të hanë ushqim dhe të rruhen dhe të lahen rregullisht. Dera e qelisë ka qëndruar e hapur gjatë ditës dhe ata kanë mundur të rrinë përjashta në oborr. Gjatë natës dera është mbajtur e mbyllur me çelës.²⁷⁶

Dëshmitari Anonim M, një civil, ka dëshmuar që në mars ose prill 1999 ai është arrestuar nga UÇK-ja dhe është çuar në një shtëpi dy katëshe në Kleçkë. Ai ka thënë që ai është mbajtur i ndaluar në një prej dy dhomave në bodrum të shtëpisë. Bodrumi ishte i errët, nuk kishte dysheme, vetëm dhe, dhe ujë dhe baltë në tokë.

Dëshmitari F, Dëshmitari O, Dëshmitari P dhe Dëshmitari Q, të cilët kanë dëshmuar që ishin të ndaluar në burg në Fshatin Kleçkë, kanë thënë që atyre i janë dhënë dyshekë sfungjeri për të fjetur dhe gjithashtu batanije²⁷⁷ Asnjëri prej këtyre dëshmitarëve nuk ka dëshmuar të ketë qenë privuar nga ushqimi.

Dëshmitari Anonim C ka dëshmuar që atyre i është dhënë shumë pak ushqim. Ai ka thënë që atyre i është dhënë ushqim rreth çdo 24 orë.²⁷⁸ Dëshmitari D, Dëshmitari F dhe Dëshmitari

²⁷⁶ Dëshmitari Anonim B, supra

²⁷⁷ Dëshmitari F, supra; Dëshmitari O, supra shënim 80; Dëshmitari P, supra; Dëshmitari Q, supra. Dëshmitari Anonim B ka dëshmuar që janë furnizuar me krevate metali për të fjetur.

²⁷⁸ Dëshmitari Anonim C, supra

Anonim B kanë thënë që ushqimi iu është dhënë më shpesh.²⁷⁹ Dëshmitari D ka thënë që ata janë ushqyer dy herë në ditë.

Dëshmitari D, Dëshmitari O, Dëshmitari P, Dëshmitari Q dhe Dëshmitari F kanë dëshmuar që i vetmi tualet ka qenë në oborrin e shtëpisë ku janë ndaluar. Asnjëri prej dëshmitarëve nuk ka thënë që ata ishin parandaluar ose limituar në përdorimin e tualetit.²⁸⁰ Dëshmitarët tjerë kanë dëshmuar njëjtë.

Dëshmitari F ka dëshmuar që ata janë mbajtur në një dhomë me derë të mbyllur por jo të mbyllur me çelës gjatë ditës. Është mbyllur me çelës gjatë natës. Kur të ndaluarit kanë pasur nevojë të shkojnë të tualet, ata kanë trokitur në derë dhe janë lejuar të shkojnë në tualet përjashta shtëpisë.²⁸¹ Dëshmitari Q e ka përshkruar tualetin si një vrimë në tokë, me copa druri anash dhe përmbi.

Dëshmitari D ka dëshmuar që në mëngjes janë furnizuar me një kovë uji për të u larë. Ai ka thënë që gjithashtu kanë mundur të djegin ca dru brenda dhomës.²⁸²

Dëshmitari Anonim C ka thënë që gjatë ndalimit të tij në Kleçkë që ka zgjatur rreth shtatë ditë ai kurrë nuk është lejuar që të largohet nga qelia e tij.²⁸³ Megjithatë, kur është marrë në pyetje nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në shkurt 2011 ai është pyetur nëse kishte ujë të rrjedhshëm në qeli. Ai është përgjigjur “Ndoshta kjo ka qenë në Tërpezë por jo në Kleçkë, nuk ka pasur ujë të rrjedhshëm, në asnjë mënyrë”²⁸⁴

²⁷⁹ Dëshmitari D, 18.01.2011, PSRK procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit në hetime, PSRK dosja C dhe 24.12.2010 Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, PSRK dosja C; Dëshmitari F, supra; Dëshmitari Anonim B, supra.

²⁸⁰ Dëshmitari D, ibid. Dëshmitari O, supra; Dëshmitari P, supra; Dëshmitari Q, supra; Dëshmitari F, supra

²⁸¹ Dëshmitari F, supra

²⁸² Ibid.

²⁸³ Dëshmitari Anonim C, supra

²⁸⁴ Procesverbali i marrjes në pyetje 22 shkurt 2011

Dëshmitari **P** dhe Dëshmitari **Q** kanë dëshmuar që dyshemeja e dhomës ku kanë qenë të ndaluar ka qenë e mbuluar me dërrasë druri²⁸⁵.

Dëshmitari **P** ka dëshmuar që dhomës i vinte era pleh kafshësh²⁸⁶. Asnjë dëshmitar tjetër nuk e ka përmendur erën. Dëshmitari **F** ka thënë që në dhomën ai ka qenë i ndaluar nuk ka qenë asnjë dritare. Dëshmitari **O**, Dëshmitari **Q**, Dëshmitari **P**, Dëshmitari **V**, dhe **UK** i janë referuar në dëshmitë e tyre një apo më shumë dritareve.²⁸⁷

Dëshmitari **V** ka dëshmuar që atij i është lejuar një vizitë nga babai i tij përderisa ka qenë i ndaluar në Kleçkë.²⁸⁸

NR ka qenë një gazetarë i agjencisë Tanjug. Ai është arrestuar nga ushtarët e UÇK-së në tetor 1998. Ai ka menduar që eventualisht është dërguar në Kleçkë. Ai është mbajtur i ndaluar deri në fund të nëntorit 1998. Ai ka thënë që ka dëgjuar persona të tjerë në veturën në të cilën ai ka udhëtuar duke iu referuar Kleçkës²⁸⁹.

Duke iu referuar gazetarëve, **GK** ka deklaruar që ata janë dërguar në **SH**. Ai ka thënë që i ka vendosur ata në dhoma ndaras ku kanë qëndruar për dy muaj. Duket që ai ka dëshmuar që, gjatë kohës së ndalimit të tyre, ata kanë mbetur në Shalë.²⁹⁰

Mbi supozimin që **NR** është ndaluar në Kleçkë, ai i ka përshkruar kushtet në atë kohë. Ai ka thënë që ka qenë shumë ftohtë dhe që nuk ka pasur ngrohje në dhomë. Ai ka thënë që ai nuk ka qenë i lejuar të del nga dhoma për të shkuar në tualet dhe e ka përdorur një kovë në dhomë. Ai ka thënë që i kanë dhënë ushqim tri herë në ditë²⁹¹.

²⁸⁵ Dëshmitari P, supra; Dëshmitari Q, supra

²⁸⁶ Dëshmitari P, supra

²⁸⁷ Dëshmitari O, supra; Dëshmitari Q, supra; Dëshmitari P, supra; Dëshmitari V, supra; Dëshmitari Anonim I, 22.11.2010, Policia e EULEX deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit, PSRK dosja B.

²⁸⁸ Dëshmitari V, ibid, f. 7.

²⁸⁹ NR, 12 janar 2012

²⁹⁰ GK, 9 maj 2012

²⁹¹ NR, 12 janar 2012

Asnjë prej dëshmitarëve nuk ka dëshmuar të ketë qenë i lidhur me zinxhirë përderisa kanë qenë të ndaluar apo që kanë parë të burgosur të tjerë të lidhur me zinxhirë.

Trupi gjykues ka gjetur kundërthënie në dëshmitë e disa dëshmitarëve në lidhje me kushtet në ndërtesën në të cilën janë ndaluar dhe kushtet në të cilat janë mbajtur. Megjithatë, këto kundërthënie me gjasë shpjegohen me faktin që disa prej dëshmitarëve janë mbajtur në ndërtesa të ndryshme në fshatin Kleçkë.

b. Trajtimi i të burgosurve gjatë ndalimit të tyre

Dëshmitari **P**, Dëshmitari **Q** dhe Dëshmitari **O** e kanë shpjeguar se si, kur janë dërguar me veturë në Kleçkë, ata janë marrë nga vetura me të cilën transportoheshin dhe janë rreshtuar. Ushtarët e UÇK-së të cilët kanë qenë të maskuar dhe të armatosur gjithashtu kanë dalë nga vetura. Dëshmitari **O** ka thënë që prej atëherë ka qenë i frikësuar se do të vritej.²⁹²

Dëshmitari **D** ka dëshmuar që i burgosuri i njohur si “**Sh**” i është nënshtruar rrahjeve përpara të burgosurve të tjerë. Trupi Gjykues gjen që “**Sh**” ka qenë **SHA**. Ai ka dëshmuar që “**Sh**” dërgohej në katin e lartë dhe pastaj Dëshmitari **D** e dëgjonte atë duke bërtitur. Të burgosurit tjerë nuk kanë keqtrajtuar në prezencën e **D**-së. Dëshmitari **D** ka dëshmuar që ai personalisht nuk është keqtrajtuar.

SD cili rregullisht vizitoi burgun në Kleçkë dëshmoi se të burgosurit nuk janë ankuar për trajtimin në burg, përveç njërit nga të burgosurit i cili ishte lodhur duke qëndruar brenda qelisë gjithë ditën dhe kërkoi nga **A**-ja t'i lejohet të kryej punë.²⁹³

Dëshmitari **F** tha se ata ishin trajtuar mirë dhe nuk ishin rrahur.

²⁹² Dëshmitari **O**, supra; Dëshmitari **Q**, supra, Dëshmitari **P**, supra

²⁹³ Dëshmitari **A**, supra

Dëshmitari **O**, dëshmitari **P** dhe dëshmitari **Q** dëshmuan se ata ishin të ndaluar në një dhomë me **SS**. Dëshmitari **O** dhe dëshmitari **Q** thanë se të burgosurit tjerë ishin të ndaluar në të njëjtën dhomë përfshirë **BK**.

Dëshmitari **O**, dëshmitari **P** dhe dëshmitari **Q** dëshmuan se asnjë nga të burgosurit nuk është keqtrajtuar.

Dëshmitari **V** dha dëshmi kundërthënëse rreth trajtimit të tij gjatë ndalimit në Kleçkë. Ai tha se gjatë asaj kohe **MS** iu kërcënua se do ta vrasë. Dëshmitari **V** dëshmoi: “Ai më tërhoqi nga qelia me një thes në kokë dhe m'u kërcënua me jetë. Kur isha në burg, **MS**, së bashku me kushërinin e tij dhe tre persona tjerë erdhën tre herë në qelinë time. Në një rast ata më kërcënuan dhe në një rast tjetër ata më goditën me shkelm”.²⁹⁴ Në të njëjtën deklaratë **V**-ja dëshmoi: “Unë personalisht asnjëherë nuk jam keqtrajtuar fizikisht në Kleçkë. Vetëm kam marrë dy shkelma me gju në bark.

Dëshmitari **V** dëshmoi se **BK** ishte marrë në pyetje disa herë në katin e epërm të shtëpisë ku ishte i ndaluar. Dëshmitari **V** nuk e kishte parë asnjëherë **BK** duke u maltretuar. Dëshmitari **V** përshkroi se kishte parë shenja në duart dhe shpatullat e **BK**, por tha se **BK** kishte thënë se ishte lënduar vetë.

Dëshmitari **V** dëshmoi lidhur me një djalë të ri të moshës 17 vjeçe, nga fshati **Obri** me të cilin ishte ndaluar dy ditë. Dëshmitari **V** dëshmoi se ushtarët e UÇK-së, përfshirë **BH**, e kishin rrahur djalin e ri.

Dëshmitari anonim **M** dëshmoi se gjatë ndalimit të tij një person me maskë e kishte goditur me shkop në shpinë dy herë.²⁹⁵

²⁹⁴ Dëshmitari **V**, *ibid*, faqe 4.

²⁹⁵ Dëshmitari anonim **M**, *supra*

Dëshmitari anonim M dëshmoi se kishte dëgjuar të ndaluar duke bërëtitur derisa ishin duke u marrë në pyetje në katin e parë. Ai tha se kur u kthyen të ndaluarit në qelitë e tyre ai mund të shihe se ata ishin rrahur.

Dëshmitari anonim L dëshmoi se gjatë ndalimit në Kleçkë ai kishte parë një ushtar të UÇK-së të burgosur në qelinë e tij i cili ai tha se ishte rrahur keq. **UK** dëshmoi se ai nuk kishte parë ndonjë krim në Kleçkë.²⁹⁶

Dëshmitari N dëshmoi se në ose rreth majit të vitit 1999 ai ishte dërguar nga ushtarët e UÇK-së ose në Kleçkë ose në Berishë ku ishte ndaluar tre ditë në një shtëpi njëkatëshe me bodrum. N-ja ishte vendosur në një dhomë në bodrum. Ai dëshmoi se, pasi u intervistua, ai u lirua.²⁹⁷

NR ishte arrestuar në tetor 1998. Ai ishte ndaluar deri në fund të nëntorit 1998. Ai tha se gjatë robërisë kishte menduar se ishte ndaluar në Kleçkë. Tha se dy të burgosur serbë ishin ndaluar në dhomën pranë dhomë së tij. Ai tha se kishte dëgjuar britma derisa ata ishin duke u rrahur²⁹⁸.

Trupi gjykues gjen se derisa të ndaluar të caktuar i ishin nënshtruar keqtrajtimit nuk ekzistojnë prova të keqtrajtimit sistematik të ndaluarve në bazë arbitrare. Deklaratat e dëshmitarëve nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se fakti se ata ishin të ndaluar në Kleçkë nënkuptonte se ata ishin në një frikë të vazhdueshme se mund t'i nënshtroheshin abuzimit fizik apo vdekjes. Duke marrë parasysh dëshmitë e mëparshme, trupi gjykues gjen se kushtet e ndalimit *per se* nuk përbënin trajtim mizor.

Përveç rastit të dëshmitarit anonim H dhe vëllait të tij, **SD** dëshmoi se asnjë nga të ndaluarit nuk i është ankuar atij për ndonjë keqtrajtim.²⁹⁹

²⁹⁶ Dëshmitari anonim L, *supra*

²⁹⁷ Dëshmitari N, deklaratë e marrjes në pyetje e dëshmitarit nga policia e EULEX-it, dosja C e PSRK-së

²⁹⁸ NR, 12 janar 2012

²⁹⁹ Faqe 14 e procesverbalit të datës 23 prill 2013

BZ deklaroi “Nuk kishte ankesa nga zyra ligjore përgjegjës i së cilës ishte SD apo ndonjë ankesë tjetër nga kushdo qoftë...nuk kam pranuar asnjë ankesë.”³⁰⁰

Nëse sjellja e caktuar përbën trajtim mizor apo jo kjo duhet të përcaktohet në bazë të çdo rasti specifik.³⁰¹ Në këtë vështrim, aktakuza përmend individë të cilët iu nënshtruan trajtimit çnjerëzor, ish drejtori i burgut **SHA**, ish oficeri i policisë **YGJ**, tre vëllezërit **B**, **E** dhe NK civilët dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij, pesë ushtarakët serbë **DT**, **D**³⁰² **V**, **BC**, **ZT**, **VM** dhe NDJ. Dëshmitë e parashtruara nga prokuroria tregojnë se disa individë të caktuar është e mundur të i jenë nënshtruar trajtimit mizor.

i. SA dhe YGJ

Dëshmitari anonim C dëshmoi se pas ndalimit në Tërpezë, ai është transferuar në Kleçkë më 26 mars 1999. Qelia ka qenë në bodrum.

Dëshmitari anonim C dëshmoi se ai ishte ndaluar përafërsisht shtatë ditë. Ai tha se kanë qenë katër të burgosur të tjerë në qelinë e tij përfshirë **SA** dhe një të ndaluar nga Prizreni që quhej I ose Y.

Dëshmitari anonim C dëshmoi se dikush me emrin **H** vinte dhe i merrte të burgosurit lart për t'u marrë në pyetje dhe për t'u rrahur.

Dëshmitari anonim C dëshmoi se megjithëse ai nuk ishte marrë në pyetje dhe nuk ishte rrahur gjatë ndalimit në Kleçkë të gjithë shokët e qelisë ishin rrahur keq.

³⁰⁰ Procesverbal i datës 5 qershor 2013

³⁰¹ Prokurori kundër FL, HB IM, TPNJ, Aktgjykimi i Trupit Gjykues, 30.11.2005, para. 232.

³⁰² Është konstatuar nga trupi gjykues se në faqe 24 të aktakuzës, e cila përmban pretendimet e prokurorisë përse i përket trajtimit çnjerëzor të burgosurve në Kleçkë, prokuroria ka dhënë emra në mes të tjerëve DV duket se i referohet DV.

Dëshmitari anonim C tha se nuk i ka njohur asnjë nga ushtarët në Kleçkë.

Më 3 prill 1999, dëshmitari anonim C ishte liruar nga “M”/Z, për të cilin dëshmitari anonim C kishte menduar se ka qenë drejtori i burgut.³⁰³

SD dëshmoi se e kishte parë **SA** në Kleçkë. **SHA** ishte nën hetime, por rasti i tij nuk arriti asnjëherë te **SD**. Kishte thashetheme se **SHA** ka qenë drejtor i burgut në Vushtrri ose në Mitrovicë³⁰⁴ dhe se kishte torturuar të burgosur politik.

Ishte dyshuar po ashtu se ai kishte qenë shef i policisë dhe i paguar nga serbët, të cilët i jepnin atij armë dhe mbështetje financiare. Ai ishte arrestuar në Mitrovicë³⁰⁵.

SD dëshmoi se **SA** ishte mbajtur në njërën nga dy dhomat në katin përdhes. **SD** tha se nuk e di se çka ka ndodhur me të.³⁰⁶

Dëshmitari D, ushtar në ushtrinë e Serbisë, dëshmoi se më 3 mars 1999 ai ishte arrestuar nga ushtarët e UÇK-së dhe ishte dërguar në një shtëpi dykatëshe ku ishte vendosur në bodrum. Ai tha se ishte ndaluar me gjashtë të burgosur të tjerë, të gjithë shqiptarë. Ai dëshmoi se të gjithë të burgosurit me të cilët ishte ndaluar kishin qenë në gjendje të keqe dhe se ishin rrahur.

Dëshmitarit D iu kujtua një i burgosur, një burrë i moshuar, të cilin të tjerët e thërrisnin “Sh”. Të burgosurit tjerë thanë se para konfliktit ai kishte qenë drejtor i burgut në Smrekonicë. Dëshmitari D dëshmoi se gjatë ndalimit ushtarët e UÇK-së kishin ardhur në dhomën e tyre dhe kishin rrahur “Sh” përpara të gjithëve. Ai tha se ata e dërgonin “Sh” lart dhe se ata mund ta

³⁰³ Dëshmitari anonim C, *supra*

³⁰⁴ NM, 17 janar 2012

³⁰⁵ NM, 17 janar 2012

³⁰⁶ SD, *supra*

dëgjonin duke bërë titur. Asnjë i burgosur tjetër nuk ishte keqtrajtuar në prani të dëshmitarit D.³⁰⁷

Dëshmitari R dëshmoi se **SA**, me nofkën “**S**” apo “**Si**”, u zhduk më 15 mars 1999, dhe ishte parë për herë të fundit në Mitrovicë. **SA** kishte punuar 25 vjet si drejtor i burgut të qarkut në Smrekonicë në Mitrovicë. Dëshmitari **R** nuk dinte ndonjë detaj tjetër për zhdukjen e **SA**.³⁰⁸

Trupi gjykues gjen se **SA** ishte ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë të administruar nga UÇK, në mars 1999 dhe se kishte mbetur atje deri më 3 prill 1999. Nuk ka prova se ai ka marrë pjesë aktivisht në luftime gjatë asaj kohe. Trupi gjykues gjen se ai ka qenë civil.

Dëshmitari anonim C dhe dëshmitari D përshkruan trajtimin e **SA** si “rrahje e keqe”. Nga deklarata e C-së del se **SA** ishte rrahur po ashtu në prani të burgosurve të tjerë, në qeli, dhe kur **SA** ishte dërguar lart britmat e tij mund të dëgjoheshin nga lart në qeli. Trupi gjykues gjen se trajtimi i tij përbënte trajtim mizor.

Trupi gjykues gjen se **SA** ishte keqtrajtuar në atë mënyrë që i shkaktoi atij vuajtje të rënda mendore dhe fizike, dhe përbënte sulm të rëndë mbi dinjitetin njerëzor.

Përsa i përket **YGJ**, trupi gjykues vë re se vetëm dëshmitari anonim C e përmend në dëshminë e tij se e kishte takuar **I** apo **Y** gjatë ndalimit në Kleçkë. Është e paqartë nëse, në fakt, ai i referohej **YGJ** apo jo. Si e tillë, dëshmia e dëshmitarit anonim C nuk është e mjaftueshme për të mbështetur pretendimet në aktakuzë se **YGJ** ka qenë i ndaluar në Kleçkë, apo se ai i është nënshtruar trajtimit mizor.

ii. BK, EK dhe NK2

³⁰⁷ Dëshmitari D, *supra*

³⁰⁸ Dëshmitari R, 22.12.2010, Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit nga ana e policisë së EULEX-it, Dosja C e PSRK-së

Dëshmitari V dëshmoi se ishte dërguar në Kleçkë dhe ishte ndaluar 56 ditë. Gjatë kësaj kohe ai ka qenë në një dhomë me **BK**, dhe në një kohë gjithashtu dhe me dy vëllezërit të cilët i njihte si I dhe E, të cilët ishin nga Caralluka. Vëllai i tretë ishte sjellë më vonë dhe ishte liruar menjëherë. Dy vëllezërit, I dhe E, janë ndaluar në burg në mes 20 dhe 30 ditë përpara se të transferoheshin në një burg tjetër.

Trupi gjykues konstaton mospërputhjen në mes emrave të vëllezërve të cilëve iu është referuar në aktakuzë dhe në dëshminë e dëshmitarit V. Vëllezërit **BK, EK dhe NK** kanë qenë nga fshati Carallukë.

Dëshmitari V dëshmoi se I dhe E i kishin thënë atij se ata akuzoheshin se janë spiunë. Dëshmitari V dëshmoi se I dhe E ishin rrahur dy ose tre herë gjatë ndalimit në Kleçkë. Dëshmitari V nuk e dinte nga kush. Ai dëshmoi se I dhe E ishin shkelmuar, goditur me shuplakë dhe rrahur me shkopinj bejsbolli. Zakonisht ata që i rrihnin mbërrinin në mbrëmje.

SD dëshmoi se i kujtoheshin tre vëllezërit K të cilët u dërguan në burgun e Kleçkës nga policia ushtarake. Ai tha se njëri nga vëllezërit quhej **B**. **SD** nuk i kujtohej nëse ai apo policia ushtarake të kishin marrë në pyetje vëllezërit Krasniqi. Ata akuzoheshin se bashkëpunonin me serbët. Ata nuk u transferuan asnjëherë te **SD** për gjykim. **SD** kishte dëgjuar se tre vëllezërit Krasniqi ishin liruar nga **FL**.³⁰⁹

Duket e mundshme se dëshmitari V i referohej **BK, EK dhe NK2**.

Dëshmitari T dëshmoi se ai i njihte tre vëllezërit, **B, E, NK**, të cilët jetonin në fshatin Carallukë. Dëshmia e tij ishte se **E** dhe **N** ishin arrestuar nga UÇK-ja në apo rreth shkurtit 1999. Ai tha se Bali Krasniqi ishte arrestuar nga UÇK-ka një muaj më vonë. Dëshmitari T e takoi N nja dy ditë

³⁰⁹ SD, *supra*

pas lirit të vëllezërve. Ai tha se N i kishte treguar se asgjë s'i kishin bërë.³¹⁰ Ai nuk kishte deklaruar, si duket, nëse vëllezërve të tyre u kanë bërë diçka.

Dëshmia lidhur me identitetin e vëllezërve është kontradiktore. Dëshmitari V u referohej dy vëllezërve I dhe E, të cilët ishin nga Caralluka. Ai tha se vëllai i tretë është sjellë më vonë dhe është liruar menjëherë. Dëshmitari T tha se E dhe N ishin arrestuar nga UÇK-ja në apo rreth shkurtit 1999 dhe BK ishte arrestuar nga UÇK-ja një muaj më vonë. Prandaj, duket se në dëshminë e tij dëshmitari V i referohet E dhe N të jenë keqtrajtuar. Megjithatë, dëshmitari T deklaroi se kur ai e kishte parë më pas N ai i kishte thënë se nuk ishte keqtrajtuar.

Trupi gjykues gjen se BK, EK dhe NK2 ishin ndaluar nga ana e UÇK-së në Kleçkë në apo rreth shkurtit 1999. Trupi gjykues gjen se asnjë nga vëllezërit në kohën e ndalimit të tyre nuk ka marrë pjesë aktivisht në luftime.

Dëshmia e dëshmitarit V lidhur me identitetin e dy vëllezërve të cilëve iu referua në dëshmi është në mospërputhje me dëshmitë e dëshmitarit T. Megjithatë, dëshmitari V përshkroi të ketë vënë re lëndimet e pësuar nga të burgosurit e ndaluar në Kleçkë. Këto lëndime ishin rezultat i rrahjes së burgosurve.

iii. Dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij

Dëshmitari anonim H dëshmoi se më 27 shkurt 1999 ai dhe vëllai i tij ishin marrë nga një grup prej katër ose pesë burrave, tre nga të cilët ishin në uniforma të UÇK-së dhe dy në rroba civile.

Dëshmitarit anonim H dhe të vëllait të tij i ishin mbyllur sytë dhe ishin dërguar në një vend ku H ishte marrë në pyetje. Dëshmitari H dëshmoi se gjatë marrjes në pyetje ai ishte i rrethuar nga katër ose pesë burra dhe ishte rrahur vazhdimisht me shkopinj dhe grushte. Kur ai rrëzohej në tokë ata e ngrehnin lart dhe vazhdonin ta rrihnin.

³¹⁰ Dëshmitari T, 03.05.2011, Deklaratë e marrjes në pyetje e dëshmitarit nga ana e policisë së EULEX-it, faqet 4, 5, 6, dosja C e PSRK

Dëshmitari anonim H dëshmoi se e kishte humbur vetëdijen. Ai tha se pas rrahjes nuk mund të qëndronte në këmbë. Ai tha se e kishin ngritur në këmbë dhe e kishin nxjerrë jashtë shtëpisë dhe hedhur në baltë dhe borë.

Dëshmitari anonim H dëshmoi se derisa ishte i shtrirë në borë ai mund të dëgjonte britmat e vëllait të tij që vinin nga brenda shtëpia.

Dëshmia e tij ishte se pas një kohe burrat dolën nga ndërtesa, e morën atë dhe e dërguan në katin më të lartë të ndërtesës ku ishte i shtrirë vëllai i tij. Ata të dy ishin të prangosur dhe me kapuç në kokë akoma. Më vonë dy burra me uniforma të UÇK-së ua hoqën kapuçat.

Dëshmitari anonim H dëshmoi se ai nuk ka qenë në gjendje të ecë. Më vonë atë natë disa burra e bartën poshtë në bodrum. Ai dëshmoi se vëllai i tij ishte tërhequr poshtë shkallëve nga këmbët. Në bodrum ata i shtrinë në dyshekë sfungjeri të hollë.

Dëshmitari anonim H dëshmoi se ai mund t'i shihte lëndimet në vëllain e tij përfshi edhe një të çarë të thellë në ballë. Dëshmitari anonim H tha se ishte shumë i dobët. Arriti të kapë një shishe me ujë aty afër dhe i dha pak vëllait. Ai tha se vëllai i tij ishte i paftë të kapërdijë. Ai tha se bërtiti për ndihmë por askush nuk erdh.

Dëshmitari anonim H provoi të kthej në vete vëllain e tij me frymëmarrje artificiale dhe provoi të i bëj masazh zemrës me bërryl, por i vëllai vdiq.

Atë mëngjes një grup i personave erdh poshtë, të udhëhequr nga një burrë i veshur me rroba civile i cili ishte përfaqësues i moshës 55 vjeçe. Ky burrë iu drejtua dëshmitarit anonim H në gjuhën serbe dhe e pyeti nëse ka qenë i torturuar dhe nëse vdekja e vëllait të tij ishte shkaktuar nga tortura.

Dëshmitari anonim H iu përgjigj se ai dhe i vëllai i tij ishin torturuar dhe se vëllai i tij kishte vdekur si rezultat i torturimit. Dëshmitari anonim H dëshmoi se burri i kërkoi falje dhe tha se do

ta gjej një doktor. Të nesërmen, një grup më i madh i anëtarëve të UÇK-së erdhën në bodrum dhe dëshmitari anonim H dhe trupi i vëllait të tij iu dhanë OSBE-së.

Dëshmitari anonim H dëshmoi se ai ishte dërguar në spital ku dy ditët e para ishte mbajtur në kujdes intensiv. Ai përshkroi se gjatë rrahjeve kishte pësuar disa fraktura në fytyrë, shpatull dhe duar. Dëshmitari anonim H dëshmoi se qëndroi në atë spital dhjetë ditë përpara se të transferohej në një spital tjetër.³¹¹

Dëshmitari anonim H, meqë ka qenë me sy të lidhur të shumtën e kohës, nuk ka mundur të identifikojë vendin ku janë ndaluar ai dhe vëllai i tij. Megjithatë, **SD** dëshmoi se ai ka qenë i informuar se dy të burgosur serbë kanë qenë të ndaluar në Kleçkë. **SD** tha se menjëherë ka shkuar në burg në Kleçkë. Ai tha se kur arriti atje, njëri nga të burgosurit serb tashmë kishte vdekur, dhe ishte evidente se i burgosuri tjetër ishte rrahur sepse fytyrën e kishte të ënjtur.

SD tha se kishte folur me të ndaluarin në gjuhën serbe. I burgosuri serb tha se nuk ishte ushtarak dhe se i burgosuri tjetër ishte vëllai i tij, i cili ishte ushtar. **SD** i kujtohej se të dy të burgosurit kishin të veshur uniforma. **SD** thërriti doktorin i cili përgatiti një raport mjekësor. I burgosuri serb i cili ishte akoma gjallë ishte në gjendje shumë të keqe. **SD** i dha disa ilaçe. Pas konsultimit me **BZ**, i cili ishte komandant i shtabit të përgjithshëm, **SD** urdhëroi që të dy të burgosurit t'i dorëzohen OSBE-së.³¹²

BZ i kujtohej se **SD** kishte folur me të rreth dy serbëve, por tha se ata ishin dërguar në qendrën e ndalimit në Lladroc. A-ja i kishte thënë atij se njëri nga ata kishte vdekur. **BZ** sugjeroi që doktori t'i vizitojë serbët dhe të vërtetojë shkakun e vdekjes. Atij i kujtohej po ashtu se të dy i ishin dorëzuar një organizate ndërkombëtare.³¹³

³¹¹ Dëshmitari anonim H, 24.08.2010, Deklarata e marrjes në pyetje e dëshmitarit nga ana e policisë së EULEX-it, dosja B e PSRK

³¹² SD, *supra*

³¹³ BZ *supra*

Trupi gjykues gjen se dëshmia e dëshmitarit anonim H është në përputhje me dëshminë e dhënë nga **SD**. Trupi gjykues konstaton se **BZ** po ashtu ishte informuar nga **SD** lidhur me dy serbët, njëri nga të cilët kishte vdekur. **BZ** deklaroi se ata ishin të ndaluar në Lladroc. Megjithatë, **BZ** personalisht nuk i kishte parë dëshmitarin anonim H dhe vëllain e tij në qendrën e ndalimit dhe ka gjasa që mbështetej në informata të dhëna nga të tjerët. Duke konsideruar dëshminë e dëshmitarit anonim H dhe **SD** trupi gjykues gjen se dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij kanë qenë të ndaluar në Kleçkë.

Trupi gjykues gjen se dëshmitari anonim H dhe vëllai i tij janë rrahur në mënyrën e përshkruar nga dëshmitari anonim H gjë që konfirmohet nga **SD**. Rrahje të tilla në kombinim me faktin se dëshmitari anonim H ka qenë dëshmitar i vdekjes së vëllait të tij si rezultat i keqtrajtimit të rëndë fizik, pa pasur mundësi që dëshmitari anonim H të kërkojë ndihmë mjekësore dhe pa i siguruar ndihmë mjekësore, përbën trajtim mizor të dëshmitarit anonim H dhe vëllait të tij.

iv. Torturimi i katër të burgosurve ushtarak serbë³¹⁴

Në aktakuzë pohohet se në mes/fund të prillit 1999 katër rezervistë ushtarakë serbë ishin dërguar në shtëpinë kryesore të UÇK-së në fshatin Kleçkë dhe ishin ndaluar në katin përdhese. Aty ata janë rrahur gjatë gjithë një ditë. Ishte pohuar se **SS1** dhe **BS** kishin marrë pjesë në rrahje. Të njëjtën ditë, të burgosurit ishin transferuar në një nga shtëpitë e djegura në fshatin Kleçkë, dhe disa ditë më vonë ishin ekzekutuar dhe trupat e tyre ishin varrosur.

Për aq sa akuzat tjera në aktakuzë i referohen **DT, DV, BC, ZF, ZM, VM dhe NGJ** prokuroria mbështetet në dëshmitë e **AZ**.

³¹⁴ Është konstatuar nga trupi gjykues se në faqe 24 të aktakuzës, e cila përmban pretendimet e prokurorisë përse i përket trajtimit çnjerëzor të burgosurve në Kleçkë, prokuroria ka dhënë emra në mes të tjerëve emrin DV, që duket se i referohet DV.

Përveç dëshmisë së **AZ** prokuroria mbështetet në dëshmitë e siguruar pas zhvarrosjes së mbetjeve mortore dhe dëshmisë së identifikimit përmes ADN-së nga dy vende në Kleçkë të identifikuar si KER01 dhe KEQ01.

Mbetjet e pesë trupave ishin gjetur në lokacionin KER01.³¹⁵ Trupat e zhvarrosur në këtë vend ishin identifikuar përmes provave të ADN-së si ato të **DT, DV, BC, ZF dhe ZT**.³¹⁶

Në vendin KEQ01 ishin gjetur mbetjet e dy trupave.³¹⁷ Trupat e zhvarrosur në këtë vend ishin identifikuar përmes ADN-së si ato të **VM dhe NGJ**.³¹⁸

TM dëshmoi³¹⁹ se në prill 1999 ka qenë komandant i rajonit ushtarak të Prizrenit i armatës Jugosllave. Ai dëshmoi se më 9 prill 1999 **ZF** dhe **ZT**, dy anëtarë të forcave rezervë të armatës së Jugosllavisë, ishin larguar nga njësia e tyre dhe kishin shkuar te shtëpitë e braktisura ku kishin jetuar myslimanët dhe shqiptarët dhe kishin vjedhur disa sende personale. Të dy ishin arrestuar dhe ishte urdhëruar të dërgohen në gjykatë ushtarake në Prishtinë. Më 11 prill 1999, **TM** lëshoi urdhër për transferimin e tyre në Prishtinë. **ZF** dhe **ZT** duhej të ishin shoqëruar në Prishtinë nga **DV** dhe **BC**. **DT** ka qenë një nga ata i cili u nis rrugës për Prishtinë. Pozita e tij ishte kapiten në ushtrinë rezerviste. **TM** përshkroi kapiten **T** si “vartës të tij të drejtpërdrejt”.³²⁰

³¹⁵ Policia e EULEX-it, raporti i policisë mbi zhvarrosjen, 30.09.2009, numri i rastit 0068-09-ECW4, dosja e PSRK H; policia e EULEX-it, raporti vlerësues i policisë, 24-26.08.2009, numri i rastit 0068-09-ECW4, dosja H e PSRK.

³¹⁶ Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, 05.02.2010, KER01-001B, MPU 2000-010251 (ZF), dosja PSRK-së L; Ministria e Drejtësisë së Kosovës, KER01.004B, MPU 2000-000251 (ZT), dosja e PSRK-së L; Ministria e Drejtësisë së Kosovës, zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, KER01-005B, MPU 1999-000047 (BC); Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, KER01-006B, MPU 1999-010047 (DV), dosja e PSRK-së L; Zyra e UNMIK-ut për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, KER01-007B, MPU 2000-020251 (DT); Komisioni ndërkombëtar për persona të zhdukur, lista e raporteve të krahasimeve të ADN-së për: UNMIK-OMPF, 001/10, 186/09, 178/09, 168/09, dosja e PSRK-së H.

³¹⁷ Dosja e PSRK-së I.

³¹⁸ Zyra e EULEX-it për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, konfirmimi i identitetit, KEQ01-002B, MPU 1999-000043 (VM) dosja e PSRK-së I; zyra e EULEX-it për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, konfirmimi i identitetit, KEQ01-001B, MPU 2001-000001 (NGJ), dosja e PSRK-së I.

³¹⁹ Dosja e PSRK-së P, faqet P21a, P21b dhe P21c.

³²⁰ Deklarata 27 janar 2005, dosja e PSRK-së I, faqe P21b.

TM dëshmoi se atë ditë rreth orës 4 pasdite një pjesëtar i UÇK-së i cili e identifikoi veten si “**B**” dërgoi një radio thirrje ku thoshte se një automjet me ushtarë të armatës së Jugosllavisë ishte ndaluar dhe se **DV** ishte duke pirë kafe me të. “**B**” nuk përmendi ushtarët tjerë të cilët e shoqëronin **DV** në automjet.

Kur **TM** u intervistua më 11 prill 2005 ai dha një shpjegim paksa më ndryshe lidhur me radio mesazhin. Në atë rast ai tha se radio thirrja më 11 prill 1999 thoshte se **DT** ishte rrëmbyer së bashku me **ZF, ZT, DV** dhe **BC**.³²¹ Në deklaratën e tij të mëtutjeshme **TM** dëshmoi se “**B**” komandoi “Shqiponjat e zeza” të UÇK-së dhe njihej gjithashtu si “**T**”. Emri i tij ishte **I**, dhe komandanti i tij ishte **RH**. Të dy ishin të stacionuar në Gllarevë.³²²

UK dëshmoi se në prill 1999 ka qenë në Kleçkë dhe ka parë katër ushtarë të UÇK-së, **MSH, BK, SK** dhe **MK** me katër të burgosur serbë të cilët i kishin arrestuar më herët atë ditë. **UK** tha se oficerët serbë nuk i kishin duart e lidhura por armët ua kishin marrë. Policia ushtarake mori përgjegjësinë e oficerëve serbë dhe i vendosi në bodrum të shtëpisë. **UK** dëshmoi se atij i ishte thënë se emri i njërit nga oficerët ishte **DM** apo, ai tha, “diçka i tillë”. **UK** nuk e dinte çka ndodhi me ta.³²³

TM dëshmoi se ai ishte kontaktuar në të njëjtën ditë nga një ushtar i UÇK-së i cili e identifikoi veten si “**B**” e që ishte i stacionuar në Gllarevë. “**B**” tha se ishte duke pirë kafe me **DV** Natyrisht, shpjegimi i mëvonshëm i **TM** ishte paksa më ndryshe.

UK dëshmoi se në prill 1999 në Kleçkë ai kishte parë katër të burgosur serbë. Atij i kujtohej se emri i njërit nga oficerët ishte **DM** apo “diçka i tillë”. Ai me siguri i referohej **DV**.

v. *Vrasja e të burgosurit ushtarak serb*

³²¹ Dëshmia P21b, TM, Departamenti për luftimin e krimit të organizuar, ministria e punëve të brendshme, Republika e Serbisë, procesverbal, 11.04.2005, dëshmitë e prokurorisë dosja P1-P31.

³²² Dëshmia P21, TM, *supra*, dëshmia P21, TM, *ibid*.

³²³ Dëshmia P6, dëshmitari anonim I.

Në aktakuzë pohohet se në prill 1999, jo më herët se 11 prill 1999, një i burgosur ushtarak serb ishte dërguar në qendrën e ndalimit të UÇK-së në fshatin kleçkë dhe më vonë ishte ekzekutuar nga **NS** i cili përdori një kosë. Më tej është pohuar se i burgosuri ishte ekzekutuar sipas udhëzimeve të **FL**.

AZ dëshmoi se ai e kishte gjetur kosën të cilën e përdori **NS** për të vrarë të burgosurin.

Në aktakuzë pohohet se **AZ** ia kaloi tehun e kosës të akuzuarit **AK**, i cili ia dha **NS**.

Më tutje pohohet në aktakuzë se **RM** ka qenë pjesë e grupit i cili ka marshuar të burgosurin te vendi ku është ekzekutuar nga **NS**. Me këtë veprim **RM** ka vendosur viktimën në dispozicion të **NS** dhe po ashtu ka parandaluar ikjen e viktimës.

Përshkrimi i ngjarjeve bazohet, pjesërisht, në dëshminë e **AZ**.

Përsa i përket të akuzuarit **AK**, gjatë shqyrtimit të parë gjyqësor³²⁴ prokurori u tërhoq pjesërisht nga aktakuza bazuar në dëshmitë mjekësore se më 18 prill 1999 **AK** kishte pësuar plagë të shumëfishta nga armët e zjarrit. Duke marrë parasysh këtë dëshmi prokuroria e pranoi se **AK** nuk ka qenë i pranishëm kur pretendohet se i burgosuri është vrarë në mënyrë të paligjshme nga **NS**.

Dëshmia e **AZ** lidhur me faktin dhe mënyrën në të cilën është ekzekutuar i ndaluari serb është në përputhje me provat e mbledhura në fshatin Kleçkë në vendin KER01.

Mbetjet mortore të pesë trupave janë gjetur në vendin KER01. Përmes analizës së ADN-së janë identifikuar si **DT, DV, BC, ZF dhe ZT**.

³²⁴ 11 nëntor 2011

Raporti i autopsisë lidhur me **BC** shënon një plagë nga armë zjarri në pjesën e pasme të kafkës³²⁵.

Raporti i autopsisë lidhur me **ZF** shënon dy plagë nga armë zjarri në pjesën e pasme të kafkës³²⁶.

Raporti i autopsisë lidhur me **ZT** shënon dy plagë nga armë zjarri në pjesën e pasme të kafkës³²⁷.

Raporti i autopsisë së Dr. MG i datës 18 nëntor 2009³²⁸ pas ekzaminimit të mbetjeve mortore të **DV** jep shkakun e vdekjes si “prerje në qafë me një mjet të mprehtë” dhe përshkruan lëndimet në trup si në vijim: *“në aspektin anterior të vertebrës së qafës numër 3 (tre) prerje e mprehtë e drejtuar tërthorazi. Prerje në korpusin e vertebrës deri në disa mm (disa milimetra) thellë”*

Raporti i autopsisë së Dr. MG i datës 19 nëntor 2009³²⁹ pas ekzaminimit të mbetjeve mortore të **DT** jep shkakun e vdekjes si “prerje e qafës me mjet të mprehtë. Traumë e shkaktuar me mjet të topitur në gjoks dhe në parakrahun e djathtë” dhe përshkruan lëndimet në trup si në vijim: *“në aspektin anterior të vertebrës së qafës numër 3 (tre) prerje e mprehtë e drejtuar tërthorazi. Prerje në korpusin e vertebrës deri në disa mm (milimetra) thellë. Prerje në korpusin e vertebrës e zgjatur në processus costarius dexter në vertebrën e tretë të qafës.”* Patologu po ashtu konstatoi traumë të shkaktuar me mjet të topitur në brinjën numër 4 në anën e majtë. Janë dy thyerje të korpusit +/-20cm nga caput costae dhe thyerja e dytë gjendet +/-26cm nga caput costae dhe thyerje në krahun e djathtë.

Një teh i kosës është gjetur në varr. Është gjetur paralel me këmbën e **ZF** dhe nën këmbët e **ZT**.

³²⁵ Dosja L, faqet L238-L335

³²⁶ Dosja L, faqet L10-L96

³²⁷ Dosja L, faqet L97-L237

³²⁸ Autopsia e kryer më 29 tetor 2009

³²⁹ Autopsia e kryer më 29 tetor 2009

Janë gjetur tri ligatura në varr dhe këto lidhen sipas arkeologut mjeko ligjor me trupat e **ZF, BC, dhe ZT**. Është konstatuar se trupat e **ZT** dhe **BC** i kanë pasur duart e lidhura prapa shpine³³⁰.

Trupi gjykues gjen se **DT, DV, BC, ZF, dhe ZT** janë vrarë në mënyrë të paligjshme.

*vi. Vrasja e **NG** dhe **VM***

Ishte pohuar në aktakuzë se më 3 prill 1999 **AZ** i kanë thënë se **FL** kishte urdhëruar vrasjen e **NG** dhe **VM** dy oficerë serbë të policisë të cilët ishin ndaluar në shtëpitë e djegura në Kleçkë për rreth tre muaj.

AZ dëshmoi se kishte folur me **FL** i cili, ai tha, ishte i befasuar që dy të burgosurit ishin akoma gjallë. Ai dëshmoi se ditën e nesërme **FL** kishte shkuar në burgun e Kleçkës me **NK1, NK2 dhe NSH**. Atje, ai urdhëroi që të nxjerrën të burgosurit nga shtëpitë e djegura aty ku ishin duke u mbajtur dhe të dërgohen në vendin e njohur si Livadhi i Canit.

AZ dëshmoi se ai, të akuzuarit **AK** dhe **BL** shoqëruan të burgosurit në atë vend. Ai tha se **FL** ka qenë i pranishëm dhe ka urdhëruar **AZ** që ai personalisht të vrasë të dy të burgosurit.

Në aktakuzë pohohet se të akuzuarit **AK** dhe **BL** kanë vendosur viktimat në dispozicion të kryesit të ekzekutimit, duke i marshuar ata te vendi i ekzekutimit të tyre.

³³⁰ Dosja e PSRK-së L, faqe L432

Mbetjet mortore të dy trupave janë gjetur në vendin KEQ01. Varri ishte i pashënuar. Janë identifikuar përmes analizave të ADN-së si trupat e **VM** dhe **NGJ**.³³¹

Raporti post mortem për **VM** jep shkakun e vdekjes si vrasje me armë zjarri në kokë dhe trung.³³²

Raporti post mortem për **VGJ** jep shkakun e vdekjes si vrasje me armë zjarri në kokë.³³³ I njëjti raport i referohet tri plagëve nga armë e zjarrit në kokë. Një nga plagët nga arma e zjarrit ishte në pjesën e pasme të kokës.

Tri plagë nga armë zjarri në kokën e dy viktimave, fakti se **NGJ** ishte po ashtu i qëlluar në pjesën e pasme të kokës dhe fakti se trupat e tyre ishin varrosur në një varr të pashënuar mbështet lëndën e prokurorisë se ky ka qenë një ekzekutim më shumë se sa pasojë e një veprimi ushtarak.

Certifikata e vdekjes së **VM** dhe **NGJ** thotë vendi i vdekjes: Kleçkë, Lipjan³³⁴.

Trupi gjykues gjen se **VM** dhe **NGJ** janë vrarë në mënyrë të paligjshme me armë zjarri siç është përshkruar në raportin përkatës post mortem dhe trupat e tyre janë varrosur në vendin KEQ01 në fshatin Kleçkë.

vii. Vrasja e AV

³³¹ Zyra e EULEX-it për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, konfirmimi i identitetit, 10.12.2010, numri i rastit KEQ01-001B, MPU 1999-000043 (Velko Markovic), dosja e PSRK-së I; Zyra e EULEX-it për personat e zhdukur dhe mjekësi ligjore, konfirmimi i identitetit, 10.12.2010, numri i rastit KEQ01-001B, MPU 2001-000001 (NGJ), dosja e PSRK-së I.

³³² Ministria Drejtësisë së Kosovës, Zyra për personat zhdukur dhe mjekësi ligjore, raporti i autopsisë, vendi i varrit në Malishevë, 14.09.2010, rasti numër KEQ01/002B, dosja e PSRK-së I.

³³³ Ministria Drejtësisë së Kosovës, Zyra për personat zhdukur dhe mjekësi ligjore, raporti i autopsisë, vendi i varrit në Malishevë, 14.09.2010, rasti numër KEQ01/001B, dosja e PSRK-së I.

³³⁴ Zyra e EULEX-it për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, certifikata e vdekjes, 14.12.2010, Velko Markovic, MPU 1999-000043, KEQ01-002B, dosja e PSRK-së I; Zyra e EULEX-it për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore, certifikata e vdekjes, 14.12.2010, Nebojsa Gjuricic, MPU 2001-000001, KEQ01-001B, dosja e PSRK-së I.

Në aktakuzë ishte pohuar se më apo rreth 3 ose 4 prill 1999 në afërsi të burgut në Kleçkë, **AA**, një i burgosur civil ishte ekzekutuar me armë zjarri të shtëna nga një grup i përbërë nga **NK 1**, **NK2**, **NS** dhe **RM**.

Në aktakuzë ishte pohuar se i akuzuari **RM** ka qenë pjesë e grupit i cili ka shoqëruar **AA**, e ka mbajtur **AA** në dispozicion të kryerësve, duke parandaluar arratisjen e tij dhe ka marrë pjesë në veprimin kolektiv duke shtyrë **AA** në gropë ku është qëlluar për vdekje.

Pretendimet në aktakuzë bazohen në dëshminë e **AZ**.

Dëshmitari anonim C dëshmoi se më 26 mars 1999 ai ishte vendosur në një qeli në Kleçkë. Në qeli kanë qenë edhe katër të burgosur tjerë, përfshirë një shqiptar me emrin **AA**.

Dëshmitari anonim C dëshmoi se gjatë periudhës në robëri **AA** i ka thënë atij se ai akuzohej se bashkëpunonte me serbët.

Dëshmitari anonim C dëshmoi se të gjithë shokët e qelisë janë rrahur.

Dëshmitari anonim C dëshmoi se më 3 prill 1999 ai ishte liruar së bashku me të burgosur të tjerë, duke përfshi **AA**. Dëshmitari anonim C e shoqëroi **AA** në fshatin Sankoc dhe ia dorëzoi kryeplakut të fshatit apo koordinatorit, **SI**, dhe kërkoi nga ai që ta shoqërojë **AA** në fshatin “Dobrashevc”, ku ishte familja e **A**. Të nesërmen filloi ofensiva serbe. Dëshmitari anonim C dëshmoi se ai kishte menduar se **A** ishte përpjekur të arrinte në “Dobrashevc” vetëm pavarësisht kësaj.³³⁵

Dëshmia lidhur me **AA** është e kufizuar. Vetëm dëshmitari anonim C deklaroi se ishte liruar nga qendra e paraburgimit në Kleçkë me **AA**.

³³⁵ Dëshmitari anonim C, *supra*

AA figuron i humbur.³³⁶ Nuk është gjetur trupi.

H. PËRGJEGJËSIA E TË AKUZUARVE

i. Mënyra e përgjegjësisë

Pika 1 në aktakuzë kundër **NK1** pohon **NK1** akuzohet “...në cilësinë e tij si komandant ...i UÇK-së, dhe person i cili mbante pozitë me përgjegjësi mbi qendrën e ndalimit në Kleçkë...”

Pika 1 në aktakuzë kundër **FL** pohon **FL** akuzohet “...si komandant...i UÇK-së dhe si person i cili ushtronte kontroll të përgjithshëm mbi qendrën e ndalimit në Kleçkë...” Pika 2 dhe Pika 3 po ashtu akuzojnë **FL** në cilësinë e tij “si komandant i UÇK-së”.

Pika 1 kundër **NS** pohon **NS** akuzohet “...në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së i cili mbante pozitë me përgjegjësi brenda qendrës së ndalimit në Kleçkë”.³³⁷

Asnjë nga pikat e akuzës ndaj **NK2** nuk pretendojnë përgjegjësi komanduese lidhur me qendrën e paraburgimit në Kleçkë apo, në fakt, lidhur me asnjë nga pikat me të cilat akuzohet.

Megjithatë, dëshmitë në të cilat u mbështet prokuroria, përfshirë deklaratat e dëshmitarëve I dhe L pretendojnë **NK2** në fakt ka mbajtur pozitë me përgjegjësi komanduese *vis a vis* qendrës së ndalimit.

³³⁶ Dëshmia P3, memo e Departamentit të mjekësisë ligjore të EULEX-it, 12.10.2011, 2011-DML-129, dëshmitë e prokurorisë dosja P1-P31.

³³⁷ Aktakuza, faqet 3, 9, 11.

Aktakuza nuk pretendon në mënyrë specifike përgjegjësi të lartë, apo komanduese, për asnjë nga të akuzuarit. Në fakt, nuk ka asnjë referencë në aktakuzë për bazën ligjore në të cilën mund të bazohet pretendimi i përgjegjesisë së lartë. Në aktvendimin e vetë të datës 20 nëntor 2012 Gjykata Supreme e Kosovës nuk bëri ndonjë përcaktim mbi këtë çështje por vendosi në vend të kësaj të “...lë çështjen të hapur”. Për pjesën e vet, prokuroria pohon përmendja e të pandehurve të caktuar të cilët mbanin pozita me kompetenca është thjeshtë për të theksuar rolet e tyre përkatëse dhe duhet të merret parasysh nga gjykata si faktor rëndues kur përcaktohet dënimi.

a. Përgjegjësia e lartë

Në mënyrë që një i akuzuar të mbahet përgjegjës si epror për krimet e kryera nga vartësit e tij, duhet provuar elementet si në vijim: (i) ekzistimi i marrëdhënieve epror-vartës; (ii) se eprori e ka ditur apo ka pasur arsye ta dijë se vepra penale do të kryhet apo se është kryer; dhe (iii) se eprori nuk ka ndërmarrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprën penale apo më pastaj të ndëshkojë kryerësin.

Ligji në fuqi

Statuti i TPNJ

Neni 7

Përgjegjësia penale individuale

[...]

3. Fakti që cilido prej veprimeve të përmendura në nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti u krye prej një vartësi nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale nëqoftëse ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi do të kryente ose kishte kryer veprime të tilla dhe eprori nuk mori masat e

nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimeve të tilla ose për ndëshkimin e kryesve të tyre.

[...]

Jurisprudenca e TPNJ

Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në rastin Kordic dhe Cerkez, 17 dhjetor 2004

839. Elementet [të cilat kërkohen për përgjegjësinë sipas nenit 7(3) të Statutit] janë:

(i) ekzistimi i marrëdhënieve epror-vartës;

(ii) eprori e dinte ose kishte arsye të dinte se një veprim kriminal do të kryhej apo se është kryer; dhe

(iii) eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimit kriminal ose të ndëshkojë kryesin e tyre.³³⁸

(i) Ekzistimi i marrëdhënieve epror-vartës

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Celebici, 20 shkurt 2001

Përsa i përket domethënies komandant apo epror siç paraqitet në nenin 7(3) të Statutit, Gjykata e Apelit në rastin *Aleksovski* vendosi:

Neni 7(3) parasheh kriteret ligjore për përgjegjësinë komanduese, kështu që i jep kuptim juridik fjalës “komandant”, në atë se dispozita bëhet e zbatueshme vetëm ku eprori me elementin mendor të kërkuar nuk ka ushtruar kompetencat e tija për të parandaluar vartësit nga kryerja e veprave apo të ndëshkojë ata më vonë. Kjo nënkupton detyrimisht se një epror duhet të ketë kompetenca të tilla paraprakisht dhe të mos i ushtrojë ato. Nëse faktet e rastit plotësojnë

³³⁸ Aktgjykimi i Trupit Gjykses në rastin *Celebici*, para.346; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, rasti *Blaskic* para.72.

*kriteret për kompetencat e eprorit siç parashihet në nenin 7(3), gjetjet faktike do të ishin se një i akuzuar është epror brenda kuptimit të asaj dispozite.*³³⁹

Sipas nenit 7(3), komandanti apo eprori është ai i cili posedon kompetenca apo autoritet në formë *de jure* ose *de facto* për të parandaluar krimin e një vartësi apo të ndëshkojë kryerësit e krimit pas kryerjes së krimit.

Kompetenca apo autoriteti për parandalimin apo për ndëshkimin nuk rrjedhë vetëm nga autoriteti *de jure* të dhënë përmes emërimeve zyrtare. Në shumë konflikte bashkëkohore, mund të ketë ekzistojnë *de facto* vetëm, qeveri të vetëshpallura dhe prandaj ushtritë apo grupet paramilitare *de facto* i nënshtrohen atyre. Struktura komanduese, e organizuar me nguti, mundet fare mirë të jetë e çrregulluar dhe primitive. Për të zbatuar ligjin në këto rrethana kërkohet përcaktimi i llogaridhënies jo vetëm për kryerësit individual por edhe për komandantët e tyre apo eprorët tjerë të cilët kanë qenë, bazuar në prova, në kontroll të tyre pa, megjithatë, mandat apo emërim zyrtar. Tribunali mund të gjejë veten të pafuqishëm për të zbatuar ligjin humanitar ndaj *de facto* eprorëve nëse do të pranonte vetëm si provë kompetencat komanduese apo letër formale të kompetencave, pavarësisht faktit se eprorët kanë vepruar në kohën relevante me të gjitha kompetencat që i bashkëngjiten një eprori apo komandanti të emëruar zyrtarisht.

Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaskic*, 29 korrik 2004

Gjykata e Apelit vë re se Trupi gjykues pajtohet me Aktgjykimin e Trupit Gjykues në rastin Celebici, i cili vërteton mendimin se një epror duhet të ketë kontroll efektiv mbi “personat që kryejnë shkelje themelore të ligjit humanitar ndërkombëtar.” Trupi Gjykues po ashtu deklaroi se “komandanti mund të marr mbi vete përgjegjësi penale për krimet e kryera nga personat të cilët nuk janë formalisht (drejtpërsëdrejti) vartësit e tij, për aq sa ai ushtron kontroll efektiv mbi ta.”

³³⁹ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Aleksovski*, para 76.

Të dyja përfundimet e trupit gjykues bien brenda kufijve të nenit 7(3) të Statutit, dhe të dyja nuk atakohen nga Apeluesi.

[...]

Është vendosur në jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar se kompetenca për të ushtruar kontroll efektiv është e domosdoshme për të vërtetuar përgjegjësinë e lartë. Pragu që duhet arritur për të vërtetuar marrëdhënien epror-vartës për qëllimin e nenit 7(3) të Statutit është kontrolli efektiv mbi vartësin në kuptim të kompetencave materiale për të parandaluar apo ndëshkuar sjelljen kriminale.³⁴⁰

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Kordic dhe Cerkez*, 17 dhjetor 2004

Baza e marrëdhënieve epror-vartës është kompetenca e eprorit të kontrollojë veprimet e vartësve të tij. Trupi gjykues në rastin *Celebici* arriti në përfundim se:

Është e domosdoshme që eprori të ketë [sic] kontroll efektiv mbi personat që kryejnë shkelje thelbësore të ligjit humanitar ndërkombëtar, në kuptim të paturit të kompetencave materiale për të parandaluar dhe ndëshkuar kryerjen e këtyre veprave.³⁴¹

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Halilovic*, 16 tetor 2007

[...] Gjykata e Apelit sjell ndërmend se koncepti i kontrollit efektiv mbi vartësin – në kuptim të kompetencave materiale për të parandaluar apo ndëshkuar sjelljen kriminale, sido që ushtrohet ai kontroll – është pragu që duhet arritur në vërtetimin e marrëdhënies epror-vartës për qëllim të nenit 7(3) të Statutit.³⁴² Përkundrejt këtij sfondi, Gjykata e Apelit sjell ndërmend se nevoja për të provuar se kryerësi ka qenë “vartës” i të akuzuarit (ndaj të cilit janë ngritur akuza sipas nenit 7(3) të Statutit) nuk kërkon vartësi të drejtpërdrejtë apo formale. Më saktë, i akuzuari duhet të jetë, për arsye të pozitës së tij, më i lartë në ndonjë lloj hierarkie formale apo joformale sesa kryerësi.

³⁴⁰ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Celebici*, para. 256. Shih kapitullin III (B) (3) në këtë aktgjykim.

³⁴¹ Aktgjykimi i Trupit Gjykues në rastin *Celebici*, para 378

³⁴² Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Celebici*, para.256

[...]

Në çdo rast, edhe nëse supozohet se Halilovic ka pasur kompetenca të kontribuojë në hetime apo në ndëshkimin e kryerësve të krimeve të kryera në Grabovicë, këto kompetenca mund të përbëjnë vetëm kontroll efektiv relevant për nenin 7(3) të Statutit nëse ato janë pasojë e marrëdhënies së vartësisë në mes Halilovic dhe këtyre kryerësve.³⁴³ Në fakt, Gjykata e Apelit sjell ndërmend se kompetenca materiale për të ndëshkuar dhe detyra përkatëse për të ndëshkuar mund të përbëjnë vetëm kontroll efektiv mbi kryerësit nëse kjo është bazuar një marrëdhënie të mëparshme epror-vartës në mes të akuzuarit dhe kryerësve. Në lidhje me këtë, kompetenca për të ushtruar kontroll efektiv në kuptim të kompetencave materiale për të parandaluar apo ndëshkuar e bën të nevojshëm ekzistimin e mëparshëm të një marrëdhënie të vartësisë, hierarkisë apo të zinxhirit komandues.³⁴⁴ Natyrisht, konceptet e vartësisë, hierarkisë dhe zinxhirit komandues duhet të vërtetohen në kuptim të strukturës organizative formale për aq sa kërkesat fundamentale të kontrollit efektiv mbi vartësin, në kuptim të kompetencave materiale për të parandaluar apo ndëshkuar sjelljen kriminale, janë plotësuar.³⁴⁵

Indikatorët e kontrollit efektiv

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Blaškić, 29 korrik 2004

³⁴³ *Shih supra*, para. 59.

³⁴⁴ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Celebici*, para. 303, ku Gjykata e Apelit ka shpjeguar se doktrina e përgjegjësisë komanduese “e zhvilluar me një theks në personat të cilët, për arsye të pozitës të cilën ata e zëjnë, kanë kompetencat mbi të tjerët”. Kjo qasje gjendet po ashtu në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në rastin *Blaskic*, para 372ff: Gjykata e Apelit së pari ka konstatuar nëse Blaskic ka pasur “kompetenca komanduese” mbi policinë ushtarake (kompetencë që gjeti se ka mundur ta ketë për misione *ad hoc* në pajtim me kërkesat specifike, para 375-381), përpara se të vlerësojë nëse ai ka pasur kontroll efektiv mbi policinë ushtarake të përmendur (para 382 ff). Në aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në rastin *Kajelijeli* (para 85-86), Gjykata e Apelit e TPNR së pari ka sjell ndërmend se “epror është ai i cili posedon kompetenca apo autoritet mbi vartësit ose *de jure* ose *de facto*” (para 85), përpara se të nënvizojë prapë prapë që duhet arritur për vërtetimin e marrëdhënies epror-vartës, domethënë “që të konstatohet përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari ka patur kompetenca që të ushtrojë kontroll efektiv mbi vartësit e tij apo të saj” (para. 86) Shih po ashtu Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në rastin *Blagojevic dhe Jokic*, para 301-303.

³⁴⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Celebici*, faqe 254

Gjykata e Apelit po ashtu vë re se obligimi i komandantit për t'i raportuar autoritetit kompetent parashihet në mënyrë specifike në nenin 87(1) të Protokollit Shtesë I, dhe se obligimi mundet po ashtu të konkludohet nga dispozita e nenit 86(2) e Protokollit Shtesë I. Gjykata e Apelit po ashtu vë re se argumentet e Apeluesit se për të vërtetuar se kontrolli efektiv ka ekzistuar në kohën e kryerjes së krimeve nga vartësit, kërkohen prova se i akuzuari jo vetëm që ka qenë kompetent të lëshojë urdhra por se urdhrat në të vërtetë janë zbatuar. Gjykata e Apelit konsideron se kjo jep edhe një shembull të kontrollit efektiv të ushtruar nga komandanti. Treguesit e kontrollit efektiv janë më shumë çështje e provave se sa e të drejtës materiale, dhe këta tregues janë të kufizuar që të tregojnë se i akuzuari ka pasur kompetenca për të parandaluar, ndëshkuar, apo për të filluar masa të cilat çojnë deri të procedura kundër kryerësve të pretenduar aty ku janë të duhura. [...]

Aktgjykimi nga Gjykata e Apelit në rastin Halilovic, 16 tetor 2007

[...] Zotësia për të ushtruar kontroll efektiv në kuptim të kompetencës materiale për të parandaluar apo ndëshkuar, për të cilën Gjykata e Apelit konsideron të jetë kërkesa minimale për njohjen e marrëdhënies epror-vartës për qëllim të përgjegjësisë së lartë, nuk sigurohet pothuajse gjithnjë përveç nëse ekziston marrëdhënia e tillë e vartësisë.³⁴⁶ Gjykata e Apelit konsideron se kompetenca materiale për parandalimin dhe ndëshkimin mundet po ashtu të ekzistojë jashtë marrëdhënies epror-vartës relevante për nenin 7(3) të Statutit. Për shembull, një oficer i policisë mund të ketë kompetenca “të parandalojë dhe ndëshkojë” krimet nën juridiksionin e tij, por kjo si e tillë nuk e bën atë më të lartë (në kuptim të nenit 7(3) të Statutit) vis-avis ndonjë kryerësi brenda atij juridiksioni.

[...]

Gjykata e Apelit konsideron se cilësimi i lokacionit si një IKM [Vend Komandues i Avancuar (Istureno Komandno Mesto)] bart rëndësi meqë “IKM-të janë përdorur nga komandantët në

³⁴⁶ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Celebici*, para 303

mënyrë që ata të ushtrojnë komandën e tyre kur janë në terren”³⁴⁷ dhe vërtetimi i tyre si i tillë mund të përbëjë një nga “treguesit e kontrollit efektiv” siç theksohet nga trupi gjykues.³⁴⁸ [...] Gjykata e Apelit konsideron që prova se një i akuzuar jo vetëm që ka kompetenca për të lëshuar urdhra por urdhrat e tij në të vërtetë zbatohen, japin edhe një shembull tjetër të kontrollit efektiv.³⁴⁹ [...] Prandaj Gjykata e Apelit gjen se një gjykues i arsyeshëm i fakteve do të mund të arrinte në përfundim se urdhrat e Halilovicit nuk janë zbatuar dhe do të mund të merrte parasysh këtë faktor me rëndësi në vlerësimin e përgjithshëm të kontrollit efektiv të Halilovicit mbi kryerësit.

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Strugar, 17 korrik 2008

Gjykata e Apelit sjell ndërmend se kompetenca e eprorit për të lëshuar urdhra nuk vërteton automatikisht se eprori ka pasur kontroll efektiv mbi vartësit e tij, por është një nga treguesit që duhet të merret parasysh gjatë vërtetimit të kontrollit efektiv.³⁵⁰ Siç vendosi Gjykata e Apelit në rastin Halilovic, lidhur me kapacitetet e tilla “urdhrat në fjalë duhet më mirë të vlerësohen me kujdes nga pikëpamja e provave tjera në mënyrë që të konstatohet shkalla e kontrollit mbi kryerësit”.³⁵¹ Për shembull, në rastin Blaskic, Gjykata e Apelit gjeti se “nxjerrja e urdhrave humanitarë nuk vërteton vetë se Apeluesi ka pasur kontroll efektiv mbi trupat të cilët kanë pranuar urdhrat”.³⁵²

Realisht, ashtu siç u vendos nga Gjykata e Apelit në rastin Blaskic, “treguesit e kontrollit efektiv janë më shumë çështje e provave se sa e të drejtës materiale, dhe këta tregues janë të kufizuar të tregojnë se i akuzuari ka pasur kompetenca të parandalojë, të ndëshkojë, apo të fillojë masa

³⁴⁷ Aktgjykimi i Trupit Gjykues, para 212. Shih po ashtu Fjalën përfundimtare të prokurorisë, para 177.

³⁴⁸ Aktgjykimi i trupit Gjykues, para 58 (citet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaskic*, para 69) dhe para 363-372 (që bën konstatimet bazuar në treguesit e përmendur më lartë).

³⁴⁹ Cf. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaskic*, para 69.

³⁵⁰ Cf. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaskic*, para 68, 70, 139.

³⁵¹ *Ibid.*, para. 204.

³⁵² Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaskic*, para 485

të cilat çojnë në procedurë ndaj kryerësve të pretenduar kur është e përshtatshme.³⁵³ Prandaj, varet nga rrethanat e rastit në qoftë se një formë e dhënë e kompetencave të cilat janë në posedim të eprorit përbën një tregues të kontrollit efektiv.³⁵⁴ Për shembull, përvoja e përket kompetencave për të lëshuar urdhra, natyrën e urdhrave që eprori ka të drejtë të lëshojë, natyrën e kompetencave të tij për të bërë atë po ashtu edhe nëse urdhrat e tij në fakt zbatohen ose jo do të ishin relevante për të vlerësuar nëse eprori ka patur kompetenca reale për të parandaluar apo ndëshkuar.

Gjykata e Apelit sjell ndërmend se nëse me të vërtetë zbatohen urdhrat e eprorit ky mund të jetë tregues i kontrollit efektiv të eprorit mbi vartësit e tij.³⁵⁵ [...]

(ii) Eprori e ka ditur ose ka patur arsye ta dijë se vepra penale do të kryhet apo është kryer

Aktgjykimi nga Gjykata e Apelit në rastin *Krnojelac*, 17 shtator 2003

Gjykata e Apelit rithekson se vlerësimi i elementit mendor që kërkohet sipas nenit 7(3) të Statutit duhet, në çdo rast, të kryhet sipas rrethanave specifike të secilit rast, duke marrë parasysh situatën specifike të eprorit përkatës në kohën në fjalë.³⁵⁶

Aktgjykimi nga Gjykata e Apelit në rastin *Blaskic*, 29 korrik 2004

Gjykata e Apelit konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Celebici* ka vendosur çështjen e interpretimit të standardit të “ka pasur arsye ta dijë.” Në atë aktgjykim, Gjykata e Apelit thotë se “eprori do të jetë përgjegjës penalisht përmes parimit të përgjegjësisë së lartë

³⁵³ Ibid., para 69. Shih po ashtu Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në rastin *Haxhihasanovic* dhe *Kubura*, para 199.

³⁵⁴ Cf. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Halilovic*, para 191-192; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Haxhihasanovic* dhe *Kubura*, para 199-201.

³⁵⁵ Shih Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në rastin *Halilovic*, para 207.

³⁵⁶ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Celebici*, para.239.

vetëm nëse informata ka qenë e arritshme për të e që do ta kishte paralajmëruar atë për veprat e kryera nga vartësit.” Për më tepër, Gjykata e Apelit thotë se “shpërfillja e detyrës për të marrë informata të tilla, sidoqoftë, nuk paraqitet në dispozitë [neni 7(3)] si vepër e ndarë penale, dhe prandaj eprori nuk është përgjegjës sipas dispozitës për dështimet e tilla por vetëm për dështimin për të marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar apo për të ndëshkuar.” Nuk ka arsye që Gjykata e Apelit të largohet nga kjo pozitë.

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Hadžihasanović dhe Kubura

Në pajtim me nenin 7(3) të Statutit, njohuria e nevojshme për të nxitur detyrën e eprorit për të parandaluar vërtetohet kur eprori “e ka ditur apo ka pasur arsye ta dijë se vartësi [i tij] do të kryej [krimet]”. Trupi gjykues në rastin *Celebici* ka interpretuar këtë kërkesë duke pasur parasysh gjuhën e përdorur në nenin 86(2) të Protokollit Shtesë³⁵⁷ dhe vendosi se, sipas standardit “ka pasur arsye ta dijë”, kërkohet të vërtetohet që eprori ka pasur “informata të natyrës, të cilat së paku, do ta paralajmëronin për rrezikun [...] veprave duke treguar për nevojën për hetime shtesë në mënyrë që të konstatohet nëse krimet e tilla janë kryer apo do të kryhen nga vartësit e tij”.³⁵⁸ Si sqarim, Trupi gjykues shtoi se “[...] është e mjaftueshme që eprori ishte vënë në hetime të mëtejshme për shkak të informatës, apo, me fjalë tjera, se ka treguar për nevojën për hetime shtesë në mënyrë që të konstatohet nëse veprat janë duke u kryer apo ishin gati për t’u kryer nga vartësit e tij”.³⁵⁹

³⁵⁷ Neni 86(2) i Protokollit Shtesë I parasheh: “Fakti se është kryer shkelje e Konventës apo e këtij Protokollit nga një vartës nuk shfajëson eprorët e tij nga përgjegjësia penale apo disiplinore, siç është rasti, nëse e kanë ditur, apo kanë pasur informata të cilat është dashur t’u japin mundësi atyre të arrijnë në përfundim në rrethanat e atëhershme, se ai është duke e kryer apo është gati për të kryer një shkelje të tillë dhe po qe se ata nuk do të merrnin masa të mundshme brenda kompetencave të tyre për të parandaluar apo për të përmbajtur shkeljen”.

³⁵⁸ Aktgjykimi i Trupit Gjykues në rastin *Celebici*, para. 383 (vërteton se eprori “ka pasur arsye të dijë” për disa krime është i barasvlefshëm me vërtetimin se ai ka pasur dijeni të “padyshimtë” apo “konstruktive” për krimet e tilla).

³⁵⁹ Aktgjykimi i Trupit Gjykues në rastin *Celebici*, para. 393.

Gjykata e Apelit në rastin Celebici e vërtetoi këtë interpretim³⁶⁰ dhe vendosi se shpjegimi i arsyeshëm prapa standardit të parashtruar në nenin 86(2) të Protokollit Shtesë I është i qartë: “dështimi për të konkluduar, apo për të kryer hetime shtesë, në dritën e informatave alarmuese përbën njohuri për veprat e vartësit”.³⁶¹ Gjykata konstatoi se këto informata mund të jenë të përgjithshme në karakter³⁶² dhe nuk është e nevojshme të përmbajnë të dhëna specifike mbi aktet e paligjshme të cilat janë kryer apo do të kryhen.³⁶³ Gjykata vazhdoi se, në mënyrë që të demonstron se eprori ka pasur mens rea që kërkohet sipas nenit 7(3) të Statutit, duhet të vërtetohet nëse, në rrethanat e rastit,³⁶⁴ ai ka qenë në posedim të informatave mjaftueshëm alarmuese për të justifikuar hetimet e mëtutjeshme.

[...]

Përderisa njohuria e eprorit dhe dështimi i tij për të ndëshkuar vartësit e tij për veprat e kaluara është e pamjaftueshme, ne veten e vetë, për të arritur në përfundim se eprori e ka ditur se vepra të ngjashme do të kryhen në të ardhmen nga grupi i njëjtë i vartësve, kjo mund, varësisht nga rrethanat e rastit, megjithatë të përbëj informata alarmuese të mjaftueshme për të justifikuar

³⁶⁰ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Celebici, para. 241, citon Aktgjykimin e Trupit Gjykses në rastin Celebici, para 393.

³⁶¹ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Celebici, para. 232. Në paragrafin 233, Gjykata e Apelit gjeti më tej se, sipas nenit 86 të Protokollit Shtesë I, është e mjaftueshme që eprori ka pasur në posedimin e tij “informatat, të cilat, nëse kanë qenë të gatshme, do të obligonin [atë] të sigurojë më shumë informata (p.sh. të kryej hetime të mëtutjeshme).”

³⁶² Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Celebici*, para. 238. Gjykata e Apelit vendosi se “një paraqitje se eprori ka pasur disa informata të përgjithshme në posedimin e tij, të cilat do ta paralajmëronin për veprime të mundshme të paligjshme nga vartësit e tij, do të ishte e mjaftueshme për të provuar se ai “ka pasur arsye ta dijë”. Si shembull të informatës së përgjithshme e cila mund të jetë në dispozicion të eprorit, Gjykata e Apelit iu referua situatës taktike, niveli i trajnimit dhe udhëzimi i vartësve, dhe karakteret e tipareve të tyre. Komenti i TPNR lidhur me nenin 86 të Protokollit Shtesë I në fakt parasheh se “informatat e tilla në dispozicion të eprorit mund t’i japin atij mundësi të arrij në përfundim se ose janë kryer shkeljet ose do të kryhen”.

³⁶³ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Celebici, para. 238; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Krnojelac, para. 155.

³⁶⁴ Gjykata e Apelit në rastin Celebici vendosi se “vlerësimi i elementit mendor i cili kërkohet sipas nenit 7(3) të Statutit duhet të kryhet në bazë të rrethanave specifike të secilit rast, duke llogaritur situatën specifike të eprorit në fjalë në kohën në fjalë.” (Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Celebici, para. 239). Shih po ashtu komentin e KNJ mbi nenin 6 të KNJ Draft kodi i krimeve kundër paqes dhe sigurisë së njerëzimit: “Neni 6 parasheh dy kritere për përcaktimin nëse eprori duhet të mbahet përgjegjës për sjelljen e padrejtë të vartësve. Së pari, eprori është dashur ta dijë apo ka pasur arsye ta dijë në rrethanat në atë kohë që vartësi është duke kryer apo do të kryej një krim. Ky kriter tregon se eprori mund të ketë mens rea që kërkohet për të bartur mbi vete përgjegjësi penale në dy situata të ndryshme. Në situatën e parë, eprori ka njohuri ekzistuese se vartësi i tij është duke kryer apo do të kryej një krim [...]. Në situatën e dytë, ai ka *informata relevante të mjaftueshme për t’i mundësuar atij të arrij në përfundim sipas rrethanave në atë kohë se vartësit e tij janë duke kryer apo do të kryejnë një krim*” (Raporti i KNJ, faqe 37-38, cituar në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në rastin Celebici, para. 234).

hetime të mëtutjeshme.³⁶⁵ Për të bërë një vlerësim të tillë, Trupi Gjykses mund të merr parasysht dështimin e eprorit për të ndëshkuar krimin në fjalë. Dështimi i tillë është me të vërtetë relevant për përcaktimin nëse, në rrethanat e rastit, eprori ka qenë në posedim të informatave të cilat kanë qenë alarmuese mjaftueshëm për ta paralajmëruar atë për rrezikun që krime të ngjashme mund të kryhen më pas nga vartësit dhe të justifikojë hetimet e mëtejme. Lidhur me këtë, Gjykata e Apelit theksoi se dështimi i eprorit për të ndëshkuar krimin për të cilin ka pasur njohuri reale ka gjasa të kuptohet nga vartësit e tij së paku si pranim, nëse jo inkurajim, të sjelljes së tillë me ndikim të rritjes së rrezikut për kryerjen e krimeve të reja.

(iii) Eprori dështoi të merr masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprën penale apo të ndëshkojë kryerësin më pastaj

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Halilovic, 16 tetor 2007

[...] Detyra e përgjithshme e komandantëve që të marrin masa të nevojshme dhe të arsyeshme është thellë e rrënjosur në të drejtën ndërkombëtare zakonore dhe buron nga pozita e tyre e autoritetit.³⁶⁶ Gjykata e Apelit thekson se masat e “nevojshme” janë masat e duhura për eprorin të shkarkojë obligimin e tij (duke demonstruar se ai me të vërtetë ka provuar ta parandalojë apo ta ndëshkojë) dhe masat e “arsyeshme” janë ato që bien në mënyrë të arsyeshme brenda kompetencave materiale të eprorit.³⁶⁷ Çfarë përbën masat e “nevojshme dhe të arsyeshme” për

³⁶⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Krnojelac, para.169.

³⁶⁶ Shih për shembull, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin Aleksovski, para. 76.

³⁶⁷ Neni 86 i Protokollit Shtesë I parasheh se eprorët janë përgjegjës nëse, *inter alia* “ata nuk kanë marrë masa të mundshme brenda kompetencave të tyre për të parandaluar apo shtypur shkeljen”; lidhur me këtë, Komenti i TPNR shpjegon se, në mënyrë që eprori të jetë fajtor, duhet të demonstron se eprori “nuk ka marrë masa brenda kompetencave të tij për të parandaluar ato” dhe shtjellon se këto masa duhet të jenë “të përshtatshme” me që nuk është gjithmonë e mundur të parandalohet shkelja apo ndëshkimi i kryerësve” (Komenti i TPNR, para 3543 dhe 3548, theksim i shtuar; neni 87 shton detyrën për të “filluar hapa të tillë të cilët janë të nevojshëm për të parandaluar shkelje të tilla [...] dhe, kur është e përshtatshme, për të filluar veprime disiplinore apo penale kundër shkelësve.” *Shih* po ashtu vendimin e Gjykatës Supreme të SHBA-së në *In re Yamashita*, 327 US 1 (1945), në 16 (“masa të tilla [...] brenda kompetencave të tij dhe të duhura në rrethana”) dhe *SHBA kundër Karl Brandt et al.*, në TWC, Vëllimi II, faqe 212 (“Ligji i luftës e ngarkon oficerin ushtarak në një pozitë komanduese një detyrë pozitive të merr veprime të tilla të cilat janë brenda kompetencave të tij dhe të duhura për rrethanat për të kontrolluar ata nën komandën e tij...”)

të përmbushur detyrën e komandantit nuk është çështje e të drejtës materiale por çështje e provave.³⁶⁸

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Haxhihasanovic dhe Kubura*, 28 prill 2008

Ashtu siç vendosi Gjykata e Apelit më herët, “çfarë përbëjnë masat [e nevojshme dhe të arsyeshme] nuk është çështje e të drejtës materiale por e provave”;³⁶⁹ vlerësimi nëse eprori e ka kryer detyrën e tij për të parandaluar apo ndëshkuar sipas nenit 7(3) të Statutit duhet të bëhet në bazë të rast pas rastit, kështu që në atë mënyrë të merren parasysh “rrethanat që rrethojnë secilën situatë specifike”.³⁷⁰ Sipas nenit 86 të Protokollit Shtesë I, për shembull, eprorët e kanë për detyrë të marrin “të gjitha masat e mundshme brenda kompetencave të tyre” për të parandaluar apo ndëshkuar shkeljen e ligjeve të luftës dhe, sipas nenit 87 të Protokollit Shtesë I, “masat e mundshme” të tilla mund të marrin formën e të dyja masave “disiplinore apo penale”.³⁷¹ Nuk mund të përjashtohet se, në rrethanat e rastit, përdorimi i masave disiplinore do të ishte e mjaftueshme për të liruar eprorin nga detyra e tij për të ndëshkuar krimin sipas nenit 7(3) të Statutit. Me fjalë tjera, në qoftë se masat e marra kanë qenë vetëm të karakterit disiplinues, penal apo kombinim i të dyjave, nuk munden në vetvete të jenë vendimtare nëse eprori ka hequr dorë nga detyra e tij për të parandaluar apo ndëshkuar sipas nenit 7(3) të Statutit. Argumenti i prokurorisë është hedhur poshtë.

Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaskic*, 29 korrik 2004

Gjykata e Apelit konsideron se edhe pse përcaktimi i masave të nevojshme dhe të arsyeshme që kërkohen të merren nga komandanti në mënyrë që të parandalojë apo ndëshkojë kryerjen e

³⁶⁸ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaskic*, para. 72.

³⁶⁹ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaškić*, para. 72. *Shih po ashtu* Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në rastin *Halilovic*, para. 63-64.

³⁷⁰ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaškić*, para. 417.

³⁷¹ Neni 86 i Protokollit Shtesë I thotë se eprorët janë përgjegjës nëse ata, *inter alia*, nuk kanë marrë “të gjitha masat e mundshme brenda kompetencave të tyre për të parandaluar apo shtypur shkeljen”. Neni 87 i Protokollit Shtesë thotë se eprorët e kanë për detyrë të “fillojnë veprime të tilla aq sa janë të nevojshme për të parandaluar shkeljet e tilla [...] dhe, kur është e duhur, të fillojnë veprime *disiplinore apo penale* kundër shkelësve” (theksim i shtuar).

krimeve, varen në rrethanat që rrethojnë secilën situatë specifike, në përgjithësi pajtohet me Trupin Gjykses në rastin Celebici i cili vendosi:

duhet, megjithatë, të pranohet se e drejta ndërkombëtare nuk mund të obligojë eprorin të kryej të pamundurën. Kështu që, eprori mund të mbahet përgjegjës penalisht për dështimin për të marrë masa të tilla të cilat janë brenda kompetencave të tilla. Ngrihet pyetja pastaj cilat janë veprimet të cilat konsiderohen të jenë brenda kompetencave të eprorit në këtë kuptim. Si konkluzion për standardin e adoptuar nga Trupi gjykses përsa i përket konceptit të eprorit, ne arrijmë në përfundim se eprori duhet të mbahet përgjegjës për dështimin për të marrë masa të tilla të cilat janë brenda mundësive të tija materiale.³⁷²

b. Deklarimi i përgjegjësisë së lartë

Është vërtetuar qartë në jurisprudencën e TPNJ dhe TPNR se prokuroria duhet të deklarojë në aktakuzë mënyrën specifike të përgjegjësisë me të cilën i akuzuari është akuzuar, gjithashtu edhe faktet materiale që përforcojnë atë mënyrë të përgjegjësisë. Aty ku i akuzuari akuzohet me Përgjegjësi të Lartë, jurisprudenca ka specifikuar faktet materiale të cilat duhet të deklarohen në aktakuzë. Dështimi për të deklaruar fakte materiale të tilla me saktësi të duhur mund të çojë tek konstatimi se aktakuza është e mangët.

Ligji në fuqi

Statutit i TPNJ

Neni 7

Përgjegjësia penale individuale

³⁷² Aktgjykimi në rastin *Celebici*, para. 395.

[...]

3. Fakti që cilido prej veprimeve të përmendura në nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti u krye prej një vartësi, nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale nëqoftëse ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi do të kryente ose kishte kryer veprime të tilla dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimeve të tilla ose ndëshkimin e kryerësve të tyre.

[...]

Neni 21

Të drejtat e të akuzuarit

[...]

4. Në vërtetimin e çdo akuze kundër të akuzuarit në bazë të këtij Statuti, i akuzuari ka të drejtën e këtyre garancive minimale, në barazi të plotë:

(a) të informohet në kohë dhe në hollësi, në një gjuhë që ai e kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

[...]

Statuti i TPNR

Neni 6

Përgjegjësia penale individuale

[...]

3. Fakti që cilido prej veprimeve të përmendura në nenet 2 deri në 4 të këtij Statuti u krye prej një vartësi, nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale nëqoftëse ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi do të kryente ose kishte kryer veprime të tilla dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimeve të tilla ose ndëshkimin e kryerësve të tyre.

[...]

Neni 20

Të drejtat e të akuzuarit

[...]

4. Në vërtetimin e çdo akuze kundër të akuzuarit në bazë të këtij Statuti, i akuzuari ka të drejtën e këtyre garancive minimale, në barazi të plotë:

(a) të informohet në kohë dhe në hollësi, në një gjuhë që ai e kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

[...]

Jurisprudenca e TPNJ

Prokurori kundër Blaçoje Simic, IT-95-9-A, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, 29 nëntor 2006:

21. Praktika e të dyjave edhe e Tribunalit Ndërkombëtar edhe e TPNR kërkon që prokuroria të deklarojë mënyrën specifike apo mënyrat specifike të përgjegjësisë për të cilën akuzohet i akuzuari.

[...]

Prokurori kundër Tihomir Blaskic, Numri i lëndës IT-95-14-A, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, 29 korrik 2004:

218. Në pajtim me jurisprudencën e Tribunalit Ndërkombëtar, Gjykata e Apelit konsideron se në rastin ku pretendohet përgjegjësi penale e lartë sipas nenit 7(3) të Statutit, faktet materiale të cilat duhet të deklarohen në aktakuzë janë:

(a)

(i) që i akuzuari është eprori³⁷³ i (ii) vartësve të identifikuar mjaftueshëm,³⁷⁴ (iii) mbi të cilët ka pasur kontroll efektiv – në kuptim të kompetencave materiale për të

³⁷³ Vendimi në *Deronjic*, Numri i lëndës.: IT-02-61-PT, Vendim mbi formën e aktakuzës, 25 tetor 2002, para. 15 (urdhër prokurorisë që të deklarojë qartë pozitën e cila formon bazën për akuzat e përgjegjësisë së lartë

³⁷⁴ Vendimi në *Deronjic*, Numri i lëndës.: IT-02-61-PT, Vendim mbi formën e aktakuzës, 25 tetor 2002, para. 19

parandaluar apo ndëshkuar sjelljen kriminale³⁷⁵ – dhe (iv) për të cilat akte pretendohet të jetë përgjegjës,³⁷⁶

(b) sjellja e të akuzuarit përmes së cilës mund të konstatohet se

(i) e dinte apo ka pasur arsye ta dinte se krimet do të kryheshin apo ishin kryer nga vartësit e tij,³⁷⁷ dhe (ii) sjellja që ka të bëjë me ata të tjerët për të cilët pretendohet se është përgjegjës.³⁷⁸ Faktet relevante për veprimet e atyre të tjerëve për të cilat veprime i akuzuari pretendohet të jetë përgjegjës si epror, megjithëse prokuroria mbetet e obliguar të jep të gjitha hollësitë të cilat mundet t’i jep, zakonisht do të deklarohen me më pak saktësi,³⁷⁹ sepse hollësitë e atyre veprimeve vetvetiu nuk janë shumë shpesh në shqyrtim;³⁸⁰ dhe

³⁷⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Celebici*, para. 256.

³⁷⁶ Vendimi në *Krnjelac* mbi Kërkesat Paraprake mbi Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 11 shkurt 2000, para. 18; *Brdjanin dhe Talic* Vendim lidhur me Kundërshtimet e Momir Talic për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 20 shkurt 2001, para. 19; *Krajishnik*, Vendim lidhur me Propozimin Preliminar mbi Formën e Aktakuzës, 1 gusht 2000, para 9; *Haxhihasanovic*, Vendim mbi formën e Aktakuzës, 7 dhjetor 2001, para 11, 17; *Mrksic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 19 qershor 2003, para. 10.

³⁷⁷ Vendimi në *Krnjelac* mbi Kërkesat Paraprake mbi Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 11 shkurt 2000, para. 18; *Brdjanin dhe Talic* Vendim lidhur me Kundërshtimet e Momir Talic për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 20 shkurt 2001, para. 19; *Krajishnik*, Vendim lidhur me Propozimin Preliminar mbi Formën e Aktakuzës, 1 gusht 2000, para 9; *Haxhihasanovic*, Vendim mbi formën e Aktakuzës, 7 dhjetor 2001, para 11, 17; *Mrksic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 19 qershor 2003, para. 10.

³⁷⁸ *Krnjelac*, Vendim mbi Propozimin Preliminar të Mbrojtjes mbi Formën e Aktakuzës, 24 shkurt 1999, para. 38; *Haxhihasanovic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 7 dhjetor 2001, para. 11; *Mrksic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 19 qershor 2003, para. 10.

³⁷⁹ Vendimi në *Krnjelac* mbi Kërkesat Paraprake mbi Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 11 shkurt 2000, para. 18; *Brdjanin dhe Talic* Vendim lidhur me Kundërshtimet e Momir Talic për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 20 shkurt 2001, para. 19; *Krajishnik*, Vendim lidhur me Propozimin Preliminar mbi Formën e Aktakuzës, 1 gusht 2000, para 9; *Haxhihasanovic*, Vendim mbi formën e Aktakuzës, 7 dhjetor 2001, para 11, 17; *Mrksic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 19 qershor 2003, para. 10.

³⁸⁰ Vendimi në *Krnjelac* mbi Kërkesat Paraprake mbi Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 11 shkurt 2000, para. 18; *Brdjanin dhe Talic* Vendim lidhur me Kundërshtimet e Momir Talic për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 20 shkurt 2001, para. 19; *Prokurori kundër Kvočka et al*, numri i lëndës.: IT-98-30-PT, vendim mbi Propozimet Preliminare të Mbrojtjes mbi Formën e Aktakuzës, 12 prill 1999, para. 17; *Krajishnik*, Vendim lidhur me Propozimin Preliminar mbi Formën e Aktakuzës, 1 gusht 2000, para 9; *Haxhihasanovic*, Vendim mbi formën e Aktakuzës, 7 dhjetor 2001, para 11, 17; *Mrksic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 19 qershor 2003, para. 10.

(c) sjellja e të akuzuarit përmes së cilës ai mund të konstatohet se ka dështuar të merr masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprimet e tilla apo të ndëshkojë personat të cilët kanë kryer ato vepra.³⁸¹

Përsa i përket mens rea, ekzistojnë dy mënyra në të cilat gjendja relevante mendore mund të deklarohet: (i) ose duhet të deklarohet gjendja specifike mendore në vetvete si fakt material, në të cilin rast, faktet me të cilat fakti material do të vërtetohet janë çështje zakonisht të dëshmimeve, dhe nuk duhet të deklarohet; ose (ii) faktet e provave nga të cilat gjendja mendore duhet të nxirret si përfundim, duhet të deklarohet.³⁸² Secili nga faktet materiale duhet të deklarohet shprehimisht, edhe pse në disa rrethana mund të jetë e mjaftueshme nëse ato pasqyrohen nga ndonjë implikim i domosdoshëm.³⁸³ Ky rregull fundamental i deklarimit është, megjithatë, i pazbatuar nëse deklarimi thjeshtë supozon ekzistimin e kushtit ligjor paraprak.³⁸⁴

Jurisprudenca e TPNR

Ferdinand Nahimana et al. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit,

³⁸¹ *Brdjanin dhe Talic* Vendim lidhur me Kundërshtimet e Momir Talic për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 20 shkurt 2001, para. 19; *Krnjelac* 11 shkurt 2000 Vendim, para 18; *Krajishnik*, Vendim lidhur me Propozimin Preliminar mbi Formën e Aktakuzës, 1 gusht 2000, para 9; *Haxhihasanovic*, Vendim mbi formën e Aktakuzës, 7 dhjetor 2001, para 11, 17; *Mrksic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 19 qershor 2003, para. 10.

³⁸² *Brdjanin dhe Talic* 26 qershor 2001 vendim, para. 33; *Mrksic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 19 qershor 2003, para. 11.

³⁸³ *Brdjanin dhe Talic* Vendim lidhur me Kundërshtimet e Momir Talic për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 20 shkurt 2001, para. 19; *Prokurori kundër Brdjanin dhe Talic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës së Katërt të Ndryshuar, 23 nëntor 2001, para. 12; *Haxhihasanovic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 7 dhjetor 2001, para. 10; *Deronjic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 25 tetor 2001, para. 9; *Mrksic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 19 qershor 2003, para. 12.

³⁸⁴ *Brdjanin dhe Talic* Vendim lidhur me Kundërshtimet e Momir Talic për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 20 shkurt 2001, para. 19; *Haxhihasanovic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 7 dhjetor 2001, para. 10; *Mrksic*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës, 19 qershor 2003, para. 12.

322. Sipas nenit 17(4), 20(2), 20(4)(a) dhe 20(4)(b) të Statutit dhe Rregullit 47(C) të Rregullave, prokurori duhet të deklarojë faktet që përforcojnë akuzat në aktakuzë, por jo provat me të cilat faktet e tilla do të provohen.³⁸⁵ Aktakuza deklorohet me hollësi të mjaftueshme vetëm nëse ekspozon fakte materiale të rastit të prokurorisë me mjaft detaje për të informuar të pandehurin qartë për akuzat kundër tij apo asaj në mënyrë që ai apo ajo të mund të përgatiten për mbrojtjen e tij apo asaj.³⁸⁶ Aktakuza e cila dështon të parashtrojë si duhet faktet materiale specifike të cilat përforcojnë akuzat ndaj të akuzuarit është e mangët.³⁸⁷ Gjykata e Apelit thekson se çështja përse i përket nëse një fakt është material apo jo nuk mund të përcaktohet në mënyrë abstrakte: nëse konsiderohet “material” ose jo varet nga natyra e çështjes së prokurorisë.³⁸⁸

323. Gjykata e Apelit e ka bërë, megjithatë, të qartë se, kurdo që i akuzuari akuzohet me përgjegjësi të lartë në bazë të nenit 6(3) të Statutit, faktet materiale që duhet të deklarohen në akatkuza janë: (i) se i akuzuari është epror i vartësve të identifikuar mjaftueshëm mbi të cilët ka pasur kontroll efektiv – në kuptim të kompetencave materiale për të parandaluar apo ndëshkuar sjelljen kriminale – dhe për të cilat vepra pretendohet të jetë përgjegjës; (ii) veprat kriminale të kryera nga ata të tjerët për të cilët i akuzuari pretendohet të jetë përgjegjës; (iii) sjellja e të akuzuarit përmes së cilës mund të konstatohet se e ka ditur apo ka pasur arsye ta dijë se krimet do të kryhen apo janë kryer nga vartësit e tij; dhe (iv) sjellja e të akuzuarit përmes së cilës mund të konstatohet se ka dështuar të merr masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprat e tilla apo të ndëshkojë personat të cilët i kanë kryer ato.³⁸⁹ Lidhur me këtë elementin e fundit, do të ishte e mjaftueshme në të shumtën e rasteve të deklarohet se i akuzuari nuk ma marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar apo ndëshkuar kryerjen e veprave penale.

³⁸⁵ *Shih, inter alia, Simic* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 20; *Ntagerura et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 21; *Kupreskic et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 88.

³⁸⁶ *Shih, inter alia, Simic* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 20; *Ntagerura et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 21; *Kupreskic et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 88.

³⁸⁷ *Ntagerura et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 22; *Niyitegeka*, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit para. 195; *Kupreskic et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 114.

³⁸⁸ *Ndindabahizi*, Aktgjykim nga Gjykata e Apelit, para. 16; *Ntagerura et al.* Aktgjykimi Gjykatës së Apelit, para. 23.

³⁸⁹ *Ntagerura et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 26, citohet Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Naletilic dhe Martinovic*, para. 67, dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Blaskic*, para. 218.

324. Aktakuza mund të jetë e mangët po ashtu kur faktet materiale në të cilat thirret prokuroria janë deklaruar pa specifikim të mjaftueshëm.³⁹⁰ Lidhur me këtë, karakterizimi i prokurorit i sjelljes së pretenduar kriminale dhe afërsia në mes të akuzuarit dhe krimit të akuzuar janë faktorë vendimtarë në përcaktimin e shkallës së specifikimit me të cilën prokurori duhet të deklarojë faktet materiale të çështjes së tij në aktakuzë.³⁹¹

Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në rastin *Tharcisse Renzaho kundër Prokurorit*, , 1 prill 2011:

64. Gjykata e Apelit sjell ndërmend se kur një i akuzuar akuzohet në bazë të nenit 6(3) të Statutit, një nga faktet materiale që duhet deklaruar në aktakuzë është “që i akuzuari është epror i vartësve të identifikuar mjaftueshëm, mbi të cilët ka pasur kontroll efektiv [...] dhe për të cilat veprime pretendohet të jetë përgjegjës”.³⁹² Eprori nuk ka nevojë të dijë saktësisht identitetin e vartësve të cilët kryejnë krime në mënyrë që ata të sjellin mbi vete përgjegjësinë sipas nenit 6(3) të Statutit.³⁹³ Gjykata e Apelit vendosi që kryerësit fizik të krimeve mund të identifikohen përmes kategorisë përsa i përket vendit të caktuar të krimit.³⁹⁴

Aktakuza nga Gjykata e Apelit, *Anatole Ntabakuze kundër Prokurorit*, Numri i rastit. ICTR-98-41A-A, 8 maj 2012:

123. Gjykata e Apelit sjell ndërmend përsa i përket [dështimit për të parandaluar apo ndëshkuar], në shumë raste do të ishte e mjaftueshme të deklarohet se i akuzuari nuk ka marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar apo ndëshkuar kryerjen e veprave

³⁹⁰ *Muhimana*, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 76, 167, 195 dhe 217; *Ntagerura et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 27.

³⁹¹ *Ntagerura et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 23, referuar *Kvocka et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 28. Shih po ashtu *Ntakirutimana*, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 73-74; *Kupreskic et al.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, para. 89.

³⁹² Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në rastin *Muvunyi*, para. 19 (theksim i shtuar).

³⁹³ Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në rastin *Muvuyi*, para. 55, referuar Aktgjykimit i Gjykatës së Apelit në rastin *Blagojevic dhe Jokic*, para. 287.

³⁹⁴ *Shih, p.sh.* Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në rastin *Simba*, para. 71, 72.

penale.³⁹⁵ Kjo buron nga fakti se dështimi i të akuzuarit për të parandaluar apo ndëshkuar mundet shpesh të konkludohet nga karakteri i vazhdueshëm apo i përhapur i shkeljeve të kryera nga vartësit e tij siç pretendohet në aktakuzë.³⁹⁶

125. Rishikimi i aktakuzës reflekton se prokuroria nuk ka deklaruar qartë dështimin e Ntabakuzes të parandalojë apo të ndëshkojë krimet e vartësve të tij. Megjithatë, Gjykata e Apelit vë re se paragrafi 6.18 i aktakuzës, në të cilin është mbështetur në mënyrë specifike në mbështetje të përgjegjësisë së lartë të Ntabakuzes, deklaroi se krimet e pretenduara në aktakuzë ishin kryer në bazë të urdhrave dhe direktivave të tij. Kjo, sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, e ka paralajmëruar Ntabakuzen se ai pretendohet të ketë dështuar të merr masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar apo ndëshkuar krimin.

[A] Paralajmërim i mëtejshëm është siguruar përmes pretendimeve për krimet e përsëritura dhe të vazhdueshme të vartësve të Ntabakuzes nga batalioni para-komando,³⁹⁷ dhe pretendimi në

³⁹⁵ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Renzaho*, para. 54; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Nahimana et al.*, para. 323.

³⁹⁶ Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Cf. Muvunyi* i datës 29 gusht 2008, para. 62. Gjykata e Apelit theksoi se gjetjet në paragrafin 44 në Aktgjykimi e Gjykatës së Apelit në rastin *Muvunyi* të datës 29 gusht 2008 në të cilat u mbështet Ntabakuze duhet të lexohen në kontekst. Shih [*Theoneste Bagosora et al* kundër Prokurorit, Numri i rastit ICTR-98-41-A, Përmbledhje e Ndryshuar e Apelit në dobi të: Majorit Aloys Ntabakuze, 24 qershor 2009, e korrigjuar nga Përmbledhja e Apelit të Ndryshuar në dobi të: Majorit Aloys Ntabakuze Korrigjimi i Dytë ("Përmbledhje e Apelit"), para. 43, 44. Në rastin *Muvunyi*, Gjykata e Apelit gjeti se prokurori ka dështuar të deklarojë në aktakuzë rolin e që kanë luajtur vartësit e Tharcisse Muvunyi në sulmin ndaj Manastirit Beneberika. Shih Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në rastin *Muvunyi* të datës 29 gusht 2008, para. 40, 41. Përkundrejt këtij sfondi Gjykata e Apelit arriti në përfundim se përsëritja e thjeshtë e elementeve juridike të përgjegjësisë së lartë nuk ka qenë e mjaftueshme për të paralajmëruar për sjelljen e të akuzuarve nga e cila mund të konstatohet se ai ka dështuar të merr masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar apo ndëshkuar. Shih *ibid.*, para. 44, 45. Në një pjesë tjetër të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në rastin *Muvunyi* të datës 29 gusht 2008 lidhur me sulmet në Universitetin e Butares, Gjykata e Apelit e refuzoi parashtresën e Tharisse Muvunyi se aktakuza e tij është e mangët përse i përket deklarimit për dështimin e tij për të parandaluar dhe ndëshkuar vartësit e tij. Gjykata e Apelit jepi arsyetimin se Trupi Gjykues ka konkluduar padysim se dështimi i Tharcisse Muvunyi nga natyra e shkeljeve të kryera nga vartësit e tij, e cila rrjedhë nga pohimet në aktakuzë se sulmet kundër Universitetit kishin qenë "të përhapura". Shih *ibid.*, para. 62]

³⁹⁷ Shih Aktakuzën, para. 6.8, 6.15, 6.19, 6.36, 6.41, 6.44. Është mbështetur në gjithë këta paragrafë përse i përket përgjegjësisë së lartë nën akuzat relevante. Shih aktakuzën, faqe 46, 48-53.

paragrafin 6.44 të aktakuzës se “disa njësi të batalionit para-komando, zbuluese dhe gardës presidenciale kanë qenë më të implikuar në këto krime”.³⁹⁸

Fusnota 88: Gjykata e Apelit vë re se prokuroria duket se parashtrohet se, duke pasur parasysh karakterin e përhapur të masakrës, dhe përfshirjen e praktikisht të secilës njësi ushtarake në kryerjen e tyre në lokacione të shumëfishta kudo në Kigali dhe prefektura tjera, ka qenë “legjitime” për aktakuzën të jep vetëm shembuj të disa lokacioneve ku kanë ndodhur masakrat. Shih [*Theoneste Bagasora et al. v. Prokurori*, numri i rastit ICTR-98-41-A, Përmbledhja e Prokurorit në Përgjigje të Ankesës së Aloys Ntabakuze, 7 shtator 2009 (Përmbledhje Përgjigjes së Prokurorit)], para. 31. Shih *po ashtu* AT. 27 shtator 2011 faqe 39. Gjykata e Apelit e konsideron këtë argument të pabazuar. Gjykata e Apelit më herët ka deklaruar se “faktet relevante për veprimet e të tjerëve për të cilat veprime i akuzuari pretendohet të jetë përgjegjës si epror...zakonisht deklarohen me më pak saktësi sepse detajet e atyre veprave janë shpesh të panjohura, dhe për shkak se veprat vetvetiu nuk janë shpesh në diskutim”. Shih *Muvunyi* Aktgjykim nga Gjykata e Apelit 29 gusht 2008, para. 58, *citohet Ntageruara et al.* Aktgjykim nga Gjykata e Apelit, para. 26, fusnota 82, *citohet Blaskic* Aktgjykim nga Gjykata e Apelit, para. 218. Megjithatë, aktakuza duhet të deklarojë sjelljen kriminale të vartësve për të cilët pretendohet se është përgjegjës i akuzuari. Shih *infra*, para. 100. Më së paku, kjo përfshin deklarimin e vendit dhe datën e përafërt të veprave të pretenduara penale dhe mënyrën se si janë kryer kur këto informata janë në posedim të prokurorisë.

Prandaj, në pajtim me jurisprudencën e TPNJ, aty ky pretendohet përgjegjësi penale e lartë faktet materiale mbi të cilat prokuroria mbështete duhet deklaruar në aktakuzë.³⁹⁹

³⁹⁸ Është mbështetur në paragrafin 6.44 të aktakuzës për të gjitha akuzat relevante sipas nenit 6(3) të Statutit. Shih aktakuzën, faqe 46, 48-53.

³⁹⁹ *Prokurori kundër Tihmoir Blaskic*, TPNJ, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, 29.07.2004, para.218; *Prokurori kundër Miroslav Deronjic*, para. 15 (urdhërimi i prokurorisë të deklarojë qartë pozitën që formon bazën për akuza të përgjegjësisë së lartë); *Prokurori kundër Milorad Krnojelac*, TPNJ, Vendimi i trupit Gjykues mbi Propozimet Preliminare mbi formën e Aktakuzës së Ndryshuar, 11.02.2000, para.18; *Prokurori kundër Radoslav Brdjanin dhe Momir Talic*, TPNJ, vendimi i Trupit Gjykues, 20.02.2001, para. 19.

Akuza 1 ndaj të akuzuarve, **NK, FL dhe NS** dhe Akuza 2 ndaj **FL** pretendon përgjegjësi të lartë të akuzuarve “si komandantë të UÇK-së” dhe/ose “anëtarë të UÇK-së të cilët mbajnë pozita me përgjegjësi brenda qendrës së ndalimit në Kleçkë, në krimin e cenimit të integritetit trupor dhe të shëndetit të një numri të pidentifikuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe robërve ushtarak serbë, të ndaluar në burgun e Kleçkës.

Aktakuza përmend individë specifik të cilët iu nënshtruan trajtimit çnjerëzor. Në Akuzën 1 kundër secilit prej të akuzuarve, prokurori nuk ka deklaruar fakte tjera materiale.

Nën Akuzën 2 **FL** akuzohet si “komandant” në krim të torturimit të burgosurit ushtarak serb, të ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë.⁴⁰⁰ Megjithatë, aktakuza përmban vetëm fakte materiale lidhur me pjesëmarrjen aktive të **FL** në krim. Në veçanti, aktakuza thotë se **FL** ka marrë në pyetje, ka qëlluar me grusht dhe ka shkëlmuar të burgosurin ushtarak serb, së bashku me të akuzuar tjerë të specifikuar.⁴⁰¹

Aktakuza për Akuzën 1 ndaj **NK1, FL dhe NS** dhe Akuza 2 ndaj **FL** dështon të deklarojë dhe të demonstrojë fakte materiale mbi ekzistimin e marrëdhënies epror-vartës; dhe se të akuzuarit e kanë ditur apo kanë pasur arsye ta dinë se vepra penale do të kryhet apo është kryer; dhe se të akuzuarit kanë dështuar të marrin masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprën penale apo të ndëshkojnë kryerësit.

Aty ku pretendohet përgjegjësi e lartë marrëdhënia e secilit prej të akuzuarve me vartësit e tij është esenciale. Pragu që duhet arritur në vërtetimin e marrëdhënies epror-vartës është ai i kontrollit efektiv mbi vartësit – kompetencat materiale për të parandaluar apo ndëshkuar sjelljen, sido që ushtrohet ai kontroll.⁴⁰²

⁴⁰⁰ Aktakuza, faqe 9.

⁴⁰¹ Aktakuza, faqe 29, 30.

⁴⁰² *Prokurori kundër Zejnel Delalic, Zdravko Mucic, i njohur si “Pavo”, Hazim Delic, Esad Landzo, i njohur si “Zenga”, TPNJ, Aktgjykimi Gjykatës së Apelit, 20.02.2001, para. 256.*

Më tej, është e rëndësishme të demonstrohet se të akuzuarit kanë pasur njohuri për krimet dhe të akuzuarit kanë dështuar të marrin masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar krimet apo për të ndëshkuar vartësit e tij.

Për më tepër, aty ku prokurori deklaron përgjegjësi të lartë, nuk është e përshtatshme të përkrahet ajo përgjegjësi nga pretendimet e pjesëmarrjes aktive të të akuzuarit, përfshirë dhënies së urdhrave kryerësve tjerë. Akuzat e përgjegjësive së lartë kërkojnë të vërtetojnë përgjegjësinë për lëshimet – aty ku deklarohet përgjegjësia e lartë me të drejtë, i akuzuari mbahet përgjegjës për dështimin për të marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar vepra të caktuara, apo për dështimin për të ndëshkuar kryerësit. Aty ku vartësit pretendohet të kenë zbatuar urdhrat e të akuzuarit, atëherë akuzat nuk është ajo e përgjegjësive komanduese.⁴⁰³

Aty ku të akuzuarit akuzohen me të dyja, edhe me përgjegjësi të lartë penale edhe me pjesëmarrje aktive (përgjegjësi personale), aktakuza duhet të ndajë qartë këto veprime sepse faktet e njëjta nuk mund në mënyrë të njëkohshme të shkaktojnë të dy llojet e përgjegjësive.⁴⁰⁴

Në mënyrë që të jetë i zbatueshëm parimi i përgjegjësive së lartë, është e nevojshme që eprori të ketë kontroll efektiv mbi personat të cilët kryejnë shkeljet themelore të së drejtës humanitare ndërkombëtare, në kuptim të pasurit të kompetencave materiale për të parandaluar dhe ndëshkuar kryerjen e këtyre veprave”.⁴⁰⁵

⁴⁰³ *Prokurori kundër Protais Zigiranyirazo*, TPNJ, Vendimi i Trupit Gjyqësor mbi Propozimin me Kusht të Prokurorisë për Leje për të ndryshuar Aktakuzën dhe mbi Kundër-Propozimin e Mbrojtjes ku kundërshtohet Forma e Rimodelimit të Aktakuzës, 02.03.2005, para. 19.

<http://www.unictr.org/Portals/0/Case/English/Zigiranyirazo/decisions/020305.pdf>.

⁴⁰⁴ *Shih Prokurori kundër Joseph Kanyabashi*, TPNR, Vendim i Trupit Gjyqësor mbi Propozimin Preliminar të Mbrojtjes lidhur me Mangësitë në Formën e Aktakuzës, 31.05.2000, para. 5.5-5.11, <http://www.unictr.org/Portals/0/Case/English/Kanyabashi/decisions/defect.pdf>.

⁴⁰⁵ *Prokurori kundër Zejnil Delalic, Zdravko Mucic, i njohur si “Pavo”, Hazim Delic, Esad Landzo, i njohur si “Zenga”, TPNJ, Aktgjykim i Shqyrtimit Gjyqësor, 16.11.1998, para. 377-378; dhe konfirmuar në Prokurori kundër Zejnil Delalic, Zdravko Mucic, i njohur si “Pavo”, Hazim Delic, Esad Landzo, i njohur si “Zenga”, TPNJ, Aktgjykim i Gjykatës së Apelit, 20.02.2001, para. 197.*

ii. Ligji mbi format e përgjegjësisë së akuzuar në aktakuzë

a. Kryerja

“Kryerja” e krimit është kryerja fizike e krimit apo shkaktimi i mosveprimit të fajshëm në shkelje të ligjit penal”.⁴⁰⁶

Actus reus që kërkohet për kryerjen e krimit është që i akuzuari të ketë marrë pjesë, drejtpërdrejt fizikisht apo ndryshe, në elementet materiale të krimit të paraparë në ligj, përmes veprimeve pozitive apo mosveprimeve, sidoqoftë individualisht apo bashkërisht me të tjerët.⁴⁰⁷ Parakushti për *mens rea* është që i akuzuari të ketë vepruar me dashje për të kryer krimin, apo me të pasurit dijeni për probabilitetin, në kuptim të gjasave të mundshme, se krimi do të ndodhë si pasojë e sjelljes së tij.

Krimi mund të kryhet përmes pjesëmarrjes në një veprimtari të përbashkët kriminale.

Përgjegjësia penale individuale rezulton jo vetëm në lidhje me personat që kryejnë veprimet kriminale, por po ashtu, në rrethana të caktuara, në lidhje me ata të cilët në ndonjë mënyrë e bëjnë të mundur për kryesin që fizikisht të kryej atë veprim.

Kur një numër i personave përfshihen në një plan të përbashkët me qëllim të kryerjes së një krimi, ata mund të dënohen për pjesëmarrje në veprimtari e përbashkët kriminale lidhur me atë krim.

b. Bashkëkryerja

⁴⁰⁶ Aktgjykimi i Trupit Gjyqes, në rastin *Krstic*, para. 601; Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në rastin *Tadic*, para 188; Aktgjykimi i Trupit Gjyqes, në rastin *Kunarac*, para 390

⁴⁰⁷ Aktgjykimi i Trupit Gjyqes në rastin *Kordic*, para 376.

Bashkëkryerja në kontekst të veprimtarisë së përbashkët kriminale dallon nga ndihma dhe mbështetja. Ku ndihmësi dhe mbështetësi e di se vetëm asistenca e tij është duke i ndihmuar një personi të vetëm për të kryer një krim të vetëm, ai është përgjegjës vetëm për ndihmë dhe mbështetje të atij krimi. Kjo është kështu edhe në qoftë se kryerësi kryesor është pjesë e veprimtarisë së përbashkët kriminale që përfshinë kryerjen e krimeve tjera.

Aty ku, sidoqoftë, i akuzuari e di se ndihma e tij është duke përkrahur krimet e grupit të personave të përfshirë në veprimtari të përbashkët kriminale dhe e ndanë dashjen, atëherë ai mund të gjendet përgjegjës penalisht për të gjitha krimet në mbështetje të qëllimit të përbashkët si bashkëkryerës.

Janë identifikuar tri lloje të veprimtarive të përbashkëta kriminale në jurisprudencën e TPNJ-së.⁴⁰⁸ Të gjitha ato kërkojnë, përsa i përket *actus reus*, ekzistimin e planit të dizajnuar të përbashkët apo të qëllimit, që përbën apo që përfshinë kryerjen e krimit që parashihet në Statutin e TPNJ-së, dhe pjesëmarrjen e të akuzuarit në planin e përbashkët:

- (a) I akuzuari ka për qëllim të kryej krimin dhe ky qëllim ndahet nga të gjithë bashkëkryerësit;
- (b) I akuzuari ka njohuri për natyrën e sistemit të shtypjes, në zbatimin e së cilës merr pjesë, dhe dashjen për ta shtyrë përpara qëllimin e përbashkët. Në raste të tilla dashja e kërkuar mund të jetë e mundur të konkludohet nga njohuria e provuar e krimeve të cilat janë duke u kryer dhe pjesëmarrja e vazhdueshme, si dhe nga pozita e autoritetit që mban i akuzuari; dhe
- (c) Ato raste në të cilat njëri nga pjesëmarrësit kryen një krim jashtë planit të përbashkët: Në raste të tilla *mens rea* është e dyfishtë.

⁴⁰⁸ Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në rastin Tadic; Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në rastin Kvočka dhe *Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në rastin Krnojelac*

- i. I akuzuari duhet të ketë qëllimin të merr pjesë dhe të kontribuoj në synimin e përbashkët kriminal; dhe
- ii. Në mënyrë që të mbahet përgjegjës për krimet të cilat nuk kanë qenë pjesë e synimit të përbashkët kriminal, por që ishin megjithatë pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme, i akuzuari duhet ta dijë po ashtu se krimi i tillë mund të kryhet nga një anëtar i grupit, dhe vullnetarisht e merr rrezikun se krimi mund të ndodhë duke u bashkuar apo duke vazhduar pjesëmarrjen në veprimtari.

Prania e pjesëmarrësit në veprimtarinë e përbashkët kriminale në kohën e kryerjes së krimit nga kryerësi kryesor nuk kërkohet.

Përgjegjësia për krimet e kryera përtej qëllimit të përbashkët të një veprimtarie të përbashkët kriminale, por e cila ishte “pasojë natyrale dhe e parashikuar” rrjedhë vetëm nëse prokuroria provon se i akuzuari ka pasur njohuri të mjaftueshme krimet tjera të atilla që ishin pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme për të. Nëse krimet e kryera jashtë qëllimit të përbashkët të veprimtarisë së përbashkët kriminale ishin “pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme” duhet të vlerësohet lidhur me njohurinë e të një të akuzuari specifik.

c. Dhënia e urdhrit

Actus reus i “urdhrit” kërkon që personi në pozitën me autoritet të udhëzojë një person tjetër që të kryej një vepër.

Nuk është e nevojshme të demonstron ekzistimi i një strukture komanduese formale epror-vartës apo marrëdhënie në mes urdhëruesit dhe kryesit. Është e mjaftueshme që urdhëruesi të ketë kompetenca dhe autoritet, ose *de jure* ose *de facto*, që të urdhërojë kryerjen e një vepre, apo që autoriteti i tij të mund të nënkuptohet në mënyrë të arsyeshme.

Nuk ka nevojë që urdhri të jepet me shkrim, apo në ndonjë formë tjetër, dhe ekzistimi i urdhrit mund të provohet përmes provave rrethore.

Përsa i përket *mens rea*, i akuzuari duhet të ketë pasur për qëllim të shkaktojë kryerjen e krimit, apo të ketë qenë i informuar për gjasat reale se krimi do të kryhet si pasojë e zbatimit apo implementimit të urdhrit.

I. GJETJET MBI PËRGJEGJËSINË E TË AKUZUARVE

AK është akuzuar me tri pika në aktakuzë.

Akuza 1 e akuzon **AK** me Krime lufte kundër popullsisë civile dhe robërve të luftës⁴⁰⁹ ku pretendohet se, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK1, NK2, NSH, BL, BS, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X, **SS2** dhe të ushtarë të tjerë të UÇK-së deri më tash të pa identifikuar, ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pa definuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarak serbë të cilët ishin ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (përfshirë të burgosur të lidhur me zinxhirë, objekte të papërshtatshme, të ftohtë të tepërt, mungesë të higjienës, ushqim jo adekuat, rrahje të shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999.

Akuza 2 akuzon **AK** me Krime lufte kundër robërve të luftës⁴¹⁰ ku pretendohet se, në cilësinë e tij se anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **NK2, NS, RM, NK1** dhe dëshmitarin bashkëpunues X

⁴⁰⁹ Sipas neneve 142, 144 të KPRSFJ, po ashtu e paraparë në nenet 120, 121 të KPK, lexuar lidhur me nenet 22, 24, 26 të KPRSFJ dhe 23, 25, 26 të KPK, në shkelje të nenit 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe neneve 4, 5(1) të PSHII

⁴¹⁰ Sipas neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht e ndëshkueshme sipas neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të nenit 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe nenet 4, 5(1) të PSHII

ka marrë pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb, të ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë, mbetjet e të cilit janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës i cili përmbante pesë kufoma; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke i siguruar **NSH**, kryesi i drejtpërdrejtë i vrasjes, një kosë, ndonëse e ka ditur, për shkak të qenit i informuar qartë për qëllimet e **NS**, se ky i fundit do të vrasë të burgosurin me kosë; në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, në një datë të papërcaktuar në prill 1999, jo përpara 11 prillit 1999.

Akuza 2 ishte tërhequr nga prokurori special i EULEX-it në pajtim me Tërheqjen e Pjesëshme të Aktakuzës, datë 09 nëntor 2011, e ushtruar në gjykatë më 11 nëntor 2011, siç u paraqit në seancën e datës 11 nëntor 2011.

Akuza 3 akuzon **AK** me Krime lufte kundër robërve të luftës⁴¹¹ ku pretendohet se, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së në bashkëkryerje me **FL**, **NK2**, **NS**, **NK1**, **BL** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, ka marrë pjesë në vrasjen e **ND** dhe **VM**, që të dy oficerë serbë të policisë të ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë, të cilët janë ekzekutuar nga dëshmitari bashkëpunues X me disa të shtëna me pistoletë; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në veprën penale duke i bërë të dy të burgosurit të marshojnë deri në vendin e ekzekutimit dhe duke i mbajtur viktimat në dispozicion të drejtpërdrejtë të kryesit të ekzekutimit, edhe pse ai e ka ditur (sepse është informuar në mënyrë të qartë për urdhrat e **FL**), apo së paku ka mundur të parashikojë me lehtësi nga urdhrat e marrë (duke i bërë të burgosurit serbë të marshojnë në një vend të largët në pyll) se çdo të ndodhë me ta; në vendin e quajtur Livadhi i Canit, afër Kleçkës, Lipjan, më apo rreth datës 04/05 prill të vitit 1999;

UK ka qenë anëtar i UÇK-së dhe ka qenë i vendosur në Kleçkë për rreth një muaj në mes majit dhe qershorit 1999. **UK** i kujtohej se roja e burgut në Kleçkë ka qenë **AZ**, me nofkën "**M**". Ai e ka parë **AZ** në Kleçkë në baza të rregullta.

⁴¹¹ Sipas neneve 22, 144 të KPRSFJ, aktualisht e ndëshkueshme sipas neneve 23, 120 të KPK, në shkelje të nenit 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949 dhe nenet 4, 5(1) të PSHII

UK po ashtu dëshmoi se roje e burgut ka qenë **AK**.⁴¹²

Dëshmitë në të cilat mbështetet prokuroria në përkrahje të përgjegjësisë penale individuale të **AK** bazohen në deklaratat e **AZ**.

UK deklaroi se ai ka qenë i vendosur në Kleçkë në mes majit dhe qershorit 1999. Gjetjet e trupit gjykues më lartë ishin se dëshmitari anonim H, vëllai i tij dhe **SA** ishin nënshtruar trajtimit mizor në burgun e Kleçkës. Megjithatë, dëshmia e dëshmitarit anonim H ishte se ai dhe vëllai i tij ishin dërguar në Kleçkë më 27 shkurt 1999. Provat kanë treguar se **SA** ishte ndaluar në burgun e Kleçkës në mars 1999, mbase, deri më 3 prill 1999. Periudha e kohës në mes shkurtit dhe 3 prillit 1999 nuk është koha kur **UK** deklaroi se ka qenë i vendosur në Kleçkë. Sidoqoftë, deklarata me shkrim e **UK**, në të cilin thjeshtë e identifikon **AK** si “një roje tjetër e burgut”, është qartë e pamjaftueshme për t’ia mundësuar trupit gjykues të arrij përfundimet mbi fajësinë e **AK**. Në veçanti, përsa i përket vrasjes së **NGJ** dhe **VM**, aktakuza pretendon se **AK** ka vënë viktimat në dispozicion të kryesit të ekzekutimit, duke i marshuar ata te vendi i ekzekutimit. Duke lënë anash dëshminë e **AZ**, nuk ka prova në dosje për të mbështetur gjetjen lidhur me sjelljen e pretenduar të **AK** në vrasjen e **NGJ** dhe **VM**.

Është konstatimi i trupit gjykues se kushtet e ndalimit në burgun e Kleçkës nuk përbëjnë *per se* trajtim çnjerëzor.

Trupi gjykues gjen se **DT** dhe **DV** janë vrarë në mënyrë të paligjshme.

Trupi gjykues ka gjetur se **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe se si rrjedhojë do të ishte e pasigurt të mbështetet në dëshmitë e tij. Edhe po qe se trupi gjykues do të arrinte në përfundim se **AZ** ka qenë dëshmitar i besueshëm, neni 157 (4) i KPPK-së parasheh se gjykata nuk duhet të shpall asnjë person fajtor vetëm në bazë të dëshmive të dhëna nga dëshmitari bashkëpunues.

⁴¹² Dëshmitari anonim I, *supra*

Trupi gjykues gjen se nuk është provuar se **AK** ka kryer veprat me të cilat është akuzuar.

Akuza 2 ishte tërhequr nga prokurori special i EULEX-it në pajtim me Tërheqjen e Pjesëshme të Aktakuzës, datë 9 nëntor 2011, e ushtruar në gjykatë më 11 nëntor 2011, siç u paraqit në seancë të datës 11 nëntor 2011. Megjithatë, kjo akuzë mbeti në aktakuzë. Për këtë arsye, akuza 2 është refuzuar sepse prokurori e tërhoqi akuzën gjatë shqyrtimit gjyqësor.

NK1 ishte akuzuar me gjashtë akuza në aktakuzë.

Akuza 1 akuzon **N** me Krime lufte kundër popullsisë civile dhe Krime lufte kundër robërve të luftës⁴¹³ ku pretendohet se ai, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe komandant, dhe si person që mbante pozitë me përgjegjësi mbi qendrën e ndalimit në Kleçkë, në bashkëkryerje me **FL, NK2, NSH, AK, BL, BS, SS1**, dëshmitarin bashkëpunues X, **SS2** dhe të tjerë ushtarë të UÇK-së të paidentifikuar deri më sot, ka cenuar integritetin trupor dhe të shëndetit të një numri të padefinuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosur ushtarak serbë, të ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (përfshirë të burgosur të lidhur me zinxhirë, objekte të papërshtatshme, në kushtet e të ftohtit të tepërt, mungesë të higjienës, ushqim joadekuat, rrahje të shpeshta); në Kleçkë, Komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit të vitit 1999.

Akuza 2 ngarkon **NK1** për Krime Lufte kundër popullatës Civile⁴¹⁴ me pretendimin se ai, si anëtar i UÇK-së, në bashkëveprim me **NK2, NS dhe RM**, kanë vrarë **AA**, një kosovar shqiptar civil, i cili më parë kishte qenë i ndaluar dhe më pas ishte liruar nga qendra e ndalimit në Kleçkë,

⁴¹³ Sipas neneve 22, 142, 144 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, aktualisht e ndëshkueshme sipas neneve 23, 120 të Kodit Penal të Kosovës, në shkelje të nenit 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, dhe nenet 4, 5(1) të Protokollit Shtesë II i të katër Konventave të Gjenevës

⁴¹⁴ sipas neneve 22, 142 KPRSFJ, aktualisht sipas Neneve 23, 120, KPK, në kundërshtim me Nenin 3, i përbashkët për të katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve 4, 5(1) APII

duke e qëlluar me armë zjarri AK-47; në Kleçkë, komuna Lipjan, më apo rreth datës 03/04 prill 1999.

Akuza 3 ngarkon **NK1** për Krime Luftë kundër Robërve të Luftës⁴¹⁵ me pretendimin se ai, si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëveprim me **NK2, NS** dhe dy ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së, kanë marrë pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë, mbetjet mortore të të cilëve u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës dhe identifikuar përmes ADN-së si **BC, ZF dhe ZT**, të cilët u ekzekutuan me disa plumba nga arma e zjarrit AK-47, nga një grup që përbëhej nga **NK1, NK2, NS**, dhe dy ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së; në Kleçkë, komuna Lipjan, në një datë të papërcaktuar në prill 1999, jo para datës 11 prill 1999.

Akuza 4 ngarkon **NK1** për Krime Luftë kundër Robërve të Luftës⁴¹⁶ me pretendimin se ai, si anëtar i UÇK-së, në bashkëveprim me **NK2** ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb, ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë, duke e rrahur atë në mënyrë të përsëritur; më pas viktimë u vra dhe mbetjet e tij mortore u gjetën në një varr masiv afër Kleçkës ku ishin pesë kufoma; në Kleçkë, komuna Lipjan, në një datë të papërcaktuar në prill 1999, jo para datës 11 prill 1999.

Akuza 5 ngarkon **NK1** për Krime Luftë kundër Robërve të Luftës⁴¹⁷ me pretendimin se ai, si anëtar i UÇK-së, në bashkëveprim me **NK2, NS, RM, AK** dhe dëshmitarin bashkëpunues X kanë marrë pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb, përmendur më lart në akuzën 4; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke bërë të burgosurin të marshojë në vendin e ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë, **NS**, megjithëse e dinte, sepse ishte informuar qartë mbi qëllimin e **NS** për të vrarë të burgosurin, nga një bisedë

⁴¹⁵ sipas neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualisht sipas Neneve 23, 120, KPK, në kundërshtim me Nenin 3, I përbashkët për katër Konventave të Gjenevës 1949, dhe Neneve 4, 5(1) APII

⁴¹⁶ sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualisht sipas Neneve 23, 120, KPK, në kundërshtim me Nenin 3, I përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe Neneve 4, 5(1) APII

⁴¹⁷ Sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualisht sipas neneve 23, 120, KPK, në kundërshtim me Nenin 3, I përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe Nenet 4, 5(1) APII

e mëparshme mes këtij të fundit dhe **FL**, se i burgosuri do të ekzekutohej, në Kleçkë, komuna Lipjan, në një datë të papërcaktuar në prill 1999, jo para datës 11 prill 1999.

Akuza 6 ngarkon **NK1** me Krime Luftë kundër Robërve të Luftës⁴¹⁸ me pretendimin se ai, si anëtar i UÇK-së, në bashkëveprim me **FLN, NK2, NS, AK, BL** dhe dëshmitarin bashkëpunues X, ka marrë pjesë në vrasjen e **NDJ** dhe **VM**, dy oficerë policie serbë, ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë, të cilët u ekzekutuan nga dëshmitari bashkëpunues X me disa të shtëna me pistoletë; më saktësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në krim duke i mbajtur viktimat në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, megjithëse e dinte, sepse ishte informuar në mënyrë të qartë mbi qëllimin e **FL** për të vrarë të burgosurit, se çfarë do t'u ndodhte atyre; në një lokacion të njohur si Livadhi i Canit afër Kleçkës, komuna Lipjan, më apo rreth datës 4 apo 5 prill 1999.

Në aktakuzë pretendohet se **NK1**, si anëtar dhe komandant i UÇK-së, dhe si person i cili ka patur post përgjegjësie në qendrën e ndalimit në Kleçkë, dhe në bashkëveprim me të akuzuar të tjerë të specifikuar, ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të papërcaktuar civilësh serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, ndaluar në qendrën e ndalimit në Kleçkë.

Trupi Gjykues gjen se kushtet e ndalimit në burgun e Kleçkës nuk përbëjnë *per se* trajtim mizor, por se nga individët e listuar në Aktakuzë, Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij dhe **SA** i janë nënshtruar trajtimit mizor.

Më tej, në aktakuzë pretendohet se **NK1**, duke vepruar në bashkëveprim, ka vrarë **AA**; ka marrë pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në burgun e Kleçkës; ka cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb ndaluar në burgun e Kleçkës; dhe pas kësaj ka marrë pjesë në vrasjen e të burgosurit ushtarak serb; dhe ka marrë pjesë në vrasjen e **VM** dhe **NDJ**.

⁴¹⁸ Sipas Neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualisht sipas neneve 23, 120, KPK, në kundërshtim me Nenin 3, I përbashkët për katër Komventat e Gjenevës 1949, dhe Nenet 4, 5(1) APII;

Roli i NK1 në burgun e Kleçkës:

Disa dëshmitarë, përfshirë **QK**,⁴¹⁹ dhe **BZ**,⁴²⁰ njihnin **NK1** si anëtar të Brigadës 121 (Brigada 'Kumanova'). Gjatë zhvillimit të Shqyrtimit Kryesor **NK1** konfirmoi se pseudonimi I tij ishte '**BF**'.⁴²¹

BZ, I cili ishte shef shtabi I shtabit të përgjithshëm të UÇK-së nga janari 1999 deri në prill 1999, deklaroi se pas nëntorit/dhjetorit 1998 komandant i Brigadës 121 u bë HS. BZ I kujtohej se '**BF**' ishte anëtar I Brigadës 121 nën komandën e ^{FL} dhe më vonë nën komandën e HS.⁴²²

Sa i përket çështjes së komandës, Trupi Gjykses vë re se, sipas dëshmisë së Dëshmitarit Anonim C, në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në Llapushnik, ishte një gjykatës mysliman që urdhëroi ushtarët të arrestonin Dëshmitarin Anonim C. Paskëtej, Dëshmitari Anonim C është vozitur deri në Terpeze.

Dëshmitari Anonim C rikujtoi se si njërit nga ushtarëve të UÇK-së u është referuar si '**BF**' apo '**N**'. 'Bashkim Fino' ishte njëri nga tre ushtarët e UÇK-së që vozitën Dëshmitarin Anonim C në Terpeze, e burgosën atë në Terpeze/Trpeza, e morën në pyetje dhe ishte i pranishëm gjatë rrahjes së Dëshmitarit Anonim C si dhe mori pjesë në këtë rrahje dhe më vonë e liroi dhe e solli Dëshmitarin Anonim C në Kleçkë.⁴²³

Mirëpo, deklarata e Dëshmitarit Anonim C është e paqartë sa i përket identitetit të '**BF**'. Asnjëherë nuk është kërkuar nga ai të identifikojë personin e njohur si **BF**. Dëshmitari Anonim C deklaroi se pas luftime, ai është përpjekur të kuptojë se kush është '**BF**' dhe zbuloi se emri i tij

⁴¹⁹ QK, *supra*

⁴²⁰ BZ, *supra*

⁴²¹ Procesverbali I datës 11.11.2011, para.25, nëndosja penale 3e gjykatës. Gjatë seancës së paraburgimit më datë 16 mars 2011, **NK1** tha se pseudonimi '**BF**' ishte ai që kishte pasur gjatë luftës. Shih *procesverbalin e seancës së paraburgimit* 16.03.2011, p.1, GJPP nëndosja 2.

⁴²² Bislim Zyrap, *supra*

⁴²³ Dëshmitari Anonim C, *supra*

është **NS**.⁴²⁴ Kësisoj, Trupi Gjykes nuk ia doli të nxjerrë nga dëshmia e Dëshmitarit Anonim C se ishte i akuzuari **NK** ai i cili voziti Dëshmitarin Anonim C në Kleçkë, gjë që mund të shërbejë si tregues i funksioneve të **NK** sa i përket Kleçkës.

Sidoqoftë, **NK1** nuk është akuzuar lidhur me asnjë vepër të pretenduar penale në Terpeze.

Për më tepër, Dëshmitari Anonim C tha se nuk e ka parë personin që e njeh si Bashkim Fino në Kleçkë.

Sa i përket Kleçkës, BZ rikujtoi se ka parë '**BF**' në selinë e Brigadës 121 në Kleçkë apo Berishë, sepse shtabi lëvizte kohë pas kohe.⁴²⁵ Mirëpo, dëshmia e BZ nuk dha detale të tjera sa i përket rolit të **NK1** në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, detale që do t'i mundësonin Trupi Gjykes të arrijë ndonjë përfundim.

NK1 deklaroi se ka qene ne burgun ne Kleçkë kohë pas kohe, duke dërguar persona aty apo duke i marrë në pyetje, por jo për të inspektuar burgun. Ai ka vizituar Kleçkën edhe për shkak se komanda e Brigadës 121 ishte aty. Sipas **NK1**, puna e tij përbëhej nga lëndët ndaj ushtarëve të UÇK-së, mirëpo, nuk i kujtohet se janë dërguar civilë në burg edhe pse kjo ka qenë e mundur. **NK1** asnjëherë nuk pa ndonjë civil serb apo ushtar në Kleçkë. Siç shihet edhe nga deklarata e **NK1**, ai ka punuar ngusht me **SD** dhe në punën e tij i është përmbajtur udhëzimeve të **SD**.⁴²⁶

SD dëshmoi se në disa raste, ai ka urdhëruar individë të caktuar në ndalim në burgun në Kleçkë. Në veçanti, **SD** është referuar rastit të **BK**, i cili është akuzuar për dezertim dhe **SD** urdhëroi që **BK** të ndalohet në burgun në Kleçkë në pritje të zbatimit të dënimit të tij. Mirëpo, sipas dëshmisë së **SD**, burgu ishte nën kontrollin fizik të policisë ushtarake të UÇK-së dhe një person i caktuar ishte përgjegjës për burgun – një 'drejtor' burgu – emri i të cilit nuk i kujtohej **SD**. Në të njëjtën kohë, **SD** e njohte '**BF**', por vetëm si polic ushtarak. **SD** e kishte parë në Kleçkë si dhe në

⁴²⁴ Dëshmitari Anonim C

⁴²⁵ **BZ**, *supra*

⁴²⁶ **NK**, *supra*.

Shtab të Përgjithshëm, dhe SD i kishte dhënë 'BF' udhëzime sa i përket sjelljes së policisë ushtarake.

Nga dëshmia e SD, nuk është bërë e qartë se NK1 ('BF') ka ushtruar komandë mbi burgun në Kleçkë. Trupi Gjykues vë re se edhe pse SD deklaroi se kishte vizituar burgun në Kleçkë rregullisht, SD përshkroi 'BF' si polic ushtarak.⁴²⁷

Në këtë pikë, edhe BZ i rikujtohet 'BF', por vetëm si anëtar i Brigadës 121 dhe BZ nuk dinte gjë më shumë sa u përket detyrave të 'BF'.⁴²⁸

Dëshmitari Anonim H dëshmoi se kur anëtarët e UÇK-së morën dëshmitarin H dhe të vëllanë më 27 shkurt 1999, në një moment të caktuar, Dëshmitari Anonim H dhe i vëllai ishin të gjunjësuar. Një person, i veshur me rroba civile dhe i armatosur me mitraloz qëlloi me një të shtëënë krejt afër kokës së Dëshmitarit Anonim H. Dëshmitari Anonim H nuk e dinte se a ishte kjo gjë aksident apo me qëllim, por një person tjetër, i veshur me rroba civile, i kishte thënë: 'Bashkim, çfarë po bën?' Pasi që personat në grup biseduan në mes tyre, ata urdhëruan Dëshmitarin Anonim H dhe të vëllanë të leviznin edhe 10 metra të tjera mbi kodër dhe të shtriheshin. Dëshmitari Anonim H mendoi se do të vriteshin, por një person me pushkë u tha të mos frikësoheshin sepse nuk do t'i vrisnin. Dëshmitari Anonim H është informuar se një komandant do t'a vendoste fatin e tyre. Pas rreth 10 minutash, erdhi një komandant me një grup prej katër deri në gjashtë meshkuj, të gjithë me uniforma dhe shenja dalluese të UÇK-së. Më tutje, Dëshmitari Anonim H dhe i vëllai janë vendosur në një veturë.⁴²⁹

Trupi Gjykues gjeti se Dëshmitari Anonim H dhe i vëllai i tij janë dërguar në burgun në Kleçkë dhe i janë nënshtruar trajtimit mizor.

⁴²⁷ SD, *supra*

⁴²⁸ BZ, *supra*

⁴²⁹ Dëshmitari Anonim H, *supra*

Dëshmia e Dëshmitarit Anonim H sugjeron se **'B'** mori pjesë në marjen e Dëshmitarit Anonim H dhe vëllait të tij në ndalim, por se ky pastaj priti udhëzimet e komandantit epror. Provat tregojnë se **'BF'** ishte nofka e **NK1**.

UK rikujtoi se në prill 1999, kur janë sjellur katër zyrtarë serbë në Kleçkë, ishte **NK ('BF')** ai i cili mori nën kontroll zyrtarët serbë.⁴³⁰ **UK** poashtu tregoi se **NK1 ('BF')** ishte 'polic i zonës' dhe detyra e tij ishte të kryente hetime dhe ai mund të hetonte kë të donte.⁴³¹

Sa i përket dëshmisë së Dëshmitarit Anonim H dhe **UK**, Trupi Gjykses duhet të bëjë dallimin se kur kjo provë ka të bëjë me rolin e **NK1** në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë dhe me pretendimet e veçanta faktike për pjesëmarrjen aktive të **NK1** në krimet e pretenduara. Sa i përket kësaj të dytes, dëshmitë e secilit dëshmitar anonim kanë të bëjnë me pretendime të veçanta, dhe si të tilla, vihet në veprim nenin 157(3), KPPK.

Sa i përket rolit të **NK1** në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, as dëshmia e Dëshmitarit Anonim H as dëshmia e **UK** nuk tregojnë se **NK1** ka dhënë urdhër apo udhëzime apo ka ushtruar masa disiplinore në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë. Derisa provat dëshmojnë se **NK1** është parë në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, provat nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar se **NK1** ka ushtruar komandë mbi qendrën e ndalimit.

Duke shqyrtuar përgjegjësinë e lartë të **NK1** në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, Trupi Gjykses vë re se provat sugjerojnë se **NK1** ishte i ndërlidhur edhe me dy ekipe të UÇK-së në dy lokacione, atë në Bellanice dhe në Shale (Lipjan). Prandaj, nuk duket se **NK1** është ekskluzivisht i lidhur me Kleçkën, por është ndarë në të paktën tre lokacione.

Sa i përket Bellanicës, Trupi Gjykses vë re se **AH**, administrator në policinë ushtarake në UÇK, ka dhënë dëshmi se që nga fundi i vitit 1998, ishte i caktuar në Bellanicë dhe mbikqyrësi i tij i parë

⁴³⁰ Prova P6, Dëshmitari Anonim I, *supra*

⁴³¹ Dëshmitari Anonim I, *supra*

ishite **UG** dhe më lart në zinxhirin komandues ishte **NK1**.⁴³² Mirëpo, **AH** nuk i dinte detyrat e **NK1**.

Sipas dëshmisë së **IZ**, ish-anëtar i Brigadës 121, një ekip i përbërë prej shtatë deri në tetë policë ushtarakë ishte i caktuar në Bellanicë dhe udhëheqësi i tyre ishte **UG**. Mirëpo, **IZ** nuk e dinte se kush ishte komandanti i policisë ushtarake për gjithë rajonin.⁴³³

BZ dëshmoi se në korrik/gusht 1998, ai i është bashkangjitur policisë ushtarake dhe është caktuar në Bellanicë. Udhëheqësi i ekipit të tij ishte **UG**. Sipas **BZ**, askush nuk e dinte se cili i raportonte cilit. Më vonë, **BZ** mësoi se **UG** raportonte te **NK2**. Ishte pjesa e detyrave të **BZ** të përcillte levizjet e ushtarëve. Si ekip, ata asnjëherë nuk arrestuan askë. **BZ** asnjëherë gjatë luftës nuk kishte qenë në Kleçkë.⁴³⁴

Ndërsa sa i përket Shalës, nga dëshmia e **SB** del se nga mesi i muajit janar 1999, ai i përkiste policisë ushtarake dhe ishte i caktuar në Shalë. Komandanti i tij ishte **AS** dhe më lart në zinxhirin komandues ishte **NK1**. Sipas dëshmisë së **SB**, detyra e tyre në Shalë ishte të mbahej rendi në treg ku kishte levizje të popullsisë, e cila ishte zhvendosur nga serbët. Ata poashtu ndihmuan popullsinë e zhvendosur për t'u rinvendosur. Një pjesë e detyrës së **SB** ishte të hetonte ushtarët e UÇK-së për shkelje disiplinë, por **SB** nuk rikujton të ketë pasur raste të tilla.⁴³⁵

Përgjegjësia e NK1:

Duke pasur parasysh këto që janë thënë më lart, provat nuk e lejojnë Trupin Gjykses të gjejë ekzistimin e marrëdhënies epror-vartës në mes të **NK1** dhe individëve që trajtuan të ndaluarit në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë.

⁴³² **AH**, 14.12.2010, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Policia e EULEX-it, Dosja PSRK D; **AH**, *supra*.

⁴³³ **IZ**, *supra*

⁴³⁴ **BZ**, *supra*

⁴³⁵ **SB**, *supra*

Provat nuk i mundësojnë Trupi Gjykest të jetë i sigurt se **NK1** e dinte apo kishte arsye për të ditur se individë të caktuar, siç ishte Dëshmitari Anonim H, i vëllai apo **SA** do t'i nënshtroheshin trajtimit mizor apo se i ishin nënshtuar trajtimit mizor; dhe se **NK1** nuk ia doli të ndërmarre masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar krimet apo për të dënuar kryerësit e tyre.

Prandaj, Trupi Gjykues gjen se nuk është dëshmuar se **NK1** ka ushtruar përgjegjësi të lartë.

Përpos përgjegjësisë së lartë, aktakuza pretendon pjesëmarrje aktive të **NK1** në cenimin e integritetit trupor dhe shëndetit të civilëve serbë, atyre shqiptarë dhe të ndaluarve ushtarakë serbë në burgun në Kleçkë. Trupi Gjykues gjen se kushtet në burgun në Kleçkë në vetëvete nuk përbëjnë trajtim mizor, por se nga individët e listuar në aktakuzë, Dëshmitari Anonim H, i vëllai dhe SHAi janë nënshtuar trajtimit mizor.

Siç është cekur edhe më parë, dëshmia e Dëshmitarit Anonim H sugjeron se 'Bashkimi' mori pjesë në ndalimin e Dëshmitarit Anonim H dhe vëllanë e tij. Mirëpo, sipas nenit 157 (3), KPPK, Trupi Gjykues nuk gjen të akuzuarin fajtor bazuar vetëm apo deri në një pikë vendimare, në dëshminë e Dëshmitarit Anonim H.

Për më tepër, **SD** shkoi në burgun në Kleçkë menjëherë pasi mësoi se Dëshmitari Anonim H dhe i vëllai ishin ndaluar në Kleçkë. Sipas deklaratës së **SD**, kur shkoi ky në burg, pa 'drejtorin' e burgun dhe një grua aty. **SD** konsultoi **BZ** dhe janë pajtuar që të burgosurit t'i dorëzoheshin OSBE-së. Paskëtaj, **SD** urdhëroi transferimin e tyre.⁴³⁶ **SD** kishte parë Dëshmitarin Anonim H dhe vëllanë e tij pasi që i ishin nënshtuar trajtimit mizor në burgun në Kleçkë, mirëpo, dëshmia e **SD** fare nuk sugjeron ndërlidhje të **NK1** në krime.

⁴³⁶ *Ibid.*

Trupi Gjykues gjen se kushtet e ndalimit në burgun në Kleçkë në vetëvete nuk përbëjnë trajtim mizor, por se nga individët e listuar në aktakuzë, Dëshmitari Anonim H, i vëllai dhe **SA** i ishin nënshtruar trajtimit mizor.

Prandaj, Trupi Gjykues gjen se nuk është dëshmuar se **NK1** i nënshtroi Dëshmitarin Anonim H, vëllanë e tij apo **SA** ndaj trajtimit mizor.

Për më tepër, aktakuza pretendon se **NK1** në bashkë-kryerje vrau **AA**; mori pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në burgun në Kleçkë; ceno integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb në burgun në Kleçkë; dhe paskëtaj, mori pjesë në vrasjen e të burgosurit ushtarak serb dhe mori pjesë në vrasjen e **VM** dhe **ND**.

Prokuroria mbështetet plotësisht në dëshmitë e **AZ** sa i përket pjesëmarrjes së pretenduar të **NK1** në vrasjen e **AA**;⁴³⁷ pjesëmarrjen e tij në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të mbajtur në burgun në Kleçkë;⁴³⁸ cwnimin e tij të integritetit trupor dhe shëndetit dhe vrasjen e të burgosurit ushtarak serb të ndaluar në burgun në Kleçkë;⁴³⁹ dhe vrasjen e tij të **VM** dhe **ND**.⁴⁴⁰

Sa u përket këtyre krimeve, dosja nuk përmban dëshmi të tjera që flasin për fajësinë e **NK1**. Gjetja e mbetjeve mortore nuk ndihmon për të arritur deri te identiteti i kryerësve. Sa i përket vrasjes së **AA**, Prokuroria i referohet Dëshmitarit Anonim C dhe Dëshmitarit D, por as këta dëshmitarë nuk dëshmojnë sa i përket identitetit të kryerësve.

Trupi Gjykues gjeti se **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe si pasojë, nuk do të ishte e sigurt mbështetja në dëshminë e tij. Edhe po të kishte arritur Trupi Gjykues gjetje tjetër sa i

⁴³⁷ Aktakuza, pp.28, 29.

⁴³⁸ Aktakuza, pp.32, 33.

⁴³⁹ Aktakuza, pp.29, 30, 30, 31. Është vënë re se në faqet 29, 30 të aktakuzës, prokurori ka kualifikuar krimet e kryera ndaj të burgosurit ushtarak serb si torturë. Mirëpo, akuza sa i përket NK1 nuk përfshin veprën penale torturë por në vend të kësaj, 'cënim i integritetit trupor dhe shëndetit të një të burgosuri ushtarak serb' (*shih akuzën 4 ndaj NK1 në aktakuzë, f.4*).

⁴⁴⁰ Aktakuza, f.27, 28.

përket besueshmërisë së **AZ**, nuk do të mund të përcaktohej fajësia e **NK1** bazuar në këtë dëshmi, sipas nenit 157(4), KPPK, sipas të cilit, 'gjkata nuk shpallë askë fajtor bazuar vetëm në provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues'.

Trupi Gjykues gjen se nuk është dëshmuar se **NK1** ka kryer veprat penale me të cilat është ngarkuar.

NK2 akuzohet me shtatë pika të aktakuzës.

Akuza 1 ngarkon **NK2** me veprën penale Krime lufte ndaj popullatës civile dhe robërve të luftës⁴⁴¹, me pretendimin se në cilësinë e anëtarit të UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **FL, NK1, NS, AK, BS, SS1**, Dëshmitarin Bashkëpunues X dhe **SS2** dhe ushtarë të tjerë, deri tani të paidentifikuar të UÇK-së, çenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të të burgosurve civilë serbë dhe shqiptarë dhe ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e tyre me zinxhirë, objekte të papërshtatshme, të ftohtin e tepërt, mungesën e kushteve higjienike, të ushqyer joadekuat, rrahje të shpeshta); në Kleçkë, komuna e Lipjanit nga fillimi 1999 deri mesi i qershorit 1999.

Akuza 2 ngarkon **NK2** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁴² me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me Dëshmitarin Bashkëpunues **X, NS, SS1, BS**, torturoi katër të burgosur ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë,

⁴⁴¹ Sipas neneve 22, 142, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), APII

⁴⁴² Sipas nenit 22, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KP, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1) PShII

mbetjet mortore të të cilëve janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës, ku të paktën tre prej tyre janë identifikuar nëpërmjet ADN-së se janë **BC, ZF dhe ZT**, duke i rrahur vazhdimisht, në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999, jo para datës 11 prill 1999.

Akuza 3 ngarkon **NK2** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁴³ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **NK1, NS** dhe dy ushtarë, deri tani të paidentifikuar të UÇK-së, mori pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, mbetjet mortore të të cilëve janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës, tre prej të cilëve janë identifikuar nëpërmjet ADN-së si **BC, ZF dhe ZT**, duke u ekzekutuar me disa të plumba të armës AK-47 nga një grup i përbërë nga **NK1, NK2, NS** dhe dy ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së, në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999, por jo para 11 prillit 1999.

Akuza 4 ngarkon **NK2** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁴⁴ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **NK1**, cënoi integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, duke e rrahur vazhdimisht; si pasojë, viktima është vrarë dhe mbetjet e tij mortore janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës, që mbante pesë trupa të pajetë; në Kleçkë, komuna e Lipjanit, në një datë të pacaktuar në prill 1999, por jo para 11 prillit 1999.

Akuza 5 ngarkon **NK2** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁴⁵ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **NK1, NS, RM, AK** dhe Dëshmitarin Bashkëpunues X, mori pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb, të përmendur nën akuzën 4 lart; më saktë, i pandehuri mori pjesë në krim duke marrshuar të burgosurin deri te vendi i ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejt, **NS**, edhe

⁴⁴³ Sipas neneve 22, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK, në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1) PSHII

⁴⁴⁴ Sipas neneve 22, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK, në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1) PSHII

⁴⁴⁵ Sipas neneve 22, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PSHII

pse e dinte, duke qenë i informuar në mënyrë të qartë mbi qëllimin e **NS** për të vrarë të burgosurin nga biseda e mëparshme në mes të dytit dhe **FL**, se i burgosuri do të ekzekutohej; në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999, jo para 11 prillit 1999.

Akuza 6 ngarkon **NK2** me veprën penale Krime lufte ndaj popullatës civile⁴⁴⁶ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **NK1**, **NS** dhe **RM**, vrau **AA**, civil shqiptar i Kosovës, i cili më parë është ndaluar dhe është liruar nga Qendra e Ndalimit në Kleçkë, duke shtënë në të me armën AK-47 në Kleçkë, komuna e Lipjanit, më apo rreth datës 3 apo 4 prill 1999.

Akuza 7 ngarkon **NK2** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁴⁷ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me **FL**, **NK1**, **NS**, **AK**, **BL** dhe Dëshmitarin Bashkëpunues X, mori pjesë në vrasjen e **ND** dhe **VM**, dy policë serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, të cilët u ekzekutuan nga Dëshmitari Bashkëpunues X me disa të shtëna pistolete; më saktë, i pandehuri mori pjesë në krim duke e mbajtur viktimën në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, edhe pse e dinte, duke qenë i informuar në mënyrë të qartë mbi qëllimin e **FL** për të vrarë të burgosurit, se çfarë do të ndodhte me ta; në lokacionin e njohur si Livadhi i Canit afër Kleçkës, komuna e Lipjanit më apo rreth 4 apo 5 prill 1999.

Aktakuza pretendon se **NK2**, si anëtar i UÇK-së dhe në bashkëkryerje me të akuzuarit e tjerë të caktuar çënoi integritetin trupor dhe shëndetin e civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë. Trupi Gjykues gjeti se Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij i janë nënshtruar trajtimit mizor në Qendrën e Ndalimit të UÇK-së në Kleçkë, me gjasë në shkurt 1999, dhe Sherafedin Ajeti, diku në mars 1999 deri 3 prill 1999.

⁴⁴⁶ Sipas neneve 22, 142 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120 KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PShII

⁴⁴⁷ Sipas neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PShII

Për pretendimin për cënim të integritetit trupor dhe shëndetit të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe atyre të burgosurve ushtarakë, në aktakuzë prokuroria i referohet dëshmitarëve anonimë **B, I, L dhe M**, të cilët kanë parë **NK2** në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë.⁴⁴⁸ Sa i përket kësaj, Trupi Gjykues gjeti se kushtet e ndalimit në vetëvete nuk përbëjnë trajtim mizor.

Prokuroria ngriti akuzat ndaj **NK2** bazuar në pjesëmarrjen aktive të **NK2** në krimet e pretenduara dhe jo bazuar në përgjegjësinë e lartë. Prandaj, Trupi Gjykues ka për të shqyrtuar përgjegjësinë e **NK2** vetëm bazuar në pretendimin për pjesëmarrjen e tij aktive.

Gjatë gjithë kohës përkatëse, **NK2** ka vepruar në lokacione të ndryshme në Kosovë.

BZ, i cili i është bashkangjitur Policisë Ushtarake në korrik/gusht 1998 dhe ishte i caktuar në Bellanicë dëshmoi se udhëheqësi i ekipit të tij ishte **UG**, i cili raportonte te **NK2**. **BZ** e kishte parë **UG** dhe **NK2** duke ardhur dhe duke shkuar. Më vonë, **BZ** kishte mësuar se **NK2** ishte i caktuar në 'Kosterc', si shef i policisë ushtarake.⁴⁴⁹

Në deklaratën e tij, **NK** tha se në dhjetor 1998 ai është transferuar në zonën operative të Pashtrikut në Kasterc (Suharekë) si komandant i Policisë Ushtarake dhe Brigada 123 ishte përgjegjëse për atë pjesë.⁴⁵⁰

SD dëshmoi se **NK2** ishte polic ushtarak që vepronte në zonën operative të Pashtrikut. Për më tepër, **SD** kujtoi që kishte kontaktuar **NK2** kur kishte shkuar në burgun në Kervasari.⁴⁵¹

Sipas dëshmisë së **BZ**, **NK2** ishte anëtar i Brigadës 121 dhe që nga dhjetori 1998 apo janari 1999, ai ishte komandant i batalionit të policisë ushtarake nën komandën direkte të drejtoratit të

⁴⁴⁸ Aktakuza, f.26.

⁴⁴⁹ BZ,

⁴⁵⁰ Çertifikë nga TMK, e datës 17 shtator 2004, dy dokumente të nënshkruara nga NK, të datës 16 dhe 25 shkurt 1999, bashkangjitur procesverbalit të marrjes në pyetje të AZ më 5 korrik 2011

⁴⁵¹ SD, *supra*

policisë ushtarake të drejtuar nga **FL**. Batalioni i policisë ushtarake ishte i shpërndarë në lokacione të ndryshme, Divjakë, Berishë dhe Lladroc. Me sa e dinte BZ, **NK2** lëvizte nëpër këto lokacione varësisht nga nevojat.⁴⁵²

Mirëpo, provat poashtu sugjerojnë se rreth dhe gjatë kohës relevante, **NK2** është parë edhe në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë.

Dëshmitarët anonimë L, M, I dhe B dëshmuar se **NK2** ka kryer disa funksione të caktuara në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, përfshirë edhe ato në kontekst të procedurave ndaj anëtarëve të UÇK-së. Mirëpo, njëri nga dëshmitarët lidhi **NK2** saktësisht me trajtim mizor të disa individëve specifikë, sikurse Dëshmitari Anonim H apo i vëllai i tij apo **SA**.

Dëshmitari Anonim L deklaroi se kishte qenë anëtar i UÇK-së dhe se më 1999 vendosi t'i bashkangjitej një Brigade tjetër dhe është thirrë në Javor. Me të arritur Dëshmitari Anonim L në Javor, është arrestuar nga një ushtar i ri i UÇK-së, anëtar i policisë ushtarake të UÇK-së dhe është sjellur në Kleçkë dhe është ndaluar aty. Të nesërmen është intervistuar nga ushtari i UÇK-së me emrin O nga Bellanica. Dëshmitarit Anonim L poashtu i është thënë se nuk është dashur t'i bashkangjitej një brigade tjetër pa miratimin paraprak. Intervistimi i Dëshmitarit Anonim L është ndërprerë nga '**N**', me mbiemrin **K** apo **K**, i cili pas lufte, ishte polic në Prizren. Ishte ky ai '**N**' që liroi Dëshmitarin Anonim L nga Qendra e Ndalimit në Kleçkë. Gjatë intervistimit të tij më 12 prill 2011, identifikoi **NK2** si personin që e njihte me emrin '**N**'⁴⁵³. Gjatë ndalimit të tij, Dëshmitari Anonim L pa edhe një ushtar tjetër të UÇK-së të burgosur, i cili i tha Dëshmitarit Anonim L se ky është rrahur para familjes së tij kur është ndaluar. Mirëpo, Dëshmitari Anonim L nuk ka parë askë të rrahur në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë. Dëshmitari Anonim L nuk ka parë as ndonjë të burgosur tjetër në Kleçkë.⁴⁵⁴

⁴⁵² BZ, *supra*

⁴⁵³ Deklarata e Dëshmitarit Anonim L, datës 12 prill 2011

⁴⁵⁴ Deklarata e Dëshmitarit Anonim L, *supra*

UK deklaroi se mes të datave maj 1999 dhe qershor 1999 ishte i caktuar në Kleçkë. Ai personalisht njihte një roje me emrin AZ ('M').

UK kishte parë **AZ** në Kleçkë rregullisht. Shpesh ka parë edhe **NK2** në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, i cili po komandonte nëntë brigada të policisë ushtarake, prej brigadës 121 deri te brigada 129. **UK** kishte parë shumë ushtarë të tjerë të UÇK-së dhe policisë ushtarake në Kleçkë. Ai kishte dëgjuar se shumë njerëz janë dërguar në Kleçkë, por nuk ka qenë dëshmitar i ndonjë krimi.⁴⁵⁵ Në një deklaratë tjetër, **UK** rikujtoi se në prill 1999, kur katër zyrtarë serbë janë sjellur në Kleçkë, **NK2** ishte ai që mori kontrollin mbi zyrtarët serbë.⁴⁵⁶

Dëshmitari Anonim M dëshmoi se ishte civil dhe ishte arrestuar në mars apo prill 1999 dhe dërguar në Kleçkë. Që ditën e njëjtë, Dëshmitari Anonim M është marrë në pyetje nga disa persona, përfshirë edhe personin që Dëshmitari Anonim M e përshkruan si gjykatës. Dëshmitari Anonim M është kërcënuar me shkopinj druri, por nuk është goditur. Një person që po qëndronte te dera me maskë kërcënoi se do të rrihte Dëshmitarin Anonim M. Në një deklaratë të mëvonshme, Dëshmitari Anonim M deklaroi se pasi që gjykatësi përfundoi së shtruar pyetjet, një person me maskë goditi Dëshmitarin Anonim M dy herë në shpinë.⁴⁵⁷ Siç duket nga deklarata e Dëshmitarit Anonim M, në një moment të caktuar **NK2** erdhi së bashku me gjykatësin dhe pyeti përse Dëshmitari Anonim M dhe disa persona të tjerë të caktuar ishin aty, hapi derën dhe i liroi. Dëshmitari Anonim M deklaroi se kishte dëgjuar individë duke bërë titur në katin e epërm gjatë marrjes në pyetje. Pasi që janë kthyer, dukeshin thuajse ishin të rrahur. Mirëpo, Dëshmitari Anonim M personalisht nuk ishte dëshmitar i rrahjes. Sipas Dëshmitarit Anonim M, ai nuk e ka ditur organizimin dhe strukturën hierarkike në burgun në Kleçkë. Që të gjithë, përpos gjyqtarit, kishin vënë maska. Më vonë, Dëshmitari Anonim M kishte dëgjuar se emri i gjyqtarit ishte Osman dhe se ishte nga Bellanica. Dëshmitari Anonim M konsideroi se Qendra e Ndalimit në Kleçkë ishte nën përgjegjësinë e FLT, i cili ishte përgjegjës për Brigadën

⁴⁵⁵ Dëshmitari Anonim I, *supra*

⁴⁵⁶ Prova P6, Dëshmitari Anonim I, *supra*

⁴⁵⁷ Dëshmitari Anonim M, *supra*

121. Kjo vepronte në atë pjesë dhe shtabi i përgjithshëm i brigadës ishte në Kleçkë. Dëshmitari Anonim M nuk e dinte se kush ishte përgjegjës për burgun.⁴⁵⁸

Dëshmitari Anonim M dëshmoi se **NK2** ishte i pranishëm në burgun e Kleçkës gjatë kohës kur Dëshmitari Anonim M dëgjoji disa individë duke bërtitur në katin e epërm dhe vrojtoi se individët dukeshin sikur të ishin rrahur. Deklarata e Dëshmitarit Anonim M përmban redaktime të konsiderueshme në një linjë me masat e vëna për të mbrojtur identitetin e dëshmitarit. Deklarata e Dëshmitarit Anonim M nuk e bën të qartë se kush janë këta individë, dhe nëse mund të jenë Dëshmitari Anonim H, i vëllai apo SA. Dëshmia e Dëshmitarit Anonim M nuk mjafton për të arritur deri te përfundime të caktuara sa i përket përgjegjësisë së **NK2**. Përpos kësaj, provat e tjera nuk tregojnë se sjelljet e **NK2** ndaj individëve të caktuar siç është Dëshmitari Anonim H, i vëllai apo **SA** përbën trajtim mizor.

Sidoqoftë, neni 157(3), KPPK parasheh se Trupi Gjykes nuk mund të përcaktojë fajësinë bazuar ‘... vetëm apo në një pikë të caktuar vendimtare mbi dëshminë e dhënë nga një dëshmitar i vetëm, identiteti i të cilit është anonim për avokatin mbrojtës dhe për të akuzuarin’.

Sipas Dëshmitarit Anonim B, ish-anëtar i UÇK-së, ka gjasa që në maj 1999 ai ishte ndaluar në Kleçkë. Kur hyri Dëshmitari Anonim B në oborr të shtëpisë në Kleçkë, ai pa **NK2**, të cilin Dëshmitari Anonim B e njihte si shef të policisë ushtarake. **NK2** pyeti Dëshmitarin Anonim B për arsyen pse ai ishte aty dhe se kush i kishte dhënë leje të shkonte në maje të malit. Për më tepër, Dëshmitarit Anonim B i është thënë se ai duhej të qëndronte në burg për aq gjatë sa të hetohej lënda e tij. Dëshmitari Anonim B kujtoi se si mbikyrësi i burgut ishte “A”. Pesë apo gjashtë ditë më vonë, Dëshmitari Anonim B është sjellur lart, ku sërish takoi **NK2** dhe një person tjerër. Dëshmitari Anonim B sërish sqaroi se si me t’u marrë nga personeli ushtarak serb, Dëshmitari Anonim B është detyruar t’u tregojë forcave serbe lokacionet e UÇK-së dhe emrat e ushtarëve të UÇK-së që ai njihte. Dëshmitari Anonim B është liruar nga Kleçka pas 21 dite për

⁴⁵⁸ Dëshmitari Anonim M, *supra*

shkak të rrezikut nga ofenziva serbe. Gjatë burgimit të tij në Kleçkë, Dëshmitari Anonim B nuk ka qenë dëshmitar i asnjë krimi.⁴⁵⁹

Prokuroria solli si provë vendimin e datës 17 maj 1999 nga gjykata ushtarake e UÇK-së, që urdhëroi që Dëshmitari Anonim B të vuajë dënimin me ndalim prej 14 maj 1999 deri 14 qershor 1999.⁴⁶⁰ **SD** tha se vendimi përmban nënshkrimin e tij.

Gjatë shqyrtimit kryesor, ai ka thënë se është informuar nga njerëz që takoi në mal se **NK2** ishte shofer autobusi dhe shef i policisë ushtarake. Me të arritur në Kleçkë, tha se ka takuar një person me rroba të zeza dhe për këtë ka supozuar se ishte **NK2**, por tani e kupton që nuk ishte ai. Mirëpo, në deklaratën e tij të dhënë në procedurën paraprake, ai ka thënë se **NK2** e ka njohur që para lufte. Kur është ballafaquar me këtë gjë gjatë shqyrtimit kryesor, ai tha se nuk ka thënë ashtu dhe se vetëm kishte dëgjuar për të. Është e qartë se ka ndryshuar dëshminë e tij në mënyrë që të mos implikohet **NK2**.

SD dëshmoi duke thënë se rregullisht ka shkuar në burgun në Kleçkë. Këtij i kujtohet **NK2** thjeshtë si një polic ushtarak në zonën operative të Pashtrikut. Ndërsa dëshmitë e Dëshmitarëve Anonimë L, I, M dhe B sugjerojnë se **NK2** ka ushtruar autoritet të caktuar në burgun në Kleçkë. Përpos kësaj, **NB**, ish-anëtar i UÇK-së, i është thënë se **AK**, **AO1**, **AO2** dhe **DR** janë ndaluar në burgun në Kleçkë. Që të katër, përpos **AO**, i përkisnin policisë ushtarake të UÇK-së. Është përmendur se **NK2** dhe **'BF** informuan ata se ishin nën arrest dhe kërkuan që t'i dorëzonin armët. Për më tepër, **NK2** u jepte urdhra të burgosurve dhe ushtarëve në burgun në Kleçkë dhe ishte përgjegjës për burgun.⁴⁶¹

Është e mundur se **NK2** ishte i pranishëm në Kleçkë në kohën në fjalë. Mirëpo, aktakuza pretendon pjesëmarrje aktive të veçantë të **NK2** në krime dhe Trupi Gjykses nuk mund të

⁴⁵⁹ Dëshmitari Anonim B, *supra*

⁴⁶⁰ Dëshmitari A, *supra*, bashkangjitur deklaratës 0096-09-EWC2/025

⁴⁶¹ Prova P 17, NB, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në hetime në PSRK, 12.09.2011, Dosja e Prokurorisë me prova P 1 - P 31.

tejkalojë atë fushëveprim. Aktakuza, pavarësisht nga provat që mund të mbështesin pretendimin për përgjegjësi të lartë, nuk përmban një akuzë të tillë ndaj **NK2**. Sa i përket përgjegjësisë së **NK2**, Trupi Gjykes vlerëson se fakti se **NK2** është i ndërlidhur me burgun në Kleçkë dhe është parë aty, nuk e ndërlidhë **NK2** me krimet specifike të pretenduara, siç është trajtimi mizor i Dëshmitarit Anonim H, vëllait të tij apo **SA**.

Më tutje, aktakuza pretendon se **NK2** duke vepruar në bashkë-kryerje vrau **AA**; torturoi dhe mori pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në burgun në Kleçkë; çenoi integritetin trupor dhe shëndetin e një të burgosuri ushtarak serb të ndaluar në burgun në Kleçkë; dhe paskëtaj, mori pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb; dhe mori pjesë në vrasjen e **VM** dhe **ND**.

Trupi Gjykes gjeti se kushtet e ndalimit në burgun në Kleçkë në vetëvete nuk përbëjnë trajtim mizor.

Prokuroria mbështetet vetëm në dëshminë e **AZ** për të mbështetur këto pretendime. Trupi Gjykes gjen se **DT, ZF, ZT, DV, BC, VM dhe ND** janë vrarë në mënyrë të paligjshme. E vetmja provë lidhur me identitetin e *kryerësve* të këtyre krimeve është dëshmia e **AZ**.

E vetmja provë lidhur me vrasjen e paligjshme të **AA** është ajo e **AZ**. Trupi i pajetë nuk është gjetur. **AA** është zyrtarisht i zhdukur.

Trupi Gjykes gjeti se **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe si pasojë, nuk do të ishte e sigurt të mbështetej në dëshminë e tij. Edhe po të kishte arritur Trupi Gjykes deri te përfundimi se **AZ** është dëshmitar i besueshëm, neni 157 (4), KPPK parasheh se gjykata nuk mund të përcaktojë fajësinë e askujt bazuar vetëm në provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Trupi Gjykes gjen se nuk është dëshmuar se **NK2** ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet.

BL akuzohet me dy pikë të aktakuzës.

Akuza 1 ngarkon **BL** me veprën penale Krime lufte ndaj popullatës civile dhe krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁶² me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me **FL, NK1, NK2, NS, AK, BS, SS1**, Dëshmitarin Bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë, deri tani të pidentifikuar, çënoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë, shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, duke i mbajtur këta nën kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e tyre me zinxhirë, objekte të papërshtatshme, , i ftohte i tepërt, mungesën e kushteve higjienike, të ushqyer nw mwnyrw joadekuate, rrahje të shpeshta); në Kleçkë, komuna e Lipjanit nga fillimi 1999 deri në mes të qershorit 1999.

Akuza 2 ngarkon **BL** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁶³ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me **FL, NK2, NK1, AK**, dhe Dëshmitarin Bashkëpunues X mori pjesë në vrasjen e **ND** dhe **VM**, dy policë serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, të cilët janë ekzekutuar nga Dëshmitari Bashkëpunues X me disa të shtëna pistolete; më saktë, i pandehuri mori pjesë në krim duke i marrshuar dy të burgosurit deri te vendi i ekzekutimit dhe duke i mbajtur viktimat në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, edhe pse e dinte (duke qenë i informuar në mënyrë të qartë mbi urdhrat e **FL**), apo të paktën ka mundur lehtë të parashihet nga urdhrat e pranuar (marrshimi i dy të burgosurve serbë në një lokacion të largët në male) se çfarë do t'u ndodhte atyre; në lokacionin e njohur si Livadhi i Canit afër Kleçkës më apo rreth datës 4 apo 5 prill 1999.

Sa i përket cënimit të integritetit trupor dhe shëndetit të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, aktakuza pretendon se i akuzuari **BL** ishte caktuar në Kleçkë dhe si

⁴⁶² Sipas neneve 22, 142, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PSh

⁴⁶³ Sipas neneve 22, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PSh APII

AK, ndihmoi Dëshmitarit Bashkëpunues **AZ** të kryejë detyrën e tij për të ruajtur të burgosurit e ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, të udhehequr nga UÇK-ja.⁴⁶⁴

Trupi Gjykses gjeti se kushtet e ndalimit në burgun në Kleçkë në vetëvete nuk përbëjnë trajtim mizor.

Sa i përket vrasjes së **ND** dhe **VM**, Aktakuza pretendon se **BL** së bashku me **AK** vendosi viktimat në dispozicion të xhelatit duke i marrshuar deri në vendin e ekzekutimit.⁴⁶⁵

Prokuroria mbështetet vetëm në dëshminë e **AZ** për të mbështetur këto pretendime. Trupi Gjykses gjen se **VM** dhe **ND** janë vrarë në mënyrë të paligjshme. E vetmja prova lidhur me identitetin e *kryerësve* të këtyre krimeve është ajo e dëshmisë së **AZ**.

Trupi Gjykses gjeti se **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe si pasojë, nuk do të ishte e sigurt mbështetja në dëshminë e tij. Edhe po të kishte arritur Trupi Gjykses deri te përfundimi se **AZ** është dëshmitar i besueshëm, neni 157 (4), KPPK, parasheh se gjykata nuk mund të përcaktojë fajësinë e askujt bazuar vetëm në provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Trupi Gjykses gjen se nuk është dëshmuar se **BL** ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet.

FL akuzohet me tre pikë të aktakuzës.

Akuza 1 ngarkon **FL** me veprën penale Krime lufte ndaj popullatës civile dhe krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁶⁶ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe komandant, dhe si person që ushtroi kontroll të përgjithshëm mbi Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, në bashkë-

⁴⁶⁴ Aktakuza, f.25.

⁴⁶⁵ Aktakuza, f.28.

⁴⁶⁶ Sipas neneve 22, 142, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat të Gjenevës 1949 dhe nenet 4, 5(1), PSh II

kryerje me **NK1, NK2, NS, AK, BL, BS, SS1**, Dëshmitarin Bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë, deri tani të paidentifikuar të UÇK-së, cënoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e tyre më zinxhirë, objekte të papërshtatshme, i ftohtë i tepërt, mungesën e kushteve higjienike, të ushqyer në mënyrë joadekuate, rrahje të shpeshta); në Kleçkë, komuna e Lipjanit nga fillimi 1999 deri mesi i qershorit 1999.

Akuza 2 ngarkon **FL** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁶⁷ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe komandant, torturoi një të burgosur ushtarak serb të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, mbetjet mortore të të cilit janë gjetur në një varr masiv që përmbante pesë trupa të pajetë, afër Kleçkës, duke e grushtuar dhe shqelmuar atë gjatë marrjes në pyetje në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999 por jo para 11 prill 1999.

Akuza 3 ngarkon **FL** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁴⁶⁸ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe komandant, në bashkë-kryerje me **NK2, NS, NK1, AK, BL** dhe Dëshmitarin Bashkëpunues X mori pjesë në vrasjen e **ND** dhe **VM**, dy policë serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, të cilët janë ekzekutuar nga Dëshmitari Bashkëpunues X me disa të shtëna pistolete; më saktë, i pandehuri mori pjesë në krim duke e urdhëruar Dëshmitarin Bashkëpunues X të ekzekutojë të burgosurit; në lokacionin e njohur si Livadhi i Canit afër Kleçkës, Lipjan, më apo rreth datës 4 apo 5 prill 1999.

Aktakuza pretendon se **FL** në cilësinë e tij si anëtar dhe komandant i UÇK-së dhe si person që ushtroi kontroll të përgjithshëm mbi Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, në bashkë-kryerje me të akuzuar të tjerë të caktuar, cënoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar

⁴⁶⁷ Sipas neneve 22, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949 dhe nenet 4, 5(1), PSHII

⁴⁶⁸ Sipas neneve 22, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PSHII

serbë dhe shqiptarë civilë dhe të burgosur ushtarak serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë.

Trupi Gjykses gjeti se kushtet e ndalimit në vetëvete nuk përbëjnë trajtim mizor, por se Dëshmitari Anonim H, i vëllai dhe **SA** janë nënshtruar trajtimit mizor.

Aktakuza pohon se **FL** në cilësinë e tij si anëtar dhe komandant i UÇK-së torturoi një të burgosur ushtarak serb të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë; dhe mori pjesë në vrasjen e **VM** dhe **ND**, dy policë serb të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë.

Roli i FL në burgun në Kleçkë

Aktakuza pretendon se **FL** ushtroi komand dhe kontroll të përgjithshëm mbi Qendrën e Ndalimit. **FL** ishte shef i policisë ushtarake të UÇK-së në rajon dhe urdhëroi se ku do të ndaloheshin të burgosurit. Aktakuza thekson se **FL** kishte fuqinë për të urdhëruar lirim dhe ekzekutimin e të burgosurve të caktuar.⁴⁶⁹

Trupi Gjykses gjen se gjatë periudhës përkatëse **FL** shërbeu si shef i policisë ushtarake të UÇK-së brenda shtabit të përgjithshëm të UÇK-së në Divjakë. Para emërimit të tij në këtë post, ai ishte komandant i Brigadës 121. Zëvendësi i **FL** ishte **HS** ('Topi'), i cili pas emërimit të **FL** në shtabin e përgjithshëm të UÇK-së, u emërua komandant i Brigadës 121.

BZ dëshmoi se në nëntor apo dhjetor 1998 ishte bërë ristrukturimi i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së. Ai tha se para kësaj, **FL** ishte komandant i Brigadës 121. Zëvendësi i tij në atë kohë ishte **HS**. Gjatë ristrukturimit, **FL** ishte emëruar Drejtor i Drejtoratit të Policisë Ushtarake, rol që e kreu nga janari deri në prill 1999.

⁴⁶⁹ Aktakuza, f.26.

BZ tha se detyrat e drejtorit të policisë ushtarake ishin të “trajnojë policinë, të nxjerrë rregullore dhe të inspektojë punën.”

Ai dëshmoi se Drejtori i Drejtoratit të Policisë Ushtarake nuk kishte funksion ekzekutiv.

NM dëshmoi se në fund të vitit 1998, ai ishte emëruar në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në Divjake. **NM** tha se fillimisht **FL** ishte komandant i Brigadës 121. Me ristrukturimin e shtabit të përgjithshëm, **FL** ishte emëruar Shef i Policisë Ushtarake të UÇK-së dhe zëvendësi i **FL HS** e zëvendësoi si komandant i Brigadës 121.⁴⁷⁰

Dëshmitarët e tjerë, përfshirë **AQ**,⁴⁷¹ **AO**,⁴⁷² **NB**,⁴⁷³ Dëshmitarin G,⁴⁷⁴ **IZ**,⁴⁷⁵ **RI** (ish-anëtar i Brigadës 121),⁴⁷⁶ **FK** (ish-anëtar i policisë ushtarake të UÇK-së),⁴⁷⁷ treguan se gjatë apo rreth kohës përkatëse **HS** ishte komandant i Brigadës 121. **BZ** dëshmoi se ‘**BF**’ si anëtar i Brigadës 121 ishte fillimisht nën komandën e **FL** dhe pastaj atë të **HS**.⁴⁷⁸

Provat mbi të cilat mbështetet prokuroria konfirmojnë se policia ushtarake e UÇK-së veprroi në bazën e UÇK-së në Kleçkë. Sipas **UK**, policia ushtarake e UÇK-së qëndroi në katin e epërm të bazës së UÇK-së në Kleçkë.⁴⁷⁹ **SD** tha se policia ushtarake e UÇK-së ushtroi kontroll fizik mbi burgun në Kleçkë.⁴⁸⁰ Dëshmitari D është ndaluar në mars 1999 në burgun në Kleçkë për 10 ditë. Në Kleçkë, Dëshmitari D pa shumë ushtarë të UÇK-së. Dëshmitari D pa një ushtare femër nga UÇK-ja duke rrahur ‘**S**’. Ushtarja femër në fjalë kishte të veshur uniformë të kamufluar, por kishte një distinktiv në dorë ku shkruante ‘policia ushtarake’ në gjuhën shqipe. Sipas Dëshmitarit D, ishte një lloj policë ushtarake.⁴⁸¹ Dëshmitarit Anonim B i rikujtohej se derisa

⁴⁷⁰ NM, *supra*

⁴⁷¹ AQ, *supra*

⁴⁷² AO, *supra*

⁴⁷³ Prova P 17, NB, *supra*

⁴⁷⁴ Dëshmitari G, *supra*

⁴⁷⁵ IZ, *supra*

⁴⁷⁶ RI, 24.05.2011, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Policia e EULEX-it, f.3, Dosja D e PSRK-së.

⁴⁷⁷ FK, *supra*

⁴⁷⁸ BZ, *supra*

⁴⁷⁹ Dëshmitari Anonim I, *supra*

⁴⁸⁰ SD, *supra*

⁴⁸¹ Dëshmitari D, 24.12.2010, deklarata e marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Policia e EULEX-it, f.5, 6, Dosja C e PSRK-së.

ishte i ndaluar në burgun në Kleçkë, një polic ushtarak i quajtur 'F' i ruante individët e ndaluar.⁴⁸²

FK, i cili ishte caktuar në polici ushtarake në fillim të vitit 1999 dëshmoi duke thënë se asnjëherë nuk ka ruajtur ndonjë të burgosur, por se ka qenë e mundur që cilido anëtar i policisë ushtarake të ruajë të burgosurit në bazën e UÇK-së në Kleçkë.⁴⁸³

Provat poashtu tregojnë se policia ushtarake e UÇK-së ka mund të ketë qenë përgjegjëse për kryerjen e hetimeve. **SD** i rikujtohet rasti i **SA**. Për këtë të fundit është thënë se ishte drejtor i burgut në Mitrovice dhe se kishte torturuar shumë të burgosur politikë. Sipas **SD**, rasti i **SA** asnjëherë nuk kishte arritur deri te ai dhe vetëm hetuesit, pra policia ushtarake e UÇK-së punoi në këtë lëndë.⁴⁸⁴

Për më tepër, Trupi Gjykes gjen se **NK2**, si anëtar i policisë ushtarake të UÇK-së ishte në bazën e UÇK-së në Kleçkë.

Trupi Gjykes gjen se anëtarët e policisë ushtarake të UÇK-së transportuan të ndaluarit në dhe nga Klecka. **SD** dëshmoi se Policia Ushtarake e UÇK-së kishte dërguar në burgun në Kleçkë vëllezërit **K** të cilit ishin akuzuar për bashkëpunim me serbët. **SD** rikujtoi se ka gjasë t'i ketë kërkuar Policisë Ushtarake të UÇK-së të sjellnin **BK** për marrje të mëtutjeshme në pyetje për akuzat për dezertim.⁴⁸⁵ **AH**, i cili i përkiste policisë ushtarake të UÇK-së, rikujtoi se si në një rast ai kishte shoqëruar një ushtar të arrestuar te **SD**.⁴⁸⁶ Dëshmitari V, ish-anëtar i UÇK-së, i cili poashtu shërbeu në Brigadën 121 dëshmoi se përgjegjëse ishte Policia Ushtarake e UÇK-së për të transferuar të burgosurit nga burgu i përkohshëm në Shalë për në burgun në Kleçkë.⁴⁸⁷ Një metodë e ngjashme e veprimit mund të vihet re edhe në lokacione të tjera. Në veçanti, sipas

⁴⁸² Dëshmitari Ananim B, *supra*

⁴⁸³ FK, *supra*

⁴⁸⁴ SD, *supra*

⁴⁸⁵ SD, *supra*

⁴⁸⁶ AH, *supra*

⁴⁸⁷ Dëshmitari V, *supra*

dëshmisë së **BZ**, qendra disiplinuese në Lladroc ishte nën përgjegjësinë gjykatës ushtarake të UÇK-së, por Policia Ushtarake e UÇK-së ruante burgun dhe të burgosurit.⁴⁸⁸

UK dëshmoi se kishte parë **FL** disa herë në Kleçkë më 1999, dhe se **FL** ishte i caktuar në ndërtesë aty ku ishte kuzhina.⁴⁸⁹ Në këtë njëjtën kohë, provat tregojnë se anëtarë të ndryshëm të UÇK-së, të cilët në raste të ndryshme janë identifikuar si përgjegjës për burgun në Kleçkë apo duke dhënë urdhra për të ndaluar, liruar apo ekzekutuar individë të caktuar. Në shumë raste, dëshmitarët kanë dëshmuar se është kërkuar nga ata ose të raportonin në Kleçkë ose janë ndaluar në Kleçkë, mirëpo, dëshmitarët nuk kanë dëshmuar duke dhënë prova që do të lejonin Trupin Gjykes të përcaktoje se e gjithë kjo ishte nën përgjegjësinë e lartë të **FL**.

SD ishte shef i departamentit ligjor në shtabin e përgjithshëm të UÇK-së në Divjakë dhe poashtu mbante gjykime ushtarake si gjykatës. **SD** dëshmoi se **BK**, ish-komandant i Brigadës së UÇK-së është arrestuar dhe sjellur tek ai. **BK** i kishte thënë **SD** se e gjithë brigada e tij kishte dezertuar dhe ky është nisur për në Shqipëri. Duke pasur parasysh seriozitetin e rastit, **SD** dënoi Blerim Kuqin me vdekje me skuadër pushkatimi. Mirëpo, filloi intervenimi i NATO-s dhe A mori përgjegjësinë të mos zbatojë dënimin dhe vendosi që **BK** meritonte edhe një shansë. **BK** lirua.⁴⁹⁰ Fare nuk i referohet ndonjë roli të luajtur nga **FL** në këtë proces.

Dëshmitari E dëshmoi se **SD** i tregoi atij rrëfimin e **BK** dhe se **BK** ishte burgosur. **SD** ishte shumë i brengosur për situatën e **BK** dhe poashtu pyeti Dëshmitarin E se çfarë duhet të bëjnë për **BK**.⁴⁹¹

BZ dëshmoi se ishte marrë vendimi për të arrestuar **BK** dhe për t'a sjellur pranë gjykatës ushtarake.⁴⁹² **BZ** nuk ishte i sigurt se ku ishte ndaluar **BK**. Pas intervenimit të NATO-s, filloi ofensiva serbe. Derisa forcat serbe po e thyenin vijën e frontit, **SD** pyeti **BZ** lidhur me ushtarët

⁴⁸⁸ BZ, *supra*

⁴⁸⁹ Dëshmitari Anonim I, *supra*

⁴⁹⁰ SD, *supra*

⁴⁹¹ Dëshmitari E, *supra*

⁴⁹² BZ, *supra*

që në atë kohë ishin në ndalim, përfshirë edhe **BK. BZ** këshilloi që ata duhet liruar dhe lëndët e tyre duhen shqyrtuar pas lufte. **SD** kishte mendim të njëjtë.⁴⁹³

SD dëshmoi duke thënë se ishte informuar lidhur me dy ushtarë serbë në burgun në Kleçkë. Ai tha se shkoi në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë për t'i vizituar. Trupi Gjykues gjeti se këta dy të burgosur ishin Dëshmitari Anonim H dhe vëllai i tij. Me të liruar Dëshmitarin Anonim H dhe vëllanë e tij, **SD** deklaroi se kishte konsultuar **BZ** dhe kishte urdhëruar që të dy të burgosurit t'i dorëzoheshin OSBE-së.⁴⁹⁴ Trupi Gjykues vë re se sipas Dëshmitarit Anonim H, personi që vizitoi Dëshmitarin Anonim H dhe vëllanë e tij, pasi që ishin rrahur, i tha Dëshmitarit Anonim H se ai nuk e dinte se ishin marrë nga UÇK-ja. Dëshmitari Anonim H mendoi se kësisoji personi i la të kuptohej se ka mundur të bëjë ndonjë gjë po t'a kishte ditur se Dëshmitari Anonim H dhe i vëllai i tij janë marrë nga UÇK-ja.⁴⁹⁵

Afredita Qerkini, ish-anëtare e UÇK-së dëshmoi dhe dukej sikur Haxhi Shala ishte përgjegjës për shtëpinë në Kleçkë.⁴⁹⁶ Edhe pse **SD** në deklaratën e tij i është referuar drejtorit të burgut në Kleçkë, ai nuk ka dhënë dëshmi sa i përket identitetit të drejtorit. Ai tha se Komandant **M** ishte përgjegjës për mbikqyrjen e përditshme të burgut.

Sa i përket **HS**, **SD** tha se nuk kujton askë me emrin HS, por kujton dikë me emrin 'T', i cili ishte komandant në atë kohë. **SD** pa 'T' në Kleçkë.⁴⁹⁷

AQ tha se qëndroi në shtëpinë e UÇK-së në Kleçkë për vetëm dy – tre orë. Pas kësaj, ajo shkoi në "mal" ku qëndroi deri në qershor 1999. Kjo gjë bie ndesh me dëshminë e **AZ**, i cili tha se kjo ka qenë e përfshirë në marrjen në pyetje të të burgosurve.

⁴⁹³ BZ, *supra*

⁴⁹⁴ SD, *supra*

⁴⁹⁵ Dëshmitari Anonim H, *supra*

⁴⁹⁶ AQ, *supra*

⁴⁹⁷ SD, *supra*

Dëshmitari V dëshmoi se ka qenë i ndaluar në burgun në Kleçkë për 56 ditë dhe se kishte qëndruar së bashku me **BK**. Sipas Dëshmitarit V, komandanti dhe shefi i burgut ishte '**M**' me emrin **A**,⁴⁹⁸ dhe **HS** dhe '**M**' shikonin se kush hynte dhe kush dilte nga burgu.

UK, i cili ishte i caktuar në Kleçkë rreth majit 1999, qershorit 1999, deklaroi se **AZ** ('**M**') ishte roje në burgun në Kleçkë. **AZ** ishte i veshur në uniformë të zezë dhe me shenjë dalluese të policisë ushtarake në dorën e majtë. **AK** ishte roje tjetër e burgut.⁴⁹⁹

Dëshmitari Anonim C tha se është liruar nga burgun në Kleçkë nga '**M**' **Z**. Dëshmitari Anonim C mendoi se '**M**' ishte drejtori i burgut. Përpos kësaj, sipas Dëshmitarit Anonim C, të burgosurit janë sjellur nga bodrumi lart për t'u marrë në pyetje nga një person për të cilin C-ja dëgjoji të thirrej 'Komandant **H**'.⁵⁰⁰

Dëshmitari Anonim B deklaroi se mbikqyrës i i burgut ishte **A**.⁵⁰¹

Dëshmitari V është marrë dy herë në pyetje nga **FL**, **HS**, **SD** dhe '**M**'. **SD** vepronte si gjyqtar, **FL** dhe **HS** ishin akuzuesit. Dëshmitari V ishte përfaqësuar nga një avokat nga Peja. Procedura ishte mbajtur në Novosellë, në një ndërtesë private⁵⁰². Me t'u kryer procedura, Dëshmitari V shkoi në shtëpi.⁵⁰³

Dëshmitari V dëshmoi se **BK** është marrë në pyetje nga **SD**, **FL**, por në të shumtën e kohës, nga **HS** ('**T**'). Një ditë, **BK** pranoi një letër, për të cilën Dëshmitari V mendoi se ishte dënimi me vdekje. Sipas Dëshmitarit V, i vetmi person me autoritet për të shkruar këtë letër ishte **SD**. Dëshmitari V rikujtoi rrahjen e një të riu, rreth 17 vjeç, që kishte vjedhur ca gjëra. Dëshmitari V

⁴⁹⁸ Dëshmitari V, *supra*

⁴⁹⁹ Dëshmitari Anonim I, *supra*

⁵⁰⁰ Dëshmitari Anonim C, *supra*

⁵⁰¹ Dëshmitari Anonim B, *supra*

⁵⁰² Jo në burgun në Kleçkë

⁵⁰³ Dëshmitari V, *supra*

po dëgjonte se si ky i riu po rrahej. I riu tregoi se ishte rrahur nga **BH**, për të cilin pretendohet se edhe ka ruajtur të burgosurit.⁵⁰⁴

Dëshmitari G, ish-anëtar i Brigadës 121 dëshmoi se ishte ftuar për intervistë në Kleçkë shkaku i një grindje apo përlëshje në të cilën kishte qenë i përfshirë. Në Kleçkë, Komandant **HS** ('T') bëri që antagonistët t'i shtrëngonin duart njëri-tjetrit dhe u tha se nuk duhej të grindeshin me njëri-tjetrin.⁵⁰⁵

Provat mbi të cilët mbështetet prokuroria, përfshirë edhe një raport që deklaron se të burgosurit janë "liruar nga C", nofkë e përdorur për **FL**, gjatë periudhës shkurt – maj 1999⁵⁰⁶ sugjerojnë se **FL** ishte në pozitë për të autorizuar lirimin e të burgosurve. Kjo nuk dëshmon se ai ka qenë fizikisht i pranishëm në burg apo se ka pasur komandë apo kontroll të përgjithshëm mbi burgun.

SD dëshmoi se kishte dëgjuar se vëllezërit me emrin Krasniqi ishin liruar nga burgun në Kleçkë nga **FL** dhe se vetëm **FL** kishte fuqi të tillë ngase ishte shef i policisë ushtarake.⁵⁰⁷

Dëshmitari T dëshmoi se i kishte thënë njëri nga vëllezërit e ndaluar, **NK**, se ishte liruar nga **FL**.⁵⁰⁸ Kjo dëshmi është thashethem. Një pohim i ngjashëm është bërë nga Dëshmitari Anonim M, mendimi i të cilit ishte se **FL** ishte përgjegjës për funksione të ndryshme në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë. Në të njëjtën kohë, Dëshmitari Anonim M deklaroi se nuk e dinte kush ishte përgjegjës për burgun dhe nëse mund të quhej burg sepse ishte thjeshtë një shtëpi.⁵⁰⁹

SD, Dëshmitari T dhe Dëshmitari Anonim M në fakt nuk e kanë parë **FL** duke dhënë ndonjë udhëzim apo urdhër apo duke ushtruar fuqi disiplinore në Kleçkë.

⁵⁰⁴ Dëshmitari V, *supra*

⁵⁰⁵ Dëshmitari G, *supra*

⁵⁰⁶ Prova 0096 – 09 – EWC2/024

⁵⁰⁷ SD, *supra*

⁵⁰⁸ Dëshmitari T, *supra*

⁵⁰⁹ Dëshmitari Anonym M, *supra*

UK dëshmoi se në prill 1999, katër ushtarë të UÇK-së sollën në Kleçkë katër zyrtarë serbë. Ai tha se policia ushtarake i mori nën kontroll. Ai dëshmoi se **FL** ishte i pranishëm atë ditë në Kleçkë. **UK** pa **FL** në kuzhinë, mirëpo se nuk e dinte se a është marrë fare **FL** me këta të burgosur.⁵¹⁰

Më tutje, Trupi Gjykes gjen se provat nuk dëshmojnë se **FL** e dinte apo kishte arsye për të ditur se individë të caktuar, siç ishte Dëshmitari Anonim H, i vëllai i tij apo **SA**, do t'i nënshtroheshin trajtimit mizor apo se i ishin nënshtuar trajtimit mizor; dhe se **FL** nuk ia doli të ndër marrë masat e nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar krimet apo për të dënuar kryerësit e tyre.

SD dëshmoi se gjatë vizitave të tij në burg, asnjë nga të burgosurit nuk është ankuar dhe nuk ka treguar shenjë se është keqtrajtuar.

BZ dëshmoi se **FL** është emëruar Drejtor i Drejtoratit të Policisë Ushtarake, një rol që e krey nga janari deri në prill 1999. Provat sugjerojnë se paskëtaj, **FL** shkoi në Shqipëri për t'u përgatitur për Operacionin Shigjeta. Se a janë këto prova të sakta apo jo, aktakuza thjeshtë pohon se **FL** ushtroi komandë dhe kontroll mbi burgun në Kleçkë dhe se ishte "shef i Policisë Ushtarake të UÇK-së në rajon". **SD** dëshmoi se burgu në Kleçkë ishte nën kontroll të Departamentit të Shërbimeve Ligjore të UÇK-së.

Shumë shpesh ka mbetur e paqartë se mbi urdhrat e cilit janë arrestuar dhe janë ndaluar individët në burgun në Kleçkë. **SD** nuk e dinte se kush e arrestoi **BK** apo ku është mbajtur **BK** derisa është sjellur në gjykatë.⁵¹¹ Të njëjtën gjë deklaroi edhe Dëshmitari E.⁵¹²

BK rikujtoi se në pranverë të vitit 1999, forcat serbe detyruan forcat e UÇK-së të tërhiqeshin dhe se UÇK-ja erdhi në fshatin e **BK**. Ushtarët e UÇK-së janë vendosur në një shtëpi në lagje.

⁵¹⁰ Prova P6, Dëshmitari Anonim I, *supra*

⁵¹¹ SD, *supra*

⁵¹² Dëshmitari E, *supra*

Pasi që **BK** kuptoi se shtëpia ishte e mbushur plot e përplot, ai propozoi që një grup ushtarësh të UÇK-së të shkonin në shtëpi të tij. Ushtarët e UÇK-së hynë në shtëpinë e tij duke e thyer derën dhe **BK** është grindur me ushtarin e UÇK-së që theu derën. Disa ditë më vonë, Policia Ushtarake e UÇK-së erdhi te **BK** dhe i kërkoi që të shkonte në Kleçkë dhe të japë një deklaratë. Behram Krasniqi erdhi në bazën e UÇK-së në Kleçkë dhe kontaktoi njërin nga ushtarët aty, ky u përpoq t'i binte shuplakë, por ushtarët e tjerë intervenuan. Pas kësaj, një ushtar tjetër i UÇK-së i tha **BK** se duhej të lajmërohej në bazë çdo tre orë.⁵¹³

Dëshmitari N dëshmoi se pas intervenimit të NATO-s, mundësisht në maj 1999, UÇK-ja e mori atë dhe e solli në një shtëpi në Kleçkë apo Berishë. Dëshmitari N tha se është vendosur në bodrumin e shtëpisë. Tre ditë më vonë, Dëshmitari N është dërguar lart për t'u intervistuar. Dëshmitari N nuk e dinte se nuk ishte komandant i bazës së UÇK-së.

AO, ish-anëtar i UÇK-së deklaroi se rreth 45 ditë pas fillimit të intervenimit të NATO-s, ushtarë të UÇK-së kërkuan nga ai të shkonte në Kleçkë dhe të raportonte te 'Topi' lidhur me akuza për lëndim të personit civil. Derisa ishte në bazën e UÇK-së në Kleçkë, **AO** nuk e pa 'Topin'. **AO** është marrë në pyetje nga tre apo katër ushtarë të UÇK-së. Azem Olluri insistoi që të pajisej me vendim me shkrim lidhur me akuzat ndaj tij. Mirëpo, **AO** nuk është pajisur me asnjë vendim të tillë formal dhe është liruar ditën e nesërme.⁵¹⁴

Dëshmitari F dëshmoi se në mars 1999 është arrestuar nga anëtarë të UÇK-së, me uniforma të zeza dhe është vozitur deri në bazën e UÇK-së në Kleçkë. Personat që arrestuan Dëshmitarin F nuk janë prezantuar. Në Kleçkë, Dëshmitari F është marrë në pyetje nga katër apo pesë persona dhe është arritur përfundimi se Dëshmitari F është ndaluar gabimisht. Dëshmitari F nuk njohu asnjë nga personat që e arrestuan, rojet apo personat që e morën në pyetje.⁵¹⁵

⁵¹³ BK, *supra*

⁵¹⁴ AO, *supra*

⁵¹⁵ Dëshmitari F, *supra*

Dëshmitari Anonim B dëshmoi se nuk e dinte kush ishin zyrtarët e Policisë Ushtarakë të UÇK-së që kërkuan të lajmërohej në Kleçkë.⁵¹⁶

Përgjegjësia e FL:

Provat mbi të cilat mbështetet prokuroria nuk dëshmojnë se **FL** kishte përgjegjësi të lartë ndaj Qendrës së Ndalimit në Kleçkë për t'a bërë atë përgjegjës për trajtimin mizor të individëve, siç ishte Dëshmitari Anonim H, i vëllai i tij apo **SA**. Më tutje, provat nuk dëshmojnë pjesëmarrjen aktive të **FL** në trajtimin mizor të individëve të caktuar, përfshirë Dëshmitarin Anonim H, të vëllanë e tij apo **SA**.

Trupi Gjykes gjen se kushtet e ndalimit në burgun në Kleçkë në vetevete nuk përbëjnë trajtim mizor.

Për më tepër, nuk ka prova përpos dëshmisë së **AZ** që lidhin **FL** me pretendimin për torturë të një të burgosuri ushtarak serb apo me vrasjen e **VM** dhe **ND**.

Prokuroria mbështetet vetëm në dëshminë e **AZ** për të mbështetur këto pretendime. Trupi Gjykes gjen se **VM** dhe **ND** janë vrasës në mënyrë të paligjshme. Prova e vetme lidhur me identitetin e kryerësve të këtyre krimeve është dëshmia e **AZ**.

E vetmja provë lidhur me pretendimin për torturën e një të burgosuri ushtarak serb është dëshmia e **AZ**.

Trupi Gjykes gjeti se **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe si pasojë, nuk do të ishte e sigurt të mbështetej në dëshminë e tij. Edhe po të kishte arritur Trupi Gjykes deri te përfundimi se **AZ** ishte dëshmitar i besueshëm, neni 157 (4), KPPK parasheh se gjykata nuk

⁵¹⁶ Dëshmitari Anonim B, *supra*

shpallë askë person fajtor bazuar në vetëm provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Trupi Gjykses gjen se nuk është dëshmuar se **FL** ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet.

RM është akuzuar me dy pikë të aktakuzës.

Akuza 1 ngarkon **RM** me veprën penale Krime lufte kundër popullatës civile⁵¹⁷ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me **NK1**, **NK2** dhe **NS**, vrau **AA**, civil shqiptar nga Kosova, i cili më parë është ndaluar dhe pastaj është liruar nga Qendra e Ndalimit në Kleçkë; më saktë, i pandehuri mori pjesë në krim duke mbajtur viktimën në dispozicion të kryerësve dhe duke e shtyer atë në një gropë në tokë ku më pastaj është ekzekutuar nga **NK1** dhe **NK2** me armën AK-47 firearms në Kleçkë, komuna e Lipjanit më apo rreth datës 3 apo 4 prill 1999.

Akuza 2 ngarkon **RM** me veprën penale Krimelufte ndaj robërve të luftës⁵¹⁸ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së në bashkë-kryerje me **NK1**, **NS**, **NK2**, **AK** dhe Dëshmitarin Bashkëpunues X mori pjesë në vrasjen e një të burgosuri ushtarak serb; më saktë, i pandehuri mori pjesë duke marrshuar të burgosurin deri te vendi i ekzekutimit dhe duke e mbajtur atë në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë, **NS**, edhe pse e dinte, duke qenë në mënyrë të qartë i informuar mbi qëllimin e **NS** për të vrarë të burgosurin nga një bisedë e mëparshme në mes të të dytit dhe **FL**, se i burgosuri do të ekzekutohej, në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999, jo para 11 prill 1999.

Aktakuza pohon se **RM** ishte pjesë e një grupi që shoqëroi **AA** deri në Kleçkë, pas lirim të tij dhe mbajti **AA** në dispozicion të kryerësve, duke penguar arratisjen e tij dhe dke marrë pjesë në shtyerjen e Arben Avdyllit në gropë në të cilën ky i fundit edhe është shtënë me armë.⁵¹⁹ Më

⁵¹⁷ Sipas neneve 22, 142, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PSh II

⁵¹⁸ Sipas neneve 22, 144, KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949 dhe neneve 4, 5(1), PSH II

⁵¹⁹ Aktakuza, f.29.

tutje, Aktakuza pretendon se **RM** ishte pjesë e një grupi ku së bashku me **NS**, marrshoi një të burgosur ushtarak serb në një vend ekzekutimi dhe vendosi viktimën në dispozicion të kryerësit dhe parandaloi arratisjen e tij.⁵²⁰

Sa i përket vrasjes së një të burgosuri ushtarak serb, aktakuza i referohet dëshmisë së patologut Dr. **MG** dhe pohon deklarinimin se deklarata e tij 'lë fare pak dyshim se dikush i tërhoqi kokën viktimës mbrapsht, duke konfirmuar kështu praninë e kryerësve të tjerë në vendngjarje'.⁵²¹ Kjo gjë në asnjë mënyrë nuk lidhë asnjë nga të akuzuarit e caktuar me pretendimin për veprën penale dhe është thjeshtë një pohim se më shumë se një kryerës ka mund të ketë vrarë viktimën.

Prokuroria mbështetet vetëm mbi provën e **AZ** për të mbështetur këto pretendime. Trupi Gjykues gjen se **DT** dhe **DV** janë vrarë në mënyrë të paligjshme.

E vetmja provë që ka të bëjë me vrasjen e paligjshme të **AA** është dëshmia e **AZ**. Trupi nuk është gjetur. **AA** është zyrtarisht i zhdukur.

Trupi Gjykues gjen se **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe si pasojë, nuk do të ishte e sigurtë të mbështetej në dëshminë e tij. Edhe po të kishte arritur Trupi Gjykues në përfundimin se **AZ** ishte dëshmitar i besueshëm, neni 157 (4), KPPK parasheh që gjykata nuk shpallë askë fajtor bazuar vetëm në provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Trupi Gjykues gjen se nuk është dëshmuar se **RM** ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet.

NS është akuzuar me gjashtë pikë të aktakuzës.

⁵²⁰ Aktakuza, f.31.

⁵²¹ Aktakuza, f.31.

Akuza 1 ngarkon **NS** me veprën penale Krime lufte ndaj popullatës civile dhe krime lufte ndaj robërve të luftës⁵²² me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, duke mbajtur një post përgjegjësie brënda Qendrës së Ndalimit në Kleçkë, në bashkë-kryerje me **FL, NK1, NK2, AK, BL, BS, SS1**, Dëshmitarin Bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë deri tani të paignifikuar të UÇK-së, çënoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serb dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serb të mbajtur në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (përfshirë edhe lidhjen e tyre me zinxhirë, objekte të papërshtatshme, i ftohtë i tepërt, mungesën e kushteve higjienike, të ushqyer në mënyrë joadekuate, rrahje të shpeshta); në Kleçkë, komuna e Lipjanit, nga fillimi i vitit 1999 deri në mes të qershorit 1999.

Akuza 2 ngarkon **NS** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁵²³ me pretendimin se në cilësinë e anëtarit të UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me Dëshmitarin Bashkëpunues X, **NK2, SS1, BS**, torturoi katër të burgosur ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, mbetjet mortore të të cilëve janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës dhe të paktën tre prej të cilëve janë identifikuar nëpërmjet ADN-së si **BC, ZF** dhe **ZT**, duke i rrahur vazhdimisht; në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999, jo para datës 11 prill 1999.

Akuza 3 ngarkon **NS** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁵²⁴ me pretendimin se ai, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me **NK1, NK2** dhe dy ushtarë të paignifikuar të UÇK-së, mori pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, mbetjet mortore të të cilëve janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës, tre prej të cilëve janë identifikuar nëpërmjet ADN-së DNA si **BC, ZF** dhe **ZT**, të cilët janë ekzekutuar dhe disa plumba nga arma AK-47 nga grupi i përbërë nga **NK1, NK2, NS**,

⁵²² Sipas neneve 22, 142, 144 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949 dhe neneve 4, 5(1), PSHII

⁵²³ Sipas neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PSh II

⁵²⁴ Sipas neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PSh II

dhe dy ushtarë të pidentifikuar të UÇK-së; në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999, jo para datës 11 prill 1999.

Akuza 4 ngarkon **NS** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁵²⁵ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me **NK1, NK2, RM, NS** dhe Dëshmitarin Bashkëpunues X vrau një të burgosur ushtarak serb të ndaluar në Qendrën e Ndalimit në Kleçkë, mbetjet mortore të të cilit janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës, që përmbante pesë trupa të pajetë duke shkaktuar disa goditje në trup (në veçanti në qafë) me kosë; në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999, jo para datës 11 prill 1999.

Akuza 5 ngarkon **NS** për Krime lufte ndaj popullatës civile⁵²⁶ me pretendimin se ai, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkë-kryerje me **NK1, NK2** dhe **RM**, mori pjesë në vrasjen e **AA**, civil shqiptar nga Kosova, i cili paraprakisht ishte ndaluar dhe liruar nga Qendrën e Ndalimit në Kleçkë; më saktë, i pandehuri mori pjesë në krim duke mbajtur viktimën në dispozicion të kryerësve dhe duke e shtyer në një gropë në tokë, ku më pas është ekzekutuar nga **NK1** dhe **NK2** me armën AK-47; në Kleçkë, komuna e Lipjanit më apo rreth datës 3/4 prill 1999.

Akuza 6 ngarkon **NS** me vepren penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁵²⁷ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me **FL, NK1, NK2, AK, BL** dhe Dëshmitarin Bashkëpunues X, mori pjesë në vrasjen e **ND** dhe **VM**, dy policë serbë të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë, të cilët janë ekzekutuar nga Dëshmitari Bashkëpunues X me disa të shtëna pistolete; më saktë, i pandehuri mori pjesë në krim duke mbajtur viktimat në dispozicion të kryerësit të drejtpërdrejtë të ekzekutimit, edhe pse e dinte, për shkak se në mënyrë të qartë është informuar mbi qëllimin e **FL** për të vrarë të burgosurit, se çfarë do t'u

⁵²⁵ Sipas neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualish penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat të Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PShII

⁵²⁶ Sipas neneve 22, 142 KPRSFJ, aktualish penalizuar nga nenet 23, 120 KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat të Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PShII

⁵²⁷ Sipas neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualish penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat të Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PShII

ndodhte atyre; në lokacionin e quajtur Livadhi i Canit afër Kleçkës, komuna e Lipjanit më apo rreth datës 4/5 prill 1999.

Aktakuza pretendon se **NS** në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, duke mbajtur post përgjegjësie brenda Qendrës për Ndalim në Kleçkë, në bashkë-kryerje me të akuzuarit e caktuar, çënoi integritetin trupor dhe shëndetin e civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë.

Trupi Gjykes gjeti se kushtet e ndalimit në vetëvete nuk përbëjnë trajtim mizor dhe se nga individët e përmendur në aktakuzë, Dëshmitari Anonim H, i vëllai i tij dhe **SA** janë nënshtruar trajtimit mizor në burgun në Kleçkë.

Për më tepër, aktakuza pretendon se **NS**, në bashkë-kryerje me të akuzuarit e tjerë të caktuar torturoi katër të burgosur ushtarakë serbë; mori pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë; vrau një të burgosur ushtarak serb të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë; mori pjesë në vrasjen e **AA**; dhe mori pjesë në vrasjen e **ND** dhe **VM**.

Roli i NS në burgun në Kleçkë:

Aktakuza pretendon se **NS** ishte ndër personat përgjegjës për udheheqjen e burgut, përfshirë edhe pranimin dhe regjistrimin e të burgosurve. Të burgosur të caktuar i janë dorëzuar përgjegjësisë së **NS** me të arritur në burg.⁵²⁸

Disa dëshmitarë rikujtuan **NS**(‘F’). **QK** e njihte **NS** si anëtar i UÇK-së.⁵²⁹ **SD** e njihte nofkën ‘F’, por nuk i dinte emrin e vërtetë. **SD** tha se kishte parën ‘F’ në Kleçkë shumë shpesh.⁵³⁰ **BZ** rikujtoi

⁵²⁸ Aktakuza, f.25.

⁵²⁹ QK, *supra*

⁵³⁰ SD, *supra*

se si 'F' ishte oficer në komandën e Brigadës 121.⁵³¹ UK pa 'F', emri i parë N në disa raste në Divjake. Sipas UK, 'F' qëndroi në barake, por e kishte të lejuar edhe të hynte në shtabin e përgjithshëm.⁵³²

Në një deklaratë tjetër, UK rikujtoi se si në prill 1999, me arritjen e katër zyrtarëve serbë në Kleçkë, ishte polici ushtarak NS ('F') i cili mori sipër përgjegjësinë mbi oficerët serbë.⁵³³

Nuk ka prova të tjera, përpos dëshmisë së AZ, lidhur me ndërlidhjen e NS në Qendrën për Ndalim në Kleçkë.

Përgjegjësia e NS:

Provat mbi të cilat mbështetet Prokuroria nuk vërtetojnë se NS kishte pozitë me përgjegjësi të lartë në Qendrën për Ndalim në Kleçkë. Për këtë arsye, Trupi Gjykes gejn se i njëjti nuk mund të mbahet përgjegjës për trajtimin mizor të individëve të caktuar, siç ishte Dëshmitari Anonim H, vëllai i tij apo SA. Provat as nuk e përcaktojnë pjesëmarrjen aktive të NS në trajtimin mizor të individëve të caktuar, përfshirë edhe Dëshmitarin Anonim H, të vëllanë e tij apo SA.

Provat mbi të cilat mbështetet prokuroria nuk vërtetojnë se NS mori pjesë në torturën e katër të burgosurve ushtarakë serbë; mori pjesë në vrasjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë; vrau një të burgosur ushtarak serb të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë; mori pjesë në vrasjen e AA; dhe apo se mori pjesë në vrasjen e VM dhe ND. Prokuroria mbështet lëndën në dëshminë e AZ.⁵³⁴ Nuk ka prova të tjera për të pohuar sjelljen e NS në kryerjen e këtyre krimeve.

⁵³¹ DZ, *supra*

⁵³² Dëshmitari Anonim I, *supra*

⁵³³ Prova P6, Dëshmitari Anonim I, *supra*

⁵³⁴ Aktuza, f.28, 29, 30, 31, 32, 33.

Prokuroria mbeshtetet vetëm në dëshminë e dhënë nga **AZ** për këto pretendime. Trupi Gjykses gjen se **DT, DV, BC, ZF, ZT, VM** dhe **ND** janë vrarë në mënyrë të paligjshme.

Prova e vetme lidhur me pretendimin për vrasje e paligjshme të **AA** është ajo e **AZ**. Trupi nuk është gjetur. **AA** është zyrtarisht i zhdukur.

Trupi Gjykses gjeti se kushtet e ndalimit në burgun në Kleçkë në vetëvete nuk përbëjnë trajtim mizor.

Trupi Gjykses gjeti se **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe si pasojë, nuk do të ishte gjë e sigurt të mbështetej në dëshminë e tij. Edhe po të kishte arritur Trupi Gjykses deri te përfundimi se **AZ** ishte dëshmitar i besueshëm, neni 157 (4), KPPK parasheh se gjykata nuk shpallë të fajshëm askë vetëm mbi provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Trupi Gjykses gjen se nuk është vërtetuar se **NS** ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet.

SS1 akuzohet me dy pikë të aktakuzës.

Akuza 1 ngarkon **SS1** me veprën penale Krime lufte ndaj popullatës civile dhe krime lufte ndaj robërve të luftës⁵³⁵ me pretendimin se në cilësinë e anëtarit të UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me **FL, NK1, NK2, NS, AK, BL, BS**, Dëshmitarin Bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë, deri tani të pidentifikuar të UÇK-së, cënoi integritetin trupir dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e të burgosurve me zinxhirë, objekte të papërshtatshme, i ftohtë i tepërt, mungesë e kushteve higjienike, të ushqyer jo adekuat, rrahje të shpeshta); në Kleçkë, komuna e Lipjanit nga fillimi 1999 deri në mes të qershorit 1999.

⁵³⁵ Sipas neneve 22, 142, 144 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PShII

Akuza 2 ngarkon **SS2** me veprën penale Krime lufte ndaj robërve të luftës⁵³⁶ me pretendimin se në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me Dëshmitarin Bashkëpunues X, **NK2**, **NS**, **BS**, torturoi katër të burgosur ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë, dhe të paktën tre prej tyre janë identifikuar nëpërmjet ADN-së si **BC**, **ZF** dhe **ZT**, duke i rrahur vazhdimisht; në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999, jo para 11 prillit 1999.

Sa i përket cënimit të integritetit trupir dhe shëndetit të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, Aktakuza pretendon se **SS1** ishte në Kleçkë rregullisht dhe se zëvendësonte **NK1** në ushtrimin e detyrave kur ky mungonte. Në veçanti, të burgosurit janë sjellur te **SS1** për pranim në burgun në Kleçkë.⁵³⁷ Më tutje, aktakuza pretendon se **SS1** mori pjesë në rrahjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë të cilët janë sjellur në Kleçkë në mes apo në fund të prillit 1999. Kësisoj, **SS1** kontriboi në torturën e katër të burgosurve ushtarakë serbë.⁵³⁸

Prokuroria mbështetet në deklaratën e **UK**, i cili tha se kishte parë **SS1** në Kleçkë më 1999.⁵³⁹ Trupi Gjykues vë re se **UK** dëshmoi se ka parë **SS1** edhe në vende të tjera gjatë luftës.⁵⁴⁰ Sidoqoftë, nuk është gjë më shumë se sa mundësia që **SS1** të ketë qenë në Kleçkë më 1999.

Trupi Gjykues gjeti se kushtet e ndalimit në Kleçkë *në vetëvete* nuk përbëjnë trajtim mizor.

Trupi Gjykues gjen se **DT**, **DV**, **BC**, **ZF** dhe **ZT** janë vrarë në mënyrë të paligjshme.

Trupi Gjykues gjeti se **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe si pasojë, nuk do të ishte gjë e sigurt të mbështetej në dëshminë e tij. Edhe po të kishte arritur Trupi Gjykues deri te

⁵³⁶ Sipas neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PShII

⁵³⁷ Aktakuzë, p.25.

⁵³⁸ Aktakuzë, pp.31, 32.

⁵³⁹ Aktakuzë, p.25.

⁵⁴⁰ Dëshmitari Anonim I, *supra*

përfundimi se **AZ** është dëshmitar i besueshëm, neni 157 (4), KPPK, parasheh që gjykatë nuk shpallë askë të fajshëm bazuar vetëm në provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Trupi Gjykes gjeti se nuk është dëshmuar se **SS1** ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet.

SS2 ngarkohet me një pikë të aktakuzës.

SS2 ngarkohet me një pikë të veprës penale Krime lufte ndaj popullatës civile dhe krime lufte ndaj robërve të luftës⁵⁴¹ ku pretendohet se ai, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së, në bashkëkryerje me **FL, NK1, NK2, NS, AK, BL, BS, SS1**, Dëshmitarin Bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë, deri tani të paidentifikuar të UÇK-së, çënoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e tyre me zinxhirë, objekte të papërshtatshme, i ftohtë u tepërt, mungesë e kushteve higjienike, të ushqyr joadekuat, rrahje të shpeshta); në Kleçkë, komuna e Lipjanit nga fillimi i 1999 deri në mes të qershorit 1999.

Sa i përket pretendimit për cënim të integritetit trupor dhe shëndetit të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, aktakuza pretendon se në rast të mungesës së **AZ** në burgun në Kleçkë, ky zëvendësohej nga **SS2**.⁵⁴²

Pretendimet sa i përket përgjegjësisë individuale të **SS2** bazohen në provat e dhëna nga **AZ**. Duke lënë mënjanën dëshminë e **AZ**, Prokurori Special i EULEX-it i është referuar edhe deklaratës së dhënë nga Dëshmitari Anonim M, i cili është 'mbajtur në Qendrën për Ndalim në Kleçkë' dhe 'vuri re **SS2** dhe **NK2** duke i kryer punët sikur të ishin personat përgjegjës për

⁵⁴¹ Sipas neneve 22, 142, 144 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat të Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PSHII

⁵⁴² Aktakuza, f.25.

burgun'.⁵⁴³ Dëshmitari Anonim M dëshmoi se është arrestuar nga anëtarët e UÇK-së në mars apo prill 1999.⁵⁴⁴

Sa i përket çështjes së trajtimit në Qendrën për Ndalim në Kleçkë, Trupi Gjykues gjeti se Dëshmitari Anonim H, i vëllai i tij dhe **SA** janë nënshtruar trajtimit mizor.

Dëshmitari Anonim H dëshmoi duke thënë se ai dhe i vëllai i tij janë dërguar në Kleçkë më 27 shkurt 1999, dhe kjo nuk është periudha që përmend Dëshmitari Anonim M të jetë mbajtur në Kleçkë, kur ka parë **SS2** aty.

Provat tregojnë se **SA** është ndaluar në burgun në Kleçkë në mars 1999, me gjasë deri më 3 prill 1999. Dëshmitari Anonim M dëshmoi se është ndaluar në Kleçkë në mars apo prill 1999, kur ka parë **SS2** 'duke përmbushur detyrat e personit përgjegjës për burgun'. Trupi Gjykues vë re se deklarata e Dëshmitarit Anonim M ka mungesë të qartësisë se a ishte mars apo prill 1999, dhe nëse ishte në prill 1999, a ishte para datës 3 prill 1999 kur M pa **SS2** 'duke kryer funksionet e personit përgjegjës për burgun'.

Trupi Gjykues gjeti se **AZ** nuk është dëshmitar i besueshëm dhe si pasojë, nuk do të ishte gjë e sigurt të mbështetej në dëshminë e tij. Edhe po të kishte arritur Trupi Gjykues deri te përfundimi se **AZ** është dëshmitar i besueshëm, neni 157 (4), KPPK, parasheh se gjykata nuk gjen askë fajtor bazuar vetëm në provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Sidoqoftë, sipas nenit 157 (3), KPPK, Trupi Gjykues nuk shpallë të akuzuarin fajtor bazuar vetëm apo deri në një pikë vendimtare në dëshminë e Dëshmitarit Anonim M.

Trupi Gjykues gjen se nuk është dëshmuar se **SS2** ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar.

⁵⁴³ Aktakuza, f.25.

⁵⁴⁴ Dëshmitari Anonim M, *supra*

BS ngarkohet me dy pikë të aktakuzës.

Akuza 1 ngarkon **BS** me veprën penale Krime lufte ndaj popullatës civile dhe krime lufte ndaj robërve të luftës⁵⁴⁵ me pretendimin se ai, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK -së, në bashkë-kryerje me **FL, NK1, NK2, NS, AK, BL, SS1**, Dëshmitarin Bashkëpunues X, **SS2** dhe ushtarë të tjerë, deri tani të pidentifikuar të UÇK-së, çënoi integritetin trupor dhe shëndetin e një numri të pacaktuar të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë të ndaluar Qendrën për Ndalim në Kleçkë, duke i mbajtur në kushte çnjerëzore (përfshirë lidhjen e tyre me zinxhirë, objekte të papërshtatshme, i ftohtë i tepërt, mungesë e kushteve higjienike, të ushqyer joadekuat, rrahje të shpeshta) në Kleçkë, komuna e Lipjanit nga fillimi i 1999 deri mesi i qershorit 1999.

Akuza 2 ngarkon **BS** me veprën penale Krime luftë ndaj robërve të luftës⁵⁴⁶ me pretendimin se ai, në cilësinë e tij si anëtar i UÇK-së dhe në bashkë-kryerje me **NK2, NS** dhe **SS1** torturoi katër të burgosur ushtarakë serbë të ndaluar në Qendrën për Ndalim në Kleçkë, mbetjet mortore të cilëve janë gjetur në një varr masiv afër Kleçkës, ku të paktën tre prej tyre janë identifikuar nëpërmjet ADN-së si **BC, ZF** dhe **ZT**, duke i rrahur vazhdimisht; në Kleçkë, komuna e Lipjanit në një datë të pacaktuar në prill 1999, jo para datës 11 prill 1999.

Sa i përket çështjes së cënimit të integriteti trupor dhe shëndetit të civilëve serbë dhe shqiptarë dhe të burgosurve ushtarakë serbë, aktakuza pretendon se i akuzuari **BS** ishte rregullisht në Qendrën për Ndalim në Kleçkë dhe zëvendësonte **NK1** në mungesë të tij. Kjo është e bazuar në dëshminë e **AZ**. Aktakuza lexon se **NK1** ishte përgjegjës për drejtimin e burgut së bashku me **NS**.⁵⁴⁷ Për më tepër, aktakuza pretendon se **BS** mori pjesë në rrahjen e katër të burgosurve ushtarakë serbë, gjë që përbën torturë.⁵⁴⁸

⁵⁴⁵ Sipas neneve 22, 142, 144 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PShII

⁵⁴⁶ Sipas neneve 22, 144 KPRSFJ, aktualisht penalizuar nga nenet 23, 120, KPK në kundërshtim me nenin 3, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës 1949, dhe nenet 4, 5(1), PShII

⁵⁴⁷ Aktakuza, f.25.

⁵⁴⁸ Aktakuza, f.32.

Edhe po të kishte arritur Trupi Gjykses deri te përfundimi se **AZ** është dëshmitar i besueshëm, neni 157 (4), KPPK parasheh që gjykata nuk shpallë askë fajtor bazuar vetëm në provën e dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

Trupi Gjykses gjen se nuk është dëshmuar se **BS** ka kryer veprat penale me të cilat ngarkohet.

Trupi Gjykses shqyrtoi të gjitha provat e cekura në anekset si më poshtë. Në veçanti, Trupi Gjykses shqyrtoi deklaratat e dëshmitarëve nga 1 deri 33 në Aneksin 1. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 18 prill 2013, prokurori dhe avokati mbrojtës janë pajtuar që dëshmitë e këtyre dëshmitarëve të konsiderohen si të lexuara pa nevojën që këta të japin *viva voce* dëshmi. Provat në anekse që i asistuan Trupit Gjykses për të përcaktuar çështjet paraprake, referohen në arsyetimin si më lart.

Në bazë të arsyeve të përmendura, Trupi Gjykses gjen si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykatësi Malcolm Simmons

Kryetar i Trupit Gjykses

Gjykatëse Mariola Pasnik
Anëtare e Trupit Gjykes

Gjykatëse Shpresa Hasaj-Hyseni
Anëtare e Trupit Gjykes

Nexhmije Mezini
Procesmbajtëse

MJET LIGJOR: Personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur janë pajisur me një kopje të Aktgjykimit, sipas Nenit 398 (1) KPPK.

SHTOJCA I

Dëshmitarët

Dëshmitë Viva Voce

1. **BZ**
2. Dëshmitari anonim B
3. Dëshmitari anonim M
4. Dëshmitari anonim C
5. Dëshmitari A
6. **UK**
7. **GZ**
8. **CC**

Dëshmitarët Ekspertë

- 1) Dëshmia P50, ekspertiza grafologjike e manuskripteve, datë 30 dhjetor 2012 e Profesor **AB**;
- 2) Dëshmia P51, ekspertiza grafologjike e manuskripteve, datë 2 korrik 2013 e Profesor **AB**;
- 3) Dëshmia D e Mbrojtjes (FL) 9 ekspertiza grafologjike e manuskripteve, datë 2 shkurt 2012 e Dr. **HK** dhe CV e **HK**;
- 4) Dëshmia D e Mbrojtjes (FL) 10 ekspertiza grafologjike e manuskripteve, datë 26 shkurt 2012 e Dr. **HK**;
- 5) Dëshmia D e Mbrojtjes (FL) 11 ekspertiza grafologjike e manuskripteve datë 30 maj 2013 e Dr. **HK**;
- 6) Dëshmia C1, Raporti i Dr. **XD** datë 12 korrik 2013.
- 7) Dëshmia C2, Raporti i Dr. **FD** datë 15 korrik 2013.
- 8) Dëshmia C3, Raporti i Dr. **NSH** datë 15 korrik 2013.
- 9) Dëshmia C4, Raporti Dr. **MK** datë 13 korrik 2013.
- 10) Dëshmia C5, Raporti i Dr. **RL** datë 12 gusht 2013
- 11) Dëshmia C6, Addendum raportit të Dr. **RL** datë 27 gusht 2013
- 12) Dëshmia C7, Email i Dr. **RL** datë 30 gusht 2013
- 13) Dëshmia C8, Raport shtesë i Dr. **XD** datë 19 gusht 2013.
- 14) Dëshmia C9, Raport shtesë i Dr. **FD** dhe Dr. **NSH** datë 21 gusht 2013.
- 15) Dëshmia C10, raport tjetër shtesë i Dr. **XD** datë 29 gusht 2013.
- 16) Dëshmia C11, raport tjetër shtesë i Dr. **FD** dhe Dr. **NSH** datë 29 gusht 2013.
- 17) Dëshmia P52 Raport i Dr. **FR** datë 29 gusht 2013

Përveç aty ku ku është bërë referencë tjetër dhe ato që janë pranuar si prova në këtë procedurë, palët u pajtuan që deklaratat me shkrim të mëposhtme të konsiderohen si të lexuara:

1. **AG**, 20 tetor 2011;
2. **AA**, 23 shtator 2011;
3. **AS** 28, shtator 2011;
4. **BS** 28 shtator 2011;
5. **ER**, 20 tetor 2011;

6. **FS** 27 shtator 2011
7. **FZ**, 1 nëntor 2011;
8. **FM** 24 tetor 2011;
9. **FH** 26 shtator 2011;
10. **HA**, 13 shtator 2011;
11. **HT**, 8 nëntor 2011;
12. **HS**, 14 shtator 2011;
13. **IH**, 13 tetor 2011;
14. **JS**, 2 nëntor 2011;
15. **KV**, 26 shtator 2011;
16. **II**, 13 shtator 2011 dhe 27 tetor 2011;
17. **MJ**, 27 shtator 2011;
18. **NB** , 13 tetor 2011;
19. **NK**, 20 tetor 2011;
20. **RM**, 26 shtator 2011;
21. **RS**, 27 shtator 2011;
22. **RS**, 20 tetor 2011;
23. **SA**, 29 shtator 2011;
24. **SS**, 2 nëntor 2011;
25. **ST**, 13 tetor 2011;
26. **SB**, 26 shtator 2011;
27. **SB**, 2 nëntor 2011;
28. **SS**, 27 shtator 2011;
29. **BT**, 24 nëntor 2011;
30. **NR**, 12 janar 2012;
31. **NM**, 17 janar 2012;
32. **HG**, 30 nëntor 2011;
33. **IZ**, 27 mars 2012 dhe 29 janar 2013;
34. **GK**, 9 maj 2012;
35. **AC**, 3 gusht 2011 dhe 1 nëntor 2011;
36. **BZ**, 29 korrik 2011 dhe 25 tetor 2011.

SHTOJCA II

PROVAT E PARASHTRUARA NGA PROKURORIA

Nëndosja A e PSRK-së

1. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 4 shkurt 2010, faqet **A1 – A14**
2. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 9 shkurt 2010, faqet **A15 – A70**
3. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 11 shkurt 2010, faqet **A71 – A115**
4. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 16 shkurt 2010, faqet **A116 – A132**
5. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 17 shkurt 2010, faqet **A133 – A149**
6. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 10 mars 2010, faqet **A150 – A166**
7. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 16 mars 2010, faqet **A167 – A193**
8. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 25 mars 2010, faqet **A194 – A218**
9. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 9 qershor 2010, faqet **A219 – A266**
10. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 20 gusht 2010, faqet **A267 – A303**

11. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 5 tetor 2010, faqet **A304 – A385**
12. Procesverbali i marrjes në pyetje të **AZ** më datë 7 tetor 2010, faqet **A386 – A389**

Nëndosja A/bis e PSRK-së

13. Procesverbal i marrjes në pyetje të Dëshmitarit Bashkëpunues **AZ** nga ana e avokatit mbrojtës më datë 5 korrik 2011, faqet **A1 7– A56**;
14. Procesverbal i marrjes në pyetje të Dëshmitarit Bashkëpunues **AZ** nga ana e avokatit mbrojtës më datë 6 korrik 2011, faqet **A57 – A93**;
15. Procesverbal i marrjes në pyetje të Dëshmitarit Bashkëpunues **AZ** nga ana e avokatit mbrojtës më datë 7 korrik 2011, faqet **A94 – A220**;
16. Procesverbal i marrjes në pyetje të Dëshmitarit Bashkëpunues **AZ** nga ana e avokatit mbrojtës më datë 9 korrik 2011, faqet **A221 – A259**.

Nëndosja B e PSRK-së

- 1) **Dëshmitari Y**, 20 prill 2012, procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK, faqet **B2 – B16**;
- 2) **Dëshmitari Anonim C**, 21 shtator 2010, procesverbali PSRK-së të dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi me shtojcë, faqet **B17 – B35**;
- 3) **Dëshmitari Anonim I**, 22 nëntor 2010, raport – marrje në pyetje deklarata e dëshmitarit, faqet **B36 – B88**;
- 4) **Dëshmitari A**, 23 shtator 2010, procesverbali PSRK-së të dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi me shtojca, faqet **B89 – B165**;
- 5) **Dëshmitari F**, 2 janar 2011, raport – marrje në pyetje deklarata e dëshmitarit me shtojca, faqet **B166 – B278**;
- 6) **BK**, 4 tetor 2010 dhe 15 tetor 2010, procesverbali PSRK-së të dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi me shtojcë, faqet **B279 – B289**;
- 7) **Dëshmitari E**, 28 tetor 2010, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi, faqet **B290 – B310**;
- 8) **Dëshmitari Anonim B**, 4 dhjetor 2010, raport – marrje në pyetje deklarata e dëshmitarit me shtojca, faqet **B311 – B354**;

- 9) **Dëshmitari G**, 11 janar 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **B355 – B394**;
- 10) **Dëshmitari Anonim H**, 24 gusht 2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **B395 – B444**.

Nëndosja C e PSRK-së

- 11) **QK**, 14 qershor 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **C3 – C14**.
- 12) **AQ**, 7 qershor 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **C15 – C34**;
- 13) **Dëshmitari T**, 3 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **C35 – C49**;
- 14) **Dëshmitari S**, 21 prill 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **C50 – C54**
- 15) **Dëshmitari V**, 18 prill 2011, intervistë në cilësinë e dëshmitarit me shtojcë, faqet **C55 – C97**;
- 16) **HB**, 8 prill 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi, faqet **C98 – C101**;
- 17) **IA**, 7 prill 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **C102 – C110**;
- 18) **NM**, 6 prill 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **C111 – C120**;
- 19) **NM**, 5 prill 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi me shtojca, faqet **C121 – C138**;
- 20) **BZ**, 5 prill 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi me shtojca, faqet **C139 – C150**;
- 21) **DD**, 4 prill 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **C151 – C158**;
- 22) **ZK**, 1 prill 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi, faqet **C159 – C164**;
- 23) **BK**, 8 janar 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **C165 – C203**;
- 24) **Dëshmitari N**, 4 janar 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **C204 – C245**;
- 25) **Dëshmitari D**, 24 dhjetor 2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 18 janar 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi, faqet **C246 – C267**;

- 26) **Dëshmitari R**, 22 dhjetor 2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **C268 – C308**;
- 27) **NH**, 2 dhjetor 2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **C309 – C322**;
- 28) **AO**, 30 nëntor 2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **C323 – C370**;
- 29) **HK**, 20 tetor 2010, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi, faqet **C371 – C388**;
- 30) **BT**, 8 tetor 2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojca, faqet **C389 – C411**;
- 31) **JU**, 24 gusht 2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit me shtojcë, faqet **C412 – C420**;
- 32) **GB**, 24 gusht 2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **C427 – C433**;

Nëndosja D e PSRK-së

- 33) **Dëshmitari Anonim L**, 12 prill 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi, faqet **D1 – D7**;
- 34) **Dëshmitari Anonim M**, 30 mars 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 20 maj 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi, faqet **D8 – D30**;
- 35) **AH**, 14 dhjetor 2010, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 27 maj 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi, faqet **D31 – D46**;
- 36) **SB**, 27 maj 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi, faqet **D47 – D54**;
- 37) **Dëshmitari U**, 25 qershor 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D55 – D77**;
- 38) **dëshmitari W**, 16 qershor 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D78 – D91**;
- 39) **IZ**, 19 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D92 – D102**;
- 40) **BZ**, 23 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D103 – D115**;
- 41) **ST**, 25 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D116 – D124**;
- 42) **RI**, 24 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D125 – D134**;
- 43) **FK**, 31 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D135 – D148**;

- 44) **ZS**, 18 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 23 korrik 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja, faqet **D149 – D169**;
- 45) **VS**, 17 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit; 23 korrik 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja, faqet **D170 – D185**;
- 46) **LS**, 18 maj 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja; 23 korrik 2011 procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja, faqet **D186 – D201**;
- 47) **Dëshmitari O**, 24 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D202 – D214**;
- 48) **Dëshmitari Q**, 26 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D215 – D227**;
- 49) **Dëshmitari P**, 25 maj 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D228 – D239**;
- 50) **BT**, 5 prill 2011, raport – marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit, faqet **D240 – D249**.

Nëndosja E e PSRK-së

- 51) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/001**;
- 52) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/002**;

Nëndosja F e PSRK-së

- 53) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/003**;
- 54) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/004**;
- 55) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/005**;
- 56) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/006**;
- 57) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/007**;
- 58) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/008**;
- 59) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/009**;
- 60) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/010**;
- 61) Dokument shënuar **0096-09-EWC2/011**;

- 62) Dokument shënuar 0096-09-EWC2/012;
- 63) Dokument shënuar 0096-09-EWC2/013;
- 64) Dokument shënuar 0096-09-EWC2/014;
- 65) Dokument shënuar 0096-09-EWC2/015;
- 66) Dokument shënuar 0096-09-EWC2/016;
- 67) Dokument shënuar 0096-09-EWC2/017;
- 68) Dokument shënuar 0096-09-EWC2/018;
- 69) Fletë-lëshim, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/019;
- 70) Certifikatë, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/020;
- 71) Vërtetim mbi shërbimin në UÇK, Dokument shënuar 0096-09-WC2/021;
- 72) Udhëzues mbi implementimin e procedurës lidhur me të ndaluarit, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/022;
- 73) Shënim për burgun ushtarak, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/023;
- 74) Raport pune, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/024;
- 75) Aktgjykim, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/025;
- 76) Aktgjykim, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/026;
- 77) Raport pune, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/027;
- 78) Raport pune, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/028;
- 79) Raport pune, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/029;
- 80) Vendim, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/030;
- 81) Kërkesë, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/031;
- 82) Kërkesë, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/032;
- 83) Vendim, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/033;
- 84) Urdhëresë, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/034;
- 85) Ankesë, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/035;
- 86) Njoftim, Dokument shënuar 0096-09-EWC2/036,

Nëndosja G e PSRK-së

- 87) Raport i policisë datë 7 qershor 2010, faqet **G1 – G4**;

- 88) Dokumente të konfiskuara gjatë një kontrolli në rezidencën e FLt më datë 29 prill 2010 – faqe **G5**
– **G244**;

Nëndosja H e PSRK-së

- 89) Raporti i NJHKL të EULEX-it me ditari i hetimeve, EWC numri **0068-09-EWC4**, faqe **H2-H5**;
- 90) Raporti i policisë mbi zhvarrosjen, 30 shtator 2009, faqet **H6-H20**.
- 91) Përmbledhje e informatave, faqe **H21-H25**.
- 92) Shtojcë, faqe H26
- 93) Raporti vlerësues i policisë me shtojca, 24-26 gusht 2009, faqe **H30-H40**.
- 94) Urdhër për zhvarrosje, inspektimi post mortem, autopsi dhe identifikim, PPP nr.685/09, 8. shtator 2009, faqe **H41**.
- 95) Komunikim nga NJHKL me PQ të EULEX-it, 27 shtator 2009, faqe **H45-H46**.
- 96) Deklaratat lidhur me zinxhirin e ruajtjes, faqe **H47-H48**.
- 97) Deklaratat e printuara të KNPZH mbi personat e zhdukur, faqe **H49-H53**.
- 98) Raporte autopsie të UNMIK-ut 29 tetor 2009, faqe **H54-H59**.
- 99) Deklaratë e zinxhirit të ruajtjes, faqe **H60**.
- 100) Formularë pranimit-dorëzimit të kufomave të zhvarrosura, 23 shtator 2009 dhe 25 shtator 2009, faqe **H61-H66**.
- 101) Certifikatë vdekjeje e **BC**, 12 dhjetor 2009, **H67-H68**.
- 102) Informatë mbi identifikimin e viktimës, faqet **H69-H91**.
- 103) Certifikatë vdekjeje e **DV**, 12 dhjetor 2009, faqe **H92-H93**.
- 104) Formulari i identifikimit të viktimës nr.1999-010047, faqe **H94-H111**.
- 105) Paraqitje e fotografisë në letër KER, faqe **H112-H134**.
- 106) CD zhvarrimit KER, faqe **H135**.

Nëndosja I e PSRK-së

- 107) CD që përmban versione elektronike të dëshmive,
- 108) Raporte autopsie me shtojca lidhur me dy kufoma gjetur në varrin KEQ, faqe 1-198.

Nëndosja L e PSRK-së

- 109) CD që përmban versione elektronike të raporteve të autopsisë dhe raporte ante mortem;
- 110) **MG**, 20 janar 2010, procesverbal i seancës dëgjimore të dëshmitarit ekspert gjatë hetimit në faqet **L1 – L3**;
- 111) **TF**, 20 janar 2010, procesverbal i seancës dëgjimore të dëshmitarit ekspert gjatë hetimit në faqet **L4 – L6**;
- 112) Kuti me fotografi të vendodhjes së varrit KER, faqe **L7-L9**;
- 113) Raport autopsie dhe raport ante mortem raport për kufomën KER01/001B, faqet **L10-L96**;
- 114) Raport autopsie dhe raport ante mortem raport për kufomën KER01/004B, faqe **L97-L237**;
- 115) Raport autopsie dhe raport ante mortem raport për kufomën KER01/005B, faqe **L238-L335**;
- 116) Raport autopsie dhe raport ante mortem raport për kufomën KER01/006B, faqe **L336-L412**;
- 117) Raport autopsie dhe raport ante mortem raport për kufomën KER01/004B, faqe **L413-L516**.

Nëndosja M e PSRK-së

- 118) Raport paraprak i policisë me shtojca dhe CD, faqe **M2 – M137** (Deklaratat e **AZ** datë 20 dhe 30 nëntor 2009 janë respektivisht **M5 – M7** dhe **M12 – M29**);
- 119) Raport i policisë mbi kthimin e sekndeve **NK1**, faqe **M138 – M144**;
- 120) Raport i policisë datë 20 qershor 2011 mbi ekzaminimin ekspertizë të sendeve sekuestruar në rezidencën e **NK1**, faqe **M145 – M180**;
- 121) Raporti i policisë mbi ekzaminimin ekspertizë të sendeve sekuestruar në rezidencën e **NS**, faqe **M181 – M184**;
- 122) Raporti i policisë mbi kontrollin e lokaleve të **NS** (dosje nr.1-3), 18.03.2011, faqe **M185 – M206**;
- 123) Raporti i policisë mbi ekzaminimin ekspertizë të sendeve sekuestruar në rezidencën e **NK1** dhe **NS** datë 6 maj 2011, faqe **M207 – M211**;
- 124) Raporti final forenzik i telefonëve mobilë konfiskuar nga **NS** dhe CD e bashkangjitur, faqe **M212 – M214**;
- 125) Raporti i policisë mbi ekzaminimin ekspertizë të sendeve sekuestruar në rezidencën e **NK1** datë 6 qershor 2011, faqe **M215 – M244**;

- 126) Urdhër bastisjeje lëshuar nga GjPP 25/10 (PPS 07/10), datë 17 mars 2011;
- 127) Kërkesë për punësim në polici nga **NK2**, datë 23.04.2002, faqe **M245 – M258**;
- 128) Raporti i policisë mbi kontrollin e zhvilluar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, 2 shkurt 2011, me shtojca, faqe **M259 – M290**;
- 129) Procesverbale mbi bastisje **M291 – M306**;
- 130) Fotografi të konfiskuara në vendbanimin e **NS**, etiketuar si dëshmi **NS1 – NS19** të nëndosjes M të PSRK-së.
- 131) Urdhër bastisjeje lëshuar nga GjPP 25/10 (PPS 07/10), datë 19 nëntor 2010.

Nëndosja O e PSRK-së

- 132) CD mbi paraburgimin e të Pandehurve;
- 133) **AK**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 14 prill 2011, faqe O1 – O25
- 134) **AK**, intervista e të dyshuarit datë 12 maj 2011, faqe O26 – O30
- 135) **NK1**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 16 prill 2011, faqe O31 – O34
- 136) **NK1**, intervista e të dyshuarit datë 12 maj 2011, faqe O35 – O48
- 137) **NK2**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 16 prill 2011, faqe O49 – O51
- 138) **NK2**, intervista e të dyshuarit datë 11 maj 2011, faqe O52 – O113
- 139) **BL**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 14 prill 2011, faqe O114 – O116
- 140) **BL**, intervista e të dyshuarit datë 11 maj 2011, faqe O117 – O124
- 141) **FL**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 13 maj 2011, faqe O125 – O127
- 142) **FL**, marrje në pyetje e të dyshuarit 17 maj 2011, faqe O128 – O150
- 143) **RM**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 14 prill 2011, faqe O151 – O155
- 144) **RM**, marrje në pyetje e të dyshuarit datë 11 maj 2011, faqe O156 – O163
- 145) **NS**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 16 mars 2011, faqe O164 – O169
- 146) **NS**, marrje në pyetje e të dyshuarit datë 11 maj 2011, faqe O170 – O178
- 147) **SS1**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 16 mars 2011, faqe O179 – O182
- 148) **SS1**, marrje në pyetje e të dyshuarit datë 11 maj 2011, faqe O183 – O200
- 149) **SS2**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 16 mars 2011, faqe O201 – O205
- 150) **SS2**, marrje në pyetje e të dyshuarit datë 12 maj 2011, faqe O206 – O209
- 151) **BS**, procesverbali i seancës së paraburgimit datë 16 mars 2011, faqe O210 – O213

152) **BS** marrje në pyetje e të dyshuarit datë 12 maj 2011, faqe O214 – O225

Dëshmitë e Prokurorisë Nëndosja I

- 153) Kopje e të ashtuquajturit 'Diteri Gjerman' i Dëshmitarit X;
- 154) Dëshmia **P2**, raporti i policit të NJHKL së EULEX-it 10 nëntor 2011 lidhur me lokacione të rëndësishme lidhur me lëndën Kleçka dhe fotografi të bashkangjitura;
- 155) Dëshmia **P3**, përgjigje e Departamentit për Mjekësi Ligjore të EULEX-it Kosovë lidhur me personin e zhdukur AA;
- 156) Dëshmia **P4**, certifikatë vdekjeje e AZ;
- 157) Dëshmia **P6**, **Dëshmitari Anonim I**, 2 nëntor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi;
- 158) Dëshmia **P7**, **MB**, 8 nëntor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi;
- 159) Dëshmia **P8**, BG, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi;
- 160) Dëshmia **P9**, **JS**, 2 nëntor 2011, raport-marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit;
- 161) Dëshmia **P10**, **FZ**, 27 tetor 2011, raport-marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit;
- 162) Dëshmia **P11**, **SZ**, 26 tetor 2011, raport-marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit;
- 163) Dëshmia **P12**, **FZ**, 26 tetor 2011, raport-marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit;
- 164) Dëshmia **P13**, **NZ**, 25 tetor 2011 raport-marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit;
- 165) Dëshmia **P14**, **IZ**, 24 tetor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja gjatë një hetimi;
- 166) Dëshmia **P15**, **BH**, 23 nëntor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit nga PSRK-ja;
- 167) Dëshmia **P16**, **BT** 24 nëntor 2011, raport-marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit;
- 168) Dëshmia **P17**, **NB**, 12 shtator 2011, raport-marrje në pyetje deklaratë e dëshmitarit;
- 169) Dëshmia P18, procesverbal i të pandehurit FL datë 29 shtator 2011;
- 170) Dëshmia P19, procesverbal i të pandehurit NS datë 25 tetor 2011;
- 171) Exhibit P20, procesverbal i të pandehurit BS datë 25 tetor 2011;
- 172) Dëshmitë **P21a**, **P21b**, **P21c**, **P21d**, **P21f**, vendim i prokurorit special të EULEX-it Maurizio Salustro për të marrë pjesë të dosjes së lëndës nr. 2003/224/PEJ, deklarata e **TM** nga autoritetet hetimore të Republikës së Serbisë, 27 janar 2005 dhe 11 prill 2004 dhe shtojca (2);
- 173) Dëshmia **P22**, **AZ** 23 nëntor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi;

- 174) Dëshmia **P23, IZ**, 23 nëntor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi;
- 175) Dëshmia **P24, CC**, 6 dhjetor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi;
- 176) Dëshmia **P25, GK**, 7 dhjetor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit gjatë një hetimi;
- 177) Dëshmia **P26, SD**, 8 dhjetor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit;
- 178) Dëshmia **P27, MZS**, 12 dhjetor 2011, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit;
- 179) Dëshmitë **P28a, P28b-P28f**, letër nga arkeologu i mjekësisë ligjore drejtuar Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro, 8 dhjetor 2011, dhe tabela krahasuese (5);
- 180) Dëshmitë **P29a** dhe **P29b**, Raport i Mjekësisë Ligjore DFM KEQ 01, 10 – 11 gusht 2010, dhe Raporti i Mjekësisë Ligjore DFM KEQ 02, 10 – 11 gusht 2010;
- 181) Dëshmitë **P30a-P30e**, letër nga hetuesi i NJHKL drejtuar Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro, 15 shtator 2011, lidhur me raportet e zhvarrosjes, raporti i policisë mbi zhvarrosjen, 24 shtator 2009, raport shtesë i policisë mbi zhvarrosjen, 17 gusht 2010, paraqitje fotografi në letër KEQ Klecka;
- 182) Dëshmia **P31, HS**, 24 janar 2012, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit;

Dëshmitë e Prokurorisë Nëndosja II

- 183) Dëshmia **P33, BK**, 7 shkurt 2012, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit;
- 184) Dëshmia **P34**, tabelë fotografi PPS 07/10– bashkangjitur dëgjimit të **Dëshmitarit V** 18 prill 2011;
- 185) Dëshmia **P35, GA**, 8 shkurt 2012, procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit PSRK;
- 186) Dëshmia **P36**, Dosja e Policisë nga Zyrat Qendrore të Policisë Duisberg lidhur me vdekjen e AZ, 28 shtator 2011;
- 187) Dëshmia **P37**, një dokument i vetëm që përmban një shënim zyrtar nga Krye-inspektori i Policisë kriminale, 29 shtator 2011, përgjigje e Mjekut të përgjithshëm, 29 shtator 2011, shënim mbi autopsinë;

Dëshmi Shtesë paraqitur gjatë Ri-Shqyrtimit

- 188) Dëshmia P38, Raporti i oficerit (lënda e NJHKL Nr. WCU-0096-09-EWC2) datë 2 prill 2012 [lidhur me pranim-dorëzimin e dëshmisë ditare sekuestruar në Gjermani]⁵⁴⁹ së bashku me dokumente të cilave i është referuar këtu dhe me data 19 mars 2011, 5, 6 dhe 8 qershor 2011, 3 korrik 2011, 25 dhe 28 gusht 2011, ;
- 189) Dëshmia P39, dokumente të ofruara nga Dëshmitari Y ku përfshihen ekstrakte të ditarit të AZs gjatë dëshmisë së saj më datë 14 maj 2013 [ku përfshihen kopje të dokumenteve paraqitur si P38]
- 190) Dëshmia P40, dokument me titull ‘Deklaratë apo padi’ datë 29 dhjetor 2010 që supozohet se është nënshkruar nga AZ;
- 191) Dëshmia P41, Dëshmi mbi pranimin e Konfiskimit e Pëkohshëm të Sendeve 26 mars 2012 nënshkruar nga Michael Pavich dhe dokumente origjinale të cilave u është referuar këtu;
- 192) Dëshmia P42, Shënim për Dosje datë 26 mars 2012 nënshkruar nga Alberto Pasquero;
- 193) Dëshmia P43, urdhrat e gjykatës për përgjimin e tëlëfonëve në posedim dhe përdorim të (a) ES, (b) ST dhe (c) FL, data të ndryshme;
- 194) Dëshmia P44, tre regjistrime DVD të përgjimeve telefonike të (a) ES, (b) ST dhe (c) FL;
- 195) Dëshmia P45, transkriptet e regjistrimeve të DVD në dëshminë P44;
- 196) Dëshmia P46, letër e datës 16 korrik 2013 dërguar Prokurorisë nga Njësia Mbështetëse e Dëshmitarëve;
- 197) Dëshmia P47, Letër e datës 12 korrik 2013 nga prokurori dërguar “Shefit të Programit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të EULEX-it”
- 198) Dëshmia P48, letër e datës 18 korrik 2013 drejtuar Prokurorisë nga Shefi i Departamentit për Sigurimin e Dëshmitarëve;
- 199) Dëshmia P49, Deklarata e AZ dhënë më datë 16 dhe 17 korrik 2007
- 200) Dëshmia P53, letër e datës 3 shtator 2013 nga KFOR
- 201) P54, Letër e datës 4 shtator 2013 drejtuar Prokurorit nga Zyra e EULEX-it për Inteligjencë të krimeve
- 202) Dëshmia C16 letër e datës 29 korrik 2013 nga Shefi i Departamentit mbi Sigurimin e Dëshmitarëve drejtuar Kryetarit të Trupit Gjyqësor
- 203) Dëshmia C12 Letër e datës 30 korrik 2013 nga Zyra e Prokurorit, Mekanizëm për Gjykatat Penale ndërkombëtare, Hagë
- 204) Dëshmia C13 Letër e datës 13 gusht 2013 nga Zyra e Prokurorit, Mekanizëm për Gjykatat Penale ndërkombëtare, Hagë

⁵⁴⁹ Pranuar nga Gjykata gjatë seancës së datës 15 maj 2013

- 205) Dëshmia C14 letër e datës 27 gusht 2013 nga KFOR
- 206) Dëshmia C15, Aktgjykim në lëndën e Zenel Kastratit et al datë 19 mars 2013
- 207) Dëshmia C17, letër e datës 9 shtator 2013 nga Kreu i Zyrës së Ndërlidhjes për Sundimin e Ligjit UNMIK
- 208) Dëshmia C18, email i datës 11 shtator 2013 nga Zyra e Prokurorit, Mekanizëm për Gjykatat Penale ndërkombëtare, Hagë

Dokumente Mjekësore të AZ

- 209) Dokumente mjekësore të AZ nga reparti i Psikiatrisë së Spitalit të Qarkut të Prizrenit data të ndryshme;
- 210) Dokumente mjekësore të AZ nga reparti i Psikiatrisë së Spitalit të Prishtinës, data të ndryshme;

SHTOJCA III

DËSHMITË E PARASHTRUARA NGA MBROJTJA⁵⁵⁰

- 18) Dëshmia e Mbrojtjes **D (NeK) 1**, një grumbull dokumentash prej 32 pgs. Dokument i paraqitur nga Avokati Mbrojtës Mahmut Halimi më datë 6 mars 2012, që gjendet në nëndosjes I të dëshmimeve të Mbrojtjes. Aty përmbidhen:
- ‘Informacije o saobracajnim prekrasajima na Kosovu’, PZ A No. 033264 (në gjuhën serbe);
 - Dy ‘Formular Deklarate’ të ndara të UNMIK-ut, AZ dhe BH (në gjuhën shqipe);
 - Shërbimi Policor i Kosovës, Raport Fillestar/ Incident’, lënda Nr. 2005-GR-5628, 7 nëntor 2005 (në gjuhën angleze);
 - Urdhër i Gjykatës së Qarkut Prizren, Pndr. Nr. 1/2008, 3 janar 2008 (në gjuhën shqipe);
 - Shërbimi Policor i Kosovës, Stacioni i Policisë Prizren, ‘Raporti i policit’, 9 janar 2008 (në gjuhën shqipe);

- Shërbimi Policor i Kosovës, Raport Fillestar/ Incident', lënda Nr. 2008-GI-4, 4 janar 2008 (në gjuhën angleze);
 - Shërbimi Policor i Kosovës, 'Formulari per ekzaminim i laboratorit te kriminalistikes se SHPK-se', lënda Nr. 2007-GA-3880 (në gjuhën shqipe);
 - Kopje e pasaportës së FK dhe 2 fq. tekst në gjuhën shqipe;
 - Aktgjykim i Gjykatës së Qarkut Prizren, P nr. 63/2008, 30 prill 2008 (në gjuhën shqipe);
 - Shërbimi Policor i Kosovës, Raport Fillestar/ Incident', lënda Nr. 2005-XP5-12, 9 qershor 2005 (në gjuhën angleze);
 - UNMIK 'Raport fillestare/ Incident Nr. 2001-JA-4083, 16 nëntor 2001 (në gjuhën angleze);
 - Shërbimi Policor i Kosovës, Raport Fillestar/ Incident', lënda Nr. 2005-XP5-22, 11 shtator 2005 (në gjuhën angleze).
- 19) Dëshmia e Mbrojtjes **D (RM) 1**, letër drejtuar EULEX-it, 14 nëntor 2011, parashtruar nga Avokati Mbrojtës Naim Qelaj, që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes nëndosja I.
 - 20) Dëshmia e Mbrojtjes **D (RM) 2**, Ankesë drejtuar PSRK-së, 29 nëntor 2011, parashtruar nga Avokati Mbrojtës Naim Qelaj, që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes, nëndosja I.
 - 21) Dëshmia e Mbrojtjes D (FL) 1 Ekstrakt nga ditari i AZ.
 - 22) Dëshmia e Mbrojtjes D (FL) 2 Ekstrakt nga ditari i AZ.
 - 23) Dëshmia e Mbrojtjes D (FL) 2a Ekstrakt nga ditari i AZ.
 - 24) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 4a**, Listë e sendeve të konfiskuara NJHKO EULEX, 28 prill 2010 (në Ministri), që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes, nëndosja I.
 - 25) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 4b**, Listë e sendeve të konfiskuara NJHKO EULEX, 28 prill 2010, 29 prill 2010 (në banesën në rrugën Rexhep Lluci; në Llapushnik; në Banje), që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes, nëndosja I.
 - 26) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 4c**, Deklaratë, 5 mars 2012, DL, që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes, nëndosja I.
 - 27) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 4d**, urdhër për bastisje GjPP, 28 prill 2010, PPS 425/09, GjPP 91/10, që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes, nëndosja I.
 - 28) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 5b**, Kërkesë drejtuar Kohës Ditore, 8 shkurt 2012, ES, që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes, nëndosja I.
 - 29) Dëshmia e Mbrojtjes D (FL) 5c Ekstrakt nga ditari i AZ.
 - 30) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 5e**, kërkesë drejtuar Kosova Sot, 8 nëntor 2011, ES; përgjigje nga Kosova Sot, 15 nëntor 2011, n/n, që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes, nëndosja I.

- 31) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 5g**, Kërkesë drejtuar Klan Kosovës, 8 shkurt 2012, ES; përgjigja e Klan Kosovës, 8 shkurt 2012, BH, që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes, nëndosja I.
- 32) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 6**, Njoftim për AZ, 24 gusht 2009, Ministria e Punëve të Brendashme të Kosovës, Departamenti Hetimor, VH, që gjendet në dëshmitë e Mbrojtjes, nëndosja I.
- 33) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 7**, letër e K.Khan QC Drejtuar Krye-prokurorit të EULEX-it, 31 janar 2012 (me dy shtojca: Letër e K.Khan QC drejtuar Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro, 10 janar 2012; përfaqësimi penal i GZ, 29 nëntor 2011), Letër e K.Khan QC drejtuar Prokurorit Special të EULEX-it Maurizio Salustro, 10 janar 2012, Prokurorit Special të EULEX-it I.
- 34) Dëshmia e Mbrojtjes **D (FL) 8**, listë 'Deklarata të cilat Prokurori duhet t'i kishte por që nuk kishte zbuluar kur është marrë në pyetje dëshmitari X' që është dorëzuar gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 7 mars 2012.
- 35) Dëshmia e Mbrojtjes **D (NK) 1**, Raporte të Policisë Ushtarake [data të ndryshme] me numër 1 - 10;
- 36) Dëshmia e Mbrojtjes **D (NK) 2**, Aktgjykim i Gjykatës Komunale në Prizren në lëndën numër 2725/05 datë 15 gusht 2007;
- 37) Dëshmia e Mbrojtjes **D (RM) 3**, letër nga Kryqi i Kuq i datës 11 nëntor 2011
- 38) Dëshmia e Mbrojtjes **D (AK) 1**, Dokumente mjekësore të AK;
- 39) Dëshmia e Mbrojtjes **D (AK) 2**, 5 fotografi me ngjyra ku shihet AK;

Gjykata shqyrtoi gjithashtu të gjitha nëndosjet e fazës paraprake dhe ato të Gjykatës, përfshirë ato që kanë lidhje me shqyrtimin e parë kryesor dhe gjitha ankesat.